

ASPEKTE JURIDIKE KRAHASUESE LIDHUR ME FILLIMIN APO ME MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL KOSOVË-SHQIPËRI

Doktoranti: Murat Hulaj

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(**Shkenca Juridike**), me profil (**E DREJTA PUBLIKE**), për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **PhD.Mirgen Prençe**

Numri i fjalëve: 71768

Tiranë, Dhjetor, 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në përgjegjësinë personale deklaroj, se ky punim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimin e kam shkruar unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri. Punimi nuk përmban ndonjë material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

A u t o r i,

ABSTRAKT

Kohët e fundit jemi dëshmitarë të ndryshimeve të shpeshta në legjislacionin e procedurës penale pothuajse në të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore, me qëllim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të përsheptimit të procedurës penale.

Këto ndryshime janë theksuar, posaçërisht, në njëzet vitet e fundit edhe në shtetet e Evropës Juglindore. Edhe përkundër tendencës që me reforma procedurale t’iu përshtaten sfidave të cilat i parashohin si forma të reja të kriminalitetit, ende mbetet qasja që të gjendet balansi i tendencave për efikasitet të procedurës penale, në njërën anë dhe asaj për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, në anën tjetër. Sistemi dhe zgjidhjet e procedurës penale bashkëkohore janë rezultat i botëkuptimit dhe nevojave të shoqërisë – shtetit bashkëkohor. Për këtë arsye, si karakteristikë e përgjithshme e këtyre ndryshimeve në sferën e legjislacionit të procedurës penale, në përgjithësi, në Evropë është përsheptimi i procedurës penale, si instrument në funksion të efikasitetit të saj. Këto ndryshime nuk lanë pa e prekur edhe legjislacionin e Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë shkrimit të këtij punimi, synimi është përqendruar në aspektet juridike krahasuese rrethë fillimit apo mosfillimit të procedimeve penale, sipas kodeve të mëhershme, aktuale zbatuese në Kosovë dhe Shqipëri, duke pasur parasysh zhvillimin historik të kornizave ligjore të së kalurës dhe Procedurave të tanishme ndër vite, si në Kosovë, ashtu dhe në Shqipëri. Më pas, duke vazhduar me kuptimin dhe rëndësinë e procedimit penal, shkaqet që çojnë në fillimin e procedimit penal, ligjshmërinë e tij, organet përgjegjëse për inicimin dhe ushtrimin e procedimi, prokurorin si subjekt qendror i fillimit apo mosfillimit të ushtrimit të ndjekjes penale, i dëmtuari si subjekt përcaktues për ndjekjen e veprave penale sipas ankimi të tij, dinamika e fillimit dhe mosfillimeve të proc.penale Kosovë-Shqipëri dhe epilogu i vendimëmarrjeve, dhe së fundi Konkluzionet dhe Rekomandimet së bashku me literaturë të shfrytëzuar.

Fjalët kyçe: *Fillimi, mosfillimi, procedimi, krahasim, subjektet,*

ABSTRACT

At the current times we have witnessed frequent changes in the criminal procedure legislation in almost all countries of Western Europe in terms of advancing the protection of human rights and expedite criminal proceedings. These differences are particularly declared in the last twenty years in the states of Eastern Europe. Despite the tendency to fit in the procedural reforms which provided challenges as new forms of criminality, still remains the struggle to find the balance of trends for efficiency of criminal proceedings in one hand and respect for human rights and freedoms, in the other hand. The system of criminal procedure and modern solutions are the result of understanding, the needs of society in modern state. So in general, changes in the area of criminal procedure legislation in Europe are accelerating the criminal procedure as an instrument in view of its effectiveness. These changes also had an impact to the legislations of Kosovo and Albania. While writing this thesis the goal is focused on Legal comparative aspects of initiating or not-initiating criminal proceedings, under previous and current applicable codes in Kosovo and Albania, taking into the consideration the historical developments of legal framework in the past and current procedural aspects throughout the years in Kosovo and Albania. Then, continuing with the meaning and importance of criminal proceedings, causes that lead to starting of criminal proceedings, its legality etc.

Responsible bodies for the initiation and conduct of proceedings, the prosecutor as the central subject for initiating or not initiating the exercise of criminal proceedings, the aggrieved party as subject to prosecution of criminal offenses under his appeal, dynamics of initiating or not initiating Kosovo-Albania criminal procedures and the outcome of decisions, and finally conclusions and recommendations together with the literature used.

Key words: Initiating, noninitiating, proceeding, comparison, subjects

Falenderime

Duke qenë mirënjohës për të gjitha mbresat që kam përjetuar që kur fillova studimet në UET, përvojat që kam fituar këtu do të përpiqem që t'i falënderoj disa prej shumë personave të cilët ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia.

Shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë profesorët, duke filluar nga prof.dr.Ardian CIVICI, prof. dr.Altin SHEGANI dhe të gjithë të tjerët.

Një falënderim të veçantë për profesorin tim, mentorin PhD.Mirgen PRENÇE, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e tij në finalizimin e disertacionit, produkt i shumë orëve konsultimi dhe mbështetjeje nga ana e tij.

Faleminderit profesor!

Falënderoj familjen time për mbështetjen që më ka dhënë, si dhe kolegët dhe bashkëpunëtorët profesionalë për mbështetjen e pakufizuar deri më tani.

Me respekt!

Murat HULAJ

Tiranë, Dhjetor,2016

Përmbajtja

DEKLARATA E AUTORËSISË	iii
ABSTRAKT	iv
ABSTRACT	v
Kapitulli I: HYRJE	- 1 -
1.1. Hyrje dhe bazimi teorik.....	- 1 -
1.2. Objekti i punimit	- 2 -
1.3. Qëllimi dhe rendësia e punimit	- 3 -
1.4. Metodologjia dhe metodat e punimit.....	- 9 -
1.5 Hipotezat dhe pytjet kërkimore të studimit.....	- 12 -
1.6. Burimet.....	- 15 -
1.7. Permbledhja dhe struktura	- 16 -
KAPITULLI II: KUPTIMI I PROCEDIMIT PENAL	- 18 -
2.1. Evoluimi i legjislacionit penal dhe procedural para dhe pas Pavarësisë së Kosovës	- 25 -
Aspekti historik.....	- 25 -
2.2. Veshtrimi historik i legjislacionit procedural-penal Shqiptar, ne lidhje me fillimin dhe mosfillimin e procedimit penal, duke filluar nga viti 1912 deri ne vitin 1995.....	- 31 -
2.3. Fillimi i procedimit penal dhe rëndësia e tij	- 41 -
2.4. Karakteri detyrues i fillimit te procedimit penal	- 43 -
2.5 Ligjshmëria e fillimit të procedimit penal në Kosovë dhe Shqipëri	- 44 -
2.6. Objektiviteti dhe paanshmëria e fillimit të procedimit penal.....	- 47 -
2.7. Objekti i procedimit penal, kuptimi i çështjes penale në procedimin penal.....	- 48 -
2.8. Procedimi penal apo ndjekja penale?	- 50 -
2.9. Hetimi i rasteve penale , si shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale.....	- 56 -
2.9.1. Pezullimi i hetimeve	- 59 -
2.9.2 Pushimi i hetimeve	- 60 -
2.9.3. Kohëzgjatja e hetimeve	- 61 -
2.9.4. Bazat e nevojshme për fillimin e procedimit penal.....	- 66 -
KAPITULLI III: PROKURORI I SHTETIT SI SUBJEKT QËNDROR I FILLIMIT TË PROCEDIMIT PENAL GJATË FAZËS SË HETIMEVE	- 73 -
3.1. Shqyrtime të përgjithshme	- 73 -
3.2. Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë.....	- 74 -
3.3. Parimi i devolucionit dhe substitucionit	- 76 -
3.4. Parimi i hierarkisë dhe i vendosjes në mënyrë monokrate	- 77 -

3.5. Parimet procedurale të punës së prokurorit të shtetit	- 78 -
3.5.1. Parimi i prezumimit të pafajësisë	- 79 -
3.5.2. Parimi i ndalimit të përdorimit të dhunës.....	- 81 -
3.5.3. Parimi akuzator	- 83 -
3.5.4. Parimi i legalitetit dhe oportunitetit	- 84 -
3.6.Policia hetimore –gjyqësore hetimore si subjekt përcaktues për iniciimin e fillimit të procedimit penal.....	- 88 -
Nocioni formal i policisë gjyqësore	- 88 -
3.7. I dëmtuari i akuzës si subjekt themelor i procedimit penal.....	- 92 -
KAPITULLI IV: VËNIA NË DIJENI E ORGANEVE TË NDJEKJES PËR	- 96 -
VEPRA PENALE.....	- 96 -
4.1. Kallëzimi penal.....	- 96 -
4.2. Organet e detyruara me të drejtë për paraqitjeje të kallëzimeve penale	- 98 -
4.3. Format dhe mënyrat e paraqitjes së kallëzimit penal	- 99 -
4.3.1. Kallëzimi anonim	- 109 -
4.3.2. Vetëkallëzimet	- 111 -
4.3.3. Njoftimet me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit.....	- 111 -
4.3.4. Aktet te papërdorshme.	- 112 -
4.4. Referimi i veprës penale të Prokurori	- 114 -
KAPITULLI V: LIGJSHMËRIA E FILLIMIT TË PROCEDIMIT PENAL,	- 115 -
DALLIMI NGA FILLIMI I PALIGJSHËM I NDJEKJES.....	- 115 -
5.1. Përse fillim e jo mosfillim i hetimeve	- 118 -
5.2. Fillimi i procedimit penal në varësi të vendit te ngjarjes.....	- 129 -
5.3. Prokurori si subjekt garantus i ligjëshmërisë së fillimit të procedimit penal	- 132 -
5.4. Sjellja e urdhërit për regjistrimin e procedimit penal	- 133 -
KAPITULLI VI: VENDIMI PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL,.....	- 136 -
KUPTIMI DHE RËNDËSIA E TIJ.....	- 136 -
6.1. Nocioni i kuptimit të mosfillimit penal	- 136 -
6.2. Pjesët e vendimit të mosfillimit penal të hetimeve	- 139 -
6.3. Autorizimi për procedim	- 140 -
6.4. Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.....	- 149 -
6.4.1. Mungesa e vullnetit të të dëmtuarit për ankim?	- 153 -
6.4.2. Fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ose kur del qartë se fakti.....	- 156 -
nuk ekziston	- 156 -
6.5. Parashkrimi i veprës penale pengesë ligjore e fillimit të procedimit penal	- 160 -
6.5.1. Parashkrimi i lëndëve penale në Gjykatat e Republikës së Kosovës, 2011-2012...-	- 163 -
6.5.2. Fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale	- 170 -

6.5.3. Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale.....	171 -
6.5.3.1. Pengesat faktike	172 -
6.5.3.2. Pengesat juridike.....	172 -
6.6. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale	173 -
6.7. Parashkrimi absolut rrethanë e mosfillimit të procedimit penal	173 -
6.8. Lloji i caktuar i veprave penale jo pengesë e fillimit të procedimit penal në çdo	174 -
kohë.....	174 -
6.8.1. Amnistia si rrethanë përjashtuese e ndjekjes penale	175 -
6.8.2. Rastet e tjera të parashikuara me ligj –rastet e gjykuara.....	176 -
6.9. Mosfillimi i procedimit penal si fazë paraprake e procedimit penal	180 -
KAPITULLI VII: DINAMIKA E FILLIMIT APO MOSFILLIMIT TË	
PROCEDIMEVE PENALE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI 2010-2015.....	184 -
7.1. Dinamika pranuese e kallëzimeve penale para riorganizimit të sistemit	186 -
prokorial 2010, 2011–2012, në prokuroritë e Kosovës	186 -
7.1.1. Paraqitje garfike/tabelare e zgjidhjes së kallëzimeve penale në periudhën	187 -
raportues –sipas personave nga viti 2010–2012.	187 -
7.1.2. Rastet e personave që kanë mbetur të pazgjidhura në fund të çdo viti.	189 -
7.1.3.Vendimet gjyqësore nga Gjykatat e R.Kosovës për periudhën 2010-2012	190 -
7.2. Dinamika pranuese e kallëzimeve penale pas riorganizimit të sistemit ...	192 -
prokuroria të Kosovës, 2013, 2014, 2015	192 -
7.2.1. Pasqyra grafike mbi zgjedhjen e kallëzimeve penale sipas personave nga viti .	194 -
2013 deri 2015	194 -
7.2.2. Kallëzime penale të pazgjidhura sipas viteve 2013-2015	196 -
7.2.3. Rastet e zgjedhura sipas personave.....	197 -
7.2.4. Vendimet Gjyqësore 2013-2015	198 -
7.3. Çështjet e regjistruara pranë organeve të prokurorisë në pesë vitet e fundit në.....	199 -
Republikën e Shqipërisë	199 -
7.3.1. Numri i rasteve në ndjekje penale, për vitet 2011 deri 2015 në R. SH.	200 -
7.3.2. Analizë statistikore e pezullimeve të procedimeve penale për vitet 2011 deri 2015	
në R. Shqipërisë	200 -
7.3.3. Dinamika e mosfillimeve të procedimeve penale në Shqipëri 2011-2015	202 -
7.3.4. Volumi i punës në hetim nga viti 2011 deri 2015.....	203 -
7.3.4.1 Volumi i punës i organit të prokurorisë për çështje të përfaqësuara në gjykata për	
vitet 2011 deri 2015.....	204 -
7.3.4.2. Të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet .	205 -
paraprake për vitet 2011 deri 2015	205 -
7.3.4.3. Të dhënat statistikore për pafajësinë e të pandehurve për vitet 2011-2015 .	207 -

KAPITULLI VIII: KONKLuzionet dhe Rekomandimet	- 208 -
LITERATURA dhe Bibliografia.....	- 231 -
Tregues i Shkurtimeve:	- 240 -

Kapitulli I: HYRJE

1.1. Hyrje dhe bazimi teorik

Nisur nga numri i madh i kallëzimeve të paraqitura në organet e policisë dhe prokurorisë, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, për të cilat nga ana e organit procedus, është vendosur mosfillimi i procedimit penal e që ka ardhur duke u rritur nga viti në vit për të identifikuar përmasat e mosfillimit, praktikat dhe opinionet e ndryshme që ekzistojnë në këtë drejtim, mendova të trajtoj fillimet dhe, kryesisht, mosfillimet e procedimeve penale, si nga ana teorike, ashtu edhe duke u përpjekur të sjell edhe përvojën time si punonjës i praktikës, me një përvojë relativisht të gjatë në organin e prokurorisë dhe në organe të tjera që ndërlidhen me sundimin e ligjit. Dëshira për të dhënë mendimin tim për përmirësimin e punës në këtë drejtim e përse jo edhe të Kodeve të Procedurës Penale si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, është edhe arsyeja se përse unë e zgjodha këtë temë për për trajtim.

Të shqyrtosh fillimin apo mosfillimin e procedimit penal do të thotë që ke ardhur në një moment më të rëndësishëm të procedurës penale. Të dish të marrësh vendime të arsyeshme dhe të bazuara në dispozitat ligjore dhe në prova që ke para vetes, të cilat nëse janë vlerësuar si të pabaza, nuk do të duhej të mbizotëronte arsyeja e marrjes së vendimit për fillim hetimesh, sepse, në këtë mënyrë, do të ishim para një hetimi të panevojshëm. Kjo gjë nënkupton një detyrim ligjor që i kërkohet çdo profesionisti në punën e tij të përditshme dhe, kështu krijohet mundësia për një përqendrim forcash profesionale të punës së përditshme në çështjet që shtrohen para teje për të vendosur.

Pikërisht për këtë arsye, në këtë drejtim, duhet të rritet kujdesi nga ana e organit procedues, në verifikimin e kallëzimeve dhe provave që ndodhen si mbështetje e kallëzimeve penale.

Duhet të shtohet profesionalizimi në vlerësimin dhe në gjykimin e tyre, duke marrë vendime të arsyetuara për mosfillimin e procedimit penal, me përjashtim të rasteve kur ekzistenca e rrethanave shpie në pamundësinë ligjore që të fillohet procedimi penal. Me kujdesin e treguar në këtë drejtim, ky tregues i punës, në prokuroritë dhe në gjykatat e të dyja vendeve, ka përjetuar ndryshime sa i përket mosfillimit të procedimit penal, prej vitit në vit. Kështu, në prokuroritë e Kosovës, prej vitit 2010 deri në vitin 2015, përveç shkaqev që na paraqiten rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, na paraqiten situata të ndryshme ndër vite. Nga viti 2011 deri në vitin 2015 kemi rritje, prej viti në vit. Gjithashtu edhe në RSH, sipas të dhënave statistikore të analizuar dhe vlerësuara është vërejtur ngritje e mosfillimeve të procedimeve nga viti në vitë shprehur në përqindje prej 13% gjerë në 26%. Më gjerësishtë do të paraqiten në kapitullin e shtatë të këtij punimi, përmes tabelave dhe grafikëve, fillimisht për Kosovën, e pastaj edhe për Shqipërinë.

1.2. Objekti i punimit

Ky punim ka për objekt trajtimin juridiko krahasor, fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, Kosovë-Shqipëri, vlerësimin dhe analizimin teorik dhe praktik të rasteve. Punimi është ndarë në tetë kapituj ku, më saktësisht përmbajtja e secilit kapitull veç e veç do të pasqyrohet në përmbledhje dhe strukturë të punimit.

Objekt i këtij punimi, i cili ndërlidhet me aspektin krahasues të kuadrit ligjor, për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, është përzgjedhur për ta trajtuar dhe për të identifikuar karakteristikat e përbashkëta dhe të veçantat e tij. Punimi, tiparet e tij, duke hedhur një vështrim mbi zhvillimin historik të legjislacionit penal dhe procedural ndër vite, në Kosovë dhe në Shqipëri, duke evidentuar përparimet e legjislacioneve penale dhe procedurale, rolin dhe autorizimet e subjekteve të procedimit penal krahas evoluimeve kohore të zhvillimeve,

shkaqet që çojnë në fillimin e procedimit penal, ligjshmërinë e tijë, duke vazhduar me mosfillimin e procedimit penal, specifikat e fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, dinamikat zhvillimore rreth fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal Kosovë–Shqipëri, 2011–2015, konkluzionet dhe rekomandimet, si dhe literatura e përdorur gjatë mbarështimit të këtij punimi, bëjnë që ky punim të jetë(dalë) më komplet,më cilësor dhe pranueshëm për të gjithë ata qe merren me këtë lëm(fushë).

1.3. Qëllimi dhe rendësia e punimit

Qëllimi i këtij studimi ka të bëjë me faktin se, legjislacioni Kosovar procedural dhe ai Shqiptar deri në çfarë shkalle garanton sigurim ligjor për fillim apo mosfillim të procedimit penal ligjor, efektiv, të paanshëm dhe të pandikuar, bazuar në dispozitat specifike të brendshme, duke pasur parasysh edhe standartet ndërkombëtare që kushtetutat e këtyre vendeve i kanë të inkuorporuara për t'i implementuar ne situatë të caktuara.Nga kjo analizë do të lindin ide për krijimin e një sistemi efikas të drejtësisë për të përmirësuar Kodet Pr. Penale të të dyja vendeve, duke bërë dhe paralelizimin me RK dhe RSh, si një garanci për zbatimin në praktikë me përpikmëri dhe për krijimin e një drejtësie efektive për kallëzimet e paraqitura, ndaj të cilave duhet vendosur me fillim apo mosfillim procedimi penal, në sajë të provave dhe kushteve ligjore, të cilat domosdoshmerisht organi procedues t'i ketë parasyshë në çdo rast konkret.

Qëllim tjetër, i këtij studimi do të jetë evidentimi i evoluimit-përmirësimit ndër vite të Legjislacionit Penal Kosovar, para dhe pas pavarësisë së Kosovës, si dhe ai Shqiptar rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, duke filluar vështrimin historik në këtë drejtim që nga e drejta zakonore shqiptare, dispozitat e Kodit Penal Otoman e deri në dispozitat e legjislacionit të sotëm penal. Duke shfrytëzuar metodën e krahasimit do të

nxirren në pah përmirësimet e bëra dhe evolimi i këtyre instituteve.

Studimi ka për synim të trajtojë terma të tillë si: dispozitat që i referohen institutit të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal, sa janë të mjaftueshme; subjektet procedural janë në nivel të detyrës, a do duhej egzistenca e një autoriteti ligjor për kontrollimin e organeve të ndjekjes? A do kishte për të sjellë disiplinim ky organ tek organet ndjekse për mosmarrje vendime fillimi dhe mosfillimi të kundërligjshme, ku si rezultat do mund të themi se jemi para obligimit ligjor të respektimit të të drejtave të njeriut, ndërjegjësimit të subjekteve pjesëmarrëse në një procedim penal, për zbatimin me korrektësi të dispozitave në favor të të pandehurit, paralelizimi i K.Pr.Penal me Kushtetutën dhe Konventat Europiane, duke i studiuar në kompleksitet këto terma për të arritur në një kuptim sa më të drejtë të termave juridiko-penale.

Qëllim tjetër, i studimit është të përcaktohet qartë se sa respektohen realisht dispozitat që i referohen institutit të fillimit apo mosfillimit të procedimit penal nga ana e subjekteve inicuese ligjore, filluar nga policia, i dëmtuari dhe nga vetë prokurori, sipas detyrës zyrtare. Më saktësisht këto do të shtjellohen në kapitullin e tretë të këtij punimi.

Vlen të theksohet se qëllim tjetër, i radhës është aspekti krahasor i dispozitave ligjore të Kodeve Penale Procedurale të Kosovës dhe Shqipërisë, që i referohen fillimit dhe mosfillimit penal procedural, zhvillimit të kornizave ligjore të së kaluarës dhe procedurave të tanishme dhe ndër vite, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.

Më pas, duke vazhduar me kuptimin dhe rëndësinë e procedimit penal, shkaqet që çojnë në fillimin e procedimit penal, ligjshmërinë e tij, identifikimin zhvillimor të dinamikës rritëse apo mosrritëse të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal, Kosovë –Shqipëri, nga periudha e regjistrimit të studimeve që nga viti 2011 e gjër në fund të vitit 2015, duke pasqyruar të dhëna sasiore të procedimeve filluse dhe mosfilluse për tërësi vitësh dhe veçanti vitesh nga ana e prokurorive, e së fundi pasqyrimet e vendimarrjeve gjyqësore.

Të gjitha këto qëllime të përmendura dhe të tjera të papërmendura, të cilat evidentohen gjatë punës studimore, janë në shërbim të pengimit dhe të luftimit të kriminalitetit e që për këtë angazhohen organe e institucione të ndryshme si: policia, prokuroria dhe gjykata. ndër të cilat vlen të përmendet se policia, për inicim rastesh, ndërsa prokuroritë, për zhvillime hetimesh dhe për mbikëqyrje së policisë, dhe është ndër organet më përgjegjëse për vendosje të fillimit apo mosfillimit të procedimit penal ndaj personave për të cilët perceptohet nga organi ndjekës, se egziston standardi minimal i dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepra penale apo standarti i dyshimit të bazuar mirë se është kryer vepra penale, dhe, së fundi, gjykatat, për dhënie verdikti, drejtësi. Format e reagimit të organeve të përmendura, në drejtim të luftimit të kriminalitetit, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në mbrojtjen e pasurisë së tyre, konsistojnë në hetimin e rasteve penale, të cilat duhet të ndërmerren në përputhje me suaza të përcaktuara me ligj. Në fund këto mund të kurorëzohen me ngritjen e aktakuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykatë, ose, në mungesë të provave, me pushimin e hetimeve. **“Sistemi dhe zgjidhjet e procedurës penale bashkëkohore janë rezultat i botëkuptimit dhe nevojave të shoqërisë – shtetit bashkëkohor”, thotë Dimitrijevič¹.**

Për këtë arsye, karakteristikë e përgjithshme e këtyre ndryshimeve në sferën e legjislacionit të procedurës penale, në përgjithësi, në Evropë, është përshpejtimi i procedurës penale, si instrument në funksion të efikasitetit të saj. Këto ndryshime nuk lanë pa prekur edhe legjislacionin e Kosovës dhe të Shqipërisë.

Pas ndërhyrjes ndërkombëtare ushtarake, në vitin 1999, kundër regjimit diktatorial në Serbi, përkatësisht në Republikën Federale të Jugosllavisë, në Kosovë u krijua një realitet i ri politik, juridik dhe ekonomik. Në një situatë të tillë, që karakterizohet me çrregullimin e jetës shoqërore dhe me një vakuum juridik dhe institucional, në ndërtimin dhe

¹ Dimitrijevič, Dragolub, E Drejta e procedurës penale, Beograd, 1976, fq.57.

funksionimin e shtetit juridik, krahas institucioneve demokratike, domosdoshmërisht është paraqitur nevoja imanente edhe për ndërtimin e një infrastrukture të re ligjore në të gjitha sferat e jetës shoqërore e, me këtë rast edhe në fushën e së drejtës penale.²

Në kushtet e një mungese absolute të legjisllacionit dhe për t'u shkëputur nga vazhdimësia e sistemit të vjetër, Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, – UNMIK³-ut, në fillim, si instrument për rregullimin e kësaj fushe, zgjodhi institutet e rregulloreve, si ato të Rregulloreve 1999/1 dhe 1999/24. Më këto Rregullore u vendos që, ligji i aplikueshëm, në Kosovë, të jetë legjisllacioni që ishte në fuqi para 22 marsit 1989. Këto ligje janë shpallur të aplikueshme për hir të sundimit të ligjit dhe të moslejimit të krijimit të vakuumit juridik deri në miratimin e ligjeve të reja.

Prandaj edhe reforma ligjore në fushën e së drejtës penale, filloi me një mori rregulloresh e urdhrash administrative. Ndërsa, me hartimin e Kodit Penal dhe atij të procedurës penale⁴ dhe, me hyrjen e tyre në fuqi, më 6.4.2004, në Kosovë u bë një hap i madh drejt shoqërisë demokratike, të mbështetur në parimin e sundimit të ligjit. Procesi i hartimit të këtyre dy kodeve është bërë me një bashkëpunim të ngushtë në mes të ekspertëve kosovarë, si: prof. dr. Ejup Sahiti, prof. dr. Ismet Salihu dhe dr. Blerim Reka dhe ekspertëve ndërkombëtarë si përfaqësues të UNMIK-ut, OSBE-së, ABA/CEL-it (American Bar Association for Central and East European Law Initiative) dhe, në veçanti, Këshillit të Evropës⁵. Në miratimin e këtyre dy kodeve, ishte evident ndikimi i faktorit ndërkombëtar, ndikim ky që vërehet edhe në miratimin e Kodit të ri të Procedurës

² Kurmehaj, Agim punimi i magjistraturës Autorizimet e Policisë në procedurën penale – Punim i magjistraturës, Universiteti i Prishtinës- 2006, fq. 5.

³ Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë u vendos me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, 10 qershor 1999.

⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/26, të datës 6.7.2003 dhe ka hyrë në fuqi në datën 6.4.2004.

⁵ Sahiti, E. dhe Rexhep Murat. 2003, f. 12.

Penale, i cili hyri në fuqi më 1.1.2013⁶. Karakteristikë e këtij ndryshimi është se mori më shumë tiparet e një sistemi ku dominojnë elementet e tipit akuzator të procedurës penale, tipar këto, sidomos të theksuara në shqyrtim gjyqësor, por edhe me rolin e ri të subjekteve të procedurës penale. Me këtë rol të ri gjyqtari i procedurës paraprake⁷ merr vendime lidhur me zbatimin e veprimeve dhe masave në procedurën paraprake me të cilat kufizohen të drejtat dhe liritë themelore të personit. Prokurori i shtetit është përgjegjës për ndjekjen dhe hetimin e veprave penale, më saktësisht fillimin dhe mosfillimin e procedimit penal. Sipas këtij legjislacioni, i pandehuri fiton më shumë garanci procedurale në ushtrimin e mbrojtjes së tij dhe shfaqet barazia e palëve në procedurën penale (neni 9 i KPP-së). Në dallim nga KPPP-ja, në kodin e ri, ndjekja penale është në kompetencë ekskluzive të prokurorit (nuk ka paditës subsidiar)⁸.

Në këtë punim të nivelit doktoral do të trajtohet tema "*Aspektet juridiko-krahasore të fillimit apo mosfillimit të procedimit penal Kosovë–Shqipëri*", me ç'rast përveç subjekteve të tjera që bartin përcaktueshmëri ligjore autorizuese rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, figura e prokurorit të shtetit është autoriteti përfundimtar ligjor si organ i pavarur shtetëror. Autorizimet dhe veprimtaria e tij që ka gjatë fazës së hetimeve, e pikërisht në kuadër të procedurës paraprake, sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të vitit 2004, si dhe tani, sipas Kodit aktual në aplikim nga 1 janari 2013⁹.

⁶ Kodi i Procedures Penale ligj Nr. 04/L-123, datë 15.5.2012 ndryshuar me ligjin nr.04/L-273, GZ 32/2014, datë 15.5.2012

⁷ Termi "gjyqtar i procedurës paraprake" është një term i ri, i paraparë për herë të parë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca deri para ngritjes së aktakuzës të marrë vendim për caktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit, pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale (neni 268, par.4).

⁸ Paditës subsidiar sipas Kodit të Përkohshëm të Pr.Penale vitë 2004 të Kosovës, është paditesi i autorizuar për ndermarrjen e ndjekjes penale ne rastet kur prokurori publik hedhë kallzimin penal, pushon hetimin apo terhiqet nga aktakuza para apo gjatë shqyrtimit gjyqësor.

⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013.

Në këtë punim do të trajtohet dhe analizohet dinamika e detyrave të prokurorit të shtetit, si subjekt qendror i procedurës paraprake për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, kompetencat e tij në luftimin e kriminalitetit, duke përfshirë kalimthi periudhën e ish-Jugosllavisë, të LPPJ të vitit 1976, pastaj KPPP e deri me kodin e ri, dhe krahasimin juridiko-normativ rreth procedimit të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal me rajonit e Shqipërisë. Gjithashtu, do të përdoren, siç u përmend më sipër metoda historike, ajo analitike, statistikore, sistemike, analizës teorike, logjike e analizës teologjike dhe metoda e rasteve praktike për të pasqyruar një qartësim studimi për temën, njëherit duke pasqyruar dhe identifikuar rolin e subjekteve procedural në fazën e procedimit paraprak penal filluar nga policia, prokuroria dhe gjykata një pasqyrë të qartë në lidhje me detyrat dhe rëndësinë e prokurorit gjatë fazës së procedimeve hetimore, do të përpjekem në pasqyrojm edhe shembuj praktikë dhe në fund do të trajtojmë aspektin proceduralo-penal. Arsyeja kryesore e trajtimit të kësaj teme, në radhë të parë është studimi analitik-kritik i autorizimeve të subjekteve që marrin pjesë në një procedim penal, duke filluar nga policia hetimore-gjyqësore, prokurori i shtetit dhe në fund nga vetë gjykatat. Këto organe, si në Kosovë, ashtu dhe në Shqipëri, janë të ngarkuara me detyrimin ligjor për ndjekjen dhe kërkimin e dënimeve ndaj atyre që vërtetohet se kanë kryer vepra penale, duke zgjeruar fokusimin në autorizimet dhe kompetencat e subjekteve, në veçanti, të prokurorit të shtetit, gjatë fazës së hetimeve, si fazë paraprake e procedimit dhe specifikat e kësaj veprimtarie procedurale. Së fundi, mendoj se, në literaturën juridike-penale, në Kosovë dhe Shqipëri kanë munguar studimet shkencore në këtë fushë. Pikërisht për këtë çështje, konsiderohet se studimi i një teme të tillë është në dobi dhe interes shoqëror.

1.4. Metodologjia dhe metodat e punimit

Metodologjia e studimit do t'i përgjigjet arritjes së qëllimeve të këtij punimi. Në varësi të hipotezës, apo pyetjeve që do të ngrihen në kapituj të veçantë të punimit, do të zbatohen edhe metodat e hulumtimit shkencor.

Gjatë mbarështimit dhe shtjellimit të këtij punimi, kam përdorur metodologjinë e kombinuar. Arsyeja, e përcaktimit për këtë metodologji janë nga shkaqet parimore dhe për nevoja e studimit. Nuk ka pasur dhe nuk ka mundësi, që për natyrën e këtij studimi të ndalemi vetëm me një metodologji, sepse studimi do të mbetet i mangët dhe jo gjithëpërfshirës. Kemi të bëjmë me studim nga fusha e të drejtës procedurale dhe penale dhe vetëm aplikimi i një metodologjie do të na orientonte tek përfundime jo konkrete dhe të mangëta.

Më qëllim që punimi të jetë sa më cilësor, i dobishëm dhe i pranueshëm për punonjësit e praktikës në sistemin e drejtësisë, qoftë si prokurorë apo gjyqtarë, studentë dhe persona të jetës akademike, për mbarështimin e këtij disertacioni kam përdorur ca prej metodave shkencore të cilat i kam vlerësuar se shkoinë në dopi të punimit dhe ato : **metodën historike, metodën juridiko krahasimore, metodën e mbledhjes së të dhënave cilësore, analizën e të dhënave, metodën e Intervistës gjysmë strukturore, metodën e analizës sistemike, metodën e analizës teorike, metoda e analizës logjike, metodën e analizës teleologjike dhe metodën e studimit të rasteve praktike.**

Ne vijim radhazi do të justifikojm arsyen e secilës prej tyre pse janë apliku?, gjatë mbarështimit të punimit duke filluar:

Metodat Historike, është përdorur për të shpjeguar zhvillimin historik të evoluimit të normave të të drejtës procedurale dhe penale, në kontekst të fillimit apo mosfillimit të procedimit penal në Kosovë në periudhat e caktuara, nga viti 1918-1941 dhe 1999-2003 e në vijim, dhe në Shqipëri filluar nga viti 1912 e deri në vitin 1995 e në vijim.

Metoda juridiko – Krahassimore Kosovë -Shqipëri është përdorur për të krahasuar normimet e legjislacionit penal dhe procedural kosovar dhe atë Shqiptar ndër vite, ekzistencën e instituteve të përfshira aktualisht në të dyja legjislacionet e vendeve përkatëse, duke u përpjekur që të sqaroj se a janë të njësuara(unifikuara) ndërmjet tyre dhe me nevojat e praktikës, se a ka nevojë ndërhyrjeje dhe ndryshimesh në legjislacionet ekzistuese të të dyja vendeve, në mënyrë që zhvillimi i një procedimi penal i fillimit apo mosfillimit të jetë edhe më i lehtë për t’u proceduar nga organet kompetente.

Metoda e mbledhjes së të dhënave statistikore, është përdorur për të nxjerrë përfundime, duke paraqitur të dhëna statistikore në tërësi vitesh dhe, në veçanti, vitesh në situata të veçanta.

Metoda statistikore është përdorur në këtë punim për të kuptuar se sa është dinamika e e fillimit dhe e mosfillimit të procedimit penal, duke bërë një krahasim ndër vite, në Kosovë para organizimit të sistemit gjyqësor dhe atë për vitet 2010-2012 dhe për vitet 2013 -2015 pas riorganizimit të sistemit të ri prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë¹⁰. Poashtu kjo metodë ka shërbye edhe për të bërë krahasimin e fillimit, apo mosfillimeve në Shqipëri, për vitet 2010–2015, në saktësi të numrit pranues të kallëzimeve penale. Se sa kjo metodë ka qenë në funksion të shërbimit për punimin, më gjerësisht do të paraqitet në kapitullin e VII të punimit si tërësi dhe veçanti për vitet, për periudhën tani të theksuar Kosovë–Shqipëri.

Metoda e Intervistës gjysmë strukturore, është përdorur për të dhënë sqarime për nocione e fenomene nga prokurorë, gjyqtarë, zyrtarë etj. Intervistat përdoren vetëm për qëllimi sqarimi dhe mbështetjen anonime.

¹⁰ Të dhëna këto që i referohen kur sistemi i prokurorive dhe gjykatave në Kosovë, kishte emërtim gjykata/prokurori komunale; gjykata/prokurori të Qarkesh dhe Gjykat Supreme para vitit 2013, ndërsa tani ka emërim tjetër si gjykatat /prokurori themelore; gjykata/prokurori Apeli, ndërsa gjykata Supreme mbetet e pandryshuar sa i përket emërimit.

Metoda e Analizës Sistemike, është përdorur për të përshkruar pozitën e normës brenda sistemit juridik, në Shqipëri dhe në Kosovë. Përdorimi i kësaj metode ka shërbyer për gjetjen e vendit të normës penale në brendi të sistemit juridik të Kosovës dhe të Shqipërisë. Këto norma duke u përdorur këto metoda, janë gjetur në norma kushtetuese (p.sh. Parimi i publicitetit, parimi i legalitetit, prezumimi i pafajësisë, etj); në norma të ligjeve organike (Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi Penal i Shqipërisë, Kodi i Procedurës Penale, etj) dhe, në norma blanket, ku kemi gjetur norma që i përkasin temës në ligje të tjera, të cilat rregullojnë marrëdhënie tjera juridike, por që mund të kenë implikime penalo juridike..

Metoda e analizës teorike, është përdorur për të shpjeguar nocione nga aspekti teorik i normës. P.sh., përshkrimi dhe sqarimi i parimit *nullum crimen sine lege* etj. Metoda është përdorur për të analizuar literaturë të gjerë, e cila ka udhëzuar përdorimin e normave juridike, të pranura përgjithësisht janë në numër jo të vogël. Parimi dhe përdorimi i tij teorik, metoda e të cilit është se nuk ka “dënim pa ligje”. Ky parim dhe parimet si, in dubio pro reo, reformatio in peius, latinisht car su etj, janë parime të përdorura gjithandej në histori dhe janë shtjelluar teorikisht. Prandaj, ka qenë e nevojshme që kjo metodë të përdoret në kontekst të konkretizimit praktik të këtyre nocioneve teorike.

Metoda e analizës logjike është përdorur për të shpjeguar normat juridike për nevoja të studimit, duke përdorur rregullat e logjikës, në veçanti, të logjikës juridike, si, p.sh. interpretimi logjik i normës juridike.

Metoda e analizës teleologjike, është përdorur për të shpjeguar qëllimin e normës. Kjo metodë është përdorur për të sqaruar qartë dhe hollësisht qëllimet e nxjerrjes së normave të reja juridiko penale në Shqipëri dhe Kosovë, në kuptim dhe në kontekst të fillimit apo mosfillimit të procedimit penal. Është e qartë se metoda teleologjike ka qenë e pashmangshme për t’u përdorur sepse shtjellimi i normave dhe, aq më tepër propozimi

për zbatimin e tyre në praktikë, nuk mund të merret me mend pa u kuptuar qëllimi esencial dhe përfundimtar i normës juridiko penale

Metoda e rasteve praktike, është përdorur për të sqaruar raste nga praktika që kanë ndodhur dhe për të cilat janë marrur vendime nga organet proceduse rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, në mënyrë meritore, apo, jo meritore si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Në vend që organi procedus të marrë fillim procedimi ka marrë mosfillim procedimi dhe anasjelltas, ashtu që, në saje të ankimeve, gjykatat, apo prokurori i përgjithshëm ka sjellur vendime vertetuese të organit ndjekës apo edhe vendime të kundërta.

1.5 Hipotezat dhe pytjet kërkimore të studimit

Në përjasje të legjislacionit penal – procedural, Kosovar dhe Shqiptar, dhe të akteve ndërkombëtare, që i kushtojnë një hapësirë të rëndësishme institutit të fillimit apo të mosfillimit të procedimit penal, ligjvënësit tanë, në Kosovë dhe ata të Shqipërisë, kanë bërë përpjekje maksimale për të garantuar normime adekuate, të përshtatëshme për këtë institut të rëndësishëm procedural. Mirëpo, përkundër kësaj, akoma mbetet sfida e këtyre organeve për të avancuar me normime dhe amandamentime edhe më tej, për një siguri të mëtejme procedimi dhe për një lehtësim të punës së organeve proceduse në këtë fazë fillimore të procedimit penal. Këtë studim, do ta shqyrtojmë përmes disa hipotezave, të cilat do të na shërbejnë si pikënisje për të evidentuar problematikat që lidhen me temën e studimit, të zgjedhur për trajtim.

Për këtë studim ka mjaft rëndësi, jo vetëm parashtrimi teorik i kuadrit ligjor të procedurës penale dhe akteve ndërkombëtare, por edhe pasqyrimi i problematikave, unifikimit të praktikave gjyqësore, rasteve konkrete, të shprehura me vendimet e organeve proceduese

që i referohen fazës së fillimi apo mosfillimit të ligjshëm apo të paligjshëm të tij. Të gjithë kapitujt e paraparë për shtjellim të këtij studimi do ti shërbejnë Hipotezave të tij dhe dhënies së përgjigjigjeve për pyetjet kërkimore të ngritura në të.

Në punën time si prokuror, nga viti 2004, jam ballafaquar shumë me fillimin dhe mosfillimin e procedimit penal, në mbikëqyrjen e veprimeve fillestare të policisë, duke ju ndihmuar në dhënien e urdhërave, sugjerimeve dhe këshillave të nevojshme, që në fazën e parë të procedimit penal. Gjithnjë duke pasur parasysh respektimin e të drejtave të njeriut, si të dyshuar, apo të pandehur, se kishin për të kryer, apo kanë kryer vepër penale.

Në këtë punim janë ngritur këto hipoteza:

I. Ekzistencën e një autoriteti ligjor specifik, për të mbikëqyrë dhe monitoruar punën e njesisë autorizuese të performancës, të autorizuar për prokurorë në Kosovë, me rastin e avancimeve të tyre në detyrë, sjellë shtytje të disiplinimit profesional të tyre, njëkosishtë vëmendje për të marrë vendime meritore, gjatë fazës hetimore, për fillim apo mosfillim të procedimit penale të ligjshëm.

II. Decentralizimi i kompetencave të Prokurorit të përgjithëshshëm në Shqipëri në raport me prokurorët e rangut më të ulët, është domosdoshmëri për ta evituar të drejtën absolute të tij në vendimmarrje që, fillimin apo mosfillimin e ankimuar, në çdo kohë ta shendërrojë në të kundërtën e vendimit të marrë nga prokurori vlerësues i çështjes, sepse te opioni shfaqet ndjenja e pasigurisë në autoritetin e sistemit prokurorial rreth ushtrimit , të procedimit penal.

III. Ekzistenca e rregullimit normativ lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore në Shqipëri është më praktike, ngase për zbatimin e tyre përkujdeset prokuroria, për dallim nga Kosova, ku, për zbatimin e vendimeve përkujdeset Gjykata.

IV. Në mes të qasjeve Shqiptare dhe Kosovare ka të ngjarë që ekziston një qasje e ndërmjetme, që nxjerr më të qartë qëllimin dhe objektivat e studimit.

Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të studimit janë:

1. Çfarë kuptohet efektivisht dhe praktikisht me termin e institutit, “Fillim apo mosfillim”, te procedimit penal? sa respektohet ky institut nga organet e autorizuar? Kush duhet të monitorojë zbatimin e tyre? Cilat janë trajtimet juridiko-penale të këtyre problematikave?
2. Si ka evoluuar zhvillimi i kuadrit ligjor rreth fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal, në Kosovë dhe Shqipëri, mbrenda vetë sistemeve të brendshme të tyre, dhe në spektrin krahasimor të tyre ndër vite?
3. Çfarë duhet bërë për të mospasur procedime penale të panevojshme dhe e kundërta?
4. A mbizotëron arsyeja e shtimit të numrit të veprave penale në kodet aktuale për ndjekje penale sipas iniciativës së të dëmtuarit? Nëse po për të cilat duhet dhënë propozim amendamenti?
5. Çfarë duhet të bëjnë krerët përgjegjës për ta zvogëluar parashkrimin e ndjekjes penale ndaj kryesve të veprave penale? A është punuar mjaftueshëm në këtë drejtim?
6. A do të duhej të kalojë përkujdesja e ekzekutimeve të vendimeve të formës së prerë në përkujdesje të Prokurorit të Shtetit në Kosovë, siç është në Shqipëri, përmes rregullimit normativ ligjor?

7. Çfarë duhet ndërmarrë që, kontrolli i punës së Policisë, Prokurorëve dhe Gjyqëtarve në Kosovë dhe Shqipëri, të përmirësohet? A janë të koordinuar këto tri segmente mesë veti?
8. A janë autorizimet dalluese ligjore në mes të Prokurorit të përgjithshëm në Shqipëri dhe Kryeprokurorit në Kosovë?
9. A duhet të vazhdojë procedimi i filluar, apo duhet të pushojë menjëherë pas vdekjes së autorit të krimit, i zbuluar më vonë?
10. Çfarë zgjidhjesh do të sillte përcaktimi i një autoriteti monitorues i veshur me autorizime ligjore të veçanta, për mbikëqyrjen e fillimit apo mosfillimin e procedimeve penal, kohë pas kohe, si preventivë pune?
11. A është i plotë legjislacioni Kosovë dhe ai Shqiptar përse i përket kuadrit ligjor për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal?

1.6. Burimet

Për nevojat e studimit është konsultuar dhe përdorur një mori burimesh, të cilat kategorizohen si më poshtë:

1. **Burimet parësore**, përfshijnë aktet ndërkombëtare që veprojnë në drejtim të

respektimit ligjor të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal, si : Konventat,

Rekomandimet, Deklaratat e aktet e tjera të organizmave të ndryshme

Ndërkombëtare, kushtetutat, kodet e procedurës penale, Kodet Penale Kosovë –

Shqipëri, ligjet, aktet nënligjore etj.

2. **Burimet dytësore**:Përfshihen tekste të autorëve të njohur vendorë dhe ndërkombëtarë,

monografi, punime shkencore që janë marrë me trajtime të procedimeve penale,

Vendimet e rasteve të praktikës hetimore e gjyqësore të procedimit penal që evidentoj

ligjëshmeri hetimi dhe kundërligjshmëri hetimi, si dhe mosfillimet që evidentojnë

poashtu ligjshmërinë e fillimit apo kundërligjshmërinë e tij, duke nxjerrur në pah

faktin se sa zbatohen dispozitat ligjore së interpretuari nga organet e ndjekjes.

3. Burimet terciare, web faqe, revista shkencore periodike, gazeta etj.

1.7. Permbledhja dhe struktura

Punimi, i cili synon të trajtojë pikat e përmendura ne seksionet e cekur më lartë, do të jetë i sistemuar në tetë kapituj. Nga aspekti teknik më tutje, punimi është ndarë në nënkapituj, varësisht nga trajtimi, studimit dhe rëndësia e çështjeve.

Në kapitulli i parë, të punimit, fillohet me trajtimin e pjesën hyrëse ku përfshihet hyrja dhe bazimi teorik, objekti i punimit, qellimi dhe rëndësia e punimit, metodologjia dhe metodat e punimit, hipotezat dhe pyjet kerkimore , burimet dhe në fund përmbledhja dhe struktura.

Kapitulli i dytë, – “Kuptimi dhe rëndësia e fillimit apo mosfillimit të procedimit penal Kosovë–Shqipëri”, në këndvështrime të faktorëve historik e social, duke e nxjerrur në pah, përmirësimet e bëra në legjislacionin penal Kosovar dhe atë Shqiptarë. Në Kosovë sipas periudhës (1945–2013) dhe në Shqipëri (1912–1995), përkitazi me përparimet zhvillimore, të fillimit dhe mosfillimit te procedimit penal. Më pastaj duke vazhduar me nën kapitullin, përse fillimi i procedimit penal është në interes të publikut, për zbulimin e rastit penal, si në Kosovë poashtu edhe në Shqipëri. Vazhduar me atë se fillimi dhe mosfillimi procedus ka karakter detyrues, duhet të jetë ligjor, objektiv dhe i paanshëm. Pastaj duke u fokusuar dhe shtjelluar se çfarë është objekti i procedimit penal, kuptimi i çështjes penale të procedimit penal , se si fillohet procedimi apo ndjekja penale, se çfarë mbart në vete hetimi, si shprehje e ndjekjes penale, pa anashkaluar bazat e nevojshme dhe rëndësinë e fillimit të procedimit penal.

Në kapitullin e tretë pasqyrohet një shtjellim përkitazi lidhur me “Organet përgjegjëse për fillimin e procedimit penal-paraprak”. Më këtë rast fillojmë nga prokurori i shtetit si subjekt themelor-qendror i fillimit të procedimit penal gjatë fazës së hetimeve, duke pasqyruar një vështrim të shkurtër të f-ionit të organit ndjekës, të para luftës së ndodhur në Kosovë, pas luftës, dhe ndryshimet që u bënë në vitin 2013. Këtu do të përfshihen edhe natyra juridike, autorizimet dhe kompetencat që ka në statet procedurale, e, në veçanti gjatë fazës së hetimeve, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, në saje të legjislacioneve aktuale në zbatim. Më tutje, në kuadër të këtij nënkapitulli, si vazhdimësi shtjellimi do të jetë policia hetimore – ajo gjyqësore, si subjekt përcaktues për fillimin e procedimit penal, duke mos anashkaluar të dëmtuarin akuzues, si subjekt themelor i procedimit penal.

Në kapitullin e radhës, përkatësisht, në **kapitullin e katërt** të titulluar “Vënia në dijeni e organeve ndjekëse për veprat penale dhe përfshirja e aktiviteteve të tyre ligjore” është trajtuar kallëzimi penal si akt, llojet e tij, me theks të veçantë kallëzimet nga personat anonime. Më pas do të analizohet vetë natyra juridike e kallëzimeve, duke vazhduar me kallëzimet që paraqiten me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit, dhe aktet e papërdorshme. Krejt në fund, vie referimi i veprave penale në zyrën e prokurorit të shtetit, drejtpërdrejt, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.

Në **kapitullin e pestë**, do të pasqyrohet përmbajtja rreth aspektit të “Ligjshmërisë së fillimit të procedimit penal”, dallimi nga fillimi i paligjshëm i ndjekjes- procedimit penal, duke pasuar me nënkapitujt, përse fillim e jo mosfillim. Pastaj do të vazhdojmë me atë se, fillimi i procedimit penal varet edhe në varësi të vendit të ngjarjes, me rolin e prokurorit të shtetit, si subjekt garantues i ligjshmërisë së fillimit të procedimit penal, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, si dhe, urdhërimi i procedimit penal nga prokurori i shtetit.

Kapitullin i gjashtë, përfshin Mosfillimin e procedimit penal, kuptimin dhe rëndësinë e tij, duke pasuar me nënkapitujt, rrethe nocionit dhe kuptimin e mosfillimit të tij, sqarimin

e pjesve te vendimit, përkatësishtë urdhërit, autorizimet e procedimit, shkaqet e mosfillimit të procedimit penal dhe mosfillimi i procedimit penal, si fazë verifikuese (paraprake) hetimore.

Në **kapitullin e shtatë**, është trajtuar “Dinamika e fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal në Kosovë e Shqipëri¹¹, për periudhën kohore 2011-2015, duke saktësuar për çdo vit fillimet dhe mosfillimet, përgjithësisht, dhe, në veçanti për çdo vit, përmes të dhënave të siguruara në nivel vendesh, Kosovë dhe Shqipëri, nga Prokuroritë e Shtetit. Nji pjesë e materialit është siguruar fizikisht, përmes prokurorëve kolegë, si dhe, duke aplikuar çasje përmes internetit, *website-n* e Prokurorisë së Përgjithshme, gjë e cila shihet më gjerësisht në raportet vjetore të raportuara në Kuvend nga ish-prokurorja e përgjithshme, e cila kishte shpalosur para Kuvendit të Shqipërisë aktivitetin e prokurorive, në luftimin e kriminalitetit për vitin 2012.

Së fundit në **kapitullin e tetë**, janë përmbledhur konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat, sipas mendimit tim, do të jenë në funksion dhe shërbim sadopak për të lehtësuar punën e përditshme të praktikës së atyre që punojnë në institucionet e sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor, policor, arsimor etj.

KAPITULLI II: KUPTIMI I PROCEDIMIT PENAL

Sipas KPPK-së dhe KPPSH-së, si dhe kushtetutave të të dyja vendeve si aktet më të larta juridike, si organe kompetente dhe të autorizuar që bëjnë regjistrimin e njoftimit të veprave penale, të cilat mund të vijnë nga subjektet në rrugë të ndryshme, organi që bën regjistrimin e tyre është ekskluzivisht organi i Prokurorisë, si organ kompetent dhe i autorizuar. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim penal të bërë nga subjektet e parashikuara

¹¹ Raporti i përgjithshëm nga zyra e Prokurorit të Shtetit në Prishtinë, 2010–2012, marrë në kopje të printuara nga zyrtarët e statistikave.

e të përcaktuara në dispozitën e neneve 197,198,199 të KPPK-së, të vitit 2004, në zbatim dhe, sipas atij të Shqipërisë aktual në fuqi, referuar neneve 281–283 të KPPSH-së, dhe dispozitave tjera normues ligjore që i referohen procedimit penal perkatesishtë egzistimit apo jo egzistimit të elementeve të veprës penale nga rastet që paraqiten prandaj, me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi, në mënyrë taksative, në nenin 208 të KPPK-së, ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që, pasi të ngarkohet me kallëzimin penal, fillimisht të merret me vlerësimin dhe përmbajtjen e shkresave të lëndës të bashkangjitura në kallëzim penal, dhe, pas një vlerësimi të drejtë dhe të lidhur me meritat, në varësi nga perceptimi i tij profesional dhe bindja e tij e pavarur në lidhje me vlerësimin e rastit që e ka në shqyrtim të mosfillojë dhe të mos marrë vendim për fillimin e hetimit kur ka mungesë provash, por në raste të tilla të aplikojë mosfillimin e procedimit penal. Ky tregues i parë i punës, pasqyrohet si mjet për t'i evituar hetimet e panevojshme mbi bazën e kallëzimeve të parashtruara në mënyrë të pabazuar, duke qënë se rritja e tyre prej vitit në vit reflektohet me mosefikasitet dhe joprofesionalizëm. Natyrisht, të dhënat statistikore, në drejtim të numrit të mosfillimeve, nuk janë gjithçka nëse ato nuk janë të bazuara në fakte konkrete-prova dhe në baza ligjore. Vendimet e mosfillimit të hetimeve duhen marrë vetëm në rastet kur vërtet ekzistojnë rrethanat të cilat argumentojnë bindshëm mosekzistencën e fakteve mbi lejueshmërinë profesionale për lejimin e fillimit të procedimit të një hetimi penal.

Në çdo sistem shoqëror-politik shteti është rregullator dhe mbikëqyrës i jetës politike, ekonomike, sociale, kulturore etj., që zhvillohet nën juridiksionin e tij. Detyrimi i shtetit, është që sistemin e drejtësisë, përmes normave ligjore materialo-penale dhe materiale-procedurale etj., ta ngrejë në nivel disiplinimi, në mënyrë që jeta dhe siguria e njerëzve që jetojnë në atë vend të jetë në kushtet e nevojshme dhe e lumtur e një vendi bashkëkohor që ka një shoqëri demokratike. Në kuadër të sistemit, shtetit i lind e drejta dhe detyra që, për të

përbushur funksionet e tij garantuese të sistemit të drejtësisë penale, të reagojë ndaj çdo lloj faktori që përbën rrezik për sigurinë e qytetarëve të vendit të vet.

Në këtë kuadër, më qëllim garantimin e sistemit të drejtësisë penale në tërësinë e tij, si dhe në drejtim të afirmimit të një shteti ligjor, shtetit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë si mbrojtës i interesave ligjore, qofshin publike, shtetërore apo private, u lind e drejta e reagimit për të vënë përpara përgjegjësisë penale subjektet që kryejnë vepra penale, të përcaktuara me kodet e tyre në zbatim.

Pra, në rast të kryerjes së ndonjë veprë penale, shteti ka të drejtën dhe detyrimin që të reagojë nëpërmjet organeve të veta për të vënë para përgjegjësisë penale dhe për t'i dënuar autorët e krimit. Në vijim të kësaj, me të marrë njoftimin se është kryer një vepër penale, shteti nëpërmjet organeve të veta vihet në lëvizje duke kryer veprime hetimore për të konstatuar nëse është kryer vepra penale, gjë që këto veprime në Kosovë ndërlidhen me veprimet e policisë hetimore, ndërsa në Shqipëri me policinë gjyqësore, por gjithnjë nën mbikëqyrjen e prokurorëve të shteteve përkatëse. Nëse nga veprimet e tyre konstatohet se ekziston një vepër penale, atëherë prokurori- policia gjyqësore-hetimore, në mbikëqyrje të prokurorëve përkatës duhet të kryejë veprime hetimore për të zbuluar autorin apo autorët e saj. Dhe, nëse zbulohet autori i veprës penale, duhet t'u referohemi kushteve të procedimit¹² që lidhen me subjektin e veprës penale rrethanat që lidhen me subjektin, kur këto rrethana pengojnë ndjekjen penale, si p.sh., personi ka vdekur, është nën moshë, autorizimi për procedim mungon¹³. Nëse nuk ekzistojnë pengesa të tilla, atëherë procedimi do të vazhdojë me hetime të mëtejshme, duke kaluar në gjykimin e çështjes (nëse çështja

¹² Sipas nenit 288 të KPPSH, të vitit 1995 të tijë, në parg. 1 citohet: Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesë në organin përkatës, ndërsa në parg. 2 citohet: Kërkesa për të autorizuar procedimin duhet të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga shënimi në regjistër i emrit të personit për të cilin është i nevojshëm autorizimi. Kur ai është arrestuar në flagrancë, autorizimi kërkohet menjëherë dhe, sidoqoftë, para seancës së vleftësimit.

¹³ Shihë nenin, 160 i KPPK-së, të vitit 2004 të tijë, apo nenin 290 të KPP-së, të vitit 2012 i cili është në aplikim nga 1 janari i vitit 2013 në R.Kosovës.

penale nuk pushohet) dhe është gjykata ajo që do të vendosë dënimin, duke i komunikuar llojin dhe masën e dënimit, si dhe duke urdhëruar ekzekutimin e tij, pushimin e çështjes¹⁴ apo shpalljen e pafajësisë¹⁵ në mungesë të fakteve.

Kështu, të gjitha veprimet që kryhen nga ana e shtetit nëpërmjet organeve të tij, që nga momenti i të kuptuarit për kryerjen e një vepre penale, hetimi vazhdon përmes subjekteve procedurale të parashikuara në KPP-së, në Kosovë dhe Shqipëri, në atë mënyrë që, varësisht nga epilogu i veprimeve në fazën paraprake-penale, kjo e fundit ju dedikohet prokurorëve të shtetit, të cilët varësisht nga rasti procedurës që kanë para veshes gjatë shqyrtimit mund të sjellin vendime konkrete apo se fundi edhe dërgimin e rastit për gjykimë, ashtu që nëse rezulton shqyrtimi gjyqësor, me një vendim meritues denues, përkujdesja i përket organit procedurës për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kështu që i tërë ky aktivitet veprimesh përbën procedimin penal në tërësi, sipas doktrinës penale. Procedimi penal mund të përcaktohet si tërësi veprimesh procedurale, edhe në kuptimin e marrëdhënieve procedurale që krijohen gjatë kësaj veprimtarie nga ana e subjekteve të procedimit penal.

Sipas kuptimit të parë, procedimi penal ndërlidhet me ndërmarrjen e veprimeve të tërësishme të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të ligjeve të procedurës penale të KPP-së të Kosovës dhe të Shqipërisë, që kryhen nga organet e caktuara shtetërore, prokurorive dhe policive përkatëse hetimore dhe gjyqësore. Këto veprime kryhen mbi bazën e të dhënave, të paraqitura nga personat juridikë të autorizuar sipas Ligjit, si dhe personave fizikë, mbi bazën ankuse, duke mos u përjashtuar edhe vetë nisma zyrtare e organit ndjekës për të nisur hetimet-procedimin. E, poqese organet gjenden para informacioneve të mjaftueshme të dyshimeve të arsyeshëm se është kryer një vepër penale, atëherë në sajë të kësaj baze

¹⁴ Neni 387 par.1, i KPPSH, vitit 1995

¹⁵ Po aty, neni 388 par.1 pika a, b,.....e, të tij.

dyshimi apo, shprehur ndryshe, perceptimit intelektual të prokurorit, se ka vepër penale. Atëherë detyrimi ndërlidhet me aktivitetin rreth procedimit të zbulimit të autorit, dhe pastaj gjykimin e tij nga gjykata dhe më në fund aplikimin e sanksionit penal ndaj tij. Nga sa rezulton më sipër, se procedimi penal, si në aspektin global, ashtu edhe në nivele nacionale, Kosovë dhe Shqipëri, organet e ngarkuara me autorizime ndjekëse ligjore, kanë për objektiv këto qëllime:

Së pari, organet kanë për qëllim që të zbulohet nëse kemi ose jo vepër penale dhe a është e përcaktuar me ligj (*nullum crimen sine lege*), së dyti, për të zbuluar autorin e veprës penale dhe, së treti, aplikimin e zbatimit të dënimit dhe masave të tjera alternative ndaj autorit të veprës penale. Që të arrihet ky qëllim ndërmjet vetë subjekteve të procedimit penal, gjykata, prokuroria, policia gjyqësore, i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit, i dëmtuari, mbrojtësi i të dëmtuarit, paditësi dhe i padituri civil, si dhe ndërmjet tyre dhe personave të tretë që marrin pjesë në procedimin penal, siç janë ekspertët, dëshmitarët etj., duhet të kenë një harmonizim të veprimtarisë së tyre, harmonizim i cili arrihet nëpërmjet krijimit të marrëdhënieve procedurale penale. Marrëdhëniet procedurale penale quhen të tilla, sepse ato lindin dhe zhvillohen në kuadrin e një procedimi penal të provokuar-iniciuar nga të tjerët apo zyrtarisht nga organet e autorizuar me ligj.

Nga pikëpamja e marrëdhënieve procedurale, me procedim penal kuptojmë tërësinë e veprimeve procedurale penale që kryhen nga ana e subjekteve të procedimit penal në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, si dhe në marrëdhëniet me personat e tretë që marrin pjesë në këtë procedim penal.

Sipas normave të Kodit Procedural të Republikës së Kosovës, si dhe atij të shtetit shqiptar, aktualisht në zbatim, përmes normave të veçanta, secilit subjekt i janë garantuar autorizimet ligjore prej momentit të fillimit e deri në përfundim të procedimit penal. Nga kjo rezulton se procedimi i tillë penal përbëhet nga disa faza. Ushtrimin e ndjekjes penale e

ka detyrim kushtetues ligjor organi i prokurorisë –prokurorët e shtetit të Kosovës dhe të shtetit shqiptar¹⁶. Këtë funksion e kryejnë në bazë të Kushtetutes dhe ligjeve pozitive të Kodeve Procedurale, duke kryer hetimet paraprake që përbëjnë edhe fazën e parë të procedimit penal. Më pas, duke qenë se faza e gjykimit i përket tipit akuzator, janë gjykatat ato që zhvillojnë dhe japin sqarimet gjyqësore (me prokurorinë si palë procedurale), të cilat në këtë mënyrë ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues dhe ligjor: Ku gjykatat japin verdiktin përfundimtar lidhur me kryesin e veprës penale. Koha gjatë së cilës zhvillohen këto veprime procedurale nga gjykata në marrëdhënie me palët, përbën fazën e dytë të procedimit penal, fazën e gjykimit. Procedimi penal i filluar, zhvilluar dhe përfunduar zbatohet nëpërmjet aplikimit të ekzekutimit të masës së dënimit që bëhet nga Prokuroria¹⁷ në bashkëpunim me Gjykatën dhe subjektet e tjera, gjë që sipas KPRK-së i bie në supe Gjykatave të Kosovës për t’u përkujdesur dhe jo prokurorive.

Mendoj se qasja e përkujdesjes për dënime të dhëna nga gjykatat, sipas Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, është më mirë, me ç’rast që barra i bie prokurorit, se sa qasja ekzistuese në Kosovë, parashikuar sipas KPPK-së, u bie gjykatave, sepse organi i akuzës është organ i mbrojtjes së ligjshmërisë së shtetit.

Koha gjatë së cilës kryhen këto veprime procedurale penale nga Prokuroria dhe subjektet e tjera, përbën fazën e tretë dhe përfundimtare të procedimit penal¹⁸.

Procedimi penal, në varësi të rastit dhe kushteve ligjore, mund të jetë më i thjeshtë, si p.sh.: Në rastin e procedimit të shkurtuar apo të procedimit të drejtpërdrejtë, vlen të theksohet se procedimi penal përbëhet nga tri fazat e theksuara më sipër. Procedimi penal është institut i veçantë, pra si formë e veprimtarisë së organeve të autorizuara shtetërore për mbrojtjen e

¹⁶ Kodi Penal i Kosovës, 2012, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2012 dhe Kodi Penal i Shqipërisë, 1995 dhe Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë.

¹⁷ Shih nenin 464 të Kodit Pr.Penal të Shqipërisë, aprovuar sipa Ligjit Nr.7895, dt, 27.01.1995.

¹⁸ Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të Republikës së Kosovës.

të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, si dhe në interes të shoqërisë. Kjo dokumentohet me rastin e vlersimeve të kallëzimeve penale të paraqitura nga subjektet në rrugë të autorizuara. Prokurorëve të ngarkuar me këto çështjet penale, u mbetet si detyrë analizimi dhe vlerësimi i kallëzimeve penale dhe varësishtë provave bashkangjitesë, të vlerësojnë ekzistencën e dyshimeve, dhe, në varësi nga shkalla e dyshimeve të marrin vendim meritor rrethe fillimit apo mosfillimit të procedimit penal, si në vijimë:

- Vendim mbi vlerësueshmërinë e kallëzimit penal.

Ky akt merret brenda 30 ditëve, dhe varësishtë nga egzistenca e provave bashkangjitesë vendoset marrja e vendimeve nga prokurori i çështjes, ashtuqë, në mungesë të provave dhe kushteve ligjore kallëzimi penal hidhet poshtë¹⁹. Në të kundërtën ekzistimi i provave mbi dyshimin e arsyeshëm apo të bazuar, sjellë detyrim për organin që të merr:

- Aktvendimin për fillimin e hetimit -Këtë vendim Prokurori e merr sipas provave të bashkangjitura në kallëzimin penal, ekziston standardi i dyshimit të arsyeshëm apo i bazuar, se është kryer vepra penale e caktuar dhe prokurori vlerëson se a duhen hapur hetimet, a jo. Për këtë merr vendim konform nenit 104 KPPRK-së, 2012:46. Me një kopje të vendimit mbi fillimin e hetimeve ka obligim ligjor që ta njoftoi gjyqëtarin e procedurës paraprake. Pas zhvillimit dhe përfundimit të hetimit nga provat e mbledhura dhe vërtetohet dyshimi i bazuar mirë, atëherë konform dispozitave ligjore të neneve 240, 241, 242 të KPPK-së, ngre aktakuzë²⁰. Për dallim sipas KPPSH-së, fillimishtë aplikohet regjistrimi i kallëzimit penal të paraqitur në regjistrin e njoftimeve të veprave penale më pastaj emri i personit urdhërohet të shënohet në regjistrin përkatës kur dihet dhe të cilit i atribuohet dyshimi i arsyeshëm se ka kryer veprën penale dhe pastaj fillohet me hetimin dhe

¹⁹ Përcaktuar sipas nenit 82, parag.1.2 & 3 KPPRK-së, vitit, 2012 fq.30.

²⁰ PP.nr.403/14, datë 9.12.2014, PTHP-DKR, Pejë

grumbullimin e provave dhe përfundon me vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve të veprave penale ose ajo shuhet apo pushon për shkaqet e parashikuara në KPRSH-së.

Shoqëria njerëzore, në varësi të etapave të zhvillimit, është përpjekur që, nëpërmjet institucioneve kompetente shtetërore, t'i sigurojë mbrojtje efektive nga dukuritë e caktuara kriminale nëpërmjet procesit penal, të gjithë personave fizikë dhe juridik të cilët kërkojnë drejtësi si palë të dëmtuara. Natyrisht, nga lindja e shtetit, institucionet, format dhe metodat preventive dhe represive kanë ndryshuar vazhdimisht deri në zhvillimin e sistemeve të reja juridiko-penale, të cilat janë krijuara mbi idenë dhe përkushtimin që dukuritë e caktuara kriminale t'i luftojnë nëpërmjet veprimeve institucionale penale bashkëkohore dhe njëkohësisht atyre që kryejnë këto akte kriminale t'u japin dënimet e merituar, të cilat, në fund të fundit, kanë qëllim riedukimin dhe rikthimin të tyre në shoqëri si qytetarë të dobishëm. Tani kur shoqëria njerëzore po ballafaqohet me forma të reja të kriminalitetit, të karakterizuara nga rrezikshmëria tepër e lartë shoqërore, si kurrë më parë, kanë shpalosur edhe problematikën e efikasitetit të luftimit të tyre. "Angazhimi i institucioneve për t'i parandaluar dhe për t'i luftuar këto forma kriminale dhe interesi shkencor e praktik i orientuar kah sistemi për kontrollin e kriminalitetit, gjithsesi, rrit rolin e së drejtës penale²¹. Kështu, kohët e fundit, edhe në Kosovë janë shënuar rezultate pozitive në këtë funksion e, posaçërisht me nxjerrjen e legjislacionit të veçantë penal dhe procedural.

2.1. Evoluimi i legjislacionit penal dhe procedural para dhe pas Pavarësisë së Kosovës

Aspekti historik

Edhe pse Kosova historikisht ka qenë për një periudhë të gjatë e pushtuar, ajo, prapë se prapë ka një histori domethënëse e të rëndësishme të zhvillimit të së drejtës penale –

²¹ Kambovski V., *E drejta penale – pjesa e përgjithshme*, botuar nga Universiteti i Evropës Juglindore, R.Maqedonisë, viti 2007:58)

procedurale. Pavarësisht nga dinamika e zhvillimeve historike mendojmë se, në kuptim më të gjerë, legjislacioni penal mund të ndahet në dy periudha të caktuara: periudha nga viti 1918–1941 dhe 1999–2003 dhe e gjithë kjo merret si e mirëqenë, sepse këtë ndarje e kanë bërë dy njohës të shquar të së drejtës penale. Sipas Prof.Dr. Ismet Salihu lidhur me vështrimin e zhvillimit historik të së drejtës penale në Kosovë vlerësohet se Kosova ka fillimet e paraqitjes së saj, e cila daton, në formën e vet, nga periudha e feudalizmit dhe vazhdon me periudhën në mes të dy luftërave botërore (1918–1941), periudhën pas luftës së dytë botërore dhe së fundi periudhën pas luftës së vitit 1999 në Kosovë.²² Edhe Prof.Dr. Ejup Sahiti, lidhur me zhvillimin historik të së drejtës së procedurës penale në Kosovë thekson se për shkak se Kosova për një kohë të gjatë ishte nën sundimin e të huajve, në territorin e saj është aplikuar e drejta e sunduesit e cila shpesh i kundërvihet së drejtës zakonore shqiptare²³. Periudha e fundit është ajo e luftës së fundit dhe vendosjes së UNMIK-ut në qershor të 1999-s e tutje. E drejta e procedurës penale është zhvilluar mbi bazën, nivelin dhe cilësinë e së drejtës penale gjatë periudhave të shënuara më sipër. Është konstatim i të gjithë autorëve dhe teoricienëve penalistë, se 1 korriku i vitit 1975 vlerësohet si datë domethënëse për historinë e legjislacionit penal, pasi që pikërisht në këtë kohë ka hyrë në fuqi ligji i parë penal i Kosovës, i cili, si në planin e përgjithshëm ashtu edhe në atë të veçantë, i ka parashikuar veprat penale që kanë rrezikuar ose dëmtuar pasuritë e qytetarëve, si dhe të Kosovës. Në kuadër të këtij legjislacioni, Kosova sikurse të gjitha njësitë e tjera të ish-RSFJ-së, përveç kohës kur ka qenë nën pushtimin serb (1989–1999), procedurën penale e ka zbatuar në bazë të ligjit të procedurës penale të RSFJ-së, të vitit 1967 (i plotësuar dhe ndryshuar në viti 1986) e që përfundimisht

²² Shih Salihu Dr. I., *E drejta penale – pjesa e përgjithshme*, botuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik Prishtinë 2003 f. 110–118.

²³ Shih në tekstin e prof.dr. Ejup Sahiti, *E drejta e procedurës penale.*, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik, Prishtinë 2005 f. 16.

shfuqizohet më 6 prill të vitit 2004, kur fillojnë të aplikohen kodet e reja të përkohshme penale dhe procedurale.

Periudha kohore e veprimit të ligjit të procedurës penale e ish-shtetit jugosllav nga viti 1967, e ndryshuar dhe e plotësuar në vitin 1986, ka ndikuar që institucionet dhe personeli kompetent për zbatimin e ligjit të stabilizohen. Gjithsesi, doktrina dhe praktika gjyqësore kanë kontribuar që ky ligj në baza formale të zbatohet relativisht mirë në jetën profesionale dhe praktike. Shikuar në baza shkencore mund të konstatojmë se ligji i Procedurës Penale të ish-RSFJ-së, gjatë kohës kur ka vepruar, ka qenë i avancuar dhe me sukses i ka rregulluar funksionet dhe veprimet e institucioneve dhe subjekteve gjyqësore. Nëse lëmë anash abuzimet dhe keqpërdorimet, të cilat janë bërë nën ndikimin e sistemit të atëhershëm politik (neni 162, al.4, i LPP-së, i vitit 1967, RSFJ, 1986, me ndryshim dhe plotësim në vitin 1986), pa asnjë hezitim vlerësojmë se ky ligj ka arritur që profesionalisht, lehtë, në mënyrë cilësore, në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut nga plani procedural, të garantojë zbatimin e ligjit penal. Përveç përparësive edhe dobësive evidente, ligji i procedurës penale është cilësuar i avancuar, për faktin se zhvillimi i fazës së hetimeve, respektivisht funksioni i hetimit, ka qenë kompetencë e gjykatës si institucion i pavarur dhe është drejtuar nga gjyqtarë hetues profesionistë. Kjo fazë procedurale është iniciuar me kërkesën e prokurorit kompetent drejtuar gjykatës kompetente respektivisht gjyqtarit hetues, i cili, në afatin e paraparë me ligj e ka ushtruar funksionin e vet hetues.

Pa dashur të vlerësoj rëndësinë e asnjë institucioni dhe subjekti procedural, kjo zgjedhje, që në fillim ka kontribuar në drejtim të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për faktin se, Gjykata, në cilësi të institucionit të pavarur e jo të palës procedurale, është

kujdesur që t'i ndriçojë të gjitha rrethanat e veprimit ose mosveprimit penal, të cilat i kanë shkuar në dëm ose në dobi të të pandehurit në procedurën hetimore.

Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës, formalisht, në esencë, ndryshon nga ligji procedural paraprak, në veçanti, lidhur me procedimin e procesit hetimor dhe, këtë funksion ia beson në kompetencë prokurorit kompetent, duke e autorizuar atë që, gjatë udhëheqjes së procesit hetues, ta drejtojë dhe të mbikëqyrë edhe punën e policisë gjyqësore (neni 200, paragrafi 3, i KPPPK-së, 2004). Me gjithë dëshirën e institucioneve të përkohshme qeverisëse në Kosovë dhe ekspertëve, që, në territorin tonë të nxjerrin dhe të funksionojnë akte ligjore, të cilat në një anë do t'i shmangen në tërësi sistemit juridik të ish-RSFJ-së dhe RFJ-së, aplikimi i tyre në disa faza po has në vështirësi dhe probleme në zbatim. Pa dashur që, në asnjë mënyrë të kritikojmë anën formale të KPPPK-së, konsiderojmë se hyrja e shpejtë e tij në fuqi paralelisht me reformat në sistemin e drejtësisë në Kosovë, në vitin 2013, pa përgatitje serioze paraprake, posaçërisht lidhur me zbatimin e fazës së hetimeve, institucionin e prokurorisë e ka gjetur jo shumë të përgatitur, si në planin e mungesës së burimeve njerëzore, ashtu edhe në planin e mosjogatishmërisë së prokurorëve të caktuar që me përgjegjësi dhe profesionalizëm t'i zbatojnë të gjitha dispozitat ligjore të këtij Kodi. Vlerësohet se dobësitë, respektivisht pikat kritike të funksionit të prokurorit të çështjes, janë: a) *Dobësitë e brendshme në sferën e zhvillimit të procedurës hetimore pa u mbështetur në parimet e caktuara penale dhe procedurale, sigurimin e provave të cilat tani në këtë fazë janë detyrim për prokurorinë; dhe*

b) *Dobësitë lidhur me zbatimin e dispozitës së nenit 46, paragrafi 3, i KPPPK-së;*

Bartja e procedurës hetimore, si funksion te prokurori, është një detyrim i ri, i cili sa është i ndjeshëm, konsiderohet edhe po aq kompleks. Kjo ndjeshmëri dhe kompleksitet del nga detyrat shtesë të prokurorisë, të cilat, realisht nuk janë të sistemuara veç e veç në

dispozitat ligjore, por që gjenden në parimet juridike, penale dhe procedurale, të cilat duhet t'i zbatojnë hetuesit. Kjo ka të bëjë me nevojën e angazhimit serioz dhe të gjithanshëm të prokurorëve në sigurimin dhe vërtetimin e materialit provues (barra e provave), në mënyrë që kjo fazë të jetë një filtër serioz i materialit provues dhe kurrësesi që angazhimi i prokurorit të jetë i njëanshëm, të sistemohet në lëndën, e cila pas fazës hetimore i bartet gjykatës në vlerësim. Është e njohur që gjykata, sipas detyrës zyrtare, e ushtron funksionin e gjykimit pavarësisht nga qëndrimet e palëve në procedurë. Por, tani prokuroria, në cilësi të palës që e përfaqëson shtetin, ka detyrime shtesë (*ex officio*), që, në një anë, të kujdeset për luftimin e krimit dhe, njëkohësisht, të kujdeset për detyrimin e saj ligjor dhe moral, në funksion të respektimit të dinjitetit njerëzor të të pandehurve, bazuar në aktet më të larta, të cilat i garantojnë të drejtat dhe liritë individuale. Kompozim i funksionit hetues me funksionin e mbikëqyrësit të të drejtave dhe lirive individuale është logjika e ligjvënësit, e cila, që në fazën fillestare të zbatimit të KPPRK-së, po has në vështirësi. Edhe pse janë detyrim, në këtë fazë nuk po zbatohen, ose me vështirësi zbatohen parimet *in dubio pro reo*, *presumimi i pafajësisë* dhe *parimi i ekonomizimit*. Jo shumë rrallë, hamendjet e prokurorisë lidhur me ekzistencën ose mosekzistencën e veprës penale, apo me cilësimin juridik të saj, duhet t'i zgjidhë gjykata me aktgjykim. Dominon logjika që çështjet e caktuara t'i vlerësojë gjykata. Mund të nxjerrim një përfundim se funksioni i hetimit, barra e provave dhe kujdesi ndaj personalitetit të të pandehurit duhet finalizuar me akte akuzuese racionale e të mbështetura në prova të bazuara. Kjo nënkupton faktin se funksioni i prokurorit sipas KPPRK-së është funksioni më i ndjeshëm me detyrime shumë dimensionale. Mënjanimi ose nënvlerësimi i logjikës mbi nevojën e veprimit të prokurorisë sipas logjikës së theksuar më sipër është shkelje e drejtpërdrejtë e parimeve dhe dispozitave procedurale dhe lirive dhe të drejtave të njeriut.

Nisur nga përvojat e deritanishme, detyrimi i respektimit të dispozitave të KPPPK- së, ku parashihet aktiviteti i zbardhjes së rrethanave, të cilat i shkojnë në favor të pandehurit gjatë procedurës hetimore, bie mbi prokurorinë. Ka raste kur prokurorë të caktuar vetëm formalisht thirren në disa dispozita aktuale, ndërkaq nga inercioni veprojnë me logjikën dhe praktikën e ish-ligjit të procedurës penale, të ish-RSFJ-së, i cili ka qenë në fuqi. Në këtë mënyrë, vlerësohet se shumica e prokurorëve **“harrojnë”** që kanë detyrim ligjor që, jo vetëm në anën formale, t’i zbatojnë me përpikmëri të gjitha dispozitat e KPPPK-së, në veçanti dispozitën e nenit 46, paragrafi 3. Në cilësi të personit që, jo rrallë, autori është prezent në procese gjyqësore, asnjëherë, në asnjë akt akuzues apo parashtresë tjetër të prokurorisë, nuk ka parë qartë në arsyetime, të jenë sqaruar veprime hetimore gjatë procedurës ndaj të pandehurit në kuptim të zbatimit të dispozitës së sipër përmendur, në mënyrë që, aty ku është e mundur, t’i zbardhin dhe provojnë provat ose rrethanat që i shkojnë në favor. Përkundrazi, disa akte akuzuese dhe parashtresa, të cilat dalin nga prokuroritë, shihet qartë se ato janë të shabllonizuara në mënyrën elektronike, në dispozitat e tyre, që nga faza e fillimit të hetimit e deri tek ngritja e aktit akuzues, janë kontradiktore me arsyetimin e dhënë dhe jo rrallë janë në kundërshtim edhe me materialin provues, sipas te cilit krijojnë bindjen e tyre (Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë, lidhur me disa çështje penale të hetuara dhe të dërguara në Gjykatë)²⁴.

Ashtu siç edhe kemi theksuar në fillim, qëllimi i shoqërisë është luftimi i kriminalitetit në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe trajtimi i kryerësve të këtyre veprave në atë mënyrë që ata t’i rikthehen shoqërisë si individë të riedukuar dhe të dobishëm. Por, konstatimi i theksuar për disa dobësi subjektive dhe objektive në zbatimin e dispozitave ligjore në fazën e hetimeve, në praktikë është argument i pamohueshëm. Koncentrimi i funksionit të hetimit dhe i ndjekjes me kompetencë të prokurorit, duke e ditur ndikimin e gjatë të ish-

²⁴ Aktakuza PP nr. 261/12, datë 24.12.2012, dhe PPnr.2135/12, datë 28.12.2012

LPP-së në kuadërtë organeve të jurisprudencës, po e reflektojnë në jetën praktike një model interesant, mikst që nënkupton zbatimin formal të dispozitave të KPPPK-së, me logjikën e veprimit sipas dispozitave të LPP-së. Nëse këtij fenomeni i shtohet mungesa e kapaciteteve njerëzore me të cilat ballafaqohen, prokuroritë kosovare drejtpërdrejt po ndikojnë që të paraqitën dy fenomene negative.

2.2. Veshtrimi historik i legjislacionit procedural-penal Shqiptar, në lidhje me fillimin dhe mosfillimin e procedimit penal, duke filluar nga viti 1912 deri në vitin 1995

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe formimit të Qeverisë së Parë Shqiptare kemi të drejtë t'i atribuohemi emërtimit të procedimit penal shqiptar, sepse në periudhën para vitit 1912 ishte në aplikim legjislacioni i pushtetit osman, i miratuar në vitin 1879, i bazuar në modelin e Kodit të Procedurës Penale të Francës, ose të Napoleonit, të vitit 1808.

Me formimin e shtetit shqiptar, për shkak të kushteve politiko-shoqërore dhe ekonomike, nuk u arrit të krijohet një legjislacion i dëshiruar procedural-penal i plotë dhe i pavarur. Edhe në periudhën e mbretërisë, gjatë se cilës u arrit të realizohet një reformë e lavdëruar juridike, nuk u arrit të krijohet një kod i procedurës penale i mirëfilltë dhe i suksesshëm . Për rrjedhojë, procedimi penal deri në vitin 1953, mbështetur në vendimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, datë 6 dhjetor 1912, është zhvilluar në bazë të normave të parashikuara në legjislacionin procedural penal osman dhe, më vonë, të shumë normave me karakter procedural penal, që përmbanin ligjet e ndryshme organike, si ato për organizimin gjyqësor, për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, për avokati, ligji “Për organizimin e drejtësisë”, i vitit 1929, të procedurës penale ushtarake për kohë paqe, i vitit 1932, ligji “Mbi përmirësimin e dispozitave procedurale” dhe ligji “Për përmbartimin”, që hyri në fuqi me 9.3.1937. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe deri në vitin 1953 u shpallën

disa ligje që përmbanin dispozita me ligjet organike të subjekteve të procedimit penal, si dhe në ato me karakter procedural. Në tërësi konstatohet se normat me karakter procedural penal përmbanin elementet e sistemit procedural, inkuizitor dhe akuzator

Çështja penale, sipas Kodit të Procedurës Penale, të vitit 1953, në lidhje me fillimin e procedimit penal, parashikonte se fillon **“kur ka të dhëna në lidhje me kryerjen e një krimi”**. Sipas nenit 95/2 të Kodit Penal të Shqipërisë, kodi përcakton se **“për fillimin e çështjes penale duhet të merret një vendim i arsyetuar, duke u treguar të dhënat dhe nenet e kodit penal, në bazë të të cilave fillon çështja, si dhe organi që duhet të hetojë ose të gjykojë çështjen”**²⁵.

Pra, për të filluar procedimi penal hetimor është e nevojshme ekzistenca e të dhënave, të cilat shfaqin dyshimin e arsyeshëm dhe krijojnë bindjen se jemi para kryerjes së një veprë penale, bindje kjo që krijohet mbi bazën e perceptimit intelektual dhe profesional të prokurorit, gjyqtarit etj., siç e parashikon ligji. Të dhëna këto që krijojnë bazën e mjaftueshme, të domosdoshme, për të nisur procedimin penal. Me krijimin e kësaj baze të të dhënash merrej vendimi përkatës i arsyetuar, duke përshkruar rrethanat e faktit me natyrë kriminale që kallëzohej, si dhe nenet e Kodit Penal që e parashikojnë si vepër penale këtë fakt. Dispozitë kjo e përmendur për të treguar se pikërisht një dispozitë e tillë mungon në kodin aktual të procedurës penale.

E kundërta e fillimit të procedimit penal është mosfillimi i procedimit penal i përcaktuar me kodet procedurale të të dyja vendeve trajtuese, mosfillim i cili pason me përpilimin e një akti, që nënkupton se ndjekja penale nuk duhet filluar dhe se nëse ka filluar duhet të pushojë në çdo fazë të hetimit, ose të gjykimin në rastet si në vijim:

- Kur i pandehuri ka vdekur²⁶.

²⁵Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, viti 1953, të tij.

²⁶Neni 290 par.1 pika a), të Kodit Pr.Penale të Shqipërisë, vitit 1995, të ligjit nr.7895 dt.27.01.1995.

- Kur i dëmtuari ka hequr dorë nga kërkesa në çështje që fillojnë vetëm me kërkesën e ankimit të dëmtuarit me përjashtim të rasteve të parashikuara me nenet 14, paragrafi i fundit dhe neni 15 të Kodit Penal të Shqipërisë.
- Kur vepra penale për ndjekje ka arritur të parashkruhet, për shkak të kalimit të afatit ligjor për ndërmarrjen e veprimeve procedurale me kohë nga organet prokuroria apo gjykata.
- Kur mungon kërkesa e të dëmtuarit për ndjekje ose ai e tërheq ankimin e paraqitur²⁷.
- Kur i pandehuri është amnistuar²⁸.
- Kur i pandehuri ka qenë i papërgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës²⁹.
- Kur i pandehuri nuk e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.
- Kur për të njëjtën vepër penale është dënuar më parë.
- Kur ka vepruar në “mbrojtje të nevojshme”
- Për shkak të nevojës ekstreme, dhe
- Heqja dorë nga kryerja e veprës penale.
- Kur vepra penale me të cilën i pandehuri ngarkohet nuk është vepër penale me ligj.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 1980, në lidhje me fillimin e çështjes penale me nenin 34, përcaktohet se: **“Vendimi mbi fillimin e çështjes penale është akt që merret nga gjykata”, gjyqtari i vetëm ose hetuesi, kur është kryer një vepër penale dhe që i jep të drejtë gjykatës, gjyqtarit të vetëm ose hetuesit të zhvillojë veprimtari procedurale**”(KPPSH,viti 1980 të tij).

Siç shihet qartë Kodi përcakton se për fillimin e çështjes penale duhet të merret një akt i veçantë nga organi procedues përkatës që ligji ia njeh një të drejtë të tillë, varësisht se në cilin stad procedimi ndodheni.

²⁷ Po aty, pika b), e nenit 290 par1 të KPPSH, të tij.

²⁸ Po aty, pika dh), e nenit 290 par1 të KPPSH, të tij.

Vlen të theksohet se rrethanat që nuk e lejojnë fillimin e çështjes penale janë të përcaktuara në nenin 290 të Kodit Penal shqiptar të vitit 1995. Çështja penale kundër një personi, apo më shumë personave, për të cilët kanë filluar hetimet apo gjykimi i tyre, qoftë sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, apo KPPSH-së, nuk mund të fillojë edhe në qoftë se ka filluar, si e tillë duhet të pushojnë menjëherë së hetuari, apo se gjykuari nga gjykata, kur paraqiten rrethanat vijuese:

- Kur personi ndaj të cilit kanë filluar hetimet ka vdekur.
- Personi ka qenë i papërgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës, me përjashtim të rasteve që parashikohen me nenin 160 të këtij Kodi.
- Personi, kryerësi i veprës, nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe nuk çmohet të merret ndaj tij, ndonjë masë edukuese.
- Mungon ankimi për vepra penale, të përcaktuara sipas KPPK-së dhe KPSH-së, me saktësisht nga ky i fundit për veprat penale të parashikuara nga nenet 63/3/5 Kodi P.SH.
- I dëmtuari ka hequr dorë nga ankimi për çështjet penale që duhet të fillojnë sipas iniciativës së tij, parashikuar me nenin 63/3 të Kodit Penal Shqiptar dhe KPPK-së për veprat penale: kanosje (neni 161 i KPPK-së, 2004), shtrëngim (neni 160, par. 5, KPPK-së, 2004:72), përhapja e sëmundjeve venerike, shpërdorimit (neni 257 par.6. KPPK-së, 2004, fq.110,111) dhe vepres penale, marrja e pasurisë së luajtshme nga (neni 258 i KPPK-së, 2004). Të gjitha këto vepra të përcaktuara në KPPK-së dhe veprat penale të cilat i referohen nenit 284³⁰ të KPPSH-së,ndiqen sipas propozimit dhe ankimit nga ana e të dëmtuarit (viktimës së veprës penale).

³⁰ Sipas nenit 284 të Kodit të Pr. Penale të Shqipërisë, vitë 1995, miratuar me ligjin nr.7895,datë 27.01.1995 dhe ndryshuar ne piken I nr. 8813,datë 13.06.2002, në par,1 citohet; se veprat të parashikuara nga nenet 89,102, par. 1, 105,106,130,239,240,241,243,264,275 dhe 318 të Kodit Pejal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.

Par.2 Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e nja deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqët vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.

-Kur i pandehuri për të njëjtën vepër në kallëzim penal është paraqitur më herët e për atë është vendosur pushimi i çështjes ose gjykata e ka gjykuar me vendim të formës së prerë, (neni 389,paragraf 3 i KPPPK-së, 2004:169).

-Kur vepra penale nuk është kryer dhe si e tillë nuk përmban elemente të një vepre penale i akuzuari lirohet nga akuza pas shqyrtimit gjyqësor me vendim meritator sipas dispozitave të KPPPK-së³¹.

-Rastet kur vepra penale është amnistuar,

-Është plotësuar afati për parashkrimin e ndjekjes penale apo kundërvajtjes penale; dhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj .

Sipas Kodit të Procedurës Penale, me nenin 73 përcaktohet se: “Gjykata, gjyqtari i vetëm ose hetuesi, kanë të drejtë të mosfillojnë çështjen penale kur çmojnë se rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit që e ka kryer atë vepër çmohet si e rëndësisë së vogël dhe kryerësi për këtë vepër ka treguar pendim të thellë”dhe e ka përmbushur dëmin ndaj palës së dëmtuar.

Po ashtu, sipas Kodit Penal të vitit 2004 të Kosovës, në nenin 7, dhe, sipas KPPSH-së, viti 1980, në nenin 3/3 përcaktohej se: “Nuk është vepër penale ajo që, ndonëse parashikohej nga një dispozitë e ligjit penal, por nuk është shoqërisht e rrezikshme për shkak të rëndësisë së saj të vogël”.

I përmendëm këto dy nene për të theksuar se vendosja e dispozitave të tilla në ligjin penal-material duhet të shihet me sy kritik, sepse sot hasim në një numër relativisht të madh të veprave të cilat në pikëpamje formale përmbajnë elemente të një vepre penale, por rëndësia e tyre është e vogël. Sikurse shprehet edhe dispozita e sipërpërmendur, nga

Par.3 Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankusi ose përfaqësuesi i tij.

Par.4 Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankusit dhe i dërgon aktet prokurorit.

Par.5 Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga i dëmtuari akuzues.

³¹ Neni 390, paragraf 1, 2, 3 të KPPPK-së, i vitit 2004 fq.169.

rëndësia e vogël e saj nuk ia vlen që të krijohen shpenzime hetimi dhe gjykimi etj. Mu për këtë kategori veprash penale, ligjvënësit kanë paraparë dispozita normuese për mosfillimin e procedimit penal, për vepra të tilla sepse siç u theksua nga kostoja shpenzuese procedurale, nuk ia vlen të fillohen hetimet. I të njëjtit mendim do të isha edhe në lidhje me vendosjen e mosfillimit të çështjeve penale në raste të veprave me rrezikshmëri të ulët, të kryera nga personat që paraqesin, gjithashtu, shkallë të ulët rrezikshmërie për vetë kontributin që japin për shoqërinë dhe vlerat që i bartin. Pa dyshim që në këtë drejtim, për të moslejuar abuzimet e mundshme të panevojshme, dhe me kosto të paarsyeshme duhet të përcaktohen kriteret e qarta ligjore.

Ndryshe nga kodet e procedurës penale të viteve të mëhershme në Republikën e Shqipërisë, Kodi i Procedurës Penale i vitit 1995, përmes dispozitës së nenit 287, normon se “Prokurori i shtetit shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka ndërmarrë vetë iniciativë dhe, në të njëjtën kohë, pasi ta mësojë emrin e autorit, të cilit i atribuohet vepra penale”, e evidenton atë në regjistrin përkatës.

Nga një vështrim krahasues të këtyre procedurave penale të theksuara sipas viteve 1953, 1980 dhe të vitit 1995, i cili, aktualisht, është në përdorim, bie në sy fakti se procedura penale, sipas viteve 1953 e 1980, parashikon se cili ishte akti me të cilin subjekti i ngarkuar duhet të merte së filluari çështjen penale (vendimi i arsyetuar ose akti). Kodi aktual i vitit 1995, siç theksuam më lart nuk parashikon ndërmarrjen e një akti të tillë.

Pokështu, do të theksoja edhe në lidhje me bazën e duhur të të dhënave, e cila bënte të mundur marrjen e një vendimi të tillë. Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1953, parashikonte “ku ka të dhëna në lidhje me kryerjen e një krimi”; ai i vitit 1980 “kur është kryer një vepër

penale”; ndërsa Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1995, parashikon çdo njoftim të veprës penale³².

Me të vlerësuar interpretimin e dispozitave të kodeve të procedurës penale të Kosovës, sipas viteve 1977, 2004 dhe 2012, aktuali në zbatim është më gjithëpërfshirës edhe pse, prapë, se prapë, disa institute kanë nevojë ndërhyrjeje amendamentimi. Ndryshe qëndron situata me kodet e procedurës penale në Shqipëri, referuar sipas viteve 1953, 1980 dhe 1995. Mendoj se përcaktimin më të saktë në këtë drejtim e ka dhënë Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, sepse KPPSH-ja e vitit 1953, sepse vetë emërtimi përcaktues i shprehur me thënien ” **kur ka të dhëna në lidhje me kryerjen e një krimi në korniza të përgjithshme, nënkuptojmë se kemi të bëjmë me elementet e përgjithshme dhe të veçanta që përcaktojnë tërësinë e elementeve të figurës së veprës penale të kryer** ”.

Shprehjet e përdorura në vitin 1980 dhe 1995 janë më të pagjetura në raport me ato të përdorura nga Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953, dhe duket sikurse paragjykojnë njoftimin e dhënë në lidhje me kryerjen ose jo të një veprë penale. Në një konkluzion për kryerjen e veprës penale mund të dilet vetëm pas verifikimeve paraprake të hetimeve të kryera dhe jo në momentin kur vendoset të fillohet – regjistrohet procedimi penal. Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953, jo vetëm që është më i gjeturi, por është edhe më i sakti, pasi që përcakton dhe lidhë regjistrimin (ose fillimin) e procedimit penal mbi bazën e ekzistencës së të dhënave (pa dyshim të bazuara) që ka në lidhje me kryerjen e një veprë penale -krimin.

Mendoj se Kodi aktual i Procedurës Penale duhet të shprehë se cili është akti që duhet të merret në lidhje me fillimin e procedimit penal dhe bazën e të dhënave mbi të cilin duhet marrë vendimin.

³² Neni 287 par.1, i K.Pr.Penal, vitit 1995, Republikës së Shqipërisë, miratuar sipas ligjit 7905, datë 21.03.1995, i përditësuar në vitin 2011 nga shtypshkronja Alb Juris.

Një boshllëk të tillë ligjor dhe praktikat e ndryshme të ndjekura në këtë drejtim nga organi procedues mendoj se i disiplinon udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i Prokurorit të Përgjithshëm” për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”. Në këtë urdhër normohet se për regjistrimin e njoftimit të veprës penale, si dhe njoftimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale të bëhet me urdhër, përkatësisht “ **vendim të veçantë të arsyetuar të prokurorit**” (nenit 287/1 dhe 315/3 të K.Pr.Penale të Shqipërisë, e që KPPRK, viti 2012, sipas nenit 104, e rregullon me emërtimin “ **Vendim mbi fillimin e hetimeve**”. Me gjithë këtë plotësim, mendoj se një akt të tillë kryesor, siç është ai i regjistrimit të procedimit penal duhet bërë rregullime të nevojshme me ligj. Në lidhje me mosfillimin e procedimit penal, KPP-ja e vitit 1953 parashikon se “ **çështja penale nuk duhet të fillojë ose duhet të pushohet ndaj të pandehurit**”, ndërsa KPPSH-ja e vitit 1980, parashikon se çështja penale nuk duhet të fillojë ose duhet të pushohet ndaj personit. Mendoj se ky është një dallim i madh, pasi që rastin e parë që ndërlidhet me vitin 1953 personi, megjithëse janë rrethanat që e përjashtojnë fillimin e çështjes penale, të lënë të kuptosh se personi i kallëzuar mund të merret në përgjegjësi penale si i pandehur, mirëpo në mungesë të provave edhe pas këtij procedimi çështja mund të pushohet. Sa i përket KPPSH-së së vitit 1980, “ **personi nuk ekziston**”, një version i tillë po mjafton konstatimi i njërit nga kushtet e parashikuara në Kod, ku çështja nuk duhet të fillojë dhe të vendoset mosfillimi apo pushimi i çështjes penale. Kjo tregon për arbitraritetin shtetëror dhe shkeljen e të drejtave të njeriut i cili ishte i paragjykuar dhe i paralizuar edhe në rastet kur çështja penale nuk duhej të fillonte.

Për personat që ende nuk e kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale ose kur vlerësohet se dënimet ndaj tyre janë të papërshtatshme e që kanë kryer vepra penale ndaj tyre sipas Kodit të vitit 1980, ligji ka parashikuar masa edukative ku si të tilla janë të shumta sipas kodeve penale të të dyja vendeve dhe, varësisht nga personaliteti i kryerësit, prokuroria

dhe gjykata aplikojnë zbatimin e tyre , marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e vendimmarrjes. Si të tilla vlen përmendur masat edukative si në vijim:

-Lënia e personit për edukim kolektiv ose organizatë shoqërore; dhe

-Vendosja e të miturit në një institucion edukimi.

Mendoj se aplikimi i masave të tilla institucionale ndaj të miturve, të cilët kryejnë vepra penale, Kodet Penale i kanë paraparë të nevojshme dhe efektive për risocializimin e personave të mitur që kryejnë vepra penale, sepse, si të tilla kanë treguar efekte risocializimi dhe largimin e të miturive nga rruga drejt kriminalitetit.

Nëse vështrojmë kategorinë e veprave penale që ndiqen mbi bazat ankimore të të dëmtuarit, vërejmë se në nenin 63/3 të KPPSH-së të vitit 1980 parashikohen disa vepra penale, të cilat i japin të drejtë të dëmtuarit të inicoj ndjekjen mbi bazën e vullnetare ankimore:

Neni 177, paragraf 1, që parashikon veprën penale të rrahjes; neni 183/1 që parashikon dhunimin e banesës; neni 181, heqja e paligjshme e lirisë; neni 176, plagosja e lehtë nga pakujdesia; neni 184, kanosja; neni 185, fyerja; neni 186, shpifja; dhe sipas nenit 63/5 janë veprat penale që ndërlidhen me: vjedhjen, neni 101; mashtrimin, neni 104; shpërdorimi i pasurisë, neni 195; falsifikimi i dokumenteve, neni 197; blerja e pasurisë së shtetasve që rrjedh nga një krim ose pranimi i saj, neni 198 të këtij Kodi, të kryera midis të paralindurve, të paslindurve ose bashkëshortëve, në qoftë se jetojnë bashkë në një familje, inicimi penal fillon me kërkesën e të dëmtuarit. Heqja dorë nga kërkesa nuk ndalon vazhdimin e çështjes penale.

Çështjet penale që KPPSH-ja e vitit 1953 njeh për ndjekje veprat penale mbi ankimin e të dëmtuarit janë përcaktuar dhe në nenin 14, ku për krime të parashikuara nga nenet 150 (plagosja e rëndë me dashje) paragraf 2, marrëdhëniet seksuale me persona që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, neni 166; korrupsioni me anë të veprave të turpshme i personave

që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, neni 167; plagosja e rëndë me dashje e disa personave, neni 151, paragraf 1; marrëdhëniet seksuale të personave që janë në gjini gjaku në vijë të drejtë, neni 168, paragraf 1 i KPPSH-së, e që për të gjitha këto vepra të cituara ndjekja penale fillohet vetëm në saje të kërkesës së të dëmtuarit, sepse ligji ia ka siguruar të drejtën e akuzës dhe se edhe pushimi i procedurës nëse është filluar mund të pushohet kur i dëmtuari tërhiqet nga kërkesa.

Heqja dorë nga kërkesa i lejohej të dëmtuarit në çdo moment dhe në çdo stad të rrjedhës së procedurës penale përderisa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë (Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, vitet 1953 dhe 1980).

Për këto çështje nuk mund të vendoset pushimi i ndjekjes penale sipas neneve 3, paragraf i fundit dhe nenit 45 (përfshirë nga dënimi për mungesë të rrezikshmërisë shoqërore) të Kodit Penal.

Në qoftë se prokurori i shtetit e sheh të nevojshme të marrë pjesë në një çështje të tillë për të mbrojtur një interes shoqëror, mbrojtja e akuzës në këtë rast i takon vetëm prokurorit pavarësisht vullnetit të dëmtuarit për heqje dorë nga kërkesa.

Sipas nenit 15 janë të përcaktuara disa krime e që në vijim vlen t'i përmendim sepse si të tilla janë të normuara me nene të veçanta e që edhe për to fillon ndjekja penale me kërkesën e të dëmtuarit, por nuk pushon në heqje dorë nga kërkesa. Ndër këto vepra, vlen të përmenden vepra penale falsifikimi i dokumenteve private sipas nenit 192; blerja ose pranimi i pasurisë që rrjedh nga një krim 193; kamata e paligjshme, neni 191 dhe dështimi i kryer nga vetë gruaja neni 160.

Poashtu ndjekja penale fillon me kërkesën e të dëmtuarit edhe për disa krime që ndërlidhen nga nenet 183 (mosdhënia e mjeteve për ushqim) paragraf 1, vjedhja nga neni 185; rrëmbimi i fëmijëve nga neni 180; përvetësimi i pasurisë së gjetur, neni 189, paragraf 1 i KPPSH-së, shtrëngimi nga neni 187, vepra penale këto të përmendura sipas KPPSH-së të

kryera midis të paralindurve, të paslindurve ose të bashkëshortëve të cilët jetojnë në një familje.

Për krimet e trajtuara me dispozita numerike të theksuara, heqja dorë nga kërkesa e të dëmtuarit nuk e ndalon vazhdimin e ndjekjes penale. Ndryshe ekziston situata referuar dispozitave të KPPK-së, e që, ky përjashtim ndërlidhet për veprat penale: të kanosjes³³, shpërdorimit (neni 257, paragraf 1, pika 6, KPPK, 2004:110) dhe për vepres penale marrja e pasurisë së luajtshme (neni 258, paragraf 3 të KPPK-së, 2004:3) etj., përcaktuar sipas KPPK-së, viti 2004, nuk mund të ndiqen kur i dëmtuari bën tërheqjen e propozimit për ndjekje penale).

Në përcaktimin e vëllimit të veprave penale për të cilat ligjvënësi ka vendosur që të ndiqen mbi bazën e ankimit të dëmtuarit pa dyshim se pasqyrojnë një stad të caktuar të zhvillimit shoqëror. Mendoj se në Kodin aktual Kosovar dhe atë Shqiptar të RSH, duhet zgjeruar rrethi i veprave penale, të cilat duhet të ndiqen mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit, si dhe i atyre figurave të veprave penale të cilat nuk ka nevojë që të kryhen hetime, por të dërgohen drejtpërsëdrejti në gjykatë. Përgjithësisht vihet re se mbi ankimin e të dëmtuarit në ndonjë përjashtim parashikohen vepra të tilla penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe që janë të thjeshta për t'u hetuar.

Fillimi i procedimit penal si institut proceduralo-penal është i bazuar në ligjin materialo-procedural-penal dhe në këtë kontest, duke iu referuar normave ligjore që disiplinojnë këtë institut, t'i përcaktojmë tiparet që e karakterizojnë atë.

2.3. Fillimi i procedimit penal dhe rëndësia e tij

Pikënisja e veprimtarisë procedurale e organeve të ndjekjes është fillimi i procedimit penal. Me një moment të tillë lidhet veprimtaria procedurale-hetimore në drejtim të dokumentimit

³³ Neni 161, paragraf 5, të KPPK-së, i vitit 2004 të tij.

mbi bazat ligjore të akteve dhe fakteve të çështjes të përcaktimit të fajësisë së autorëve të veprave penale.

Instituti i fillimit të hetimeve, përkatësisht procedimit penal, ka një rëndësi të madhe shoqërore dhe juridike. Rëndësia shoqërore lidhet me faktin se përmes këtij instituti fillohet procedimi penal, i cili ka për qëllim luftën kundër kriminalitetit, mbrojtjen e interesave shoqërore të ligjshme të shtetasve të vet, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, si dhe të vetë rendit juridik. Rëndësia juridike qëndron në faktin se nga momenti kur organi procedues vendos fillimin e procedimit, legjitimohet tërësisht që të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme procedurale të parashikuara nga KPPK-ja dhe KPPSH-ja, që kanë të bëjnë me sqarimin dhe argumentimin e rrethanave të çështjes konkrete gjatë hetimeve. Sa më afër të jetë një vendimmarrje mbi fillimin e procedimit penal në vetë kohën e kryerjes së veprës penale, aq me efikase do të jetë veprimtaria e organeve të ndjekjes penale në drejtim të kërkimit, gjetjes, grumbullimit, zbulimit të fakteve, identifikimit të autorëve të veprave penale dhe vënien e tyre para përgjegjësisë penale.³⁴

Përveç kësaj vendimmarrjen duhet parë edhe në anën tjetër të medaljes, në garantim të ligjshmërisë që marrja e vendimit të jetë e bazuar, në funksion të respektimit, të lirive dhe të të drejtave të shtetasve ndaj të cilëve organet e prokurorisë ndërmarrin veprime procedurale hetimore.

Prokuroritë e niveleve të ndryshme në kuptimin global dhe nacional, janë të autorizuar nga shoqëritë përkatëse të vendit që përmes ligjit themeltar kushtetues dhe ligjeve bazike të kodeve përkatëse procedurale, ushtrimin e ndjekjes penale e bëjnë sipas inicimeve – denoncimeve apo kryesishtë, me qëllim të mbrojtjes së vlerave juridike të çdo shoqërie, për shkak se fillimi i procedimit penal është në interes të publikut kur paraqitet nevoja për një gjë të tillë.

³⁴Skënder Begeja, *Kriminalistika*, 2004.

Neni 24/3 të KPPSH-së përcakton: “Kur nuk është i domosdoshëm ankimi ose autorizimi për procedim, ndjekja penale ushtrohet kryesisht”. Del qartë se ky parim, bën të mundur që procedimi penal të jetë detyrë e organit procedues duke u mbështetur pikërisht në interesin shoqëror, interes i cili kërkon që fillimi i procedimit, ndryshe nga ndjekja *ex-officio* kemi për ato raste kur përcaktimi i penale të bëhet nga prokuroria pavarësisht dëshirës së të dëmtuarit (sipas KPPK-së, 2012) për të ushtruar ndjekjen penale janë vetë të dëmtuarit e veprës penale, sigurisht vetëm për ato vepra të përcaktuara shprehimisht në KPPSH, nenet 59 dhe 284, i dëmtuari i akuzës person i dëmtuar nga vepra penale.

2.4. Karakteri detyrues i fillimit të procedimit penal

Sipas KPPK-së dhe KPPSH-së, sistemi i ndjekjes penale është detyrues. Nga kjo rrjedh se prokurori i shtetit, si organ i autorizuar, është titullar i ndjekjes penale dhe ka detyrim ligjor që të fillojë së proceduari ndaj çdo fakti që ka të bëjë me vepra penale. Pra, sistemi i procedimit penal sipas KPPK-së dhe atij të shtetit shqiptar ka sanksionuar se fillimi i procedimit penal është detyrë e menjehershme e organit procedues, pikërisht organit akuzues në këtë rast, prokurorëve të dyja vendeve, si organe për ndërmarrjen e ndjekjes penale drejtë ndriçimit të rasteve kriminale, penale që kryerësit e krimeve të vihen para drejtësisë dhe të njëjtit të ndëshkohen me dënimin meritore - sanksionuar për veprimet e tyre të bëra pas vërtetimit dhe administrimit të provave që gjykatat përkatëse i nxjerrin gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura.

Fillimi i procedimit penal manifeston veprimin e organit ndjekës në rastin konkret prokurorët e shtetit. Këto që konform dispozitave përkatëse të KPPK-së dhe KPP-së shqiptare, që nga momenti i ardhjes në dijeni për vepra penale të ndodhura, qoftë nga policia apo nga institucionet e tjera me të drejtë ligjore të paraqitjes së kallëzimeve penale dhe nga momenti i pranimit të tyre-(neni 209, paragraf 2 i KPPK-së, v, 2004; dhe të

KPPSH-së,v,1995), kanë obligim ligjor që, menjëher kallximeve të pranuar, tju japin përgjigje ligjore, duke ndërmarrë veprime hetimore të nevojshme rreth ndriqimit të rastit të paraqitur.

2.5 Ligjshmëria e fillimit të procedimit penal në Kosovë dhe Shqipëri

Synimi i çdo prokurori të shtetit dhe organeve të tjera të lidhura me ndjekejen penale është qëndrimi për t'u shërbyer idealeve dhe detyrave të besuara, për punët dhe detyrat e tyre të përditshme, të ndërmarrin ndjekjet penale drejt ndriqimit të rasteve penale, që ndaj kryerësve të veprave penale, në mënyrë të ligjshme, të aplikojnë dhe të zbatojnë dispozitat përkatëse ligjore për rastet konkrete, me norma përkatëse.

Sipas sistemit të procedimit penal, duhet të zbatohet parimi i ligjshmërisë, i cili nënkupton respektimin dhe zbatimin e detyrueshëm të normave ligjore, sepse ky parim në mesin e shumë parimeve të tjera është “parim i përgjithshëm dhe primar që duhet respektuar” (neni 33 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vitit 2008, dhe neni 29, paragraf 1 i KRSH-së, 1998). Këto parime përmes, dispozitave të përgjithshme, përcaktohen edhe në legjislacionet procedurale të kodeve, ku thuhet: Sipas KPPK-së dhe nenit 2 të KPPSH-së, “Dispozitat procedurale caktojnë rregulla për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, hetimit dhe gjykimin e personave të cilët ishin të përfshirë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e pakënaqësive me mjete ankimore ndaj vendimeve gjyqësore, si dhe më në fund, rregullojmë mënyrën dhe zbatimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të normuara dhe shprehin detyrim ligjor, për t'u respektuar nga ana e subjekteve të procedimit penal, nga personat juridik, organet shtetërore dhe shtetasit e vendit”³⁵.

Kështu, sipas kapitullit IV (n. 46–52 të KPRK-së, të vitit 2012 fq.19-20) të KPPK-së, perkatesisht neni 24 të KPPSH-së, prokurori i shtetit është i detyruar të ndërmarrë

³⁵Kodi i Procedurës Penale, viti 1995,

ndjekjen penale rreth fillimit të procedimit penal, kur ndaj personit apo personave të caktuar ekziston dyshimi i arsyeshëm, se është kryer vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare apo sipas ankimit të të dëmtuarit. Kjo ndjekje ushtrohet kur ekzistojnë fakte dhe dyshim i arsyeshëm apo i bazuar mirë se është kryer vepra penale e përcaktuar me ligj.

Për t'i evituar hetimet e panevojshme KPPK-ja, ka përcaktuar se, për të filluar një hetim ndaj një personi, duhet të jetë evident, së paku dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar se është kryer vepra penale e përcaktuar me ligje, për të lindë detyrimi ligjor dhe autorizues prokurorëve për të marrë vendim mbi fillimin e hetimeve. Në të kundërtën, në saje të kallëzimit penal, duhet që të ndërmarrë veprime shtesë përmes policisë gjyqësore apo drejtpërdrejt për sigurimin e fakteve të nevojshme për të filluar një procedim të ligjshëm për të ndërmarrë ndjekjen penale. Në të kundërtën, përfundojmë në situata të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme, të cilat janë të panevojshme dhe të padëshirueshme.

Në lidhje me ligjshmërinë e fillimit të procedimit penal, përkatësisht fillimin e paligjshëm të ndjekjes penale, KPSH-ja, përmes nenit 313, për të garantuar ligjshmërinë e ndjekjes penale, parashikon si krim fillimin e paligjshëm të ndjekjes penale, duke siguruar kështu garantimin e një prej të drejtave themelore të njeriut, paprekshmërinë e personit. Garanci kjo e njohur dhe e sanksionuar me ligjin themelor të shtetit dhe konventat për liri dhe të drejtat e njeriut dhe normave morale në funksion të respektimit të dinjitetit njerëzor të të pandehurve, bazuar në aktet më të larta, të cilat i garantojnë të drejtat dhe liritë individuale. Kompozimi i funksionit hetues me funksionin e mbikëqyrësit të të drejtave dhe lirive individuale është logjika e ligjvënësit, e cila, që në fazën fillestare të zbatimit të KPPK-së, po has në vështirësi. Edhe pse nga kjo fazë rrjedhin detyrimet ligjore të organeve proceduese që, si të tilla në praktikë nuk po gjejnë zbatim të duhur, ose me vështirësi po zbatohen parimet ***in dubio pro reo, prezumimi i pafajësisë dhe parimi i ekonomizimit***. Jo rrallë herë, hamendjet e prokurorisë lidhur me ekzistencën ose mosekzistencën e veprës

penale apo me cilësimin juridik të saj, duhet t'i vendosë gjykata. Dominon logjika që çështjet e caktuara t'i vlerësojë gjykata. Mund të nxjerrim një përfundim se funksioni i hetimit, barra e provave dhe kujdesi ndaj personalitetit të të pandehurit duhet finalizuar me akte akuzuese racionale e të bazuara në prova të themelta.

Kjo nënkupton faktin se funksioni i prokurorit, sipas KPPK-së, është funksioni më i ndjeshëm, me detyrime shumëdimensionale. Mënjanimi apo nënvlerësimi i logjikës mbi nevojën e veprimit të prokurorisë, sipas logjikës së theksuar më sipër, është shkelje e drejtpërdrejtë e parimeve dhe dispozitave procedurale dhe lirive e të drejtave të njeriut.

Fillimi i procedimit penal si institut proceduralo-penal është i bazuar në ligjin materialo-procedural-penal dhe në këtë kontekst, duke iu referuar normave ligjore të këtij institut i ri, përcaktimeve të tipareve që e karakterizojnë atë, lindin detyrimet e subjekteve të procedimit penal, personave juridikë, për organet shtetërore dhe shtetasit e vendit³⁶.

Kështu, sipas nenit 46 të KPPK-së, gjegjësisht, nenit 24 të KPPSH-së, prokurori i shtetit është i detyruar të ndërmarrë ndjekjen penale rreth fillimit të procedimit penal kur ndaj personit apo personave të caktuar ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale. Ndjekja sipas detyrës zyrtare-shtetërore ushtrohet kur ekzistojnë fakte dhe dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar se është kryer vepra penale. Për ta evituar hetimin e paarsyeshëm, KPPK-së ka përcaktuar se, për të filluar hetimi ndaj një personi, duhet të jetë evident së paku dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar se është kryer vepra penale, dhe, pastaj organi ndjekës të marrë vendim mbi fillimin e hetimeve, apo të mbledhë akoma prova në sajë të veprimeve në të kundërtën në sajë të kallëzimit penal, duhet që të ndërmarrë veprime hetimore shtesë përmes policisë apo edhe vetë si prokuror e më pas varësisht nga faktet e grumbulluara të merë vendim konkret ligjor sipas ligjit për fillim apo jo fillim hetimesh.

³⁶ Kodi i Procedurës Penale, i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1995.

2.6. Objektiviteti dhe paanshmëria e fillimit të procedimit penal

Fillimi i procedimit penal duhet të ketë karakter objektiv. Është detyrim ligjor që organet e ndjekjes të ushtrojnë detyrën e besuar, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje pozitive, në mënyrë të drejtë, të paanshme ndaj secilit person që kryen apo tenton të kryej vepër penale, pavarësisht përkatësisë së tyre politike, etnike, fetare, racore etj. Ky karakter nënkupton zbatim korrekt të ligjit, pa u bërë objekt ndikimesh, qoftë të brendshme apo të jashtme, presionesh, kanosjesh, ndërhyrjesh të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nga kushdo dhe për çfarëdo arsyes. Kryerja e detyrës korrekte dhe funksioni i besuar, qoftë si prokuror apo gjyqtar, nuk duhet kuptuar si një privilegj në kryerjen e funksioneve publike, por duhet kuptuar si një detyrim ligjor, kushtetues ligjor dhe profesional. Mosrespektimi i këtij parimi humb besimin në sytë e publikut si, vëzhgues i jashtëm, i cili, në njëfarë forme përpiqet ta përcjellë punën nga këndvështrimi i një sy kritik, si në sistemin prokurorial ashtu edhe në atë gjyqësor, organe këto të pavarura dhe të shenjta, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Vlera e paanshmërisë është kategori kushtetuese, si në Kosovë ashtu edhe Shqipëri, që i atribuohet Sistemit Prokurorial dhe atij Gjyqësor në përgjithësi, e veçanërisht individualitetit të prokurorëve dhe gjyqtarëve në veçanti. Parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal nuk duhet kuptuar në mënyrë selektive të rasteve, por këto parime duhet kuptuar në mënyrë të përgjithshme, për të gjitha rastet që na paraqiten. Këto parime si dhe shumë të tjera jo të paraqitura, jo vetëm që janë të karakterit nacional, por obligohemi t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë, sepse, nga aktet juridike më të larta e deri tek ato ligjore sepse si të tilla janë detyruese dhe me karakter universal. Sepse janë të përcaktuara edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, sipas neneve 3, 4, 5, 6, 7, si dhe me shumë instrumente të tjera të karakterit evropian.

2.7. Objekti i procedimit penal, kuptimi i çështjes penale në procedimin penal

Përcaktueshmëria normuese e veprave penale, si në KPK dhe në KPSH, është edhe arsye e ekzistencës së zhvillimit të procedurës penale, duke obliguar shtetin që nëpërmjet veprimeve të parashikuara në procedurën penale të zbulojë nëse është kryer ose jo vepra penale, cili është autori i kryerjes së saj, të vërtetohet se vepra a është kryer me dashje direkte apo me dashje eventuale, me faj apo pa faj, në çfarë forme faji është kryer etj³⁷. Në këtë mënyrë, rruga që ndiqet nga organet proceduese orientohet rreth një ngjarjeje, ndodhie, veprimi, e më pas në drejtim të një personi. Ose orientimi mund të jetë si ndaj faktit ashtu edhe ndaj personit, në të njëjtën kohë (njëkohësisht),mënyrë të njëkohshme. Atëherë kur kemi atribuim të veprës penale ndaj një personi, konkret. Pikërisht këto fakte, veprime apo mosveprim e ngjarje, janë objekt i perceptimit intelektual për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë të dënueshme penalisht. Pra përbëjnë edhe objektin e procedurës penale apo, thënë ndryshe, përbëjnë çështjen penale. Për këtë arsye, policia gjyqësore, përkundër aktivitetit të ndërmarrë në hapat fillestarë të hetimit³⁸, konform dispozitiv të KPPK-së, në grumbullimin e informacioneve rreth zbulimit të kryerësit të mundshëm, nuk arrin ta bëjë një gjë të tillë ashtu që aktivitetin e vet taktiko-operativ të punës e formalizon me paraqitjen e kallëzimit penal ndaj NN personit edhe pse vepra ka ndodhur dhe i dëmtuari është evident, sipas shprehjes së ankimit. Në sajë të këtij ankimi, të të dëmtuarit ,aktiviteti i bie mbi supe fillimisht policisë përkatëse që të merret me rastin në shqyrtim me prokurorët e çështjes përkitazi me ndërmarrjen e veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve. Kodi i procedurës penale, ka përcaktuar se organet proceduese duhet të kryejnë veprime procedurale hetimore edhe pa qenë i individualizuar

³⁷Salihu, I. *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Prishtinë 2005, f. 292

³⁸ Nenet 80–81 të KPPK-së, të vitit 2012:29, 30 dhe në 281, 282,283të KPSH-së,1995.

personi që mund të ketë kryer atë siç theksohet në nenin 287³⁹, neni 326 (pezullimi i hetimeve) të KPP-së.

Pra, nga ky detyrim del se mund të procedohet me procedim penal për një vepër penale e cila paramendohet si e tillë edhe kur nuk njihet autori i veprës. Pra edhe kur mungojnë dy nga elementet e figurës së veprës penale dhe, konkretisht, subjekti dhe ana subjektive e veprës penale. Nga kjo del se jemi para një çështjeje penale, atëherë kur ekzistojnë katër elemente të figurës së veprës penale, por çështje penale kemi edhe atëherë kur kemi vetëm dy nga elementet e saj dhe, pikërisht, elementet e anës subjektive dhe objektin e figurës së veprës penale.

Në varësi të çështjes penale, nëse ekzistojnë të katërta elementet e figurës së veprës penale, apo vetëm dy nga elementet e saj, kemi dhe detyrimin e organit procedues për të zhvilluar procedimin penal, njëkohësisht, si rreth faktit, ashtu edhe ndaj personit. Poskësaj, organi ndjekës zhvillon edhe procedimin penal rreth faktit, për të vërtetuar rrethanat e tij dhe, më pas, për të zbuluar autorin e kryerjes së vepres penale, nëse e ka kryer me faj ose jo dhe me çfarëdo forme faji. Pra, objekt i procedimit penal është çështja penale, e cila na paraqitet në kuadrin e perceptimit intelektual, në formën e dyshimit të arsyeshëm se jemi para një vepre penale gjegjësisht, para një fakti kriminal, por pa persona konkretë, apo në formën e një fakti të dënueshëm penalisht që i atribuohet një personi konkret.

Ndërkaq, procedimi penal është një dhe i vetëm, por nga pikëpamja e fillimit të tij themi që fillim të procedimit penal kemi atëherë kur procedojmë rreth një fakti, i cili paramendohet se është kriminal. Më pas vazhdohet në atribuim të një personi konkret ose, në të kundërtën, pezullohet procedimi hetimor për moszbulim autori, deri sa të plotësohet afati i parashkrimit, si institut që aplikohet, si me dispozitat e KPK-së, ashtu edhe me dispozitat e KPSH-së.

³⁹ Regjistri i njoftimit të veprave penale sipas nenit 287 par 1 të KPPSH, vit 1995.

2.8. Procedimi penal apo ndjekja penale?

Procedimi penal apo ndjekja penale? – kësaj pyetjeje i jepet zgjidhje nëpërmes dhënies përgjigje të pyetjes përse ekzistojnë dispozitat e kodit të procedurës penale?

Kodi i Procedurës Penale, duke normuar rrugën që duhet të ndiqet nga organet shtetërore për aplikimin e dënimit ndaj atyre individëve që kanë cenuar, dëmtuar apo kanë rrezikuar një të drejte, të marrë nën mbrojtje nga ligji penal për t'i dhënë përgjigje edhe pyetjes se përse ekzistojnë dispozitat e tij.

Kështu, mund të themi se objekt i procedimit penal është fakti (veprimi, mosveprimi, ngjarja), e cila dyshohet që është e karakterit kriminal. Pra, është materia, ngjarja që është objekt i procedimit mendor të njeriut. Kodi i Procedurës Penale fillimin e procedimit penal dhe vazhdimin e tij e ndërmerret edhe pa qenë i individualizuar personi që e ka kryer veprën penale. E mjaftueshme është ardhja në dijeni se është kryer vepra penale dhe është provokuar me paraqitje kallëzimi penal se është kryer vepra penale. Madje madje, KPP-ja, në nenet 293, 294 e në vijim, ka përcaktuar dhe veprime të ngutshme, apo, thënë ndryshe, të papërsëritshme, që duhet të kryhen nga prokuroria apo policia gjyqësore detyrimisht kur është vënë në dijeni, në mënyra dhe forma të ndryshme, se ka ndodhur apo pritet për t'u kryer një vepër e caktuar penale. Me njoftim, përkatësisht me të regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale në prokurori se është kryer vepra dhe se ekziston dyshimi arsyeshëm edhe pa qenë i individualizuar personi i dyshuar si autor i kryerjes së saj. Kjo shpjegohet me faktin se, shteti, nëpërmjet organeve të tij, është i autorizuar nga shoqëria (ligjvënësi) të reagojë ndaj atyre veprimeve, të cilat vetë shoqëria nëpërmjet ligjvënësit i ka përcaktuar në veprime të dënueshme. Pra, këtu ndërthuret e drejta materiale penale me të drejtën procedurale penale.

Kodi Procedural i Kosovës, përkatësisht KPPSH-ja, përcaktojnë rrugën, veprimet që duhet të ndiqen nga organet që kanë për funksion luftën kundër kriminalitetit dhe vënien në vend të së drejtës së cenuar, e mbrojtur nga e drejta materiale penale. Ndërkohë kjo rrugë e gjatë ka për qëllim aplikimin e një sanksioni penal ndaj një shkelësi të ligjit penal-material.

Prokuroria, së bashku me policinë gjyqësore janë organe që kanë si mision të posaçëm luftën kundër kriminalitetit. KPP-ja ka përcaktuar rregullat e detyrueshme që diktojnë kryerjen e veprimeve procedurale hetimore nga prokuroria e policia gjyqësore edhe pa qenë i individualizuar personi që e ka kryer veprën penale. Këto detyrime burojnë nga funksioni kryesor që ato kanë për luftën kundër kriminalitetit, funksion i cili shprehet me shprehjen e ndjekjes penale, përmes marrjes së veprimeve hetimore të nevojshme të përcaktuara sipas dispozitave normuese të KPPPK gjegjësisht të KPPRK-së, përkatësisht të KPPSH-së.

Meqë figura e veprës penale ka katër elemente, ligji procedural penal, për efekt të luftës ndaj kriminalitetit, që zhvillojnë këto organe, ka autorizuar prokurorinë dhe policinë gjyqësore që të ndërmarrin veprime procedurale hetimore për të zbuluar autorin e veprës penale. Pra, zbulimi i autorit të veprës penale është qenësor për krijim të mundësisë për ushtrimin e ndjekjes penale nga prokuroria, organ ky që kryen këtë funksion, i ndihmuar edhe nga policia gjyqësore. Për të përmbushur funksionin në luftën kundër kriminalitetit, KPP-ja ka autorizuar prokurorinë dhe policinë gjyqësore që të kryejnë veprime procedurale edhe pa qenë i individualizuar personi. Mjafton që të ekzistojnë vetëm dy elementet e një figure të veprës penale. Pra, veprimet e kryera nga prokuroria e policia gjyqësore kryhen në drejtim të elementeve thelbësore të faktit, siç mund të jenë: -këqyrja e vendit të ngjarjes nga ana e policisë gjyqësore, që ndërlidhet me veprimet e para policore të quajtura veprime

fillestare hetimore, të cilat ndërmerren pasi që policia të ketë pranuar informata se është kryer vepra penale⁴⁰ pas ndodhjes së veprës penale;

-Ekspertimi i gjurmëve të ndryshme nga personat përgjegjës të forensikës;

-Marrja e të dhënave nga personat e vendit të ngjarjes (nenin 70 paragraf 1, 2 dhe 3.3, 3.4 të KPRK-së, 2012), filluar me të dëmtuarit, dëshmitarët, poqë se ka edhe persona të tjerë, të cilët në momentin e ndodhjes së veprës penale kanë qenë të pranishëm dhe e kanë parë ngjarjen se si është zhvilluar.

Të kryesh këto veprime do të thotë se ke proceduar përkitazi me një vepër penale, pasi ke aplikuar formën, veprimet që parashikon procedura penale (gjithmonë ekziston dyshimi, perceptimi intelektual që kemi një vepër penale—veprimin e penalizuar).

Por, këtu duhet të sqarohet koncepti procedim, se nuk procedohet fakti e as nuk procedohet personi në rastin kur është individualizuar, por procedohet, bëhen ndjekje, kryhen veprime procedurale, penale, në drejtim të faktit, rreth këtij fakti të paramenduar kriminal. Së pari, duhet sqaruar nëse fakti është kriminal, apo jo, është i shkaktuar nga ndonjë veprim njerëzor, apo nga ndonjë shkak jonjerëzor, nëse ekzistojnë pasoja kriminale, apo jo, koha kur ka ndodhur fakti, mjetet me të cilat është kryer vepra, mënyra e kryerjes etj. Me këtë lloj të procedimit synohet sqarimi i elementeve të anës objektive të veprës penale, e paramenduar si e tillë.

Pokështu nuk procedohet personi, në kuptimin e drejtpërdrejtë, por kryhen hetime rreth këtij personi. Ndiqet nga prokuroria në lidhje me këtë fakt të paramenduar si veprim i ndaluar dhe i kundërligjshëm. Kur themi se procedohet personi, kuptojmë se ndaj tij kryhen një sërë veprimesh procedurale me qëllim të vërtetimit nëse fakti i paramenduar kriminal është shkaktuar nga ky person apo jo. Për këtë qëllim duke mbledhur prova të ndryshme e,

⁴⁰ Nenin 70, paragraf 1, 2, pika 3.9 e KPRK-së, 2012:26

më pas konkludohet nëse veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia apo jemi para një shtate të një rasti fatkeq të ndodhur.

Te sistemi ekzistues i ndjekjes penale, akuzator-inkuizitor, dispozitat që bëjnë fjalë për vënien në dijeni për veprën penale kanë të bëjnë me të ashtuquajturin sistemin akuzator. Me këtë rast nuk duhet anashkaluar edhe vetë sistemin inkuizitor, ndjekja përmes së cilit është e detyrueshme *ex officio* nga Prokuroria duke paraqit kërkes tekë gjyqëtari hetues, për fillimin e hetimeve. Në bazë të kësaj rrjedhë se funksioni i ndjekjes penale sipas sistemit inkuizitor, është i detyrueshem, kryesisht nga organi shtetëror-prokuroritë përkatëse të shteteve. Duke qenë se fillimi i procedimit penal i përket sistemit mikst të ndjekjes penale, ligji, kompetencat për ushtrimin e këtij funksioni ia ka dhënë edhe të dëmtuarit të akuzës, subjekt ky i posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale⁴¹ dhe atë sipas KPPPK-së, gjë që me Kodin e Procedurës Penale të tanishem nuk e ka këtë të drejtë të ndërmarrë ndjekjen si paditës subsidiar, kur prokurori tërhiqet nga ndjekja penale. Ky funksion i ndjekjes ka kaluar krejtësisht në duart e prokurorit, sa i përket së drejtës së hetimit në sate të kallëzimeve penale të pranuar – adresuara, qoftë përmes ushtrimeve institucionale, apo nga vetë të dëmtuarit-personat fizikë apo juridikë si denoncus të rasteve qe ju kanë ndodhur, gjegjësisht janë viktimizu.

Organet shtetërore aktivitetin e tyre në zhvillimin e veprimeve të procedurës hetimore e zhvillojnë sipas dispozitave të KPP-së, rreth një fakti të paramenduar si kriminal e që tillë është i përcaktuar me ligj se veprimi i kryerësit është i kundërligjshëm dhe, si i tillë ky veprim është i normuar edhe me sanksion penal.

Pra, koncepti “**procedim penal**” dhe “**ndjekje penale**” është koncept i së njëjtës gjë, që do të thotë se një fillim procedimi penal ndaj një fakti të perceptuar në kuadrin e dyshimit të arsyeshëm, se ka ndodhur një vepër penale, detyra ligjore e organeve autorizuese, me të

⁴¹ Nenet 101, 102, 103 të KPPRK-së 2012: 45, 46 të tijë.

marrë dijeni se vepra penale ka ndodhur apo është në pritje të ndodhjes, duhet që të vihen në veprime, të ndjekjes penale varësisht nga rasti. Pra, të fillohet me hapat e nevojshëm ligjorë, konform dispozitave të procedimit penal, pavarësisht se është ose jo i individualizuar autori i veprës penale. E tëra kjo është, njëkohësisht shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale. E njëjta gjë vlen edhe atëherë kur organi procedues kryen veprime procedurale në drejtim të një personi konkret, i cili është nën hetim si pandehur. Në këtë rast mund të themi se kemi procedim penal rreth një personi konkret për të cilin do të thotë se kemi ushtrim të ndjekjes penale. Në rastin e ushtrimit të ndjekjes penale nenet që përcaktojnë pushimin e çështjes nga gjykata e Kosovës janë të theksuara sipas dispozitave ligjor të KPPRK-së, ndër të cilat vlen të përmenden dispozita e nenit 363 dhe neni 364 e që për dallime KPPSH-ja këtë e rregullon sipas neneve 387, 428 dhe 442.

Sipas KPPRK-së, neni 363 përcakton, se gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet, atëherë kur:

- Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza, që nga hapja e shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundim të tij përcaktuar sipas (neni 52 të KPPPK-së, 2004:20). I akuzuari është gjykuar për të njëjtën vepër me aktgjykim⁴², të formës së prerë, apo procedura kundër tij ka pushuar me vendim të formës së prerë⁴³ apo kur ka kaluar afati i parashkrimit⁴⁴ të veprës. Poashtu, kur vepra penale është përfshihet me amnisti ose falje, apo kur ekzistojnë rrethana të tjera të përcaktuara me ligj që e përjashtojnë ndjekjen penale nga prokurori apo kur pushohet çështja në Gjykatë pasi mbajtje së shqyrtimit kryesor verbalo publikë e, në mungesë të provave të administruara gjatë shqyrtimit vërteton krejtë një pasqyrë tjetër

⁴² Aktgjykim i sjellur nga gjykatat në Kosovë, ka baras vlerësimë me vendimin gjyqësor të gjykatave në Shqipëri.

⁴³ Neni 36,3 p.1, pika 1.2, i KPRK-së, 2012 faqe 152;

⁴⁴ Neni 365, paragraf 1, pika 1.3, i KPRK-së, viti 2012, faqe 152

faktike në raportë më atë të prokurorit, Gjykata detyrimishtë obligohet të merr aktgjykim lirues, në situata e përcaktuara sipas asaj se :

- Vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale⁴⁵; Egzistenca e rrethanave që përjashtojnë, përgjegjësinë penale të kryerësit për të cilat rrethana do të flitet më gjerësisht në një pjesë të një kapitulli të ardhshëm të këtij punimi; dhe
- Në situatat kur gjatë gjyimit nuk është arritur të provohet se i akuzuari ka kryer vepren penale për të cilën akuzohet.

Për dallim nga Kodi i Pr. Penale të Kosoves, KPPSH-ja, me nenin 387, përcakton se Gjykata e faktit si gjykatë e shkallës së parë vendos pushimin e çështjes, **“Kur ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdohet, apo kur vepra penale është shuar”**. Ndërsa neni 428 përcakton se Gjykata e Apelit, pasi të shqyrtojë çështjen sipas mjeteve juridike ankimore të rregullt, vendos si më poshtë:

-Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, në rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit.

Në nenin 442 theksohet se Gjykata e Lartë vendos pushimin e çështjes atëherë:

-Kur ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose të vazhdohet.

Poashtu edhe Gjykata e Apelit sipas autorizimeve që ka konform ligjit mbi Gjykatat, si instancë e shkallës së dytë, sipas mjeteve të rregullta juridike vendos në raste të caktuara, edhe pushimin e çështjes, përveç vërtetimit të aktgjyimit të shkallës së parë, mund të vendos ndryshimin e tij, apo të vendos prishjen dhe, kthimin e çështjes në riprocedurë të shkallës së parë pranë gjykatës që ka sjell vendimin mbi çështjen penale. Siç shihet për të njëjtin vendim baza ligjore që Gjykata e Apelit e përdor, i referohet me saktësi neni 290, i cili bën fjalë për rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal apo vazhdimin e tij. Kurse Gjykata e Faktit dhe Gjykata e Lartë, si bazë ligjore për marrjen e vendimit për

⁴⁵ Neni, 390 par. 1, KPPK-së, 2004, faqe 169

pushimin e çështjes, u referohen rasteve kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte apo të vazhdonte.

Nëse do të donin të pranonin faktin që, koncepti **“ndjekje penale”** dhe **“procedim penal”** janë të ndryshëm, nuk do të bënin gjë tjetër veç se do të pranonin cenimin e ligjshmërisë së sistemit të drejtësisë, ku gjykatat e shkallëve të ndryshme marrin të njëjtin vendim gjyqësor, atë të pushimit të çështjes, duke iu referuar rasteve të ndryshme. Ndërkaq, po të pranonin këtë fakt, se këto koncepte janë të ndryshme, atëherë do të përqafonin idenë e një sistemi të pasigurisë juridike. Në këtë arsyetim, në të kundërtën, nëse e pranojmë se sistemi ynë i drejtësisë bazohet në ligjshmëri dhe siguri juridike, atëherë termi **“ndjekje penale”** dhe **“procedim penal”**, që përcaktojnë kodet e shteteve të cilave u referohet punimi, është i njëjti koncept dhe, si rrjedhojë nuk lejojnë fillimin e procedimit penal apo vazhdimin e tij. Nëse ka filluar, procedimi penal, ne sja të rrethanave ligjore, atëherë këto rrethana nuk mund të aplikohen në kuadër të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale apo vazhdimin e saj kur ajo ka filluar.

Pra, me nocionin **“ndjekje penale”** apo **“procedim penal”**, kuptojmë aktivitetin autorizues shtetëror që ndërmer Prokuroria, e ndihmuar nga policia gjyqësore, me anë të të cilit synohet të zbulohet nëse kemi vepër penale apo jo, cili është autori i saj, në çfarë forme faji është kryer ajo, si dhe të përcaktohet masa e dënimit nga ana e gjykatës dhe zbatimi i masës shqiptuese nga ana e Prokurorisë, apo Gjykatës.

2.9. Hetimi i rasteve penale , si shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale

Hetimi i rasteve penale vështuar kohesishtë sipas Legjislacionit ishë Procedural Jugosllavë, gjerë në vitin 2004 në Kosovë. Poashtu në Shqipëri gjerë në reformat e viteve 1992-94 hetimet ishin kryer përmes gjykatave. Me reformat të cilat janë zbatuar në këtë

sferë, posaçërishtë me aprovimin e KPr.PPK-ës, në vitin 2004 dhe në vitin 2012, janë përqaftuar më tepër elemente të sistemit akuzator ku hetimet nga gjykatat janë bartur tekë Prokuroria si organ i akuzës. Nji gjë e tillë ka ndodhur edhe me reformat në legjislacionin Penal dhe Procedurat në Shqipëri, pas viteve 1992-1994, kalimi prej nji sistemi ne nji sistemin aktual demokrati ku dhe është sjellur Kodi i Procedures Penale i vitit 1995. Rrjedhimishtë ne të dyja vendet si shtete, hetimet kanë kaluar nënë përgjegjësit dhe kompetencat e prokurorve të shtetit.

Prokuroret e shtetit, pas vlerësimit të kallëzimit penal të pranuar nga ana policia apo nga burimet tjera, vlerësojnë se provat e parashtruara në kallzim penal paraqesin dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale, atëherë prokurori-et, ka-në detyrim ligjor të sjellë vendim formal të shkruar për fillimin e hetimeve përshtatëshmerisht sipas (nenit 104 të KPPRK-së, 2012:45) përmes aktit formal, intern, te prokurorit të shtetit i cili vendim nuk mund të atakohet. Ndërsa në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë prokurori publik i fillon hetimet me “urdhër”, duke ju referuar (nenit 287/1 dhe nenit 315/3 të KPPSH-së.

Vendimi për fillimin e hetimeve sipas nenit 104 sipas KPrPK, duhet të përmbajë: personin ndaj të cilit kanë filluar hetimet apo që priten të fillojnë: Vepra për të cilin egziston dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar se është kryer, objekti i veprës penale, koha dhe vendi i kryerjes së saj, pasoja e shkaktuar, mjeti me të cilin është kryer vepra penale, i dëmtuari i veprës, si dhe rrethanat tjera të përcaktuara me ligje si; përshkrimi i veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimi ligjor i veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit nese janë autorizuar dhe provat me të dhënat e tjera (*E drejta e procedurës penale*) mbledhura deri në atë moment. Një kopje e vendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjithashtu, rezultatet e

veprimeve fillestare të policisë dhe mbledhjes së provave janë pjesë e lëndës hetimore. Hetimi kryhet vetëm lidhur me veprën penale dhe me të pandehurin e përcaktuar në vendim.

Qëllimi i hetimit është të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngrihet aktakuza apo të pushohet procedura dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jenë të pamundshme apo të vështira të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor (neni 103, paragraf 2). Me zbatimin e hetimit, mundësohet që materiali i panevojshëm, të mos shkojë në shqyrtimin gjyqësor, si i tillë duhet të veçohet nga provat tjera, kur vlerësohet se është siguruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Procedurës dhe se provat e tilla janë të papranushme për Gjykatën. Me çdo rast, me anë të hetimit duhet të sqarohet e të vërtetohen elementet përbërëse të veprës penale, si objekti, domethënë marrëdhëniet shoqërore që mbrohen posaçërisht nga ligji penal, veprimi ose mosveprimi i rrezikshëm për shoqërinë dhe i kundërligjshëm, lidhja shkajkore, si dhe faji kryesit në formën e dashjes apo pakujdesisë, elemente të tjera plotësuese a fakultative të veprës penale⁴⁶.

Prokurori i shtetit gjatë zbatimit të hetimeve, për hir edhe të objektivitetit të tij, duhet t'i çmojë jo vetëm rrethanat fajësuese, por edhe ato shfajësuese dhe të kujdeset që të merret prova, e cila mund të mos ishte në dispozicion më vonë në shqyrtim gjyqësor. Nëse prokurori i shtetit gjatë kryerjes së hetimit, eventualisht mëson për kryerjen e një vepre tjetër, penale ose për një të dyshuar tjetër atëherë ai mund të fillojë një hetim të ri, apo të marrë vendim për zgjerimin e hetimeve⁴⁷. Kundër të pandehurve, L.M., M.F. dhe A.K., zgjeroi hetimet për veprën penale, pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 i KPK-së. Për këtë

⁴⁶ Dharmi, Jorgo, *I pandehuri – marrja e një personi në cilësinë e të pandehurit*, Horizont, Tiranë 2001:22

⁴⁷ Rasti PP/I nr. 298/13, i datës 25.3.2014, ku prokurori i shtetit, zgjeroi hetimet e filluara kundër të pandehurit F.B. për vepër penale të vrasjes në datën 09.09.2013)

veprim e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake sipas (nenit 103, paragraf 4). Varësisht prej rrjedhës së hetimit, hetimi i filluar duhet ta ketë edhe fundin. Kështu nga rezultatet e hetimit, i cili mund të ketë përfundime të ndryshme. Në situata të caktuara me ligj hetimi mund të pezullohet, të pushohet ose të përfundojë kur është arritur qëllimi i hetimit, për të ngritur aktakuzën.

2.9.1. Pezullimi i hetimeve

Në rastet kur për zhvillimin e mëtutjeshëm të hetimit të filluar paraqiten pengesa procedurale, të cilat pamundësojnë zhvillimin e tij, prokurori i shtetit mund të marrë vendimin për pezullimin e hetimeve⁴⁸.

Para se të pezullohet hetimi mblidhen të gjitha provat e mundshme lidhur me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit (neni 157).

Pengesat procedurale për të cilat prokurori i shtetit mund të marrë vendim për pezullimin e hetimit, janë përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 157, e ato janë:

- se i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga ndonjë çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë;
- është arratisur; ose
- ekzistojnë rrethanat e tjera të cilat e pengojnë ndjekjen penale.

Prokurori i shtetit e rifillon hetimin e pezulluar pas eliminimit të pengesave⁴⁹, për të cilat është shkaktuar pezullimi dhe është marrë aktvendimi mbi pezullimin.

Në procesverbalin e hetimit bëhet shënimi për kohën dhe arsyet e pezullimit dhe pa vonesë njoftohet gjyqtari i procedurës paraprake në kuptim të dispozitës ligjore të (nenit

⁴⁸ (Rasti PP/I nr. 218/13, i datës 9.12.2013, kur prokurori i shtetit ka pezulluar hetimet për të pandehurit Z.K. nga shkaku se i njëjti gjendej në arrati, fq.80)

⁴⁹ Neni 157, par. 3, KPRK-së, viti 2012, fq.71.

157, paragraf 4 të KPPRK-ës, të vitit 2012). Sipas paragrafit 5, të nenit të lartpërmendur, derisa hetimi është i pezulluar, nuk llogaritet koha në zbatimin e hetimit, e as në kohën e parashkrimit të veprës penale. Hetimi i pezulluar mund të rifillojë atëherë kur pushojnë shkaqet për të cilat është marrë vendimi për pezullimin e hetimeve dhe krijohen kushtet procedurale për vazhdimin e tij.

2.9.2 . Pushimi i hetimeve⁵⁰

Mundësia tjetër e prokurorit të shtetit, pas ndërmarrjes, së veprimeve hetimore, është pushimi i hetimeve⁵¹, të cilat pushohen me vendim, në rastet kur: -nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm që personi për të cilin janë filluar hetimet ka kryer vepër penale; -vepra penale për të cilën kanë filluar hetimet, nuk paraqet vepër penale sipas K.Penal të Kosovës dhe asë të K. Penal të Shqipërisë.

-ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale ;

-vepra penale është përfshirë në amnistinë e miratuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe

-ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen (neni 158 paragraf 1, pika 1-5).

Pasi prokurori i shtetit ta pushojë hetimin, ai ka obligim ligjor dhe për këtë duhet ta njoftojë gjyqtarin e procedurës paraprake. Poashtu brenda tetë ditësh nga pushimi i hetimit, duhet ta njoftojë të dëmtuarin, i cili për dallim nga kodi i mëparshëm, tani nuk e ka të drejtën që të vazhdojë ndjekjen penale si paditës subsidiar, status të cilin ia garantonte neni 224, paragraf 2 i KPPP-së të vitit 2004. Hetimi, gjithashtu, pushohet automatikisht pas kalimit të afatit kohor nga neni 159, për të cilit do të flitet në vijim.

⁵⁰ Neni 158, paragraf 1, i KPRK-së, viti 2012

⁵¹ Rasti Prokurorise se Pejës PP.nr. 313/13, i datës 21.2.2014, ku prokurori i shtetit, në Prokurorinë Themelore në Pejë, D.K.R. pushoi hetimet kundër të pandehurit T.B. për vepër penale të grabitjes nga neni 329 i KPK-së, nga shkak se nuk ekzistojnë elementet e kësaj veprë penale.

Sa u përket pikave 4 dhe 5 (më lartë), e përkrahim mendimin e prof. Sahiti dhe Murati, të cilët theksojnë se ka një përsëritje të panevojshme lidhur me pushimin e hetimeve kur vepra penale është përfshirë me amnisti të miratuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nëse personi ndaj të cilit është filluar procedura penale, në ndërkohë vdes, prokurori detyrimisht obligohet të marrë aktvendim mbi pushimin e hetimeve sipas (neni 160 të KPPK-ës, apo sipas nenit 328 të KPPSH, të vitit 1995), me vetë faktin se hetimet ndërlidhen me individualizim të personit si kryes vepra e jo me persona të tjerë.

2.9.3. Kohëzgjatja e hetimeve

Hetimi i filluar nga prokurori i shtetit duhet edhe të përfundojë. Për dallim nga Kodi i mëparshëm i procedurës penale i cili sipas nenit 225 të KPPP-së, thotë se: *“nëse hetimi nuk përfundon brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, prokurori publik, i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit”*, mund të autorizojë hetimet edhe për gjashtë muaj të tjerë, kur kjo arsyetohet me ndërlikshmërinë e çështjes. Ndërsa për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me të paktën pesë vjet burgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë edhe një vazhdim prej gjashtë muajsh të tjerë. Gjykata Supreme e Kosovës, përjashtimisht ka mundur të autorizojë edhe një vazhdim prej gjashtë muajsh. Pra, përfundimisht hetimet, sipas KPPP-së, kanë mundur të zgjasin 24 muaj(dy vite).

Gjithashtu ,Me Kodin e ri të Procedurës Penale, përkatësisht me nenin 159, parashihet se hetimi duhet të përfundojë brenda dy viteve nga fillimi i tij. Nëse brenda këtyre dy viteve nuk është ngritur aktakuza ose nuk është pezulluar hetimi mbi bazën e arsyeve të cilat u cekën më lart, hetimi duhet menjëherë të pushohet. Përjashtimisht sipas paragrafit 2 të

këtij neni, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim të hetimit prej gjashtë muajsh, në rastet kur hetimi është i ndërlikuar, kur përfshihen katër apo më shumë të pandehur, ekzistojnë disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare apo ekzistojnë rrethana të tjera të jashtëzakonshme. Mirëpo një vazhdim të tillë, gjyqtari i procedurës paraprake nuk mund ta urdhërojë në rast se i pandehuri është në paraburgim, përveç rasteve kur prokurori i shtetit tregon se hetimi po zbatohet në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij.

Dallimi me Kodin e mëparshëm është se me kodin e ri më nuk ka nevojë që çdo gjashtë muaj të bëhet kërkesa për vazhdimin e hetimeve, me përjashtim të rastit të fundit, që nënkupton se hetimet po kryhen në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij. Gjithashtu, me Kodin e ri është edhe një risi e cila është paraparë me nenin 153 dhe ka të bëjë me njëfarë kontrolli të hetimeve, të punës efikase të prokurorit të shtetit, sipas të cilit, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngrihet aktakuza (neni 156 i KPPRK-së, viti 2012, fq.70).

Sa i përket Republikës së Shqipërisë, përkatësisht sipas (nenit 323, paragraf 1 të KPPSH-së, 1995) hetimet paraprake duhet të përfundohen brenda tre muajve nga dita në të cilën emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Sipas nenit 324, paragraf 1, prokurori mund të zgjasë hetimet për një kohë deri në tre muaj, më tej paragrafi 2, zgjatjet e mëtejshme secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve më komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vite. Tej afatit 2-vjeçar në raste të jashtëzakonshme, hetimi mund të zgjatet vetëm me miratimin e prokurorit të

përgjithshëm deri në një vit për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.

Ndërsa në Republikën e Maqedonisë, prokurori publik, është i obliguar që për padinë penale të vendosë në afat prej 3 muajsh dhe ta përfundojë procedurën hetimore në afatin prej 6 muajsh nga sjellja e urdhrit për realizimin e hetimeve (pezullimi, pushimi apo të ngrejë aktakuzë sipas KP-së të Maqedonisë). Në raste të ndërlikuara, ky afat mund të shtyhet nga prokurori i lartë publik edhe për 6 muaj, ndërsa prokurori publik i shtetit edhe për 3 muaj të tjerë. Pas kalimit të këtyre afateve, prokurori është i obliguar të sjellë një vendim.

Thënë ndryshe, hetimet, si në aspektin global ashtu edhe në atë nacional, janë tërësi e aktiviteteve hetimore nga organet e autorizuar, të cilat organe kanë për synim zbulimin e së vërtetës rreth faktit kriminal se a ekziston apo jo kryerja e veprës, rrethanat e kryerjes së faktit kohën dhe vendin e kryerjes së veprimit kriminal, kush është kryerës i veprës penale, përcaktimin e formës së fajit të kryerësit nëse vërtetohet etj. Koncepti hetim dhe procedim penal nuk ka ndryshim me faktin se qëllimi i hetimit është të zbulohet ekzistenca e rrethanave të faktit, nëse janë kriminale ose jo, si dhe të bëjë të mundur vërtetimin nëpërmjet sigurimit të fakteve, për përcaktimin e autorit të veprës penale dhe të fajit të tij. Ndërsa, qëllimi i procedimit penal apo i ndjekjes penale është më i gjerë, pasi procedimi penal synon aplikimin e sanksionit penal ndaj autorit të veprës penale. Ndryshimi midis procedimit penal- ndjekjes penale dhe hetimit qëndron edhe për sa i përket natyrës së veprimeve të tyre. Kështu, është e vërtetë se në procedurën penale nuk përcaktohet se cilat janë veprime hetimore. Mirëpo, duke iu referuar qëllimit të hetimit të parashtruar më sipër arrijmë të japim definicionin se me veprime hetimore do të kuptojmë ato veprime procedurale të parashikuara në ligjin procedural penal me anë të të cilave synohet të plotësohet ky qëllim.

Po kështu, gjatë një procedimi penal, përveç që kryhen veprime hetimore, kryhen edhe një mori veprimesh të tjera në marrëdhënien e subjekteve të tjera të procedimit penal. Pra, hetimi është koncept më i ngushtë se procedimi penal – ndjekja penale. E thënë ndryshe, hetimi është shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale- procedimit penal.

Në këtë kontekst të këndvështrimit mund të themi se kur plotësohet qëllimi i hetimit do të plotësohet edhe qëllimi i procedimit penal- ndjekjes penale, dhe e kundërta është nëse nuk plotësohet qëllimi i hetimit atëherë nuk plotësohet as qëllimi i procedimit penal - ndjekjes penale që ndërlidhet me dënimin e fajtorit.

Nuk mund të themi se veprimet hetimore të organeve tëurvejimit dhe të gjurmimit në ndryshim me kodet e mëparshme nuk kanë vlerë procedurale penale, pasi që ato nuk janë të parashikuara si të tilla në KPP. Këto lloj veprimesh gjurmuese kryhen nga organet e ndryshme të shtetit, siç janë shërbimet informative të shtetit, SHIU, SHKB etj., të cilat kryesisht janë të natyrës sekrete dhe shërbim për parandalimin e veprave penale. Këto **si tilla nuk përbëjnë asnjë vlerë provuese dhe as ndonjë provë pranuese, por shërbejnë si** bazë e mjaftueshme për fillimin e procedimit penal⁵².

KPPSH-ja aktuale, për ndryshim nga kodet e mëparshme, nuk flet për fillim të hetimeve paraprake, por shprehet vetëm për përfundim të hetimeve, duke përcaktuar afatet e përfundimit të hetimeve pasi në regjistër të jetë evidentuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale.

Nga kjo del se fillimi i hetimeve paraprake është dita e shënimit të emrit të personit në regjistrin përkatës. Mirëpo, duke u nisur nga koncepti që trajtuam më sipër, fillimi i hetimit lidhur me veprën penale të paramenduar si të tillë, është momenti kur ke kryer veprimet e para procedurale-penale për sqarimin e rrethanave të faktit që është e njëjta gjë me veprimin hetimor. Pra, edhe veprimi procedural me anë të cilit kërkohet të sqarohen

⁵²S. Begeja. *Kriminalistika* Tiranë viti, 2004.

elementet e faktit, elementet e anës objektive, si dhe përcaktimi i fajtorit, është, njëkohësisht, veprimi hetimor.

Ndërkaq, rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal që kanë të bëjnë jo me personin, janë të tilla që, veprimet, pasojat nuk janë të karakterit të rrezikshëm për shoqëri.

Në këtë mënyrë nuk legjitimojnë prokurorinë për ushtrimin e ndjekjes penale. Janë këto rrethana që kërkojnë një verifikim paraprak të materialit kallëzues apo ankues nga ana e Prokurorisë për të përcaktuar nëse këto veprime të pretenduara janë të dënueshme penalisht. Për të sqaruar rrethanat e aktit të pretenduar, e me qëllim të ndriqimit të veprës penale duhet vërtetohet se kushë e ka kryer dhe me çfarë forme të fajit është kryer nëse në sajë të grumbullimit të provave në procedurë ndjekje hetimor gjendëm para një fakt kriminal të ndodhur dhe të parapar me ligjë.

Për të ilustruar sa më sipër, shërben kryerja e veprave penale pa autor. Në këtë rast kryhen të gjitha veprimet hetimore të mundshme për të zbuluar fajtorin, por pa rezultat dhe si rrjedhim vendoset pezullimi i hetimit, apo, thënë ndryshe, të procedimi penal. Nëse më pas zbulohet autori, i cili është i vdekur, atëherë lind pyetja se çfarë ka ushtruar deri atëherë organi procedues me veprimet procedurale të kryera prej tij për sqarimin e rrethanave të faktit? A nuk ka filluar një procedim penal, a nuk ka ushtruar ndjekje penale?!

Një gjë e tillë del edhe nga ekzistenca e tri funksioneve themelore të procedurës penale e që janë:

-Ndjekja penale;

-Dhënia e drejtësisë; dhe

-Mbrojtja e të pandehurit.

Nën kompetencën e ndjekjes penale nënkuptojmë funksionin e prokurorit për një gjë të tillë, apo, thënë ndryshe, autorizimet e prokurorit për ndjekje penale, ose, ushtrimi i

ndjekjes penale nga ana e tij, pas ardhjes së tij në dijeni për veprën penale të kryer, nëse ekziston perceptimi subjektiv i arsyeshëm që ka vepër penale.

Në këtë mënyrë arrijmë në përfundim se vet ushtrimi i ndjekjes penale-procedimi penal, shprehet, së pari, me kryerjen e veprimeve hetimore për sqarimin e rrethanave të faktit, nëse fakti i pretenduar është kriminal apo jo, nëpërmjet evidentimit me anë të fakteve të mbledhura nga kryerja e veprimtarisë procedurale se këtë vepër penale e ka kryer një subjekt konkret. Nëse vërtetohet se ky subjekt mund të merret ose jo në përgjegjësi penale, me komunikimin e akuzës në përfundim të hetimeve dhe me dërgimin e çështjeve në gjykim.

2.9.4. Bazat e nevojshme për fillimin e procedimit penal

Në KPPK-së dhe KPPSH-së egzistojnë normat procedurale që rregullojnë institutin e fillimit të procedimit penal, respektivisht të hetimeve formale paraprake sipas nenit 101, 102, 103, 104 të KPPK-së, ndërsa sipas KPPSH-së këto norma i gjejmë në kreun e dytë dhe të tretë të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, të vitit 1995, që i referohen neneve 24,25,26, ...etj. Normat që rregullojnë këtë institut kanë përcaktuar se çdo njoftim që i vjen prokurorit për vepër penale, apo vetë prokurori është vënë në dijeni me iniciativën e tij shënohet në regjistrin PP të veprave penale që aplikohen në prokuroritë e Kosovës, me aplikim uniform të regjistrave, ndërsa prokuroritë kompetente të Shqipërisë mbajnë regjistrat e njoftimit të veprave penale.

Shikuar nga ana tjetër, KPP-ja, në zbatim në Shqipëri për ndryshim nga kodet e mëparshme nuk shpreh se me çfarë akti, me çfarë baze do të shprehë prokurori vullnetin shtetëror për fillimin e procedimit penal. Siç theksuam edhe më sipër kjo paraqet një problem për punën e organit të prokurorisë. Megjithatë, problemi (çështja) rrethe fillimit

është zgjedhur me anë të udhëzimit nr. 241, të datës 21.11.2005, **“Për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”**.

Pyetja që mund të shtrohet në këtë drejtim është se a mundet që, një akt procedural, i cili duhet përcaktuar me ligj të mund të plotësohet me një urdhër, qoftë ky edhe urdhër i prokurorit të përgjithshëm? Mendoj se një vakuum i tillë duhet plotësuar me ligj.

Sipas udhëzimit të përmendur si më lart, prokurori, pasi verifikon dhe vlerëson aktet që i ka në dispozicion, për ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale, me anë të një, urdhërojnë akti në formën e vendimit në Kosovë, ndërsa sipas urdhrit në Shqipëri, urdhëron zyrat përkatëse të sekretarisë që t’i evidentojnë, t’i shënojnë në regjistrat përkatës, në PP apo në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Njoftimin për vepër penale, sipas vendimit mbi fillimin e hetimeve apo urdhrit e përcaktojnë nenet 104 i KPRK-së, 2012 dhe neneve 287/1 dhe 315/3 të KPPSH-së, 1995.

Mirëpo, në plan të parë, dispozita e nenit 287 të KPPSH-së të jep përshtypjen se, apriori, i çdo lloj njoftimi, pavarësisht nga burimi që ka marrë në dijeni prokurori, shënohet në regjistër, gjë që do të përbënte edhe fillimin e procedimit penal. Ndërkaq, po të pranonim këtë arsyetim, duke e interpretuar dispozitën në mënyrë laterale edhe në mënyrë të shkëputur nga dispozitat e tjera të kreut pasardhës, nuk do të bëhet gjë tjetër, veçse do ta vendosnim veprimtarinë e Prokurorisë në një antikap dhe në një tension të vazhdueshëm. Kjo e fundit, për faktin sa thamë më lart, se fillimi i procedimit penal është ligjor, që do të thotë se duhet të kemi të dhëna të mjaftueshme për të filluar procedimin penal. Këto arsye të dërgojnë në një interpretim joliteral, por në një interpretim logjik dhe sistematik të tyre, që kanë të bëjnë me dispozitat të cilat përcaktojnë rrethanat që nuk do lejojnë fillimin e procedimit penal, nenet 288, 290 të KPPSH-së. Kjo rrethana krijojnë edhe një konfuzitet të plotë për sa i përket fillimit ose jo të procedimit penal, kjo për faktin se ekzistojnë një mori rrethanash që duan një investigim procedural të prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Kështu,

sipas vendimit nr.65, të datës 30.01.2002, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë thekson se **“neni 290 Kodi i Procedurës Penale parashikon rrethanat kur procedimi nuk mund të fillojë, apo në qoftëse ka filluar duhet të pushojë”**. Këto rrethana, sipas germave të kësaj dispozite, lidhen me veprën penale ose me autorin që e ka kryer atë. Në rastin në fjalë, prokuroria, duke iu referuar gërmës “c” të kësaj dispozite e ka lidhur mosfillimin e hetimeve me mos ekzistencën e elementeve të veprës penale. Që prokuroria të arrijë në këtë përfundim pa filluar çështjen penale, për pasojë pa kryer hetime që lidhen me sa i referohet, duhet të konstatojë se fakti i kallëzuar nuk parashikohet si vepër penale nga KP-së, ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale dhe më tej. Të verifikojnë nëse ajo është shuar ose amnistuar, me kuptim të neneve 66 e 71 të KP-së. Prokuroria nuk ka qenë para një rasti që i referohet. Asaj i është kallëzuar për një vepër, e cila parashikohet si vepër penale nga KP-ja, që është falsifikim i dokumenteve shëndetësore nga personat që kanë për detyrë t’i lëshojnë ato, parashikuar sipas nenit 188 të KP-së. Nëse fakti ekziston ose jo dhe nëse vepra penale është kryer nga personat e treguar, ky përfundim mund të nxirret vetëm pasi të jenë kryer hetimet lidhur me rrethanat. Pra, organi i procedurës, që të bëjë këto veprime hetimore, detyrimisht duhet të fillojë çështjen penale. Tjetër është nëse fakti nuk është i normuar dhe i përcaktuar si vepër penale, së cilës i është referuar prokuroria me vendimin e mosfillimit të saj dhe, tjetër është kur fakti nuk ekziston. Për çështjen e parë mund të procedohet edhe me mosfillim të çështjes, pasi që prokuroria të bëjë verifikimin përkatës, ndërsa në rastin e dytë, detyrimi i prokurorisë është që t’i zhvillojë hetimet dhe, në sajë të hetimeve të zhvilluara, të sjellë përfundimin për të vendosur nëse çështja ka vend për dërgim në gjykatë për t’u gjykuar apo duhet pushuar për një nga shkaqet që i parashikon neni 290 i KPP-së. Megjithatë organi i prokurorisë ka gabuar, kur të dyja gjykatat nuk e kanë konstatuar një gjë të tillë gjatë procedimit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj shkon më tej, kur thotë: se kërkuesve nuk provoj që të ekzistojë fakti i

falsifikimit të dokumenteve shëndetësore dhe se certifikata e asistencës, në lindje, nuk rezulton të jetë e falsifikuar. Ngatërrimi i konceptit të mosekzistencës së faktit me atë se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, siç shihet, gjen vend edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Që të vihet në përfundimin që ka arritur kjo gjykatë me arsyetimin e saj, duhet detyrimisht, të kryhen hetime, gjë që, në fakt nuk ka ndodhur, më që çështja penale nuk është filluar nga organi i akuzës” (vendimi nr. 65, datë 30.1.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

Duke qenë para një situate të tillë konfliktuale, theksoj se hapësira kohore prej marrjes në dijeni për kryerjen e veprës penale e deri në momentin që të urdhërohet regjistrimi i veprës penale, quhet **“Faza paraprake e hetimeve” ose, procedura jopenale**. Shkaqet, arsyet, bazat ligjore që të çojnë në këtë përcaktim, normalisht që do të jenë pjesë e trajnimit të plotë në çështjen e këtij punimi, kështu që, për të qenë sa më esenciale për trajtimin e bazave të nevojshme për fillimin e procedimit penal, le të trajtojmë konceptin bazë të mjaftueshëm ligjor në zbatim. Për fillimin e procedimit penal duhet të ekzistojnë bazat e mjaftueshme, për shkak se, për të filluar një procedim penal të mirëfilltë, duhet të ekzistojnë bazat e mjaftueshme. Megjithatë, duke qenë se jemi në stadin e parë të fillimit të procedimit penal, bazë, e nevojshme është ekzistimi i, së paku dy kushteve:

-Ekzistenca e shkaqeve ligjore;dhe

-Të dhënat e mjaftueshme.

Në fazën e fillimit të procedimit penal, përkatësisht përpara fillimit, njoftimi për kryerjen e një veprë penale në përmbajtjen e tij shpesh, për shkak të bazës së pamjaftueshme të dyshimit për fillimin e tij, paraqitet nevoja për plotësime, sqarime, verifikime, si dhe për kryerjen e ndonjë veprimi të mundshëm hetimor, në mënyrë që prokurori të jetë sa më objektiv dhe i sigurt në *vendimmarrjen e tij*.

Nga ana tjetër, bazat e mjaftueshme për fillimin e procedimit penal janë të lidhura pashmangshmërisht me vetë ekzistencën ose jo të veprës penale. Pra, me rrethanat që pasqyrohen në kallëzim apo në ankim, në sensin që këto rrethana, detyrimisht, duhet të verifikohen, paraprakisht, duke u vlerësuar- hetuar nëse përkojnë apo jo me realitetin objektiv apo kemi një shtrembërim të atyre rrethanave nga subjektet kallëzuese (neni 390, par. 1, 2, 3, 4, f.143, i Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012), apo faktit të pretenduar nuk i përgjigjet asnjëra nga veprat penale të parashikuara nga KP-ja. Kjo del e qartë nga vetë përmbajtja e nenit 290, pika 1, germa “C”, e KPPSH. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ose kur del qartë që fakti nuk ekziston.

Për të pasur baza të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, këto baza u referohen vetëm elementeve të anës objektive të objektit mbrojtës të veprës së treguar dhe vetëm si përjashtim, këto baza të mjaftueshme lidhen me subjektin konkret të veprës penale.

Pra, duhet të kemi të dhëna të mjaftueshme se marrëdhëniet shoqërore janë dëmtuar apo cenuar si pasojë e një veprimi të ndërmarrë, apo mosveprimit, që është dashur të ndërmerret. Për të arritur në sqarimin e bazave të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal është e nevojshme të sqarojmë se, vetë procedimi penal synon arritjen e së vërtetës, duke zbatuar procedurën penale, e cila, jo gjithmonë mund të arrihet. Mund të ndodhë që një person ka bërë simulim të një vendngjarjeje, duke krijuar rrethana se është vrasë me ndonjërin nga ortakët e biznesit, ndërkohë që vetë kishte ndryshuar identitetin dhe pamjen fizike. Në këto kushte organi procedues kishte filluar procedimin penal mbi bazë të të dhënave të mbledhura në vendngjarje, si dhe duke u nisur nga fakti se, gjatë hetimeve kishte rezultuar se, në mes të dy ortakëve kishte mosmarrëveshje lidhur me biznesin, fakt i cili e bëri më të besueshme vrasjen e personit edhe pse trupi i viktimës nuk ishte gjetur. Mbi këtë bazë përfundon edhe procedimi penal, duke u zbatuar edhe dënimi prej 20 vitesh.

Me t'u liruar nga burgju, personi i dënuar arrin ta zbulojë personin që kishte simuluar vrasjen dhe këtë të fundit (simuluesin e vrasjes) e vret.

Siç kemi thënë edhe më sipër, procedimi penal-fillimi dhe zbatimi i hetimeve, është perceptim intelektual i prokurorit gjatë hetimeve paraprake dhe i gjyqtarit për gjatë shqyrtimit gjyqësor se kemi vepër penale ose jo dhe, se atë e ka kryer një person konkret apo jo vepër penale. Për këtë rast të përmendur dhe një mori rastesh të tjera, kur është vendosur rishikimi i vendimit të formës së prerë, pushimi i çështjes nga gjykatat më të larta, është shprehje e asaj që e vërteta në procedimin penal, jo gjithmonë, është absolute.

Procedimi penal gjithmonë synon drejt së vërtetës absolute e që për efekt të trajtimit të bazave të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, duhet të bëjmë një perceptim të së vërtetës në fazat e procedimit penal. Në përfundim të procedimit penal, edhe pse e vërteta e arritur është kryesisht absolute, ndërsa në fazën e hetimeve paraprake themi që jemi në stadin e verifikimeve të grumbullimit të fakteve se a kemi apo jo vepër penale, kushë është autori i saj, a ka përgjesi penale nëse ai është zbuluar, dhe rrethanave të tjera ligjore që obligojnë në këtë fazë procedimi paraprak të ndërmirren nga organet proceduse ligjore. Por në fazën kur fillohet procedimin penal për çfarë të vërtetë mund të diskutojmë?

Në këtë fazë mendohet se, kryesisht, nuk mund të flitet për të vërtetën, pasi për të arritur këtë të vërtetë në ndihmë të arsyes, intelektit, përvojës, duhet të sigurohen të dhëna në sajë të hetimeve paraprake e, rrjedhimisht, patjetër, duhet të vendosësh fillimin e procedimit penal. Nëse vepra është ose jo vepër penale, cili është autori i saj, koha kur është kryer, mjetet, rrethanat, mënyra e kryerjes së veprës etj. Të gjitha këto identifikime duhet të zgjidhen përgjatë zhvillimit të hetimeve paraprake e, më pas, nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor.

Në këtë fazë, përpara se të vendosim fillimin e procedimit penal, jemi vetëm në kuadrin e një perceptimi intelektual, në kuadrin e një dyshimi se mund të jemi përpara një vepre

penale. Nëse nga perceptimi i të dhënave të marra në kallëzim, si dhe duke u nisur nga një verifikim i këtyre të dhënave jashtë procedurës penale, arrihet në perceptimin intelektual dhe profesional se mund të jemi para një vepre penale, atëherë themi se detyrimisht, duhet të fillojmë procedimin penal.

Arsye bazë për të vendosur fillimin ose mosfillimin e procedimit penal është perceptimi profesional i prokurorit, i formuar mbi bazën e studimit të materialit të dhënë që e ka para vetës, apo duke iu referuar materialit që dëshmon përmes provave të bashkangjituranëse se mund të jemi para një vepre penale apo jo.

Nëse vlerësueshmëria e perceptimit profesional e prokurorit, për kallëzimin penal të trguar, pason me dyshim të arsyeshëm, apo të bazuar se është para një vepre penale, atëherë, për të sqaruar këtë dyshim, detyrimisht duhet të vendosë për fillimin e procedimit penal, duke zbatuar fillimisht hetimet paraprake.

Nëse krijohet perceptimi profesional i prokurorit se për rastin konkret nuk ka vepër penale, atëherë lind detyrimi për mosfillimin e ushtrimit të ndjekjes penale nga ana e tij. Ky detyrim i nënshtrohet dispozitës përkatëse të KP-së, i cili nuk lejon fillimin e procedimit penal, për arsye që në mënyrë taksative i përshkruan dispozita përkatëse të Kodeve Pr.Penale në Kosovës dhe Kodi i Pr. Penale të Shqipërisë?

Pra, mosfillimi i ushtrimit të ndjekjes penale, pason me marrje të vendimit mbi hedhjen e kallëzimit penal, në sajë të rrethanave të përcaktuara me neni (82 par.1 të KPRK-së, 2012:30). Dhe kjo, pasi që prokurori të këtë bërë analizimin dhe vlerësimin e kallëzimit penal që ka në shqyrtim. Raportet në drejtim të fillimit ose të mosfillimit janë të tilla që, për rastin e fillimit të ushtrimit të hetimeve mjafton vetëm një dyshim i arsyeshëm se kemi vepër penale, që dyshimi të jetë ligjor dhe i detyrueshëm për t'u ushtruar. Ndërsa, në rastin e mosfillimit të procedimit, përjashtohet ekzistenca e çdo lloj dyshimi se mund të kemi vepër penale.

KAPITULLI III:PROKURORI I SHTETIT SI SUBJEKT QËNDROR I FILLIMIT TË PROCEDIMIT PENAL GJATË FAZËS SË HETIMEVE

3.1 Shqyrtime të përgjithshme

Meqenëse objekt trajtimi i punimit të disertacionit, është fillimi apo mosfillimi i procedimit penal në këtë kapitull do i referohemi autorizimeve të prokurorit si subjekt qendror gjatë fazës së procedimit të hetimeve apo mosfillimit të tyre. Mu për këtë nuk do të lëshohemi në statet e tjera ngase kapitullit të emërtuar për shtjellim i humbë kuptimi. Faza e hetimeve kalon në tri nënfaza: a) në nën fazën e procedurës parapenale, që konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të kërkuara për mbledhjen e informacioneve (neni 69,70 paragraf 1,2,3, pika 3.1–3.13, sipas KPPRK-së, 2012:26-27), rreth zbardhjes dhe ndriçimit të çështjes penale të caktuar; b) në nën fazën e zhvillimit të hetimeve (nenet 101–102 të KPPRK-së,f.45), që fillon me nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimeve; dhe c) në nën fazën e grumbullimit të provave të kërkuara, si të atyre personale, poashtu edhe të atyre materiale, të cilat, pas vlerësimit nga ana e prokurorit të shtetit, japin shkallën e arsyeshmërisë për vepër penale dhe, në fund, kurorëzohen me ngritjen e aktakuzës (kapitulli XV i KPPRK-së, viti 2012, neni 241,fq.109), apo me pushimin e hetimeve (neni 158, par.1, pika 1.6 dhe paragraf 2, i KPPRK-së, 2012 fq.71).

Sipas KPP-së, prokurori i shtetit përkujdeset dhe udhëheq hetimin e çështjes penale prej momentit kur informohet nga ana e policisë për grumbullimin e provave të kërkuara deri në vendosjen e fillimit të hetimit. Sipas nenit 68 të KPP-së, procedura penale kalon në katër faza: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën sipas mjetit juridik. Procedurës penale mund t'i paraprijnë veprimet fillestare dhe mbledhja e informatave nga neni 84. Prokurori si subjekt qendror dhe përcakues rreth fillimit apo mosfillimit të procedimit penal në këtë stade procedimi

dhe në statet tjera të punës se tije, përmes parimeve të përgjithshme dhe të veqanta të cilat do i përmendim ne vijim.

3.2. Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë

Po e fillojmë me një rregull se të drejtat dhe liritë e njeriut janë *“aq më mirë të mbrojtura sa më shumë që profesionistët ligjorë dhe juridikë janë të mbrojtur nga ndërhyrjet dhe presioni”*. Sanksionimi i parimit të pavarësisë është garanci për ushtrimin e rregullt të autorizimeve të prokurorisë, duke shmangur ndërhyrjet eventuale nga pushtetet e tjera dhe duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë për detyrat e ngarkuara. Prokurorët e shtetit si organe shtetërore kanë pavarësi të plotë në kryerjen e funksionit të ndjekjes, si dhe janë të pandikuar nga organet shtetërore në ushtrimin e detyrave të tyre, pa u bërë objekt ndikimesh, presionesh ose ndërhyrjesh, duke marrë masat e duhura për mbrojtjen e interesit shtetëror dhe të individëve. Çdo ndikim i jashtëm është i ndaluar, sepse cenon pavarësinë e prokurorit dhe ndikon në ushtrimin jo të drejtë dhe objektiv të detyrave të tij. Që të sigurohet kjo pavarësi e plotë, karshi degëve të tjera të pushtetit, është e domosdoshme të garantohet nga Kushtetuta që, në rastin tonë, siç themi është e garantuar, me nenin 109 par.1, i KRK-së, viti 2008, sipas të cilit *“Prokurori i shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj”*. Këtë garanci e sanksionon edhe neni 3, par. 1, i LPSH-së, sipas të cilit *“Prokurori i shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme”* e, poashtu pavarësia është proklamuar edhe në nenin 47 të KPP-së, sipas të cilit titullohet pavarësia e prokurorit të shtetit, *“Organet publike nuk mund të ndikojnë në mënyrë formale apo joformale e as të drejtojnë veprimet e prokurorit të shtetit në trajtimin e çështjeve individuale apo në hetime”*.

Nocioni i paanshmërisë nënkupton jo vetëm pavarësinë ligjore, në raport me dy institucionet tjera, Legjislativin dhe Ekzekutivin, të cilat mbështeten në kushtet objektive apo garancitë Kushtetuese-ligjore. Prokurorët nuk duhet të shfaqin paragjykime rreth çështjes së parashtruar para tyre dhe ata nuk duhet të veprojnë në mënyrë që të promovohen interesat e njëres palë. Kjo është e garantuar me nenin 109, par. 2, të KRK-së, 2008, sipas të cilit *“Prokurori i shtetit është institucion i paanshëm dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit”* e, poashtu është e garantuar sipas paragrafit të lartpërmendur dhe nenit 3, paragraf 2, të LPSH-së, sipas të cilit *“Prokurori i shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime, për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore apo pozitës shoqërore”*. Paanshmërinë e prokurorëve e kërkon edhe deklarata e Budapestit në nenin 11, pika “f”, ku përcaktohet që prokurorët duhet të jenë të paanshëm dhe koherentë, por edhe të shihen nga të tjerët si të tillë. Pra paanshmëria e prokurorëve nuk mjafton të supozohet nga brenda, por duhet të testohet edhe nga jashtë, sepse dukja në publik përbën një tregues aktiv të matjes së paanshmërisë, gjë që e rrit besimin e qytetarëve tek institucionet e drejtësisë⁵³.

Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët janë tri grupe profesionale, të cilat luajnë një rol kyç në administrimin e drejtësisë dhe në parandalimin e mosndëshkimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Si rrjedhojë, ato konsiderohen të jenë kryesoret për ruajtjen e një shoqërie demokratike dhe për mirëmbajtjen e një sundimi të drejtë të ligjit. Për këtë arsye është e domosdoshme që shtetet të pranojnë si të vërteta detyrimet e tyre ligjore ndërkombëtare që dalin nga burime të ndryshme të së drejtës ndërkombëtares. Sipas këtyre detyrimeve ligjore ata duhet t'i lejojnë gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, të

⁵³Hasni, Čukalovič, op. cit., f. 538.

kryejnë përgjegjësinë e tyre profesionale në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, pa asnjë ndërhyrje të panevojshme nga ekzekutivi, legjislativi apo grupe ose individë privatë.

Këto parime nuk janë krijuar për përfitimin personal të vetë prokurorëve, por për të mbrojtur njerëzit kundër abuzimeve me pushtetin. Një sistem ligjor, i bazuar në respektin për sundimin e ligjit, ka nevojë për prokurorë të vendosur, të paanshëm dhe të pavarur, të cilët janë të gatshëm të hetojnë me vendosmëri dhe të ndjekin penalisht krimet që dyshohen se janë kryer, madje edhe nëse ato janë kryer nga persona zyrtarë. Nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk e kryejnë rolin e vet përkatës deri në fund, (të pavarur dhe të paanshëm), në mënyrë që të mbisundojë drejtësia në shoqëri, atëherë do të kemi rrezik serioz, se një kulturë mosndëshkimi do të zërë fill dhe në këtë mënyrë do të ndeshemi me probleme gjatë përpjekjeve për të arritur drejtësinë ligjore. Çdo ndikim (ndërhyrje) e jashtme apo e brendshme, që reflekton me vendimmarrje jo meritore, për cilëndo nga palët procedurale, në shenjë pakënaqësie, mund të të shpije (dërgoj), deri te vetëgjyqësia që rezulton me një keqësim të mëtejshëm të administrimit të drejtësisë, dhe ndoshta edhe trazira të reja të dhunshme.

3.3. Parimi i devolucionit dhe substitucionit

Parimi i devolucionit nënkupton të drejtën e prokurorit më të lartë që të ndërmarrë dhe, drejtpërsëdrejti t'i kryejë punët nga kompetenca e prokurorit të rangut më të ulët neni 11, ligji nr. 03/L-225, 2010. Kryeprokurori i shtetit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Prokurori i rangut më të ulët është i detyruar t'i respektojë të gjitha detyrimet që i vijnë nga prokurori i rangut më të lartë. Për ndërmarrjen e veprimeve nga prokurori i rangut më të lartë, ai nuk është i obliguar t'i japë sqarime prokurorit të rangut më të ulët, mirëpo është i obliguar që ta zbatojë parimin e legalitetit gjatë ndjekjes.

Sipas parimit të substitucionit, prokurori i rangut më të lartë mund t'ia besojë prokurorit punët e prokurorit të rangut më të ulët atij të rangut të njëjtë, ose lëndën ta dërgojë në kompetencë, në prokurorinë tjetër të të njëjtit rang sipas kompetencës territoriale. Kjo bëhet për arsye që të shmanget ndikimi i jashtëm në punën e prokurorisë, për shkak të natyrës së çështjes penale, si dhe ndikimeve të jashtme.

3.4. Parimi i hierarkisë dhe i vendosjes në mënyrë monokrate

Bazë ligjore e këtij parimi janë (nenet 11–13 të LPSH-së, 2010). Struktura e prokurorisë është e organizuar në atë mënyrë që, në krye të saj është kryeprokurori i shtetit, prej rangut më të ulët e deri tek ai më i larti, me ç'rast kemi varshmërinë e prokurorive të rangjeve më të ulëta nga ato më të larta. Ky parim ndahet në hierarkinë e jashtme dhe të brendshme.

Parimi i hierarkisë së jashtme nënkupton se prokurorët e rangut më të lartë mund të japin për prokurorët e rangjeve më të ulëta për ndjekjen e rasteve penale, ligji mbi Prokurorinë e Shtetit nr.03/L-225, i datës 30 shtator 2010. Prokurorët janë të obliguar t'i zbatojnë urdhrat nga eprorët e tyre. Prokurorët e rangjeve më të larta, mund t'ua japin udhëzimet, prokurorëve të rangjeve më të ulëta, në çdo fazë të procedurës, deri në përfundim të çështjes penale; Prokurori i rangut më të ulët ka detyrim që t'u përmbahet këtyre udhëzimeve dhe ato t'i zbatojë në punë. Udhëzimet e detyrueshme vijnë zakonisht nga kryeprokurori i shtetit (A.nr. 2/13, datë 4.1.2013, e që ka të bëjë me arrestimin, ndalimin dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë-paraburgimit). Mirëpo, nuk përjashtohet mundësia që këto udhëzime të vijnë edhe nga prokurorët e rangjeve më të larta në raport me prokurorët e rangut më të ulët. Sipas këtij parimi rregullohet raporti ndërmjet prokurorive të rangjeve të ndryshme.

Ndërsa parimi i hierarkisë së brendshme nënkupton rregullimin e brendshëm të një prokurorie. Në të vërtetë, në krye të një prokurorie është kryeprokurori, i cili koordinon punën brenda saj (udhëheq me punën në prokurori, bën ndarjen e punëve të prokurorët, varësisht nga specializimi i tyre, si dhe jep udhëzime për prokurorët përkatës). Këto udhëzime kanë karakter intern dhe e obligojnë atë prokuror të cilit ato i jepen. Ato nuk udhëzojnë edhe gjykatën, sepse për gjykatën është merituar veprimi i prokurorit, i ndërmarrë në procedurë, pa marrë parasysh se a është në pajtim me udhëzimin e dhënë apo jo. Me parimin e vendosjes në mënyrë monokrate nënkuptohet që prokurori kompetent t'i ushtrojë vetë të gjitha punët rreth ndjekjes penale, të cilat janë në kompetencë të asaj prokurorie. Prokurori i shtetit mundet vetë t'i kryejë funksionet e një prokurori, ose, t'ia besojë një prokurorie tjetër të asaj prokurorie. Prokurori është përgjegjës për ligshmërinë e veprimeve të cilat i ushtron.

3.5. Parimet procedurale të punës së prokurorit të shtetit

Parimet procedurale-penale, marrë në përgjithësi, përfaqësojnë rregullat mbi të cilat mbështetet procedura penale⁵⁴. Ato janë rregulla themelore që përcaktojnë karakterin dhe përmbajtjen e mënyrës së procedimit penal. Prokurori i shtetit, siç u cek edhe më lart, në procedurën penale, njihet si subjekt apo organ përgjegjës për hetimin e veprave penale, mbikëqyrjen e punës së policisë gjyqësore, si dhe ndërmarrës i drejtpërdrejtë i veprimeve hetimore dhe detyrimeve të tjera të parapara me kodin procedural (neni 51, paragraf 1 dhe 2, i KPPK-së, 2004:20). Pas marrjes së informacionit nga ana e policisë se ka ndodhur një vepër penale, prokurori kyçet në dhënien e sugjerimeve për grumbullimin e provave. Këtu është me rëndësi njohja e dispozitave procedurale për zbatim dhe interpretim të

⁵⁴ A. Hajdari, *E drejta e procedurës penale e të miturve*, Prishtinë, 2005: 35

drejtë të tyre. Prandaj, subjektet e procedimit penal duhet t'i kenë të qarta në tërësi rregullat që lidhen me funksionet, të drejtat dhe detyrat e tyre⁵⁵.

Prokurori i shtetit, punën e vet e mbështet në zbatimin e Kushtetutës së Kosovës, ligjeve vendore dhe akteve të tjera ndërkombëtare, me të cilat garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Ai, gjatë punës së tij zbaton disa parime procedurale, të cilat njëherë e përcjellin punën e tij e, poashtu janë edhe në favor të të pandehurit, me qëllim të balancimit të dy tendencave të procedurës penale, të cilat shërbejnë për objektivitetin e punës së tij. Sipas nenit 4 të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (ligji nr. 8737, i datës 12.2.2001), kjo është rregulluar kështu:

“Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut”. Parimet të cilat e udhëheqin punën e prokurorit të shtetit, poashtu shërbejnë edhe për efikasitet dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, janë të parapara edhe në ligjin për prokurorinë e shtetit (neni 6). Ndër parimet më kryesore në të cilat mbështetet puna e prokurorit janë: prezumimi i pafajësisë, ndalimi i përdorimit të dhunës, parimi akuzativ, parimi i legalitetit dhe i oportunitetit. Me qëllim që prokurori i shtetit të kryejë detyrat në mënyrë sa më objektive e shohim të udhës që t'i përmendim këto parime, një nga një.

3.5.1. Parimi i prezumimit të pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë është parim ligjor i përcaktuar. Sipas këtij parimi çdo person i akuzuar për vepër penale, konsiderohet i pafajshëm përderisa është paraparë në të mirë të të pandehurit dhe shërben si kundërpeshë për barabarësinë e tij me prokurorinë e

⁵⁵Islami, Hoxha, Panda, op. cit., f. 42.

shtetit⁵⁶. Ky parim përbën një ndër elementet thelbësore të procesit ku nuk është provuar fajësia e tij me aktgjykim të plotfuqishëm. Për rëndësinë që ka ky parim tregon edhe fakti se i njëjti është i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 31, paragraf 5, sipas të cilit *“çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”*, gjithashtu, është paraparë në nenin 3, paragraf 1 të KPP-së, si dhe me akte të tjera ndërkombëtare (neni 11 i DUDNJ-së, neni 6, paragraf 2, i KEDNJ, neni 14, paragraf 2, KNDCP).

Edhe në Republikën e Shqipërisë i njëjti është sanksionuar në të njëjtën mënyrë me (nenin 30 të KRSH-së dhe nenin 4 të KPPSH-së).

Prezumimi i pafajësisë është parim themelor. Prokurori i shtetit duhet të ketë parasysh tretmanin që duhet ta ketë i pandehuri gjatë fazës së zhvillimeve të hetimeve, mirëpo ky parim vlen edhe për punën e gjykatave e deri me marrjen e vendimit përfundimtar. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i tij në praktikë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit në të gjitha fazat e procedimit. Ky e çliron të pandehurin nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejta që të mos i përgjigjet akuzës dhe të mbrohet në çdo mënyrë të përshtatshme. Për organin që procedon, personi nën hetim duhet të konsiderohet i pafajshëm edhe pse është marrë në pyetje si i pandehur. Marrja e një personi në cilësinë e të pandehurit, bëhet me rastin e dyshimit të arsyeshëm për fajësinë e tij, por ai mbetet vetëm dyshim dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet verifikimit dhe shqyrtimit gjyqësor në të gjitha shkallët. Andaj, vetëm kur vendimi i fajësisë të marrë formë të prerë, i pandehuri quhet fajtor⁵⁷.

Prokurori duhet ta ketë parasysh këtë parim derisa ta ngrejë aktakuzën. Me ngritjen e saj, faktikisht personi i caktuar për prokurorinë konsiderohet i fajshëm dhe, sipas tij është

⁵⁶Sahiti, E & Murati, R, *Edrejta e procedurës penale*, 2013:96.

⁵⁷Islami, Hoxha, Panda, op. cit., f. 53

vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se personi konkret ka kryer vepër penale. Mirëpo, pas ngritjes së aktakuzës, për respektimin e këtij parimi kujdeset Gjykata. Komiteti për të drejtat e njeriut, në komentin e tij të përgjithshëm, nr. 13, thotë se parimi i supozimit të pafajësisë nënkupton që: *“barra e provës për të dëshmuar akuzën bie mbi prokurorinë dhe i akuzuari duhet të mbetet i dyshuar. Asnjë faj nuk mund të supozohet derisa të jetë dëshmuar akuza për një dyshim të bazuar. Më tutje supozimi i pafajësisë përfshin të drejtën për t’u trajtuar në pajtim me këtë parim. Për këtë arsye është detyrë e të gjitha autoriteteve t’i “shmangen paragjykimin të rezultatit të gjykit”*⁵⁸.

Ky parim konsiston edhe në atë se, nëse prokurori nuk arrin ta vërtetojë dyshimin e bazuar mirë, atëherë i pushon hetimet, ku, nga kjo buron edhe rregulli *in dubio pro reo*, i cili është sanksionuar me nenin 3, paragraf 2, të KPP-së, 2003: 3, ndërsa, në Republikën e Shqipërisë, në nenin 4, paragraf 2, të KPPSH-së, 1995, sipas të cilit, mëdyshjet lidhur me veprën penale interpretohen në favor të të pandehurit. Nga kjo rrjedh rregulli se, baza për vendimin e ngritjes së aktakuzës është ekzistenca e provave që vërtetojnë atë e jo mungesa e provave, andaj po e cekim se konform kësaj nuk mund të shërbejë si provë fajësie refuzimi i të pandehurit për t’i dhënë shpjegime prokurorit, as edhe fakti se ai nuk propozon të nxirren prova vërtetojnë pafajësinë e tij.

3.5.2. Parimi i ndalimit të përdorimit të dhunës

Gjatë marrjes së deklaratës së të dyshuarit nga ana e policisë, pastaj, gjatë marrjes në pyetje në prokurori nga ana e prokurorit, me hapjen e hetimeve e, poashtu, në gjykatë, veprimet duhet të kryhen gjithnjë pa përdorur dhunë ose kërcënime. Çdo provë e marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale është e papranueshme, dhe si te tilla

⁵⁸General Comment no. 13 (article 14), në UN Compilation of General Comments, fq. 124.

gjykatat kompetent me rastin e dhënjes se verdiktit drejtësisë i veçoin nga shkresat e lëndës duke nxjerrur vendim për shpallje si të pavlefshme. Si të tilla Kodet procedurale përmes dispozitave normues ligjore parashikojnë shprehimisht, p.sh., kurë deklarata është nxjerrë me dhunë gjatë procedimit penal në çfarëdo faze të procedimit, në drejtim të pohimit të një fakti, nënkupton, provë të papranueshme për Gjykatat, nga se vendimet gjyqësore nuk mund të mbështeten në të, (neni 153, par. 1,2, i KPPK-së, 2004:60). Rëndësia e këtij parimi vërtetohet edhe me faktin se, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është paraparë, në nenin 27 normimi ku thekson se *“askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*. Edhe KPP-ja, në nenin 10, paragraf 3, e adreson këtë parim e, poashtu parimi i njëjtë është paraparë me akte ndërkombëtare, (neni 5, DUDNJ, neni 1 i Konventës kundër Torturës, “deklarata e dhunshme ose pranimi i dhunshëm i diçkaje që nuk është kryer, është ajo që është nxjerrë me dhunë, kërcënim, mashtrim, premtim, me përdorimin e mjeteve ndaluese që mund të jepen t’i jepen të pandehurit ose dëshmitarit”).

Kjo nënkupton se dinjiteti i të dyshuarit të paraburgosuri, të gjykuarit, i personit të dënuar, gjithnjë duhet të respektohet. Andaj, përdorimi i dhunës gjatë fazës së hetimeve, përbën shkelje të rëndë të KRK-së, të KPP-së, si dhe nenit 3 të KEDNJ-së, siç u theksua më lart *“askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore apo poshtëruese”*.

GJEDNJ-ja ka vlerësuar se “edhe në rrethanat më të vështira, Konventa ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin çnjerëzor, apo poshtërues”. Kjo Gjykatë ka përcaktuar kushtet për identifikimin e torturës e që janë:

- Të ketë prova të dhembjes dhe të vuajtjes fizike ose mendore;
- Keqtrajtimi të jetë kryer nga persona zyrtarë ose të ngarkuar nga ligji;
- Dhembja ose vuajtja të jetë shkaktuar me dashje ose për një qëllim të caktuar,

- si nxjerrja e të dhënave apo pranimi i fajit; dhe
- Shkalla e dhembjes dhe e vuajtjes të jetë e rëndë.

Udhëzimet e vitit 1990, mbi rolin e prokurorëve në Shqipëri, përmbajnë dispozitën e rëndësishme në vazhdim: *“kur prokurorët kanë prova kundër një dëshmie për të cilën ata e dinë në bazë të shkaqeve të arsyeshme, se është nxjerrë me metoda joligjore, që përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, veçanërisht kur përfshihet tortura e mizoria, trajtimi apo dënimi jonjerëzor e degradues apo abuzime të tjera, ata duhet të refuzojnë të përdorin dëshmi të tilla ndaj çdokujt, përveç atyre të cilët kanë përdorur metoda të tilla apo duhet të informojnë gjykatën dhe duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar se përgjegjësit që kanë përdorur metodat e tilla të sillen para drejtësisë”*. Edhe neni 54 (1) (c) i Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare parashikon që njëra nga detyrat e prokurorëve në lidhje me hetimet është të *“respektojnë në mënyrë të plotë të drejtën e personave që del nga ky statut”*, që nënkupton, ndër të tjera, të drejtën e specifikuar në nenin 55.1. C që ka të bëjë me ndalimin e detyrimit dhe torturës.

3.5.3. Parimi akuzator

Sipas KPP-së, procedura penale fillon me vendimin për fillimin e hetimeve, të cilin e nxjerr prokurori i shtetit kur ekziston dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar se, është kryer një veprë penale, e cila mund të fillojë procedurën penale pas paraqitjes së kallëzimeve penale nga policia ose institucionet tjera me të drejtë paraqitje apo nga propozimi i të dëmtuarit (neni 185, paragraf 5, i KPRK-së, 2012 dhe neni 6, paragraf 3, i KPSH-së, 1995). Nga ky parim rrjedh edhe premisa e njohur latine *“nemo iudex sine actore”* që do të thotë se nuk ka gjykim pa padi. Tani, me kod të ri të gjitha veprat penale ndiqen nga prokurori i shtetit sipas detyrës zyrtare me përfshirje të disa veprave për të cilat nevojitet

propozimi i të dëmtuarit. Ndërsa, me kodin e mëparshëm, prokurori i shtetit bënte ndjekjen për veprat penale për të cilat ndjekja ishte *ex-officio*. Për disa vepra të tjera ndjekja mund të bëhej me padi private (nenet 187, 188, 189, 190 KPPK, 2004). Prokurori i shtetit është i detyruar që të bëjë ndjekjen e kryerësve të veprave penale. Pasi ta pranojë kallëzimin penal, duhet ta bëjë shikimin e tij dhe të përcaktohet se a ka bazë për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e procedurës penale e, po qe se nuk ka vend për ndjekje penale, atëherë e hedh kallëzimin penal, duke i dhënë njoftim për hudhje të dëmtuarit, gjegjësishtë përmes Aktvendimit njëherit të drejtën që ja derivon dispozita përkatëse e nenit 62 të KPPK-ës, vitit 2003, ku sipas nenit 62, paragraf 2 i dëmtuari ka të drejtë të ndërmarrë apo të vazhdojë ndjekjen brenda tetë ditësh nga dita e njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni., si paditës subsidiar përshtatëshmerisht sipas (neni 62, paragraf 2 dhe 4 të KPPK-së, i vitit 2004, f.24), e që sipas kodit aktual të zbatueshëm nga 1 janari 2013, një e drejtë ndjekjeje është hequr. Arsyeja e heqjes së institutit të paditësit privat-subsidiar ka rezultuar se nuk ka treguar rezultate në praktikë, kur prokurori ka hequr dorë nga ndjekja penale.

3.5.4. Parimi i legalitetit dhe oportunitetit

Prokurori i shtetit e ndërmerr ndjekjen penale kur ekziston dyshimi i bazuar se personi i caktuar ka kryer vepër penale. Sipas KPP-së prokurori i shtetit fillon ndjekjen penale me vendim për fillimin e hetimeve (përcaktu sipas nenit 102 të KPPK, të vitit 2012), ashtu që, pas marrjes së vendimit, prokurori është i obliguar të veprojë në përputhje me ligjin dhe hetimin ta përfundojë brenda afatit të paraparë ligjor. Në të kundërtën, hetimi duhet të pushohet (neni 158, paragraf. 3 të KPPK-ës). Prokurori i shtetit ka të drejtë që në bazë të provave, të cilat janë grumbulluar në çështjen penale, pas pranimit të kallëzimit penal dhe pas vlerësimit të tij, të vendosë që pas fillimit të hetimeve, të hedhë kallëzimin penal,

të kërkojë informata shtesë ose mund të ngrijë aktakuzë pa hetim të drejtpërdrejt (rasti penal 2013-DE-215, për të cilin Prokuroria Themelore në Pejë, DKR-ja nuk ka zhvilluar hetimet, sepse nga provat e parashtruara në kallëzim penal, kishte prova të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejtë dhe konform nenit 240, paragraf 1, të KPP-së, ka ngritur aktakuzë të drejtpërdrejt nën PP/II nr. 790/13, datë 12.9.2013, në drejtim të veprës penale “lëndim i lehtë trupor” nga neni 188, paragraf 1, të KPK-së dhe veprës penale të “kanosjes” nga neni 185, paragraf 2 të KPK-së), sepse kjo mundësi i është dhënë me nenin 101, paragraf 2 dhe me nenin 240, paragraf 1, të KPP-së. Detyrimi i prokurorit që del nga parimi i legalitetit nuk vlen vetëm për fillimin e ndjekjes penale, por edhe për zhvillimin e saj gjatë tërë procedurës ashtu që puna e prokurorit duhet të mbështetet në ligjet pozitive⁵⁹.

Sipas nenit 6, paragraf 2 dhe 3, të KPP-së, procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër penale. Ndërsa sa i përket paragrafit 3 të këtij neni prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik ai privat, gjyqtari media nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit. Me këtë dispozitë janë ngritur dilema nëse prokurori në krahasim me Kodin e mëparshëm vepron sipas parimit të legalitetit apo ky parim i ka miratuar vendin parimit të oportunitetit. Duke pasur parasysh konceptin e përgjithshëm të kodit aktual, si dhe duke marrë parasysh mundësinë e aplikimit të procedurave alternative, posaçërisht të marrëveshjes për negocimin e fajësisë, e cila mund të arrihet në çdo fazë të procedurës dhe shtrirjen që ky institut procedural do të duhej ta ketë në të ardhmen, logjike është për prokurorinë e shtetit fillimi i procedurës dhe ndjekja të jetë opsion-mundësi e tij, e jo

⁵⁹Çollaku, Hashim, *Roli dhe funksioni i prokurorit publik*, Instituti Gjyqësor i Kosovës – Prishtinë, janar 2009 fq. 106

detyrim me çdo kusht dhe në çdo rast⁶⁰. Mirëpo, kur prokurori i shtetit ka informacione të mjaftueshme, të cilat arsyetojnë dyshimin e bazuar se është kryer vepër penale, nëse nuk zbatohet ndonjë procedurë alternative, ai duhet ta fillojë procedurën penale, duke u udhëhequr me parimin e legalitetit.

Megjithatë, ky parim vlen edhe më tutje dhe duke u mbështetur në nenin 109 të KRK-së, nenet 4 dhe 7 të LPSH-së, sipas të cilave prokurori i shtetit është përgjegjës për ndjekjen penale të personave të akuzuar. Parimi i legalitetit ka edhe disa përjashtime dhe ato janë:

1. Rastet për të cilat nevojitet propozimi i të dëmtuarit apo leja paraprake e organit kompetent, çka nënkuptohet se prokurori nuk mund të fillojë procedurën penale nëse i dëmtuari nuk ia dorëzon provën se propozimi është dhënë; si dhe
2. Rastet kur prokurori, zbaton parimin e oportunitetit-arsyeshmërisë, përkatësisht në rastet kur nuk detyrohet ta ndër marrë ndjekjen. Ky rast zakonisht vjen në shprehje kur kemi të bëjmë me kryerës të mitur, por nuk përjashtohet mundësia edhe për madhorët.

Për të miturit kjo mundësi është paraparë për shkak se atyre u kushtohet kujdes i posaçëm si në procedurë penale ashtu edhe sa i përket sanksionit penal. Ky përjashtim parashihet në nenin 56, paragraf 1 dhe 2 të KDM-së, nr 03-L93, i vitit 2010, sipas të cilit për veprat penale për të cilat është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet ose gjoba, prokurori i shtetit mund të mosfillojë zbatimin e procedurës përgatitore edhe pse ekzistojnë prova se i mituri ka kryer vepër penale, kur konsideron se nuk është i arsyeshëm zhvillimi i procedurës kundrejt të miturit, duke marrë parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer, jetën e mëparshme të të miturit dhe cilësitë e tij personale. Gjithashtu, ai mund të mos e fillojë procedurën kundër të miturit kur ekzekutimi i dënimit ose i masës edukuese është duke ecur për vepër penale tjetër, nëse duke e marrë parasysh peshën e veprës penale dhe dënimin apo masën edukuese që

⁶⁰Sahiti, Murati, op. cit., fus. 56, f. 92

është duke u ekzekutuar, nuk do të kishte efekt zhvillimi i procedurës dhe shqiptimi i sanksionit për atë vepër. Me këtë parim kuptohet se përkundër faktit se ka prova të mjaftuara se i mituri ka kryer vepër penale, prokurori i shtetit zbaton arsyeshmërinë e tij **(ka të drejtën e oportunitetit që për vepra penale deri në tri vite të dënueshme mundet edhe të mos iniciojë procedurë në gjykatë, por atë ta vendosë vetë përmes aplikimit të masave të diversitetit sipas nenit 18, fq. 7, të KDM-së nr.03/7-193, datë 28.7.2010)**, kështu që duke u udhëhequr me rrethanat që kanë të bëjnë me personalitetin e të miturit dhe ambientin jetësor të tij, ka mundësi të mos ushtrojë ndjekjen.

Ndërsa te rastet për madhorë ky parim bën përjashtim kur prokurori i shtetit nuk detyrohet të fillojë ndjekjen penale ose mund të heqë dorë nga ndjekja dhe atë, kur ligji penal parashikon që gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale dhe prokurori çmon se vetëm gjykimi pa sanksion nuk është i nevojshëm dhe rastin kur kryerësi i veprës penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në një vit sinqerisht pendohet për veprën penale dhe ndalon pasojat e dëmshme ose bën kompensimin e dëmit. Prokurori i shtetit poashtu gjatë fazës se hetimeve apo gjykimit ,vlerëson nevojën për aplikimin e dispozitës se nenit 231 të KPPSH, për aplikimin e zëvendësimit apo bashkimin e masës së sigurisë për sigurimin e prezencës se të pandehurit përshtatëshmerisht si në përmbajtje të saj duke bërë zëvendësimit e saj poashtu parimi i oportunitetit vjen në shprehje edhe në rastet për ekstradim ose transferim të procedurës penale.

Origjina e prokurorisë së shtetit të sotëm (Ministrisë Publike) është e tipit francez dhe njihet që nga koha e mesjetës. Monteskje aprovonte këtë kur thoshte: *“Ne kemi sot një ligj të admirueshëm, është ajo që duhet që princi të paraqesë një oficer në çdo gjykatë për të ndjekur në emër të tij të gjitha krimet”*. Dalëngadalë institucioni u shfaq pothuajse në të gjitha vendet. Sipas KPPRK-së, në zbatim nga 1 janari 2013, roli dhe autorizimet e

prokurorit mbasin po ato që ishin pas miratimit të KPPK-së të vitit 2004, në ushtrimin e ndjekjeve penale, në hetimin, udhëheqjen e policisë hetimore-gjyqësore, duke bërë kontrollin e hetimeve paraprake, duke ngritur aktakuza në gjykatë, mbrojtjen e akuzës në Gjykatë dhe në aplikimine mjeteve juridike, të rregullta dhe ato të jashtëzakonshme tek organi i shkallëshmërisë, duke apeluar në Gjykatë Apeli dhe sipas nevojës edhe në atë të Gjykatës Supreme, varësisht se vendimet e sjella a janë të karakterit meritator apo jo meritator e në situatat kur dhe pasi që kjo e fundit shpall fajësinë e kryerësve të veprave penale, prokurori merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod. Procedimi penal fillon nga një subjekt themelor, që ka për detyrë shtetërore të ushtrojë ndjekjen penale dhe, si përjashtim, prokurori e fillon ndjekjen penale vetëm edhe me ankimin e të dëmtuarit bazu ne (neni 284 i KPPSH-së, i vitit 1995).

Ndërtimi i sistemit në shtetin është i arritur në saje të sistemit mikst, sistem ky i bashkuar në saje të sistemit akuzator dhe atij inkuizitor, i cili vërehet edhe tek instituti i fillimit të procedimit penal. Siç shihet, ndjekja penale sipas detyrës shtetërore është karakteristikë e sistemit inkuizitor të procedurës penale.

E kundërta e fillimit të procedimit penal, e tipit inkuizitor, është tipi akuzator i procedurës penale, i cili bazën e fillimit të procedimit penal e ka të normuar sipas vullnetit, mbi bazën e vullnetit të të dëmtuarit i cili ka qenë dhe është objekt i veprës penale. Prokurori është organ përgjegjës për të ushtruar ndjekjen e veprave penale, të cilat ndiqen sipas detyrës shtetërore apo me vullnetin e të dëmtuarit.

3.6 Policia hetimore –gjyqësore hetimore si subjekt përcaktues për iniciimin e fillimit të procedimit penal

Nocioni formal i policisë gjyqësore

Me policinë gjyqësore do të kuptojmë një tërësi organesh publike/shtetërore, veprimtaria

e të cilave synon të sigurojë kushtet për ushtrimin e ndjekjes penale që duhet të fillojë që nga çasti i konstatimit të një veprë penale.

Mbështetur në dispozitat e KPPRK-së, pikërisht në dispozitate nenit 69–83, si dhe në nenin 30 të KPPSH-së, për autorizimet e policisë gjyqësore, thuhet se policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet duhet të marrë dijeni për vepra penale, të ndërmarrë preventiva rreth parandalimit të ardhjes së pasojës. Nëse është shkaktuar pasoja, të kërkojë autorët e shkaktimit të saj duke kryer hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. Dispozitat ligjore të neneve 69,70,71–83, përcaktojnë detyrimet ligjore fillestare të policisë, specifikisht, gjë që këto autorizime, sipas KPPSH-së, rregullohen me ligjin nr. 8677, të fuqizuar më 2.11.2000, për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, në nenin 3 ku theksohet:

- Se policia gjyqësore është subjekt i procedimit penal;
- Detyrat e saj kryesore është ardhja në dijeni për vepra penale;
- Të parandalojë pasojat e mëtejme;
- Të kryejë veprime hetimore të plota e të gjithanshme, kryesisht ose me urdhërim delegimi, si dhe të bëjë zbulimin e autorëve dhe provave që ndërlidhen me veprimtarinë e tyre kriminale dhe detyrat e tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore, me qëllim të zbatimit të ligjit penal të saj (ligji nr. 8677 i R.Shqipëris, datë 2.11.2000,“Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”).Siç shihet, policia ka funksion të rëndësishëm të veprimtarisë së saj, madje, ndër çështjet kryesore të fushëveprimit të saj është parandalimi dhe zbulimi i veprave penale, duke i referuar prokurorit materialin e nevojshëm për fillimin e procedimit penal.

Policia gjyqësore, si organ, siguron ndjekjen e një numri shumë të madh të çështjeve penale. Detyra kryesore e policisë është marrja në dijeni për veprat penale, kryerja e veprimeve hetimore për vepra të ndryshme penale, të cilat cenojnë klauzolën e rendit

publik, duke ndihmuar kështu punën e organeve që merren drejtpërdrejt me ndjekjen penale. Pra, nëpërmjet kësaj realizohen një mori funksionesh, si: parandalimi i krimit, zbatimi i ligjshmërisë dhe mbrojtja e sigurisë së brendshme nga cenimet dhe kërcënimet e ndryshme. Vlen të theksohet se puna e policisë sot është pragu apo fillimi i procesit penal dhe, shpeshherë është ky fillim që përcakton ekzistencën apo mosekzistencën e vendosjes së drejtësisë në vend. Ky është një standard krejt i ndryshëm nga ai i policive në shoqëritë jodemokratike, të cilat vihen në shërbim të thellë të elitave të sistemit. Në të gjitha shoqëritë demokratike funksionet policore janë nga më parësoret që një shtet synon t'i realizojë me qëllim që jeta e komunitetit ose e shoqërisë të jetë sa më e përballushme. Në të njëjtën kohë, është edhe funksioni më problematik, sepse shërbimi policor ka të drejtën dhe përgjegjësinë për t'iu përgjigjur me forcë shkeljeve kur situatat e kërkojnë një gjë të tillë. Kjo e drejtë, për të përdorur forcë në emër të ligjit, lejon të ngrihen pyetjet kritike në lidhje me diskrecionin e policisë dhe, njëkohësisht ndalon kryerjen e operacioneve policore nga struktura jopolicore. Në kohë të vështira, shërbimi policor vihet shpeshherë në fokusin e pakënaqësive publike⁶¹,

KPPRK-ja, herë pas here është përcjellë me ndryshime, duke i dhënë policisë më shumë fleksibilitet për të lejuar atë që të kryejë disa hapa hetimorë, me qëllim që organi i ndjekjes të lirohet nga disa angazhime, të cilat mund të kryhen edhe nga policia. Poashtu, edhe KPPSH-ja shqiptare, herë pas here, është përcjellë me ndryshime, duke i dhënë policisë gjyqësore kompetenca hetimore. Arsyeja e parashikimit të policisë gjyqësore në procedurën penale ka qenë e bazuar në domosdoshmërinë për të siguruar kualitetin e nevojshëm në fillimin e procedimit penal dhe në zhvillimin e hetimeve paraprake.

Praktika hetimore ka dëshmuar dhe dëshmon se faza më e dobët e procedimit penal është procedimi penal paraprak në faktin se në këtë fazë është marrë policia e më vonë

⁶¹ A. Shëgani, *E drejta penale e krahasuar*, botimi i vitit 2008, fq.134

përmirësimet e tilla i ka bërë organi i policisë gjyqësore si organ më adekuat i profesionalizuar.

Policia gjyqësore themi se është subjekt përcaktues i fillimit të procedimit penal për arsye se ajo, *de facto*, praktikisht realizon ndjekje penale, duke kryer një mori veprimesh me iniciativë në përputhje me KPP-në, duke shënuar në këtë mënyrë dhe fillimin e procedimit penal.

Kështu, në zbatim të kompetencave të përcaktuara (neni 201,paragraf 2, pikat 1, 2, 3, 4, 5, i KPPK-së, 2004:79), policia gjyqësore vepron me iniciativë për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale për kërkimin dhe pyetjen e personave që gjenden në vendin e ngjarjes si persona që kanë dijeni për rrethana të hetimit, për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohet hetimi. Ajo kryen kontrollin dhe sekuestrimin, në rast flagrante, kur personi është duke ikur, kryen ekspertime të ndryshme qoftë rlevime daktiloskopike, fotografime etj.

Të gjitha këto veprime policore, të ndërmarra nga policia gjyqësore, pa dyshim që i nënshtrohen kontrollit të prokurorit. Por, duke qenë se këto fakte kryhen nga profesionistët, ato janë të vlefshme dhe, si të tilla, nga praktika kanë reflektuar fillimin e procedimit penal. Hetimet paraprake përbëjnë bazën e procedimit penal. Gjatë kësaj faze zgjidhen një varg problemesh të rëndësishme si: merren provat që nuk mund të përsëriten, caktohen masat e sigurimit, bëhet njoftimi i akuzës, grumbullohen të dhënat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale dhe individualizimin e autorit të kryerjes së saj, etj. Krahas Prokurorit, e ngarkuar me kryerjen e hetimeve paraprake është dhe Policia Gjyqësore. Në këtë kapitull do të trajtohen disa momente të rëndësishme që lidhen me riorganizimin dhe veprimtarinë e Policisë Gjyqësore. Policia Gjyqësore është një nga subjektet e rëndësishme të procedimit penal. Në këndvështrimin historik, në vitin 1995, me hyrjen në fuqi të K.Pr.Penale u suprimua struktura organizative e Hetuesisë së Prokurorisë dhe Policisë

Hetimore të Ministrisë së Brendshme dhe në zbatim të ligjit Nr.8007 datë 5.10.1995 "Për miratimin e dekretit nr.1188 datë 10.08.1995 "Për Policinë Gjyqësore", u krijua struktura organizative dhe filloi rishtazi funksionimi i Policisë Gjyqësore. Me ligjin Nr.8677 datë 2.11.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" u shfuqizua dekret-ligji i lartpërmendur, me synim riorganizimin dhe ngritjen në një nivel më të lartë.

3.7. I dëmtuari i akuzës si subjekt themelor i procedimit penal

Duke u mbështetur në parimin e interesit publik të procedimit penal, sipas të cilit, për të ushtruar, kryesisht, ndjekjen penale, shërben interesi i përgjithshëm shoqëror, themi që për pjesën dërmuese të veprave penale, të parashikuara në Kodin Penal Shqiptar, ndjekja e tyre bëhet sipas detyrës shtetërore. Ndërkaq, siç e kemi shprehur edhe më lart, KPP-ja parasheh se, për disa lloje të veprave penale, ndjekja e tyre nuk bëhet, kryesisht, nga prokuroria, por nga vullneti i ankimit të të dëmtuarit dhe nga lloji i veprës penale. Në doktrinën e procedurës penale, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese hasen qëndrime të ndryshme për sa i përket pozitës procedurale penale të këtij lloj subjekti. Mirëpo, për të arritur në një konkluzion sa më të qartë lidhur me këtë pozitë shpjegojmë shkaqet apo arsyet se përse KPP-ja, ka parashikuar rastet kur mundet dhe nuk mundet i dëmtuari të ngrejë akuzë.

Duke iu referuar dispozitave të KP-së dhe të KPP-së, të cilat përcaktojnë se ndjekja penale bëhet vetëm nga i dëmtuari i akuzës, do të konstatojmë se këto lloj veprash penale kanë një rrezikshmëri të ulët, në kuptimin që rrezikshmëria shoqërore e këtyre veprave penale limitohet me sanksione të ulëta. Duke pasur parasysh këtë, ligjvënësi ka autorizuar vetë të dëmtuarin që të vendos të ushtrojë kompetencat e tij për të drejtat e veta që i janë cenuar nga të tjeret, ashtu që, këtë mundësi ia ka garantuar ligji i KPK-së,që, në saje të vullnetit te

tij, t'i drejtohet gjykatës për ta vënë në vend të drejtën e tij të cenuar⁶². Kjo e drejtë e tij ndërlihej me disa vepra penale të cilat, sipas Kodit të Përkohshëm Penal, të vitit 2004, kanë qenë të sistemuar në grupin e veprave penale kundër nderit dhe autoritetit. Kështu themi se për ndjekje ose jo të tyre i dëmtuari vendos në sajë të vullnetit të tij dhe në përputhje me interesin e vet. Në këtë mënyrë KPP-ja, ka gjetur zgjidhjen më optimale, duke lënë, pikërisht, ndjekjen e këtyre lloj veprave penale në interesin personal të të dëmtuarit. Në këto raste, ligjvënësi ka marrë parasysh faktin se ndjekja e këtyre veprave penale të mos iniciohet nga prokurori publik me faktin se ndërhyrja e tij do të mund të shkaktohte një rrezik theksial (potencial-të mundëshëm) rreth acarimit të marrëdhënieve ndërmjet subjektit kryerës së veprës penale dhe vetë të të dëmtuarit.

Megjithatë, ky interes personal nuk duhet të keqpërdoret, por duhet të përcaktohen afatet kohore brenda të cilave i dëmtuari ka të drejtën e ndjekjes.

Legjislacioni shqiptar ka parashikuar vetëm afate të përgjithshme parashkrimi për kundërvajtje penale.

Në këtë kontekst gjykoj se është e domosdoshme që të përcaktohen afatet e posaçme të parashkrimit për ato lloj veprash penale që ndiqen nga i dëmtuari i akuzës. Për sa i përket pozitës procedurale të të dëmtuarit të akuzës nuk jam i mendimit të shprehur në doktrinën penale, që kërkesën për marrjes të autorizimit për persona që gëzojnë imunitet, ta bëjë prokurori kërkesën për fillimin e hetimeve, duke argumentuar:

- Se ligjvënësi i ka dhënë të drejtën për të iniciuar e më pas për të vazhduar procedimin penal vetë të dëmtuarit akuzues.
- Kjo i duket qartë me vetë dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e të dëmtuarit akuzues, nga të cilat rezulton se, i dëmtuari i akuzës, është subjekt themelor i ndjekjes penale, roli i

⁶²Ejup Sahiti. *E drejta procedurës penale*.

prokurorit që merr pjesë në këto gjykime, nuk është themelor, pasi, për këto lloj veprash penale interesi personal është mbizotërues në raport me interesin shoqëror⁶³.

Kështu, është e vërtetë se prokurori merr pjesë në këto gjykime, por pjesëmarrja e tij është aksesore, pikërisht sa i përket vetë të dëmtuarit akuzues. Barra e provës për të vërtetuar akuzën, i takon të dëmtuarit të provojë se është cenuar të drejtat e tij nga i pandehuri dhe, nuk është prokurori ai që mbron interesin e tij në emër të interesit shoqëror.

Nëse do të pranonim se prokurori është subjekt themelor për këto çështje, atëherë, ku do të ndryshonte i dëmtuari akuzues me të dëmtuarin nga vepra penale për sa u përket të drejtave që i takojnë?

Në këto çështje gjyqëse roli i prokurorit ka karakter formal, e jo esencial, të debatit gjyqësor, anë e cila e obligon prokurorinë se, në përputhëni me zhvillimin e debatit gjyqësor, të krijuar ndërmjet vetë të dëmtuarit akuzues dhe të personit që i atribuohet vepra penale, të kërkojë dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Po të jetë subjekt themelor i ndjekjes penale në këto gjykime, atëherë lind pyetja se a mund të kërkojë pafajësi prokurori gjatë gjykimit të këtyre çështjeve?

Kështu, nisur nga sa u tha më lart, themi se prokurori në këto gjykime është subjekt dytësor i ndjekjes penale dhe jo subjekt themelor. Duke qenë se është subjekt dytësor, kërkesa për marrjen e autorizimit për fillimin e procedimit, penal i përket pikërisht të dëmtuarit të akuzës, pasi që interesi i tij personal, siç e theksova më lart, është mbizotërues në raport me interesin shoqëror. Vendimi nr. 39, i datës 23.6.2000, i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë ka interpretuar paragraf 2, të nenit 73 të Kushtetutës, duke vendosur: “për çështjet e parashikuara nga neni 59 i KPPSH-së, kërkesa për marrjen e autorizimit, për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, i drejtohet Kuvendit të Republikës së

⁶³Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë, viti 2004.

Shqipërisë, nga vetë gjykata pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit të akuzës.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese arsyetohet se për këto çështje “fillimi i ndjekjes penale është në kompetencë të gjykatës...”. Kërkesën për marrjen e autorizimit ka të drejtë ta bëjë vetëm gjykata, pa pasur nevojë për ndihmë ose ndërhyrjen e prokurorit. Gjykata është i vetmi organ procedues i cili zhvillon procedurën për vepra penale që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit të akuzës. Në lidhje me këto definicione ka mendime se gjykata në procedurën penale është e veshur me pushtetin për të dhënë drejtësi dhe, si e tillë, nuk është organ procedues në kuptimin e ushtrimit të ndjekjes penale. Një gjë e tillë do të bënte që funksioni i ndjekjes penale dhe ai i vënies së drejtësisë të grumbullohet në një organ të vetëm, në gjykatë, gjë që është karakteristike në procedurën inkuizitore, në të cilën grumbullimi i funksioneve të procedurës penale bëhet nga një organ i vetëm. Ndërkaq, çështja e të dëmtuarit të akuzës është karakteristike e sistemit akuzator të procedurës penale, në të cilën nuk mund të flitet për grumbullim të funksioneve themelore të procedurës penale te një organ i vetëm.

I interesuar për të filluar procedimin penal në këto gjykime nuk është as gjykata e as prokuroria, por i vetë i dëmtuari i akuzës, duke qenë se ligjvënësi për disa subjekte ka parashikuar disa procedura të veçanta për të filluar procedimin penal. Autorizim për procedim është subjekti i ligjëzuar për të hequr ato pengesa, duke kërkuar vetë marrjen e autorizimit pranë organit kompetent.

Prandaj duke u nisur nga interesi personal e jo ai shoqëror që mbartin këto lloj procedimesh, themi se ato lindin nga paditë private, paditë të cilat ushtrohen jo civilisht, por penalisht. Duke qenë se janë padi private, roli kryesor për vënien në vend të së drejtës së cenuar apo të dëmtuar i përket individit e jo ndonjë subjekti tjetër. Nisur nga sa u tha më sipër, themi se subjekt themelor i ndjekjes penale, në këto çështje, është vetë i dëmtuari i akuzues. Në

këto lloj çështjesh funksioni i ndjekjes penale ushtrohet nga i dëmtuari akuzues, pasi që fillimi i procedimit penal, marrja e cilësisë si të pandehurit, bëhet nga i dëmtuari akuzues dhe jo nga ndonjë subjekt tjetër. Funksioni i gjykimit ushtrohet nga gjykata, ndërsa funksioni i tretë i procedurës penale, funksioni i mbrojtjes, ushtrohet nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

KAPITULLI IV: VËNIA NË DIJENI E ORGANEVE TË NDJEKJES PËR VEPRA PENALE

4.1. Kallëzimi penal

Kallëzimi penal është akt me shkrim apo me gojë, përmes të cilit janë të përmbledhura informacionet në lidhje me kryerjen e një apo me shumë veprave penale, akt ky që përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit. Se ç'farë ne vehte bartë ligjësishtë nja kallëzimi penal duhet ti referohemi normimeve të caktuara si; nenit 80 & 81 të KPPRK-së, 2012: 29, 30, dhe neneve 281 dhe 282 të KPPSH: 124, 125, 126.

Ne një rast të mosfillimit të procedimit penal nga ana e prokuroris edhe kur ka kallzim për një vepër penale, gjykata ka detyruar prokurorin që të nisë veprimet procedurale hetimore për ta hetuar çështjen. Gjkata ka arsyetur se prokuroria ka vepruar në shkelje të ligjit penal, pasi që vepra për të cilën është bërë kallzimi penal parashikohet në kodin penal me një masë dënimi nga 3 deri në 10 vite burg dhe nuk gjen zbatim nën 290 i Kodit Penal. **VENDIMI Nr.752⁶⁴** i Gjykatës së Apelit, Tiranë, datë 11.07.2012 për mosfillimin e procedimit penal nga ana e prokurorisë, i iniciuar me kallzim penal. Shoqëria “A”

⁶⁴ Shihë Vendimin Nr.752 dt.11.07.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë , aksesuar në faqen zyrtare www.gjykataeapelitirane.al.

shpk., me datë 02.09.2011 ka paraqitur pran Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiran Ankimin kundër vendimit të mosfillimit të proçedimit Penal te datës 22.07.2011, lidhur me kallzimin penal nr.2267 te vitit 2011.

Vendimi i mosfillimit te proçedimit penal, ose të dërguar nga Prokuroria e Tiranës, me datë 13.09.2011.

Shoqria Tregtare ‘A’ me dt. 01.04.2011 i është drejtuar Prokuroris së Rrethit Tiranë me kallzimin penal kundër shtetasve S.D. dhe Q. K. të akuzuar: për vepren penale të vjedhjes në bashkpunim, mashtrim në bashkpunim dhe falsifikim të dokumentave të parashikuara nga nenet 135, 143, 186 e 25 të K.Penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka bërë verifikimet paraprake të kallzimit penal, me datë 22.07.2011 ka vendosur:

“Mosfillimin e proçedimit për kallzimin penal nr.2267 të vitit 2011” bazuar në nenin 290 shkronja “d” e “dh” dhe 291 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi e ka shqyrtuar këtë çështje, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.2267, dt.22.07.2011 dhe detyrimin e Prokurorisë të fillojë procedimin penal”.

Këtë vendim e ka apeluar organi i Prokurorisë, i cili kërkon ndryshimin e vendimit penal të gjykatës së faktit.

Kolegji Penal çmon se, pretendimet e parashtruara në apelin e prokurorit janë të pabazuara. Organi i prokurorisë është i detyruar të fillojë procedimin penal dhe të hetojë rreth tij. Nga pala kallëzuese është pretenduar se shtetasit e kallëzuar S.D e Q.K. kane vjedhur pasurinë e saj, me anë të shpërdorimit të detyrës, e parashikuar nga neni 135 i K. Penal.

Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal nuk bëhet fjalë pa u trajtuar shkaqet e mos hetimit të kësaj akuze të ngritur nga kallëzuesi. Po kështu, në kallëzimin penal është

pretenduar se, dy shtetasit, me anë mashtrimi në bashkëpunim kanë përfituar në pasurinë e shoqërisë, gjë e cila parashikohet si vepër penale nga neni 143/2 të K. Penal dhe ka për sanksion penal dënimin nga 3 gjer në 10 vjetë.

Nga organi i akuzës është interpretuar në mënyrë të padrejtë neni 66 shkronja “c”, e K.Penal. Për rrjedhojë edhe baza ligjore e vendosur për mosfillimin e proçedimit penal, është jo e drejtë.

Në nenin 290, shkronja “d” e “dh” është parashikuar se:

- vepra penale është shuar;- është dhënë amnisti;

Në rastin në shqyrtim vepra penale e parashikuar nga neni 135 dhe 143/2 të K.Penal, për të cilën pretendohet në kallëzimin penal, nuk është shuar dhe as është amnistuar. Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë Tiranë.

4.2. Organet e detyruara me të drejtë për paraqitjeje të kallëzimeve penale

Me qëllim të luftimit të kriminalitetit, detyrë parësore e organeve shtetërore është që të marrin preventiva para dhe pas kryerjes së veprave penale, me qëllime që të mbrohen vlerat individuale dhe të përgjithëshme shoqërore. Në këtë drejtim, KPPRK-ja dhe KPPSH-ja, siç u tha më lart, obligon të gjitha organet publike t’i paraqesin veprat penale që ndiqen, kryesisht, për të cilat janë informuar ose kanë ardhur në dijeni në ndonjë mënyrë tjetër. Personat publikë të autorizuar me ligj, përgjatë ushtrimit të detyrës, nëse konstatojnë se është kryer një vepër penale, apo është duke u kryer, duhet të kallëzojnë atë përpara organeve të ndjekjes penale edhe pa qenë i individualizuar personi që i atribuohet vepra penale. Duke u nisur nga rëndësia që ka për shoqërinë lufta ndaj kriminalitetit e me qëllim që të garantohet vetëmbrojtja shoqërore, qytetarët kanë të drejtë t’i kallëzojnë veprat penale, të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, dhe kanë për detyrë e detyrim ta bëjnë këtë në

rastin kur moskallëzimi i veprës penale përbën krim. Megjithatë, as për këto vepra penale nuk mund të dënohen personat që në raport me autorin e veprës penale janë të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, i adoptuari, bashkëshorti, si dhe personat e tjerë që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo të profesionit.

4.3. Format dhe mënyrat e paraqitjes së kallëzimit penal

Bazuar në këtë, të gjithë personat fizikë dhe juridikë, pranë organeve të autorizuar shtetërore të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje të posaçme pozitive, si të dëmtuar nga veprat penale, kanë të drejtë ti njoftojnë, organet shtetërore, policinë, prokurorin, duke paraqitur rastet, për cenimin e të drejtave dhe pasojave që ju është shkaktuar nga vepra penale apo të paraqesin vepren që ju ka ndodhur personave të tjerë nese kanë qenë okular kur ka ndodhur vepra, sepse kështu kemi të drejtë ti themi vehtes, rrethit dhe shoqërisë se kemi kryer një obligim që derivon nga ligji përkatës dhe kushtetuta e vendit që jemi obligim ta respektojmë. Kjo paraqitje e kallëzimeve penale në Kosovë dhe në Shqipëri bëhet në mënyrë të ngjajshme duke i adresuar kallëzimet drejtpërdrejtë me gojë dhe më shkrimë dhe me mjete të tjera teknike (neni 80, par.1, i KPPRK-së, 2012:29). E rëndësishme është që në rast se kallëzimi paraqitet gojarisht, detyrim i dy organeve të përmendura është që kallëzuesin ta paralajmërojnë për pasojat e kallëzimit të pavërtetë⁶⁵ (rasti i kallëzimit penal 2015-DA-0846. Ref: 2015-HRP-46, i datës 25.5.2015) paraqitur në Prokurorinë themelore, Pejë, Departamenti për Krime të Rënda.

Detyrimi i prokurorit, pas pranimi të kallëzimit penal, është që ta vlerësojë dhe ta çmojë besueshmërinë e tij, sipas ligjit dhe varësisht nga materiali dhe provat e prezantuara në të, vendosë fillimin ose mosfillimin e procedimit penal. Nëse nga kallëzimi penal nuk mund të

përcaktohet mbi bazë të perceptimit intelektual, se jemi para një ngjarjeje të veprimit të kundërligjshëm të ndodhjes së një veprë penale, përkatësisht të një fakti me natyrë kriminale, ose, të dhënat e kallëzimit nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, prokurori është i autorizuar të bëjë verifikime të nevojshme, por pa kryer veprime hetimore.

KPPRK-ja, obligon ligjërisht prokurorinë e shtetit se, me të pranuar kallëzimin penal, brenda afatit prej 30 ditësh, duhet ta marrë në përpunim dhe të vendosë fillimin apo mosfillimin e hetimeve dhe varësisht situatës dhe provav, e të marrë vendime konkrete nëse e hedhë, poshtë kallëzimin penal, aplikon (nenin 82, paragraf 1, pikat 1–5, të KPPRK-së, 2012:30). Me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, nuk ka qenë evident përkufizimi kohor i 30-ditëshit, gjë që tani paraqitet një risi, për dallim me Kodin e mëhershëm të KPPK-së, që ishte në aplikim deri në fund të dhjetorit 2012 (Rregullorja e UNMIK-ut nr.).

Referuar KPPSH-së, përkatësisht udhëzimit të prokurorit të përgjithshëm, “për regjistrimin e njoftimeve të veprave penale”, nuk ka të dhëna që tregonin se bëhet fjalë për vepër penale të kryer. Atëherë, detyrimi i prokurorit është që të mosfillojë procedimin penal. Në praktikën e përditshme të punës së organit procedues, këto veprime kryhen në pajtim me KPP-në, ndonëse pranohet, se me kryerjen e veprimeve të tilla po supozohet se kemi nisur procedimin penal. Nëse dhe pas verifikimit prej dhjetë ditëve, që ka në dispozicion prokurori, në bazë të **udhëzimit nr. 241 të prokurorit të përgjithshëm, “për regjistrimin e njoftimeve të veprave penale”**.

Është e parëndësishme nëse personi që bën kallëzim penal, të dijë se vepra penale ndiqet sipas kallëzimit të të dëmtuarit, apo, kryesisht, ose që, për ndjekjen penale të personit që kallëzohet të kërkohet autorizim nga organi kompetent. Në situatat kur masat dhe veprimet e kryera nga policia, përkatësisht provat e mbledhura, nuk sigurojnë bazë për kallëzimin

penal të policisë gjyqësore dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, policia, sipas udhëzimit të prokurorit, paraqet raport të veçantë në adresim të prokurorit të shtetit përkatës, në territorin ku dyshohet të ketë ndodhur rasti. Megjithatë, formulimi i nenit 287 i KPPSH-së ka sjellë paqartësi të shumta në këtë drejtim. Kështu, nuk përcaktohet qartë nëse çdo njoftim kallëzimi, ankimi, duhet të regjistrohet menjëherë në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Ashtu siç duhet të regjistrohet, aktualisht nga ana e prokurorit, në të shumtën e rasteve ky njoftim pas një verifikimi jo procedural-penal. Po të pranohet rastin e parë se, gjdo njoftim duhet të shënohet në regjistrat e veprave penale, atëherë rrjedhimisht, del që ke regjistruar një vepër penale, si të tillë, pa asnjë lloj verifikimi. Pra, në këtë rast kemi regjistruar një vepër penale vetëm sipas perceptimit të ankuesit apo kallëzuesit. Mirëpo, si mund të regjistrosh kallëzimin në regjistrin e veprave penale pa një perceptim të prokurorit, nëse njoftimi mund të jetë vepër penale apo jo?

Po të pranojmë këtë zgjidhje, a përbën kjo një nonsens, që ta regjistrosh si vepër penale, madje edhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, vetëm mbi bazë të kallëzimit? Po të kuptohej kështu kjo dispozitë, sipas interpretimit lateral, një regjistrim i tillë do të përbente edhe fillimin e hetimeve ndaj personit konkret dhe të gjitha këto mbi bazën e vetme të një kallëzimi apo ankimi për procedim penal, të bërë nga shtetasi, nëpunësi publik apo personeli mjekësor.

Formulimi i dispozitës lë për të dëshiruar, pasi që thotë: regjistër i njoftimit të veprave penale, në vend se duhet të thuhej: regjistrat e veprave penale, pasi që vetëm mbi bazë të këtyre regjistrave operohet me vendim fillimi të procedimit apo pushimit të tij.

Regjistri i njoftimit të veprave penale duhet të thuhej regjistrat e veprave penale, pasi vetëm mbi bazë të këtyre regjistrave operohet me vendim fillimi të procedimit apo pushimit të tij.

Regjistri i njoftimit të veprave penale duhet të jetë në trajtën e një libri protokolli si në

Kosovë që i përngjet një porte të vetme të institucionit nga ku mund të hyjnë të gjitha njoftimet për veprat penale, qoftë kryesisht apo me forma të tjera. Mirëpo këto njoftime mund të jenë dhe lajthitje të personave që i kallëzojnë apo i ankojnë.

Titulli i dispozitës duhet që të quhet regjistri i veprave penale. Në praktikën e organit procedues, aktualisht, mbahen disa regjistra të tillë dhe, jo të gjitha kallëzimet i regjistrojnë në një regjistër, siç është vepruar më parë.

Vlen të përmendet se, aktualisht regjistrat e prokurorive në Kosovë janë unike dhe mbajnë shenja të ndryshme. Regjistrat PP (shërbejnë për ti evidentuar procedimet penal me kryerës të njohur), regjistrat me PPP(evidentohen kallëzimet penale me kryes të panjohur. Ne regjistra PPN raportet policore, raportet njoftuese, raportet e veçanta etj. Regjistrat RLN shërbejnë për ti evidentu rastet me masa te sigurisë si: paraburgimet, masat e tjera të fshehta etj. Ndërsa aplikimi i regjistrave me shenjen PPM, shërbejnë për evidentimet e kallëzimeve penale ndaj kryesve të mitur. Regjistrat e theksuar me shenjat e theksuar aplikohen në mënyrë unike në nivel të përgjithshëm në R.Kosovës.

Një kategori kallëzimesh, nga të cila del i qartë fakti me natyrë kriminale mbi bazë edhe të udhëzimit nr.241 të 21.11.2005, të prokurorit të përgjithshëm, shënohen në regjistrin e njoftimit të veprave penale, që do të thotë se për ato ka nisur procedimi penal. Prandaj, kjo dispozitë duhet kuptuar në mënyrë të tillë, që prokurori shënon në regjistrin e njoftimit të veprave penale jo çdo kallëzim. Një kategori kallëzimesh regjistrohen në një regjistër më vete, ku bëhet shënimi si kallëzim dhe data e hyrjes (ardhies) së tij e, pasi të bëhen verifikimet e nevojshme të prokurorit, të shënohen veprat penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Pra, regjistrimi i veprave penale nuk varen nga pretendimet e kallëzuesit, por i nënshtrohet vlerësimit nga ana e prokurorit. Njoftimet për veprat penale janë akte propozuesve për të filluar një ndjekje penale-procedim penal, pra ato përbëjnë nismën për të filluar ose jo procedimin penal. Në praktikën aktuale, një njoftim i veprës penale

regjistrohet në librin e kallëzimeve penale dhe më pas në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Një gjë e tillë bëhet, si rregull, brenda 10 ditësh e, më pas bëhet regjistrimi edhe i emrit të personit që i atribuohet vepra penale.

Për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, sipas udhëzimit të prokurorit të përgjithshëm, është dhënë një zgjidhje oportune, duke përcaktuar detyrimin e prokurorit për ta regjistruar procedimin penal, si dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, vetëm pasi të administrohen aktet procedurale që ia atribuojnë kryerjen e veprës penale atij.

Neni 287 i KPPSH-së ka sjellë konfuzion në praktikën e organit procedues, pasi **që** nuk e ka përcaktuar aktin e prokurorit për vëllimin e procedimit penal, por thekson se vetëm shënohet në regjistër njoftimi i veprës penale dhe emri i personit që i atribuohet vepra penale, duke e përcaktuar fillimin e procedimit penal, bërjen e këtyre shënimeve. Në këtë kontekst, udhëzimi i mësipërm ka normuar këtë institut, si nga pikëpamja procedurale, duke përcaktuar rregulla të detyrueshme në këtë drejtim, ashtu dhe nga pikëpamja kohore. Sipas dispozitave në fuqi të KPP-së së Kosovës dhe atij të Shqipërisë, kallëzimet penale mund të bëhen me gojë. Rastet me gojë paraqiten edhe në polici edhe në Prokurori. Janë të theksuara rastet që paraqiten në Polici, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, por, si raste nganjëherë paraqiten edhe në Prokurori, te prokurorët kujdestarë, drejtpërdrejt, ku këta të fundit janë obligatorë për të përpiluar shënim zyrtar. Kur paraqitja bëhet me shkrim nga palët deponuese, -të njëjtëve u jepet numri rendor i protokollit, si shenjë identifikuese për rastin e paraqitur. Në rastin e kallëzimit me gojë prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore mban një procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

- Vendin dhe kohën e marrjes së kallëzimit;
- Gjeneralitetet e atij që bën kallëzimin;
- Personit dhe detyrat e atij që e merr kallëzimin;

- Paralajmërimin e përgjegjësisë penale në rast të kallëzimit të rremë;
- Përshkrim të rrethanave të marrjes dijeni për veprën penale nga personi që bën Kallëzimin;
- Identifikimin e personave të tjerë që mund të kenë dijeni për rrethanat e veprës Penale;
- Përshkrimin e pasojave që kanë ardhur prej saj;
- Personat që janë të dëmtuar nga vepra penale;
- Të dhënat në lidhje me autorin e veprës penale;
- Të dhënat në lidhje me mundësinë e gjetjes së provave ose burimeve të provave;
- Përshkrim të hollësishëm të elementeve përbërëse të faktit kriminal;
- Nënshkrimin mbi treguesin e kallëzimit penal dhe atij që e pranon kallëzimin penal.

Në rastet kur kallëzimi është me shkrim, pasi të verifikohet materiali, bëhet regjistrimi i tij në regjistrin e njoftimit të veprave penale, ose, në të kundërtën, vendoset mosfillimi i procedimit penal, duke bërë njoftimin e personit që ka paraqitur kallëzimin. Nëse kallëzimi i paraqitur është anonim, ai nuk mund të shërbejë si shkak për fillimin e procedimit penal. Kallëzimet anonime mund të përdoren vetëm atëherë, kur vetë shkresa e kallëzimit përcaktohet se mund të jetë e falsifikuar. Pra, që të përbëjë një provë materiale. Përkundrazi, mund të jetë një kallëzim anonim me shkrim që shoqërohet me dokumente mbi të cilat mund të zbulohen gjurmë apo pasojë të veprës penale. Detyrimi, i nëpunësve publikë për të kallëzuar veprat penale karakterizohet nga këto veçori:

- Nëpunësi publik i vë në dijeni të veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, ose për shkak të funksioneve apo të shërbimit;
- Personi duhet të jetë një nëpunës publik;
- Vepra penale (krim apo kundërvajtje penale) duhet të jetë nga ato që ndiqet kryesisht dhe jo ato që ndiqen në ankim;
- Vepra duhet kallëzuar edhe nëse nuk dihet autori i kryerjes së saj (edhe sipas KPPK-së edhe atij shqiptar, pavarësisht se a dihet autori kur ndodhë kryerja e veprës penale dhe dihet

i dëmtuari, apo, më mirë të themi, është shkaktuar rasti e, i cili, doemos, duhet të evidentohet tek organet përkatëse policore hetimore dhe gjyqësore dhe të njoftohet organi i ndjekjes);

- Kallëzimi bëhet me shkrim edhe me gojë;

- Moskallëzimi, kur nëpunësi publik ka marrë dijeni gjatë ushtrimit të detyrës, ose për shkak të saj, sjell si pasojë marrjen e personit në përgjegjësi penale. Ky detyrim është edhe për persona që merren me procedim civil apo administrativ.

Nëpunësi publik në kallëzimin me shkrim duhet të paraqesë: Institucionin, punonjës i të cilit është nëpunësi, elementet thelbësore të faktit që mendohen se janë vepra penale, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin e personit dhe çdo gjë tjetër që shërben për të identifikuar personin të cilët i atribuohet vepra penale, gjeneralitetet dhe çdo gjë që shërben për të identifikuar personin e dëmtuar nga vepra penale, gjeneralitetet dhe çdo gjë tjetër që shërben për të individualizuar personat që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit kriminal. Nëse bëhet kallëzimi me gojë para prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore respektohet për aq sa është e mundur përmbajtja e kallëzimit që duhet të bëhet me shkrim.

Përveç nëpunësve publikë, KPP-ja ka parashikuar detyrimin personelit mjekësor për të bërë kallëzimin në organet e ndjekjes penale, për ato vepra penale për të cilat ata vijnë në dijeni për shkak të ushtrimit të funksionit të tyre. Tiparet e këtij kallëzimi penal janë:

- Detyrimi për të kallëzuar se a ka vetëm ai personel mjekësor që me ligj apo me akt nënligjor është i detyruar të bëjë kallëzim penal;

- Marrja në dijeni për veprën penale ka ardhur si rezultat i ushtrimit të funksionit që ata kryejnë;

- Vepra penale duhet të jetë nga ato që ndiqen kryesisht (zyrtarisht);

- Koha brenda së cilës duhet të bëjë kallëzim është 48 orë nga kryerja e ndërhyrjes ose dhënies së ndihmës;

Juridiksioni territorial për kallëzim është vendi ku është bërë ndërhyrja dhe kur ka rrezik nga vonesa, kallëzimi bëhet tek oficeri i policisë gjyqësore më i afërt.

Nëse ndërhyrja është bërë nga një grup mjekësh, asnjëri prej tyre nuk përjashtohet nga detyrimi për kallëzim, përveç rastit kur kallëzimi bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjithë mjekët.

Në rastin e kallëzimeve me shkrim përmbajtja duhet të theksohet me sa vijon:

- Personi, të cilit i është dhënë ndihma;
- Gjeneralitetet rreth identifikimit, në mënyrë të tërësishme, duke e përfshirë datën e lindjes, vendin e lindjes, profesionin, statusin familjar etj.;
- Rrethanat e faktit për të cilat ai mendon se përbëjnë figurën e elementeve të veprës penale;
- Mjetet me të cilat është kryer ndërhyrja ose është dhënë ndihma;
- Pasojat që ka shkaktuar ndërhyrja e tij etj.

Nëse kallëzimi penal parashtrohet me gojë atëherë duhet të mbahet procesverbal dhe duhet të evidentohen rrethanat e përshkruara si më lart:

Sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, procedurat të cilat ndiqen me ankim të të dëmtuarit, janë veprat penale të përcaktuara në K.P.SH. të vitit 1995 sipas këtij emertimi.

- Plagosja e lehtë, me dashje (kundërvajtje penale e përcaktuar me nenin 89 të KP-së);
- Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale, duke shpërdoruar detyrën zyrtare, të përcaktuar sipas nenit 105 të KPSH-së, fq.36;
- Fyerja për shkak të detyrës, kundërvajtje, përcaktuar sipas nenit 239 të KPSH-së,fq.74;
- Shpifja ndaj Presidentit të Republikës, krim, përcaktuar sipas nenit 241 të KP-së;
- Marrëdhëniet seksuale me dhunë, më të rritura, krim, përcaktuar sipas nenit 102, par. 1 të KP-së;-Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjedhur martesë, përcaktuar me nenin 130 të KP-së, fq.45;

- Shpifja për shkak të detyrës përcaktuar sipas nenit 140 të KP-së;
- Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore, nenit 243 i KPRSSH-së, fq.75;
- Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275 i Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, fq.83);
- Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë (neni 264 i KPRSSH-së, fq.80);
- Fyerja e gjyqtarit të përcaktuar, (neni 318 i KPRSSH,fq.98).

Për këto lloje veprash penale, procedimi fillon vetëm me ankimin e të dëmtuarit, ankim i cili bëhet përpara organeve të ndjekjes penale. Për fillimin e procedimit penal është e mjaftueshme që i dëmtuari të shprehë vullnetin e tij edhe nëse nuk njihet personi të cilit i atribuohet vepra penale. Ankimi mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Nëse bëhet me shkrim, ai duhet të përmbajë:

- Gjeneralitetet e personit që bën ankimin, si dhe adresën e tij;
- Përshkrimin e rrethanave të faktit për të cilat kërkohet të procedohet;
- Kohën e kryerjes së veprës, vendin dhe mjetet e kryerjes së saj etj.;
- Nënshkrimin e të dëmtuarit;
- Identifikimin dhe gjeneralitetet e personit të cilit që ia atribuon veprën penale;
- Deklarimi se kërkon të fillohet një procedim penal.

Në rrethanat kur deklarimi i të dëmtuarit bëhet me gojë nga përfaqësuesi i të dëmtuarit, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore duhet të verifikojë identitetin, si dhe bazën juridike që jep të drejtën e përfaqësimit të posaçëm për këtë deklaram. Duhet theksuar se prokura që të shërbejë si bazë ligjore e mjaftueshme për të filluar një procedim penal duhet të jetë e posaçme dhe jo e përgjithshme. Kjo për arsye se ky lloj deklarimi nuk përfshihet në prokurën e përgjithshme. Për sa u përket të dëmtuarve të mitur nën moshën 14 vjeç, të drejtën e ankimit e ushtrojnë përfaqësuesit ligjorë – prindërit.

Me rastin kur ankimi apo heqja dorë prej tij bëhet me gojë prej vetë të dëmtuari, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore duhet të sigurohet për identitetin e personit dhe të mbajë procesverbalin përkatës për këtë veprim, i cili, detyrimisht, duhet të nënshkruhet nga i dëmtuari. Mosnënshkrimi i procesverbalit e bën atë të pavlefshëm. Procesverbali i përpiluar me rastin e ankimit nga ana e personave të autorizuar, prokurorit apo policisë gjyqësore duhet të përmbajë:

- Identitetin dhe detyrën e atij që harton procesverbalin, kohën dhe vendin ku hartohet;
- Gjeneralitetet e personit që bën ankimin;
- Përshkrimin e faktit për të cilin bëhet deklarimi;
- Të dhënat personale të personit apo personave në bashkëveprim që atribuohet vepra penale, nëse dihet;
- Deklarimin e vullnetit, me anë të të cilit kërkohet fillimi i procedimit penal;
- Nënshkrimin e të dëmtuarit;
- Nënshkrimin e personit që mban procesverbalin.

Mund të ndodhë që organet e ndjekjes penale, kur vihen në dijeni për këto vepra penale, atëherë, organi i procedurës duhet të njoftojë personat e dëmtuar me këto vepra, se, a dëshirojnë të bëjnë ankim apo jo, duke i ftuar ata që të mbajnë qëndrimin përkatës. Nëse nuk dëshirojnë të bëjnë ankim, atëherë mbahet një procesverbal, në të cilën administrohet vullneti i të dëmtuarit për të mos ushtruar ndjekje penale. Në këtë rast kemi hequr dorë nga e drejta e ankimit, gjë që çka e bën të pamundur shtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe për të njëjtin person.

Nëse organi i procedurës ka kryer hetime, veprime hetimore pa marrë autorizimin e të dëmtuarit, atëherë ai duhet ta ftojë të dëmtuarin dhe ta pyesë nëse dëshiron të vazhdojë ose jo procedimin e filluar. Nëse pohon se nuk ka ankim dhe nuk dëshiron të vazhdojë me

procedim, atëherë detyra e organit procedues është që të pushojë procedimin e çështjes dhe të mos veprojë apriori, pa pyetur të dëmtuarin.

Problemi vështirësohet kur procedimi penal ka filluar nga ana e prokurorisë, pa marrë ankimin e të dëmtuarit. Si do të veprohet në ato raste kur i dëmtuari, vullneti i të cilit është i domosdoshëm për fillimin e procedimit penal, apo për vazhdimin e tij, nëse ka filluar, vdes?

A duhet të vazhdojë procedimi i filluar, apo duhet të pushojë menjëherë?

Mendoj se, edhe nëse jemi para një fillimi të gabuar të procedimit penal nga ana e prokurorisë, në rast se vdes i dëmtuari pa dhënë vullnetin e tij, prokurori, në çdo rast, duhet të vendosë pushimin e procedimit të filluar, për shkak se mungon ankimi i të dëmtuarit. Ndërkaq, tërheqja e ankimit, që parashikohet sipas nenit 286 të KPP-së, është një e drejtë e të dëmtuarit për të disponuar lidhur me përfundimin e procedimit, do të thotë se; Sipas kësaj dispozite tërheqja e ankimit nga ana e të dëmtuarit duhet të jetë e vullnetshme dhe personale apo nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm ose nëpërmes përfaqësuesit ligjor. Ky veprim bëhet përmes deklaratës së shkruar dhe të paraqitur në organin e procedurës.

4.3.1. Kallëzimi anonim

Me kallëzim anonim nënkuptojmë kallëzimin e paraqitur tek organet përgjegjëse të shtetit e që personat që paraqesin veprën si të tillë nuk dëshiroin të identifikohen apo shënojnë identitet të pa qenë. Ky lloj kallëzimi është një formë tjetër e marrjes në dijeni për veprë penale e cila paraqitet në formën e një letre anonime. Paraqitje të tilla janë bërë për arsye të ndryshme, me qëllim që identiteti i paraqitësit të mos zbulohej për shkaqe sigurie. Vlen të theksohet se kallëzimet e tilla, të paraqitura, në të shumtën e rasteve kanë rezultuar si lajmërimet e rrejshme dhe të pavërteta.

Fakti se duhet të merret me rezervë është se këtij lloj kallëzimi i mungon elementi thelbësor e që është identiteti i personit që paraqet kallëzimin, se a është neni 283/2 i KPPSH-së. Ndërkaq, neni 283, paragraf 3 i KPPSH-së, parashikon, shprehimisht, që kallëzimi anonim nuk mund të përdoret, me përjashtim të rasteve të mëposhtme, neni 194 i KPPSH-së:

- Përveç kur përbën ndonjë provë materiale;
- Kur dyshohet se janë bërë nga i pandehuri.

Në këto raste themi se kallëzimi anonim mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të nisur fillimin e procedimit penal. Megjithatë, kallëzimet anonime duhet të shihen me kujdes, në mënyrë që të mos ta fusin veprimtarinë e organit procedues në rrugë pa krye, që do të thotë se kallëzimi anonim mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për ta filluar procedimin penal, vetëm atëherë kur në tërësinë e tij mungojnë elementet se ka veprë penale. Nëse kallëzimi anonim është i shoqëruar edhe me ndonjë provë materiale, nga e cila ekziston dyshimi i arsyeshëm se jemi para një veprë penale, për vërtetimin e tij patjetër, organi procedues duhet të fillojë procedimin penal për zbulimin e së vërtetës (ndonjë kasetë, audiovizive, ndonjë celular etj.). Nga praktika nuk kanë munguar rastet kur, pas verifikimit të faktit për të cilin bëhet kallëzimi anonim të ketë rezultuar, me të vërtetë, ekzistenca e veprës penale e në raste të tilla është treguar kujdes që, sa të jetë e mundur, të identifikohet personi që ka bërë kallëzimin dhe, pasi të identifikohet, të kontaktohet me të, të merren të dhëna prej tij të dhëna në lidhje me kallëzimin e bërë, apo t'i kërkohej atij të nënshkruajë kallëzimin. Kur personi që bën kallëzimin anonim në kuptimin që nuk ekziston, nëse arrihet të identifikohet, plotëson kushtet e nevojshme për fillimin e procedimit penal kundër tij për veprën penale të kallëzimit të rremë, sipas nenit 305 të KPPK-së.

4.3.2. Vetëkallëzimet

Nga praktika e përditshme rrjedh se vetëkallëzimet janë më të rralla, sepse, as sipas KPSH-së dhe as sipas KPK-së, personat nuk ndiejnë interesim ta inkriminojnë vetveten. Sigurisht, këtu duhet treguar një kujdes i veçantë mbi marrjen e kallëzimit, për të bërë të mundur edhe një vlerësim paraprak lidhur me gjendjen mendore të personit kallëzues. Praktika ka treguar se kallëzimet e tilla bëhen nga personat në gjendje të dyshimtë mendore, prandaj verifikimi i këtyre kallëzimeve është i domosdoshëm dhe duhet bërë, duke treguar kujdes maksimal. Nga ana e policisë gjyqësore, merren kallëzime të kësaj natyre dhe kjo ndodh kryesisht te të miturit. Ndonëse kallëzuesi i atribuon vetes kryerjen e veprës penale (te rastet e vjedhjes etj.), nga ana e policisë gjyqësore nuk bëhen verifikimet e duhura për të bërë të mundur përcaktimin e objektit të dëmtuar, apo edhe në rastet kur ai është i identifikuar, nuk pyetet personi i dëmtuar dhe ndodh që, kur regjistrohet procedimi penal dhe pyetet i dëmtuari, ai mohon që të jetë dëmtuar nga ndonjë vepër penale.

4.3.3. Njoftimet me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit

Këto lloj njoftimesh për vepra penale sigurohen nëpërmjet medias së shkruar dhe audiovizive. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur fillimet e procedimeve penale janë provokuar pikërisht nga mjetet mediatike, të shkruara dhe nga ato elektronike, dhe si të tilla kanë rezultuar si të suksesshme. Sidoqoftë, këto lloj të dhënash duhet të çmohen me maturi dhe kujdes maksimal, pasi që ato mund të fusin veprimtarinë e organeve proceduese në një rrugë pa krye. Verifikimet e këtyre lloj kallëzimeve jo vetëm që bëhen duke thirrur autorin e shkrimit apo njoftimit, por edhe duke bërë verifikime të duhura të këtyre të dhënave, duke e ballafaquar atë me të dhëna reale në lidhje me faktin që

kallëzohet. Po ashtu, njoftimi me telefon dhe me faks mund të jetë një burim tjetër i njoftimit të veprave penale, për rregullat e së cilës aplikohen nenet e veçanta të KPPRK-së dhe KPPSH-së.

Në lidhje më këtë shprehet mendimi se, nga puna e përditshme si prokuror në Pejë, për rastet të tilla të njoftimeve të veprave penale përmes mjeteve të komunikimit, jo që nuk janë shfaqur përmes shtypit ditor, mjeteve të informimit: radios, televizioneve, por organet e ndjekjes asnjëherë nuk kanë shfaqur gatishmëri të përpilimit të një shënimi zyrtar dhe të urdhërojnë sekretarinë penale që, për X apo Y personin, të iniciohet procedim penal për veprën e caktuar penale.

4.3.4. Aktet te papërdorshme.

Policia gjyqësore, si organ që kryen veprime procedurale, nganjëherë gjatë punës së vet ato aktivitete i kryen në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe, për këtë arsye, veprimet e tilla nuk mund të përdoren si veprime të ligjshme në nxjerrjen e një prove. KPP-ja këtë pavlefshmëri e përcakton sipas nenit 128, ndërsa sipas nenit 128 ka përcaktuar pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve që janë marrë në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Sipas përcaktimit që e bën paragrafi i dytë i këtij neni (128), një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm, nuk mund të bëhet i vlefshëm. Në zbatim të nenit 131 të KPP-së, pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasshme të cilat varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm, aq më tepër, bëhen të pavlefshme aktet e mëpasshme që varen nga një akt që konstatohet i pavlefshëm.

Në praktikën e gjykatave ndeshet pretendimi për pavlefshmëri të akteve procedurale të cilat janë marrë duke mos u respektuar rregullat procedurale. Për këtë motiv detyrohet të nënvizojmë qëndrimin se, aktet e pavlefshme janë ato të cilat ligji, shprehimisht i parashikon si të tilla. Me këtë kuptim, shkelja e rregullave do të sjellë pavlefshmëri, të

aktit, kur kjo pasojë është e parashikuar shprehimisht me ligj. Sipas nenit 129 të KPP-së përcaktohet se pavlefshmëritë e ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 128, mund të deklaronin në kërkesën e palëve. Në interpretim të kësaj dispozite, çdo pavlefshmëri që është parashikuar në kod, përveç asaj që është parashikuar në nenin 128 të KPP-së, është relative. Pra, organi që procedon nuk ka diskrecion të përcaktojë pasojën e pavlefshmërisë së një akti, pasi atë e ka zgjidhur vetë ligji. Ai vetëm do të verifikojë nëse ekzistojnë kushtet e ligjit për ekzistencën e tij. Në nenin 151/4 të KPP-së, parashihen kriteret e provës së papërdorshme. Sipas kësaj dispozite **“provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren”**. Kjo papërdorshmëri ngrihet edhe sipas detyrës zyrtare në çdo gjendje e shkallë të procedimit. Sipas përkufizimit të mësipërm, prova do të konsiderohet e papërdorshme, jo vetëm kur është shkelur ligji në marrjen e saj, por edhe kur kjo shkelje lidhet me një urdhërim ndalues të tij. Vetë papërdorshmëria si institut që përjashton përdorimin e provës nga procesi i të provuarit, ka për qëllim që të shmangë shkelje flagrante të ligjit, të konsideruara të rënda për liritë dhe të drejtat e individit. Liritë e marra në mbrojtje në këto raste janë më të rëndësishme për t’u respektuar, se sa të mirat që mund të rrjedhin për shoqërinë nga shkelja e tyre. Provat që konsiderohen të papërdorshme janë marrë me shkelje të dispozitave ndaluese të ligjit për pasojë ato nuk mund të rimerren edhe sikurse të ekzistojë mundësia.

Kështu, mund të ndodhë që oficerët e policisë gjyqësore të kenë kryer veprime procedurale në kundërshtim me kërkesa të ligjit, siç mund të jetë pyetje e një personi, e kryer me një iniciativë nga ana e policisë gjyqësore, duke e pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit bëhen hetime, ndërkohë që s’ka ndonjë atribuim të personit për veprën penale, ndonjë procesverbal kontrolli apo sekuestrimi të ndërmarrë në kundërshtim me kërkesat e ligjit procedural penal. Në të gjitha këto raste, edhe pse këto akte janë të pavlefshme në kuptimin

që janë të papërdorshme ato mund të shërbejnë sigurime njoftimi për organin e procedurës, ku rezulton se ka vepër penale konkrete.

4.4. Referimi i veprës penale të Prokurori

Veprimtaria e policisë gjyqësore është e normuar si veprimtari që shërben për sigurimin e të dhënave të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, si veprimtari që shënon, praktikisht, fillimin e procedimit penal dhe si veprimtari në shërbim të një vazhdimi të procedimit penal sa më efektiv. Kështu, referimi i veprës penale te prokurori përbën një akt kryesor të policisë gjyqësore, me anë të cilit ajo informon prokurorinë menjëherë për veprën penale të marrë në dijeni prej të tjerëve. Detyrimi i policisë gjyqësore, për të njoftuar prokurorinë menjëherë, lidhet me faktin se a është prokurori ai që bën drejtimin e hetimeve dhe kontrollin e tyre. Referimi i veprës penale te prokurori bëhet vetëm me anë të përpilimit me shkrim të informacionit. Ky informacion duhet të përmbajë:

- Ditën dhe orën në të cilën polica gjyqësore ka marrë dijeni për kryerjen e një vepre penale, elementet thelbësore të faktit kriminal;
- Elementet e tjera të grumbulluara deri në momentin e informimit;
- Burimet e provës dhe aktet e tjera të kryera prej saj me iniciativë;
- Gjeneralitetet, si dhe çdo të dhënë tjetër që shërben për të identifikuar personin të cilit i atribuohet vepra penale;
- Gjeneralitetet e të dëmtuarit nga vepra penale, si dhe të atyre personave që kanë dijeni për rrethanat e dobishme për qëllime të hetimit.

Referimit të veprës penale i bashkëngjiten aktet e kryera deri atëherë nga ana e policisë gjyqësore, provat materiale të sekuestruara. Ky referim i veprës penale duhet të bëhet pa vonesë. Kodi ynë nuk ka parashikuar ndonjë afat kohor, por, gjithmonë, koha e referimit

duhet të jetë sa më i afërt me kohën e kryerjes së veprimeve procedurale, të ngutshme nga ana e policisë gjyqësore. Në praktikën e përditshme referimi i veprës penale te prokurori bëhet, në më të shumtën e rasteve me vonesë, vonesë kjo që shkon në disa ditë, madje, në ndonjë rast, me javë të tëra, gjë për të cilën duhet të gjendet zgjidhje.

Referimi i veprës penale te prokurori, e cila kryhet nga pakujdesia, kryesisht përbën një shkelje disiplinore, përndryshe, nëse kryerja ka rezultuar me dashje dhe, si pasojë e saj u shkaktohet dëm i rëndësishëm interesave të shtetasve ose atyre shtetërore, oficeri i policisë gjyqësore rrezikon të ndiqet penalisht për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Nëse vonesa kryhet me dashje dhe e ka si qëllim favorizimin e fajtorit, personi përgjegjës mund të ndiqet penalisht për krimin e parashikuar nga neni 302/1 të KP-së, përkrahja e autorit të krimit. Nëse referimi i veprës penale është i mangët, me ç/rast mund të jenë janë fshehur aktet procedurale, atëherë personi përgjegjës rrezikon të ndiqet penalisht për veprën penale të kryerjes së veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Vlen të theksohet se, mbetet edhe shumë për të bërë për rritjen e efikasitetit të punës së policisë, e cila ndikon drejtpërdrejt edhe në eficiencën e organit procedues, duke i krijuar mundësinë dhe kohën e duhur të këtij organi për t/u marrë me çështjen e rëndësishme të krimit të organizuar dhe luftës kundër korrupsionit, të cilat mbeten prioritet në punën e këtij organi. Megjithatë, angazhimi konkret në drejtim të përmirësimit dhe efikasitetit të organeve gjyqësore, të policisë dhe prokurorisë, me qëllim rritjen e luftës ndaj krimit të organizuar dh korrupsionit, janë tema të rëndësishme, të cilat trajtohen gjatë zbatimit në praktikë të MSA-së⁶⁶

KAPITULLI V: LIGJSHMËRIA E FILLIMIT TË PROCEDIMIT PENAL, DALLIMI NGA FILLIMI I PALIGJSHËM I NDJEKJES

Ligjshmëria e fillimit të procedimit penal është një nga parimet kryesore që gjen një shërim në KPP të Kosovës dhe në atë shqiptar që aktualisht aplikohen. Duke u nisur nga parimi i

⁶⁶ A. Hoxha, *Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE-së*, botimi i vitit 2010

ligjshmërisë së ndjekjes penale, ligjet proceduralo-penale ua kanë besuar prokurorëve, si organ i mbrojtjes së ligjit penal, ekskluzivitetin e fillimit ose të mosfillimit të procedimit penal, në mënyrë që asnjë fajtor të mos i shmanget ndjekjes penale dhe asnjë i pafajshëm të mos i nënshtrohet procedimit penal pa baza të mjaftueshme juridike.

Në këtë kontekst, prokurori duhet të jetë shumë i aftë nga pikëpamja profesionale, ashtu që duhet të jetë aktiv, kërkues, eficient, lidhur me përmbajtjen e njoftimeve të veprave penale, pasi që vetëm atëherë mund të themi se e përmbush me dinjitet fisnikërinë e funksionit të tij. Është ky parim ai që shpreh karakterin thellësisht demokratik të së drejtës tonë procedurale-penale. Ligjshmëria e fillimit të procedimit penal lidhet, së pari, me ekzistencën apo dyshimin e arsyeshëm e që,(nënkuptohet ekzistenca e dy a më shumë provave se është kryer vepra penale) për ekzistencën e një fakti të kundërligjshëm,që konsiderohet si vepër penale. Ky është minimumi i nevojshëm që të jemi përpara një fillimi të ligjshëm të procedimit penal. Së dyti, duhet të jetë cenuar, dëmtuar apo të jetë rrezikuar një lloj i caktuar i marrëdhënieve shoqërore, të mbrojtura posaçërisht me ligj penal.

Pra, që të jemi përpara fillimit të ligjshëm të procedimit penal, kërkohet konkurrimi i dy kushteve të sipërcituara, e vetëm nëse të dhënat i atribuohen dhe një person konkret konkurren edhe një kusht i tretë, i cili ka të bëjë me cilësitë individuale të tij. Këtë përfundim e nxjerrim si rezultat të interpretimit literat të nenit 290 të KPP-së. Sa i përket fajësisë ose jo të personit konkret, ai nuk është kusht për regjistrimin e procedimit penal. Pra, dhe për fillimin e çështjes penale pasimi i një rrethane të tillë i përket hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes.

Ndërkaq, për të parandaluar çdo lloj arbitrariteti që mund të shfaqet në subjektivizmin e prokurorëve të ndryshëm, në dëm të drejtave dhe lirive të individëve,apo të formacioneve të tyre sociale, kodi penal shqiptar, ka parashikuar si **“krim”** fillimin e paligjshëm të

ndjekjes penale ndaj një personi që dihet së është i pafajshëm (Kodi Penali Republikës së Shqipërisë, neni. 313 KPSH-ës).

Detyrimi ligjor i prokurorit të shtetit në Kosovë, përkatësisht në Shqipëri, është që në momentin kur vihem në dijeni se është kryer një veprë penale, të ndërmarrë të gjitha veprimet që e autorizojnë atë sipas ligjit dhe, më pas, varësisht, nga faktet dhe provat që grumbullon, të vendosë ligjshmërinë rreth regjistrimit të veprës në regjistrin e veprave penale, në regjistrin përkatës.

Një moment delikat është edhe momentit i regjistrimit të emrit të tij në regjistrin e veprave penale, kur vepra i atribuohet atij si veprë penale. Me gjithë kujdesin e treguar në këtë drejtim, nga praktika nuk kanë munguar rastet kur në regjistrin e njoftimit të veprave penale është bërë regjistrimi i emrit të personit, të cilit i është atribuuar vepra penale dhe, nga ky hetim i mëtejshëm ka rezultuar se ai person fare nuk ka pasur lidhje me atë krim. Këto raste, në praktikën e përditshme, janë evidente, sepse organet, shpeshherë jo me qëllim, mendojnë se “x” apo “y” personi e ka kryer veprën penale të caktuar. Këto raste ndërlidhen me rastet e mashtrimeve e me qëllim të përfitimit për vete, apo për personin tjetër, paraqesin dokumente të rreme në emër të dikujt tjetër, përmes të cilave dokumente kanë mundur të tërheqin edhe pensionet e pleqërisë apo ato suplementare. Në lidhje me këto çështje, në praktikë ka pasur mendime dhe veprime të ndryshme, lidhur me kohën, si dhe me të dhënat që nevojiten për t’i atribuuar kryerjen e një veprë penale një personi konkret.

Për këtë arsye, prokurori i përgjithshëm, përmes udhëzimit të datës 21.11.2005, pika 3, thotë: **“në rastet kur materiali i referimit të veprës penale nga policia gjyqësore shoqërohet me aktet procedurale që përmbajnë atribuime për person konkret, prokuroi urdhëron si regjistrimin e njoftimit të veprës penale, ashtu edhe regjistrimin e emrit të personit”**. Arsyeja që është bërë një normim i tillë ka të bëjë me faktin se policia

gjyqësore ka administruar akte procedurale që përmbajnë atribuime për një person konkret, që do të thotë se ekziston një minimum i bazuar të dhënash që ta përligjë (ligjësojë) ushtrimin e ndjekjes penale në drejtim të një personi konkret.

Në këtë mënyrë, udhëzimi i mësipërm është tepër i nevojshëm në kushte të këtij vakuumi ligjor, të klimës jo shumë miqësore që ekziston në marrëdhëniet e personit në regjistër ka krijuar bazën e duhur për ta marrë atë në përgjegjësi penale.

5.1. Përse fillim e jo mosfillim i hetimeve

Ekzistenca e Institutit të mosfillimit të procedimit penal është e lidhur me faktin që autorizimi i shoqërisë për të ushtruar ndjekjen penale nga Prokuroria është i lidhur me ekzistencën, së pari të një verifikimi kontrollues të njoftimeve, atëherë, me marrjen në dijeni, më nuk ka dyshim të arsyeshëm se jemi para një vepre penale konkrete që është kryer apo është tentuar të kryhet. Nëse arrijmë të konstatojmë se, në sajë të veprimeve verifikuese, por jo edhe veprimeve hetimore, jemi përpara ndonjëres prej atyre rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal atëherë jemi obligatorë që të veprojmë në aplikimin e institutit për të mosfilluar procedimin penal, për shkak të mungesës së fakteve. Arsyeja përse nuk të jap autorizim shoqëria për të ndërmarrë fillimin e ndjekjes penale, apo të procedimit penal, është, pikërisht, fakti se kjo shoqëri, për mbrojtjen e interesave të saj, e ka autorizuar prokurorin publik- të shtetit që të vihet në lëvizje vetëm kur mendohet mbi bazë të të dhënave që disponon në materialin e kallëzimit se jemi para një veprimi, ngjarjeje reale, faktit të dënueshëm nga kjo shoqëri e të parashikuar nga ligji material penal.

Por, nëse për konstatimin e materialit kallëzues, Prokuroria apo policia gjyqësore ka kryer veprime hetimore–procedurale për sqarimin e rrethanave të pretenduara, të cilat në

momentin e kallëzimit janë të dyshimta, atëherë ti ke ushtruar autorizim, të cilin ta ka dhënë shoqëria për të ushtruar ndjekje penale. Pra, autorizimin vërtet ta jep shoqëria, nëpërmjet Kushtetutës dhe ligjit procedural-penal, por vet autorizimi është një proces i perceptimit subjektiv të prokurorisë. Themi se autorizimi për të filluar procedimin penal është perceptim subjektiv për të justifikuar faktin se ky autorizim edhe mund të perceptohet në mënyrë jo të drejtë, për arsye se nuk mund të flitet me saktësi nëse fakti i pretenduar është apo jo i vërtetë. Mirëpo, ndodh që ndonëse ke filluar procedimin penal dhe je duke ushtruar ndjekjen penale, gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, apo edhe në stadin për procedimin penal gjatë zhvillimit të gjykimit, të konstatohet se nuk ke pasur autorizim nga shoqëria për të filluar këtë ndjekje penale, pasi që fakti nuk ka ekzistuar, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale apo, thënë ndryshe, (rrethanat që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale apo dhënë ndryshe rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal). Për këto arsye, ky autorizim duhet të jetë përgjatë perceptimit subjektiv sa më afër të vërtetës, në kuptimin që veprimi, apo fakti i pretenduar të kenë dyshimin e arsyeshëm se ato janë të kundërligjshme dhe të sanksionuese – dënueshme, sipas legjislacionit penal kosovar dhe atij të shtetit shqiptarë RSH-së, sipas normave konkrete të përgjithshme dhe të veçanta.

Autorizimi për të filluar procedimin penal, apo ndjekjes penale jepet, së pari, për të sqaruar se veprimi apo mosveprimi janë të dënueshme penalisht dhe a janë të parapara me Kodin Penal si të ndëshkueshme dhe, pasojat e shkaktuara a gjenden të normuara në dispozitat ligjore në Kodet Penale të shteteve përkatëse, vërtetimi i të cilave kryesisht bëhet nëpërmjet veprimeve hetimore procedurale-penale. Më pas, nëse arrihet të vërtetohet se fakti është kriminal, atëherë kryhen veprime të tjera hetimore për të individualizuar personin apo personat që kanë kryer veprën penale. Prandaj është shprehja, kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte apo të vazhdonte, e cila të cakton këtë që thamë më lart se, ky autorizim jo

gjithmonë është i perceptuar saktë, për shkak se dalin apo zbulohen rrethana që tregojnë se ky autorizim nuk duhet të kishte filluar apo vazhduar.

Shkaqet që ndërpresin këtë autorizim e, për rrjedhojë edhe ndjekjen penale të filluar nga prokuroria, i referohen, qoftë faktit, qoftë edhe subjektit që i atribuohet kjo vepër penale, e paramenduar si e tillë. Kështu, për ta ilustruar sa u tha më lart, shërben kryerja e veprave penale pa autor. Të gjitha veprimet hetimore ndërmerren për të ardhur deri te zbulimi i fajtorit. Por, në ato raste kur nuk kemi arritur rezultate të ndriçimit, se, rasti ndaj personave të caktuar, vendoset pezullimi i hetimit, i cili pezullim është veprim procedural kur prokurori nuk ka kushte për t'i zhvilluar hetimet, apo për të mbledhur prova, për shkak se i pandehuri mund të jetë në arrati, me qëllim që t'i shmanget ardhjes, apo sepse vuan nga ndonjë sëmundje dhe, është në shërim, brenda apo jashtë vendit dhe për shkak të rrethanave të sëmundjes nuk është i denjë për t'u mbrojtur. Ky pezullim shfaqet përderisa janë të pranishme rrethanat pezulluese.

Mirëpo, nëse ndërkohë, më vonë, zbulohet autori, që tashmë është i vdekur, atëherë lind pyetja se çfarë ka ushtruar prokuroria deri atëherë me veprime procedurale për sqarimin e rrethanave të faktit? A nuk ka filluar një procedim penal, a nuk ka ushtruar ndjekje penale? Nisur nga sa u tha më lart, themi se, shteti, me anë të organeve të veta, ka autorizim të reagojë për të vërtetuar, si veprën penale ashtu edhe autorin e saj. Pra, ky autorizim shprehet nga Kushtetuta, me shprehjen konstitucionale, me ndjekje penale.

Kështu, ndodh që ka një vepër penale të dukshme, por vëren se personi, i cili, duket qartë se është autori i veprës penale, p.sh. të vrasjes, ka vdekur. Natyrisht, lind pyetja se a duhet kryer veprime procedurale, apo hetimore nga organet e prokurorisë dhe policisë gjyqësore, si këqyrja e vendit të ngjarjes, ekspertimit të armës së gjetur në vendin e ngjarjes, ekspertimit mjekoligjor të kufomës etj.? Pa dyshim, këto veprime procedurale që janë veprime hetimore, por jo gjë tjetër, veçse shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale, të cilat

kryhen mbi bazë të detyrimit kushtetues për të ushtruar ndjekje penale. Ndërkaq, këto veprime hetimore janë detyrë për të përmbushur funksionin themelor, atë të ushtrimit të ndjekjes penale, rreth ndriçimit dhe argumentimit që në të vërtetë s'janë gjë tjetër, veçse veprime procedurale, por jo në kuadrin e ushtrimit të kompetencës ligjore të bërjes së hetimeve, pra i kryen këto veprime kryesisht për të përmbushur funksionin themelor atë të ushtrimit të ndjekjes penale, duke përbërë dhe argumentimin që mbi bazë të kryerjes së vendimeve të tilla procedurale-hetimore, procedimi i filluar–ndjekja e filluar nuk mund të vazhdojë, për arsye se vërtet jemi para një veprë penale–fakti kriminal, por personi që e ka kryer, ka vdekur. Duke qenë në rrethana të këtilla, nuk ka kuptim që të vazhdohet procedimi, në faktin se procedura penale zhvillohet me qëllim që kryerësit e veprës penale t'i shqiptohet dënimi meritor, dhe pas ekzekutimit, ai të risocializohet ashtu që në të ardhmen, të mos kryejë vepër penale. Qëllimi primar është që personi i dënuar të kuptojë peshën e dënimit dhe, në të ardhmen të mos përsëritë veprime të tilla, dhe të bëhet i dobishëm për rrethin ku jeton dhe vepron. Mirëpo, në rastet e tilla, kur vdes personi, nuk arrihet asnjë qëllim, sepse vepra penale ndërlidhet me kryerësin e jo me persona të tjerë, që do të thotë se nuk ka kuptim që procedimi të vazhdojë. Ky arsyetim e ka burimin nga autorizimi apo detyrimi që i ka dhënë shoqëria shtetit për të reaguar ndaj një fakti kriminal, fakt i cili ka synuar një interes të mbrojtur nga ligji materialo-penal dhe në përmbushje të këtij detyrimi, prokuroria apo policia gjyqësore është e detyruar që t'i shpjegojë shoqërisë, duke kryer veprime hetimore të nevojshme, që unë e ushtrova autorizimin që më dhe, por që ky autorizim nuk mund të vazhdojë më, pikërisht se personi ka vdekur. Duke theksuar se, nëse prokuroria apo policia gjyqësore kryen veprime procedurale hetimore penale komfor rregullave procedurale penale, si në drejtim të faktit të supozuar kriminal, ashtu dhe në drejtim të personit, atëherë, detyrimisht, ka filluar një procedim penal. Kështu, është njëlloj si në veprat penale pa autor, kur shteti ka reaguar, ka kryer veprime hetimore përmes

prokurorisë e policisë gjyqësore, që do të thotë me fjalë të tjera që ka ushtruar veprimtari procedurale. Pra, do të thotë se ka proceduar rrjedhimisht, por kjo duhet të shoqërohet me veprimin e regjistrimit të procedimit penal në regjistrin e njoftimeve të veprës penale. Po fillove të veprash në rrugën e procedurës penale, me anë të veprimeve procedurale hetimore, duke respektuar kërkesat e ligjit, nuk mund të thuash se nuk ke filluar procedimin penal dhe, detyrimisht, duhet ta regjistrosësh si procedim penal. Por ky procedim i filluar nuk mund të vazhdojë nëse personi ka vdekur ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, duhet autorizim i procedimit etj., ndërsa pranohet sa më sipër, në praktikë nuk veprohet gjithnjë në këtë mënyrë, por ndodh, që ndonëse janë kryer veprime procedurale-hetimore dhe kryhen edhe veprime verifikuese të po kësaj natyre, nuk janë të pakta rastet kur vendoset mosfillimi i procedimit penal.

Trajtojmë rastesh nga praktika

Disa nga rastet praktike në Kosovë dhe në Shqipëri të trajtuara nga organet e autorizuar.

Analizim rastesh praktike të kallëzimeve nga Kosova dhe Shqipëria rreth procedimeve të fillimit apo të mos fillimit penal.

Rasti nr. 1. (sipas kallëzimit anonim)

Rasti me nr. (2014-DA-3183, i datës 5.12.2014), ka të bëjë me paraqitjen e kallëzimit penal në Prokurorinë Themelore të Pejës-Departamenti për Krime të Renda, kundërt të dyshuarit të v. penale, R. D. ga fshati Kosoriq, Komuna e Pejës, ndaj të cilit ka ekzistuar dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, e sanksionuar sipas nenit 275 të KPRK-së.

Ky rast është iniciuar nga personi anonim, me dt. 28.11.2014, nga njësi i hetimeve në Pejë, pasi është marrë informata, se në lokalit ku punon i dyshuari i këtij kallëzimi penal, ka mundësi të ketë armë zjarri, ashtuqë, rreth orës 18:30, me urdhër verbal të prokurorit kujdestar, Policia ka shkuar në bastisje në lokalit-shitoren R.D. dhe në shtëpinë e të

dyshuarit R. D. dhe pasi është bastisur lokali dhe shtëpia të dyja prona të dyshuarit, policia ka gjetur dhe ka konfiskuar: një pushkë 10-she, prodhim i panjohur, me numër serik 01112, dy karikatorë të armës ak, 47, municion kalibër 7.62mm, 563 copë, municion kalibër 7.9 mm, 2 copë, municion kalibër 9mm, 3 copë dhe municion kalibër, 7.62mm, 3 copë. Gjithsej 571 copë fishekë.

I dyshuari, me rastin e intervistimit ka deklaruar se armën dhe municionin e ka që nga koha e luftës dhe asnjëherë nuk e ka keqpërdorur, Ndaj tijë prokuroria ka zhvilluar hetimet, duke marrur, vendim mbi fillimin e hetimeve, nën shenjë (PP nr.403/14, dt. 8.12.2014), për vepër penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armës, nga (neni 374, paragraf 2 të KPK-së, 2012:118).

Pas zhvillimit të hetimit kjo prokurori ka gjetur se personi ne fjalë, me veprime të tij ka kryer vepër penale të përmendur dhe ndaj tijë pas përfundimit të hetimeve dhe grumbullimit të provave, është vërtetuar se i njëjti është kryerës i veprës penale, ka ngritur aktakuzë, nën shenjë e njëjtë të vendimit mbi fillimin e hetimeve **(aktakuza PPnr.403/14, datë 9.12.2014) për veprën penale armëmbajtje pa leje, nga neni 374, par. 2 të KPK-së dhe ndaj të përmendurit**, gjykates kompetente i ka kërkuar që pasi ta mbanë shqyrtimin gjyqësor verbalo publikë, të njëjtit ti shqipton dënimin e paraparë me ligj, si dhe shqiptimin e dënimit plotësues-konfiskimin e armës dhe municionit.

Gjykata Themelore në Pejë-DKR, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, të pandehurin e shpall fajtor, (me datën 26.5.2015, sipas aktgjykimit P.nr.312/15 që në shqyrtim fillestar). Personi ne fjalë që në sh.fillestar ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe ka shprehë pendimë, ku, gjykata e mori për bazë si rrethanë letësuse duke shqiptuar dënim me burgim me kohëzgjatje prej 2 viteve, me kusht prej 3 viteve, ashtuqë dënimi ndaj tijë nuk ka për t'u ekzekutuar fare, nëse i akuzuari, në afat prej tri vitesh nuk do të kryejë vepër penale.Ndaj të akuzuarit njëjtit nën numër të rastit (2015-DA-633), sipas informatave anonime, Policia ka

kërkuar nga Prokuroria që të lëshohet urdhëresë për bastisje prapë sërish të dyshuarit R.D. nga fshati Kosuriq, Komuna e Pejës, për shkak të dyshimit të arsyeshëm të kryerjes së veprës penale, mbajtje në pronësi, kontrolle, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374,paragraf 2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Pejë, nën shenjën REZ.,Nr. 112/2015, ka miratuar urdhëresë për bastisjen e shtëpisë së të dyshuarit R.D.,me datën 26.3.2015, të cilën urdhëresë policia e ka zbatuar, ashtuqë, me rastin e shkuarjes në bastisje, në datën 27.3.2015, ka filluar bastisjen rreth orës 19:25 e ka përfunduar në orën 20:05. Bastisja është realizuar në fshatin Kosoriq, në shtëpinë e personit R.D. nën dyshimin e bazuar të armëmbajtjes pa leje. Mirëpo, tek ky person, përgjatë kontrollit për armë, nën shkallë, të cilat shpiejnë në katin e dytë të shtëpisë, policia ka gjetur një qese plastmasti, të përzier me qese të tjera e të mbushura me çaj,mep.46.2gr.Policia, nën dyshim se është substancë narkotike e llojit marihuanë,e marrin, e fotografojnë dhe e konfiskojnë përmes njësitit të Forenzikës të Stacionit Policor në Pejë.

I dyshuari R. D. i intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës në polici, me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë, deklaroi se:**“Nuk jam në dijeni se nga ka ardhur ajo substancë që po dyshohet nga ana juaj se është e llojit marihuanë”**. Gjithashtu, deklarohet se: “Jemi familje e madhe dhe kemi shumë nipër e mbesa që vijnë nga jashtë dhe kanë pasur mundësi që ndokush nga ata ta ketë lënë”. I dyshuari mohon se është shitës apo përdorues i narkotikëve. Pas hapjes së rastit, në policinë e Pejes, nën shenjën PP II 1262/2015, është iniciuar procedura hetimore në Departamentin e Përgjithshëm për fillimin e procedimit penal-hetimeve nga prokurori, me dyshimin e arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprë penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga (neni 275 të KPRK-së). Pasi që rezultatet nga laboratorit i Forenzikës kanë rezultuar se substanca

narkotike, me peshë 46.2g është e llojit marihuanë dhe për këtë prokurori i çështjes, pas zhvillimit të hetimeve, nën shenjën PP II 1262/2015 ka ngritur aktakuzë dhe të njëjtin e ka përcjellë në Gjykatën Themelore në Pejë në Departamentin e Përgjithshëm Penal, i cili pritet të fillojë me mbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore.

Rastë i II –të, i radhës i paraqitjes se kallëzimit penal dhe epilogu vlerësues për të:-

Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, me numër rasti 2015-DA-0846, më datën 25.5.2015 i është adresuar prokurorisë, Departamentit për Krime të Rënda, me referim të kallëzimit penal kundër H. SH., nën dyshimin e arsyeshëm të mbajtjes në pronësi ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 të KPK-së.

Rastë i III praktikë natyra e k.p.(vetëkallëzim i vepres penale në Pejë).

I paraqituri, H. SH., në datën 19.4.2015, në Stacionin Policor të Vitomiricës edhe vetë paraqet rastin, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm. Më këtë rast i deklaron Policisë se, persona të panjohur, rreth orës 21:05 kishin hedhur në shtëpinë e tij një mjet shpërthyes, në sallonin ku ai kishte qenë duke qëndruar. Krahas kësaj policisë i deklaron se, përpos shpërthimit, ka pasur edhe të shtëna me armë. Në kohën kur kishte ndodhur shpërthimi ai kishte qenë në dhomë i vetëm, pa asnjë anëtarë të familjes, sepse pak më herët familjen e kishte dërguar te familja e gruas. Policia e HR-Pejë, kundër shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm i ishte përgjigjur thirrjes të nesërmen, më datë 20.4.2015, me ç'rast, fillimisht, e kishin takuar të dyshuarin, dhe kishin pasur dyshime në deklaratën e tij, sepse vendi i ngjarjes përshkruhej krejt ndryshe në raport me deklarin e tij. Ndërkohë, Policia kishte kërkuar ndihmë nga njësi për trajtimin e mjeteve eksplozuese, IEDD, i cili është përgjigjur ftesës së shkuarjes në vendin e ngjarjes dhe, në bazë të provave të gjetura në vendngjarje, kishin konstatuar se, në bazë të sasisë që është përdorur me rastin e gjuajtjes së mjetit shpërthyes ka qenë e pamundur që ankuesi të ketë qenë në dhomën ku kishte ndodhur incidenti. Kështu, pra, nga ankuesi prapë e marrin një deklaratë, i cili tani pohon,

se derisa ky kishte qenë duke luajtur me bombë, ajo ishte aktivizuar dhe të njëjtën e kishte lëshuar brenda sallonit, ndërsa ai kishte vrapuar, duke shkuar në katin e II të shtëpisë së tij. Raporti nga IEDD-ja, i datës 21.4.2015 përputhet në tërësi me deklaratën e ankuesit, i cili, më pas kalon në cilësinë e të dyshuarit për dy vepra penale. Për shkak të kallëzimit të rremë, nga nenin 390/1 të KPK-së dhe për shkak të veprës penale, mbajtje në pronësi, kontroll të paautorizuar të armëve, nga neni 374, paragraf 1.

Rasti u dërgua në Prokurori, në datën 25.5.2015, për veprën e parë, nga neni 390/1 në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë, ndërsa për veprën nga neni 374/1 kallëzimi penal nga ana e policisë është dërguar në DKR të Prokurorisë në Pejë. Për këtë të fundit Prokurori i çështjes ka zhvilluar hetimet dhe ka ngritur aktin akuzues, nën shenjë PP 138/2015, ndërsa Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë, prokurori i çështjes, për kallëzimin penal që ka të bëjë me v.p të **kallëzimit të rremë nga neni 390**, par. 1, i KPK-së, ka marrë vendim mbi procedimin hetimor dhe çështja është në procedim e sipër.

Nga këto dy rasteve praktike vërehet se, në rastin e parë kemi një referim-informacion anonim se nga të tjerët se tek i dyshuari R. D. kemi një informacion anonim se, personi me inicialet e përmendura është i dyshuar për armëmbajtje pa leje, gjë që ka rezultuar si informacion i saktë dhe që, në herën e dytë, i njëjti informacion për policinë dhe organet të tjera relevante, ka qenë i pasaktë, sa i përket veprës së armëmbajtjes pa leje. Mirëpo, me rastin e bastisjes për herën e dytë, ka rezultuar krejt një vepër tjetër dhe ajo vepra penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 të KPRK-së.

Nga sa u përshkrua, për rastin e parë, në luftimin e kriminalitetit rol të madh luajnë edhe qytetarët, në qoftë se u ndihmojnë organeve për paraqitjen e rasteve kur ndodhin veprat penale. Kjo formë e paraqitjes e ndihmon rënien e kriminalitetit dhe zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Në rastin e dytë, të kallëzimit të rremë, është një risocializim i mirë për personat, si në rastin konkret, që ta shpjerë vetën në zonën kriminale, pa pasur nevojë dhe se, vendosja, nga cilësia e tij prej të dëmtuarit në të dyshuar e, më pas, në të pandehur dhe, së fundi se gjykuari (i dënuar), konsideroj se është një mësim dhe vetëdërgjegjësim për të akuzuarin dhe të tjerët, të cilët dëgjojnë dhe kanë pasur synim ndonjë paraqitje të tillë të kallëzimeve të rreme, për ndonjë interes të caktuar, që do ta pengojnë vetveten në hapa të tillë.

Rasti I nga praktika -Tiranë

Nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut në Tiranë, është paraqitur referimi për veprën penale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë përmbajtje: në datën 23.2.2009, shtetasi K. L. ka bërë kallëzim në Komisariatit e Policisë nr. 2 në Tiranë, dhe ka kallëzuar se shtetasi Th. P., në datën 21.2.2009, rreth orës 19:00, i ka dalë përpara dhe është konfliktuar me të për motive banale, me ç'rast, rezultat i këtij konflikti, shtetasi TH. P. e ka qëlluar kallëzuesin me sende të forta, duke iu drejtuar me fjalët: **“kësaj here shpëtove, por herën tjetër do të të dërgoj në varr”**., do ta pres kokën, dhe menjëherë është larguar nga vendi i ngjarjes. Në lidhje me këtë, policia gjyqësore e ka pyetur vetë të dëmtuarin dhe familjarët e tjerë. Krahas kësaj është vendosur caktimi i ekspertit mjekoligjor, i cili edhe e ka dhënë ekspertimin më akt formal dhe me përmbajtje të natyrës së goditjeve. Në bazë të këtij raporti, **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor në Tiranë, ka dhënë vendim mosfillim të procedimit penal, duke u arsyetuar kështu: “nga akti i ekspertimit mjekoligjor, të datës 28.2.2009, me nr. 91, ka rezultuar se në trupin e të dëmtuarit, K. L. vihen re dëmtime në kokë, në regjionin parietal, të majtë, si dhe në gishtin e majtë të dorës së majtë.** Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë. Vërehet se kanë sjellë humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën deri në 9 (nëntë) ditë. Në bazë të këtij përshkrimi gjejmë se jemi përpara veprës penale të “dëmtime të tjera me dashje, e parashikuar nga neni 90, pika 2, i KP-së, bazuar në nenin 59/1 të KPP-së. Kjo vepër ndiqet

mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues, drejtpërsëdrejti në gjykatë”. Në këtë rast rezulton se ka filluar hetimi, janë ndërmarrë veprime procedurale deklaruese, është caktuar eksperti mjeko ligjor dhe pastaj nga të gjitha rastet e tjera të praktikës, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Rasti, si i tillë duhej të regjistrohej si procedim penal e të transferohej për kompetenca lëndore, pasi që vepra ndiqet drejtpërsëdrejti në gjykatë, gjithmonë nëse nuk do të kishte vend që të fillonte procedimi për një vepër penale tjetër.

Pokështu, rastin e ankimit të të dëmtuarit, kur procedimi penal fillon vetëm mbi bazën e ankimit të tij, i cili mundë të jetë shprehur me gojë apo me shkrim. Mirëpo, ndodh që prokuroria apo policia gjyqësore, personalisht, të vijë në dijeni, kryesisht për një vepër penale dhe, ata vetë, ndërmarrin kryerjen e veprimeve procedurale hetimore. Mirëpo më pas, kuptojnë se janë përpara veprave penale ndaj të cilave nuk mund të fillohet procedimi pa ankimin e të dëmtuarit.

Por, mund të jemi edhe para rastit kur ke proceduar kryesisht dhe, gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake, të vish në përfundimin se cilësimi ligjor i veprës penale të jetë nga ata, për të cilët duhet ankimi i të dëmtuarit për të filluar procedimin.

Kështu, si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, jemi përpara një perceptimi subjektiv, të gabuar nga ana e prokurorisë, pasi që ajo ka kryer veprime procedurale hetimore, ka proceduar pa pasur autorizimin nga i dëmtuari. Pra, që ka qenë perceptimi i gabuar për veprën e kallëzuar, që ka bërë të mundur edhe fillimin e procedimit penal.

Prandaj edhe në këto raste themi se nëse nuk e jap autorizimin i dëmtuari, ndërkohë që prokuroria ka kryer veprime procedurale, detyrimisht duhet të regjistrohet si procedim penal dhe më pas të vendoset pushimi i tij, shkak se mungon ankimi i të dëmtuarit apo transferimi i tij për kompetencë lëndore.

5.2. Fillimi i procedimit penal në varësi të vendit të ngjarjes

Për përcaktimin e fillimit të procedimit penal, për disa lloj veprash penale rol dominant ka edhe vendi i kryerjes së veprimeve procedurale. Këtë e themi për faktin se vendi i ngjarjes e ndërlidh organin procedues në autorizime dhe kompetenca për zhvillimin e procedurës penale hetimore aty ku është kryer krimi-vepra. Kjo do të thotë se organi, prokuroria dhe policia gjyqësore, varësisht nga vendi i ngjarjes, shtrijnë juridiksionin në territorin ku edhe ushtrojnë funksionin e tyre.

Këtu është fjala se, për veprat penale me vendngjarje, veprimet e para procedurale kryhen pikërisht përnjës natyra e tyre, në vendin e ngjarjes dhe, si të tilla mund të përmendim këqyrjet, pyetjet e personave të pranishëm në vendin e ngjarjes, (neni 297 i KP-së,) kontrollet e personit, të vendeve, të lokaleve të bëra nga policia gjyqësore në rastet e nevojës dhe urgjencës, (neni 298 i KPP-së,) **“gjithmonë kur ato miratohen nga prokurori”**. Kur është e nevojshme marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore apo kulturore, caktojnë në cilësinë e ekspertit, specialist të fushave përkatëse, (nenet 278; 279 etj).

Është pikërisht ky moment i kryerjes së njërit prej këtyre veprimeve procedurale komform dispozitave të KPP-së që përcakton, detyrimisht, fillimin e procedimit penal. Ndërkaq, KPP-ja ka përcaktuar që, si fillim i afatit të hetimeve të merret vetëm në ato raste kur kemi personin konkret të dyshuar. Mirëpo problemi është i komplikuar, për arsye se e ku procedimin penal edhe për ato vepra penale pa autor, kur thotë se vendoset pezullimi i hetimeve për këto lloj veprash penale, sipas nenit 323 të KPP-së.

Për të shmangur praktikën e gabuar të prokurorive dhe për të normuar regjistrin e procedimeve penale, prokurori i përgjithshëm ka nxjerrë udhëzim, nr. 241, të datës 21.11.2005, **“Për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale”**. Sipas këtij normimi është përcaktuar me të drejtë se kemi

një procedim penal, i cili përbëhet, së pari, nga procedimi në lidhje me rrethanat e faktit që domosdoshmërisht do të operosh me kryerje veprimesh hetimore dhe, nëse ky procedim penal, në lidhje me përcaktimin e faktit, është kriminal, atëherë vazhdohet më tej me procedimin në lidhje me një person konkret, gjithmonë duke kryer veprime hetimore të nevojshme, të lidhura me ushtrimin e ndjekjes penale. Në momentin e ardhjes në dijeni për një ngjarje që perceptohet dhe vlerësohet se mund të jetë kriminale, si p.sh., kur jemi para një vënie të zjarrit. Vetëm kjo e dhënë është e mjaftueshme për fillimin e çështjes penale dhe për përcaktimin e veprimeve të para hetimore, ose të masave të shpejta që duhen marrë. Verifikimi i këtyre të dhënave është i pamundur të bëhet jashtë procedurës penale, pasi që, për të arritur në zbulimin e së vërtetës nëse jemi para një veprë penale apo para shkaqeve të tjera, duhet, patjetër të hetosh. Pra, do të thotë se, patjetër duhet të procedosh me anë të këqyrjes së vendit të ngjarjes, eksperimenteve etj. Kështu, në zjarret që perceptohen se mund të jenë me natyrë kriminale, hapi i parë hetimor ndërlidhet me vend shikimin, me pyetjen e personave që e kanë parë gjendjen, me pyetjen e të dëmtuarve, të personave që kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarrit, ekspertimit teknik etj. Pra, mbi bazë të këqyrjes së vendit të ngjarjes e veprimeve të tjera hetimore ke filluar një procedim penal, ke filluar një procedim penal rreth një fakti, ke filluar një çështje penale. Prandaj, për këto raste duhet të vendoset pushimi i procedimit të filluar kur jemi para rrethanave që nuk lejojnë procedimin penal ndaj personit, por, gjithmonë, duhet regjistruar si procedim i filluar. Një tjetër lloj i veprave penale, që përcaktojnë fillimin e procedimit penal në vendngjarje, janë krimet e vrasjeve. Mënyra që provokojnë fillimin e çështjeve penale në vrasje janë: kallëzimi mbi zbulimin e kufomës, njoftimet e personave të afërm-familjarë, njoftimet mbi shpalljen e personave si të pagjetur, të humbur etj. Themë që provokojnë, për arsye se ekzistenca e një trupi të vdekur nuk paraqet dhe as që shërben si, apriori, e domosdoshme, si fillim i çështjes penale. Pra, i hetimit pa u bërë një verifikim paraprak. Verifikimi është i

domosdoshëm në ato raste kur kallëzimi i paraqitur bën fjalë për shpalljen e një personi si të pagjetur. Theksoj se faza e verifikimeve do të jetë e tillë që merr të dhëna, por pa kryer veprime hetimore të parashikuara nga KPP-ja. Si të tilla, mund të përmendim, marrjen e të dhënave nga mjeku i familjes që ka përcjellë ecurinë e sëmundjes, marrja e të dhënave nga kartela mjekësore e tij etj. Kështu, në rastet kur zbulohet kufoma, organi procedues bën verifikimin, duke qenë i pranishëm edhe mjeku ligjor, apo një mjek tjetër. Në rastet kur nuk është e mundur të sigurohet një mjek ligjor, duke marrë mendimin e tij, nëse ekziston dyshimi se vdekja është e dhunshme, por mendimi që jepet nuk përkon me cilësinë e ekspertit mjekoligjor.

Çështja penale fillon atëherë kur ka të dhëna se vdekja është shkaktuar me dhunë dhe se për këtë vdekje shkak është një veprim i njeriut e jo faktori natyror.

Në rast dyshimi për këtë të fundit, organi procedues detyrimisht duhet të fillojë procedimin penal, duke kryer veprime hetimore për zbulimin e së vërtetës. Kur viktimja gjendet e varur ose e vdekur në rrethana të dyshimta, çështja penale fillon në çdo rast, pasi që vetëm procedimi, duke kryer veprime hetimore, mund të vërtetojë se kemi vrasje apo vetëvrasje.

Dhe, poqese janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes e më pastaj është vendosur për mosfillim procedimi penal, është jo korrekt, sepse tashmë ka filluar procedimi penal, duke kryer veprime hetimore mbi bazë të dyshimit të arsyeshëm se jemi para kryerjes së një vepre penale.

Në këto raste, rrjedhimisht, nuk mund të procedosh me mosfillim procedimi penal, por me regjistrim të procedimit, penal dhe pastaj me pushim të procedimit për ato shkaqe që parashikon ligji.

Me gjithë këtë, në praktikën e përditshme, shpeshherë veprohet, pikërisht, në të kundërtën. Pra, procedohet me mosfillim.

5.3. Prokurori si subjekt garantues i ligjëshmërisë së fillimit të procedimit penal

Në kuadër të parimit të ligjshmërisë që mishëron në tërësi ligjin proceduralo-penal e në veçanti institutin e fillimit ose mosfillimit të procedimit penal, si subjekt themelor dhe tejet i rëndësishëm është veprimtaria ndërmarrëse e personit të autorizuar – prokurorit të shtetit, i cili ka rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave të ligjshme publike, shtetërore dhe private. Nga vetë autoriteti që ia garanton ligji mbi procedurën penale, prokurori i shtetit është sovran më i rëndësishëm që ndërlidhet me ushtrimin e ndjekjes penale, ushtrim ky i garantuar në sajë të dispozitave ligjore të KPP-së. Për vetë rëndësinë që paraqet ushtrimi i ndjekjes penale, ka fuqizuar, konstitucionalisht dhe ligjërisht, rolin dhe kontrollin e prokurorit, me qëllim që ata të jenë të fortë, të pathyeshëm, parimorë e gjithmonë të papajtueshëm në luftën kundër kriminalitetit.

Kjo do të thotë se Kushtetuta dhe ligji e obligojnë prokurorinë të kontrollojë zbatimin korrekt e të njëjlojtë të ligjeve në të gjithë veprimtarinë procedurale penale, e, sigurisht edhe në aspektin e ushtrimit ose jo të ndjekjes penale, nëpërmjet akteve të fillimit ose të mosfillimit të procedimeve penale. Kështu, Kodi i Procedurës Penale, në mënyrë indirekte, si dhe udhëzimi nr. 241, i datës 21.11.2005, i prokurorit të përgjithshëm, i ka dhënë prokurorit mjete të nevojshme ligjore për verifikimin, kontrollimin, sqarimin e fakteve që, nga burimet e njoftimit pretendohet të jenë kriminale, në mënyrë që ai të jetë sa më komod në pozicionin e tij kushtetues – ligjor, për sigurimin dhe garantimin e ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale, në formën e fillimit ose mosfillimit të procedimit penal.

Nga sa u tha më lart, rezulton se prokurori posedon të gjitha mjetet e nevojshme për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e punës së organeve të policisë gjyqësore, që do të thotë se ushtron një kontroll mbi ta. Në vijim duhet thekuar se prokurori është ai, i cili vendos me konsekuencë mbi qëndrimet që do të mbajnë ndaj veprimtarisë procedurale hetimore të

strukturave të policisë gjyqësore, para regjistrimit të procedimit, pasi që një qëndrim i drejtë është përcaktuar në drejtim të përmbushjes së rolit të prokurorit, si subjekt garantues i ligjshmërisë së fillimit të procedimit penal.

Pra, prokurori, si subjekt garantues i ligjshmërisë së fillimit të procedimit penal, vërehet mjaft qartë në të drejtën që ai ka për të bërë brenda afatit dhjetë ditor, afat ky joligjor, por i normuar në urdhrin përkatës, që, për mendimin tim, për vetë infrastrukturën e njoftimeve është tërësisht i parëndësishëm, apo i papërshtatshëm. Të gjitha veprimet e mundshme ligjore, të karakterit verifikues, sqarues, administrativ, apo, më saktë të themi, të karakterit ekstra procedural. Në këtë mënyrë nuk do të kemi veprime që përbëjnë cenim të drejtave të shtetasve, në drejtim të respektimit të ligjshmërisë së fillimit të procedimit penal.

Duke qenë konsekuent në moscenimin e interesave të ligjshme të shtetasve, prokurori duhet të jetë i qartë dhe i saktë që në momentin kur urdhëron regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Është pikërisht ky moment delikat në kuptimin që, një vlerësim jo i drejtë, një mungesë e plotë përkushtimi, në drejtim të verifikimi të sqarimit të plotë të rrethanave të çështjes që u ndan mbrojtjen e atyre të drejtave me dhunimin e tyre të drejtave në rast të fillimeve të procedimeve penale të gabuara. Prandaj, është e pafalshme që prokurori, si roje, si respektues i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, të shndërrohet në dhunues të tyre.

5.4. Sjellja e urdhërit për regjistrimin e procedimit penal

Urdhëri për regjistrimin e procedimit penal përbën një nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së prokurorit, pasi që lidhet drejtpërsëdrejti me parimin e ligjshmërisë të së drejtës tonë procedurale, nga njëra anë, dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve, nga ana tjetër. Për këtë arsye, prokurorët duhet të gëzojnë aftësi profesionale,

pasi që momenti i vendimmarrjes për fillimin e procedimit penal është vendimtar. Ky ndihmon në kapërcimin e pengesave burokratike, shpejton hetimin, është më koherent dhe ndikon më mirë në edukimin e shtetasve dhe në parandalimin e veprave penale. individëve dhe shoqërisë - në edukimin e shtetasve në drejtimin parandalues të kryerjes së veprave penale. Për ndryshim nga kodi i mëparshëm i procedurës penale, në kodin aktual nuk gjejmë të pasqyruar termin ‘plan hetimi’ lidhur me domosdoshmërinë e kryerjes së disa veprimeve, në mënyrë që ato të justifikojnë qëllimin dhe rëndësinë e madhe sociale e juridike që ajo mbart. Në këtë kontekst, vlen të përmendim udhëzimin e prokurorit të përgjithshëm, nr. 241, të datës 21.11.2005, i cili përcakton një vijë orientuese mbi veprimtarinë e prokurorit, që nga marrja dijeni për veprën penale e deri në vendimmarrjen për fillimin e procedimit penal.

Siç kemi thënë edhe më sipër, vendimi mbi fillimin e procedurës penale është në kompetencë të prokurorit, i cili e kryen këtë veprim nëpërmjet një akti procedural-administrativ të veçantë dhe të arsyetuar që, në bazë të udhëzimit të prokurorit të përgjithshëm, quhet “urdhër për regjistrimin e procedimit penal”.

Nga vetë përmbajtja e tij del se ky urdhër merret vetëm nga prokurori, ku çmon se ekziston një veprë penale konkrete, e parashikuar nga ligji penal, mbi bazë të dhënave që disponon, i cili legjitimon tërësinë e atyre veprimeve procedurale, të kryera nga policia gjyqësore deri në atë kohë, gjithmonë për atë veprimtari procedurale hetimore, të kryer komform dispozitave të KPP-së, si dhe i jep të drejtë prokurorit, që nga ai moment, të kryejë të gjitha veprimet e plota hetimore.

Në arritjen e këtij perceptimi që legjitimon edhe veprimet e kryera para regjistrimit të procedimit është pika 3 e udhëzimit 241, e datës 21.11.2005, e cila nuk të lë vend për diskutim kur thotë: “Në raste kur materiali i referimit të veprës penale nga policia gjyqësore shoqërohet me akte procedurale që përmbajnë atribuim për person konkret,

prokurori urdhëron si regjistrimin e njoftimit të veprës penale, ashtu edhe regjistrimin e personit”. Ky akt procedural-administrativ, si një akt që sanksionon një moment me rëndësi të madhe juridike, është një akt kryesor që përbëhet nga tri pjesë:

- pjesa hyrëse;
- pjesa përshkruese; dhe
- pjesa urdhëruese.

Pjesa hyrëse: Në pjesën hyrëse shënohet vendi, koha, emri dhe mbiemri i prokurorit, si dhe numri i protokollit të kallëzimit apo i referimit të veprës penale.

Pjesa përshkruese: Këtu shënohet fabula e kallëzuar ose e referuar nga polica hetimore në Kosovë dhe ajo gjyqësore, në Shqipëri, si vepër penale, elementet thelbësore të faktit, si dhe përcaktueshmëria në dispozitë të KP-së që kualifikojnë faktin si vepër penale, tregohen shkaqet që justifikojnë marrjen e këtij urdhri. Si të tilla janë verifikimi i grumbullimit të të dhënave të nevojshme, si për faktin, ashtu edhe për personin. **Pjesa urdhëruese:** Në pjesën urdhëruese shënohet cilësimi juridik i veprës penale, si dhe përcaktohet emri i prokurorit dhe i oficerit policor gjyqësor, të ngarkuar me hetimin e çështjes. Në fund të urdhrit nënshkruhet nga prokurori që e ka marrë atë.

Kualifikimi juridik: Me këtë, çdo vepër penale në vete, ka elementet e posaçme. Para se të regjistrohet si veprës penale në regjistrimin e procedimit penal, duhet paraprakisht, t’i jepet cilësimi juridik fillestar, pasi që, kryesisht, bazohet në të dhëna jo të plota. Sepse të dhënat e plota mund të sigurohen vetëm gjatë hetimit të plotë, përgjatë procedimit penal. Me gjithë rregullimin që është përpjekur të bëjë ky akt, ai nuk është i plotë. E themi këtë pasi që nga praktika ka rezultuar se, gjatë hetimeve paraprake, fakti për të cilin është bërë regjistrimi i procedimit penal, rezulton ndryshe. Në këto raste nuk normon se si duhet vepruar. Mendoj se edhe në këto raste prokurori duhet të veprojë me urdhër, duke urdhëruar ndryshime të nevojshme në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në lidhje me

ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës për të cilën është bërë regjistrimi i procedimit penal. Për mendimin tim, ky urdhër lë për të diskutuar, por, meqenëse një trajtim i tillë del jashtë kuadrit të kësaj teme, jam i mendimit se nuk ka nevojë për zgjatje të mëtejme rreth saj.

KAPITULLI VI: VENDIMI PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL, KUPTIMI DHE RËNDËSIA E TIJ

KPP-ja, përmes nenit 291, përcakton se kur ekzistojnë rrethana që nuk e arsyetojnë –lejojnë fillimin e procedimit penal. Prokurori duhet të japë vendime të arsyetuara për mosfillimin e procedimit. Sipas nenit 59, prokurori dhe gjyqtari, kur çmojnë se në materialin e njoftimit nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se vepra ka ndodhur, në realitet, ose, megjithëse ka ndodhur ajo nuk përmban elemente të veprës penale, ekzistojnë rrethana të tjera të parashikuara me ligj që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, vendos për mosfillimin e procedimit.

6.1. Nocioni i kuptimit të mosfillimit penal

Me mosfillim procedimi penal do të kuptojmë pamundësinë ligjore të shtetit që nëpërmjet organeve të veta, policisë dhe prokurorisë, të kryejë veprimtari procedurale hetimore për një çështje të caktuar.

Përkufizimi i mësipërm është i lidhur drejtpërsëdrejti me vetë rëndësinë e madhe sociale dhe juridike që paraqet instituti i fillimit ose mosfillimit të procedimit penal. Themi se vendimi i mosfillimit të procedimit në mënyrë të kundërligjshme është me pasoja sociale – juridike, si për shoqërinë, në tërësi, ashtu edhe për shtetasin, pasi që mosfillimi i procedimit në baza joligjore ndikon negativisht në interesin që ka shoqëria për luftën ndaj

kriminalitetit. Si pasojë e kësaj nuk vënë në vend të drejtat, apo interesat e ligjshme të personat fizikë ose juridikë, që janë cenuar ose dëmtuar nga vepra penale.

Në këtë vështrim vlen të theksohet se prokurori duhet të jetë sa më objektiv e real, i paanshëm, jo subjektiv dhe, në çdo moment, të mos ndikohet nga kushdo qoftë, nga autorët e brendshëm, ku punon, apo nga faktorët e jashtëm. Vetëm në këtë mënyrë, kur u shmangët ndikimeve nga jashtë dhe nga brenda, në fazë të procedurës paraprake, ka arritur qëllimin e synuar. Nëse prokurori ka subjektivitet, atëherë mund të vijë edhe deri tek ajo që mos ta kryejë detyrën si duhet dhe të parandalojë mosfillimin e procedimit kur është e nevojshme dhe ka prova të fillohet, apo, e kundërta. Praktika ka dëshmuar se moskuptimi i drejtë i rëndësisë që paraqet mosfillimin është bërë shkak për marrjen e vendimeve në mënyrë të kundërligjshme.

Megjithatë, për të parandaluar mosfillimet e procedimeve në mënyrë të kundërligjshme, ligji i PP-së ka përcaktuar se, ky vendim, jo vetëm duhet të jetë i arsyetuar, por ka përcaktuar detyrimin e organit procedues për t'ua njoftuar menjëherë vendimin atyre që kanë bërë kallëzimin ose ankimin, të cilët mund ta kundërshtojnë atë brenda tetë ditësh, sipas nenit 62 të KPPK-së, të vitit 2004, kod ky i aplikueshëm deri më 1 janar të vitit 2013. Me këtë kod që aplikohet instituti i të dëmtuarit –paditësit privat për të ndërmarrë ndjekjen në duart e veta ,pasiqë paditësi i autorizuar nuk e sheh të nevojshme, gjatë ushtrimit të kompetencave që i ka. Për dallim nga ky reflekton KPPSH-ja, i cili këtë institut e ka ende në aplikim, me të drejtë ankimi në afat prej pesë ditësh nga njoftimi i vendimit, afat ky që, për mendimin tim, lë shumë për të dëshiruar.

Ndërkaq, në nenin 291/2 nuk përcaktohet mënyra e njoftimit, por, duke u nisur nga parimet themelore të së drejtës penale, si dhe duke iu referuar praktikës së deritanishme, mendoj se, për çdo rast, t'i jepet një pasiçë vetëm në këtë mënyrë plotësohen më së miri kushtet që subjektet e interesuara të sigurohen e të garantohen për ligjshmërinë e saj. Në eventualitetin

e asaj që subjektet kanë bërë kallëzim ose ankim nuk janë të bindur për ligjshmërinë e këtij vendimi, atëherë atyre u lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës që të kërkojnë shfuqizimin e vendimit të mosfillimit dhe detyrimin e organit procedues për të nisur atë. Nga praktika ka lindur mendimi se me një vendim të tillë duhet të njihet edhe personi ndaj të cilit është bërë kallëzimi, megjithëse është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Një qëndrim të tillë ka ndjekur edhe praktika e sotme gjyqësore, sa i përket njoftimit. Me datë njoftimi gjithmonë do të kuptojmë atë datë ku i interesuari, definitivisht, ka marrë në dijeni për vendimin e mosfillimit të procedimit. Jo në pak raste e, sidomos në ato raste që materiali kallëzues ka ardhur nga policia gjyqësore e shtetit.

Ky vendim u njoftohet edhe këtyre organeve. Një vendim i tillë, mua, personalisht, jo vetëm që nuk më duket i drejtë, por e shoh si shprehje të presionit apo të mosbesimit që ekziston midis këtij organi, – policisë dhe atij procedues, – prokurorisë. Këtë mendim e shpreh pasi që neni 291 i KPP-së, pag. 2 përcakton se cila janë subjektet, të cilat duhet të vihen në dijeni dhe që kanë të drejtë ankimi ndaj tij (atyre që kanë bërë kallëzimin).

Një problem me rëndësi praktike, mendoj unë është fakti se çfarë do të bëhet me ato raste ku është vendosur mosfillimi, në mënyrë të kundërligjshme, ndaj një personi konkret, të cilin gjykata më pas ka shfuqizuar. Si do veprohet në këtë rast, nëse organi procedues konstaton se është parashtruar ndjekja penale?

Si do të veprohet kur është vendosur pushimi i procedurës ndaj një subjekti konkret, të cilit nuk i është paraqitur as akuza në gjykatë, më pas, detyron rifillimin e procedimit, por që, tashmë, nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në momentin kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë kanë kaluar afatet e parashkrimit?

I shtruar këto çështje me qëllimin e vetëm që të tregojmë se sa i rëndësishëm është mosfillimi i procedimit, pasi që një vendim i mosfillimit i pa bazë do të përbënte arsye ligjore që subjekti penal të përfitojë nga hapësirat e tjera ligjore, siç janë edhe afatet e

parashikimit të ndjekjes penale. Për një kategori veprash të rënda, apo shumë të rënda, si ato kundër jetës së personit, apo të kryera nga persona në detyrë, ose për shkak të saj, këto afate duhet të jenë më të gjata dhe të parashikojnë mos parashkrimin edhe të këtyre veprave, siç veprohet jo në pak shtete të botës demokratike. Situata e pas vitit 1997 dhe ajo aktuale, mendoj se e dikton një nevojë të tillë.

Nga arsyet e përmendura më lart del rëndësia e mosfillimit të procedimit penal, pasi që çdo zgjerim pa baza e kushte, apo jashtë kushteve dhe kriterëve ligjore, përbën arbitraritet. Në të kundërtën, një kufizim pa baza e kushte për të vepruar, çon në liberalizim dhe dobësim të luftës ndaj kriminalitetit. Kështuqë, mosfillimi i procedimit duhet të jetë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, rregull ky i diktuar edhe nga vetë sistemi ynë detyrues i procedimit penal.

6.2. Pjesët e vendimit të mosfillimit penal të hetimeve

Sikurse ç'do vendim që i ka pjesët e veta, ashtu edhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal ka pjesët e veta dhe ato:

- Në pjesën e parë, atë pjesën hyrëse, ku shënohet vendi, koha, emri dhe mbiemri i prokurorit, si dhe nr. i prot. të kallëzimit apo referimit të veprës penale.
- Pjesa përshkuese, në të cilën shënohet fabula e kallëzuar ose e referuar nga policia gjyqësore, si vepër penale, elementet thelbësore të faktit, shkaqet që justifikojnë marrjen e këtij urdhri dhe, si të tilla, janë analizat juridike të pretenduara, nga të cilat rezulton se nuk mund të vendoset fillimi i procedimit penal, duke iu referuar edhe dispozitës konkrete. E rëndësishme për t'u evidentuar në këtë pjesë është analiza e fakteve, në mënyrë të tillë që të përjashtojë ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi në kallëzim.

- Pjesa urdhërues - diapozitivi, në të cilën shënohet mosfillimi i procedimit penal, duke iu referuar rastit të parashikuar me ligj, si dhe e drejta e ankimit, duke përcaktuar afatin prej 5 ditësh nga marrja në dijeni, emrin, mbiemrin e prokurorit dhe nënshkrimin e tij.

6.3. Autorizimi për procedim

Autorizimi për procedim tregon aktin me të cilin autoritetet kompetente përkatëse (që ndryshon në varësi të rasteve; Gjykata Kushtetuese, Kuvendi, Ministria e Drejtësisë) lejojnë ushtrimin e ndjekjes penale, e cila asaj i vihet nga dispozitat ligjore të veçanta. Një gjë e tillë vihet për cilësinë e subjektit aktiv për shkak të funksionit që ushtron, p.sh., është parlamentar etj.

Nga momenti i regjistrimit të rastit të kallëzimit penal në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, i cili regjistrim urdhërohet nga ana e Prokurorit, lirisht mund të themi se ka filluar nisja e procedimit penal nga ana e organit procedues. Detyra e organit procedurës, pas këtij regjistrimi, është që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të zbulimit të autorit të veprës penale. Mirëpo, në rastet e parashikuara me ligj, organi i Prokurorisë nuk mund të fillojë këtë proces pa marrë leje paraprake në formën e autorizimit për procedim nënë kushtet siq e përcakton neni 289 par.2 i Kodit të Pr. Penale i Shqipërisë, vitë 1995. Ekzistenca e autorizimit për të proceduar është e lidhur ngushtë me vetë qenien e një shteti ligjor e të së drejtës, i cili ka për qëllim që të garantojë veprimtarinë ligjore të disa funksioneve shtetërore apo publikë. Me qëllim garantimin e kësaj veprimtarie shtetërore, për funksionarët e këtyre veprimtarive është parashikuar që ata kanë imunitet nga ndjekja penale.

Imuniteti si institut lindi si domosdoshmëri për mbrojtjen e parlamentarëve dhe parlamentarizmit nga pushteti arbitrar i mbretit, i cili kishte nënë varësinë e tij edhe pushtetin gjyqësor. Ky institut për herë të parë u sanksionua nga parlamenti anglez, në

aktin e të drejtave (Bill of Rights), të vitit 1689. Me vonë ky akt i parlamentit anglez zgjoi interesim të madh edhe në shumë shtete të tjera, të cilat në kushtetutat e tyre e aplikuan imunitetin parlamentar. Madje sot, këtë institut të së drejtës kushtetuese e gjejmë në shumë kushtetuta edhe pse realiteti që diktoi lindjen e këtij instituti nuk ekziston më.

Imuniteti në vetvete përfshin pa përgjegjshmërin penale, si dhe paprekshmërinë nga ndjekja penale. Përgjegjshmëria penale është e sanksionuar nënenin 73/1⁶⁷ të Kushtetutës, duke shprehur se: **“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimin e shprehur në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes”** (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë).

Një të drejtë të tillë Kushtetuta ua ka njohur vetëm deputeteve edhe Presidentit të Republikës. Ndërsa, në lidhje me veprat penale që mund t'i kryejnë gjatë kohës kur janë deputetë, ata mbajnë përgjegjësi penale dhe gëzojnë imunitet procedural. Me një mbrojtje të tillë. Kushtetuta ka veshur gjyqtarë të të gjitha niveleve, anëtarët e Këshillit të Ministrave, Avokatin e Popullit dhe Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kjo e drejtë e tyre vlen për të gjitha veprat penale, pavarësisht se mund të jenë kryer para se të merrnin funksionin, apo gjatë kohës kur janë në funksion.

Ndjekja penale ndaj këtyre funksionarëve bëhet nga prokuroria, në përputhje me kompetencën lëndore dhe tokësore, mirëpo, duke pasur parasysh se procedimi nuk është i lejueshëm pa autorizimin e organit përkatës, përderisa nuk merret një autorizim nga organi përkatës. Deri në marrjen e autorizimeve për procedim, prokuroria nuk mund të kryejë asnjë veprim hetimor që lidhet me personin për të cilin kërkohet autorizimi (nuk lejohet ndalimi, caktimi i masave të sigurimit, kontrollimet, këqyrja e personit, njohja etj.).

⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë: 21.10.1998, shpallur me dekretin nr.2260, datë 28.11.1998, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Pra, prokuroria mund të kryejë çdo veprim tjetër hetimor që është i ndryshëm nga veprimet e parashikuara nga neni 289 i K.Pr.Penale. Kërkesa për autorizim është një e drejtë dhe detyrim i organit të Prokurorisë për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare – kryesisht apo me *ankim*.

Dhënia e vendimit apo mosdhënia e tij përmes të cilit autorizohet organi për ndjekje penale nuk paraqet vendim fajësie, pasi organi përkatës nuk gëzon attribute gjyqësore. Ky është një vendim që shpreh pëlqimin që procedimi penal ndaj funksionarit të vazhdojë apo jo. Prandaj, kërkesa për autorizim duhet të përmbajë dokumente- jo të tërë dosjen hetimore të rastit, që provojnë se akuza nuk është e bazuar në qëllime politike. Vendimi për dhënien apo mosdhënien e autorizimit për procedim duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar. Për këtë grup – kategori personash, të cilët ushtrojnë funksione publike shtetërore, përcaktuar sipas nenit 59 të KPP-së, nuk mund të ushtrohet ndjekja penale, pa vullnetin e një organi shtetëror të përcaktuar me ligj.

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë në një rast lidhur me fillimin ose mosfillimin e procedimit penal në rastin e një deputeti, edhe pse kishte autorizim për ndjekjen penale, nuk vazhdoi gjykimin. E pushoi procedimin penal, duke u arsyetuar se fitimi i një mandati të ri parlamentar duhej të shkaktonte një kërkesë të re autorizimi për fillimin e procedimit penal nga ana e prokurorisë. Gjykata e Lartë mban qëndrimin se, kërkesën për autorizim e bën vetëm prokuroria, mbështetur në nenin 73 të Kushtetutës. Për këtë arsye procedimi penal nuk mund të vazhdonte⁶⁸.

Ndërkohë, mendimi i pakicës argumenton se autorizimi i sesionit paraardhës të Legjislaturës duhej të ishte i mjaftueshëm dhe nuk kishte nevojë për autorizim të ri. Referenca në rastin e një të pandehuri tjetër, që kishte fituar mandatin e deputetit për

⁶⁸ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 6 datë 13.03.2009, aksesuar në datën 14.5.2016 në faqen www.gjykatae.larte.gov.al

herë të parë ndryshon nga rasti në fjalë, sepse ai nuk kishte pasur asnjëherë një autorizim të Kuvendit për ndjekjen penale.

Vendimi, Nr.6 datë 13.03.2009 me: Fillimi dhe mosfillimi i procedimit penal për shkak të imunitetit të deputetit edhe kur ka autorizim për fillimin e ndjekjes penale (në legjislaturën e mëparshme).

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se zgjedhja e të pandehurit Fatmir Mediu, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në datën 01.08.2009 dhe mungesa e një autorizimi për procedim të Kuvendit të Shqipërisë për këtë person, pas mandatimit si deputet, është një prej rrethanave ligjore të parashikuara nga neni 290/1, i K.Pr.Penale. Në bazë të këtij neni, ndjekja penale e filluar në ngarkim të pandehurit, Fatmir Mediu, nuk mund të vazhdojë.

Rezulton se mbi bazen e kërkesës së organit të akuzës, Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr.185, date **16.06.2008**, ka vendosur: *“Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Fatmir Mediu, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”*.

Pas marrjes së këtij autorizimi, si detyrim procedural që buron nga përmbajtja e nenit 288 të K.Pr.Penale, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme Fatmir Mediu, është marrë si i pandehur, dhe në përfundim të hetimit, ai është dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë, pasi ishte një prej subjekteve, që në zbatim të kërkesave të nenit 75/b-2 të K. Pr. Penale, gjykohet prej Gjykatës së Lartë, si shkallë e parë.

Gjykata e Lartë, pasi që konstatoi se nuk kishte pengesë ligjore për të gjykuar të pandehurin, Fatmir Mediu, gjykim i cili është vazhdim i ndjekjes penale të filluar nga organi i akuzës dhe i lejuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me autorizimin e dhënë në datën 16.06.2008, filloi procedurat e shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Në seancën gjyqësore të datës 14.09.2009, pasi që u paraqiten prova nga mbrojtësit e të pandehurit, sipas te cilave i pandehuri, Fatmir Mediu, pas datës 01.08.2009, ka marrë

mandatin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arriti në përfundimin se kjo rrethanë e re është ndalim për këtë Kolegj që të vazhdojë ndjekjen penale në ngarkim të pandehurit, Fatmir Mediu.

Ky ndalim, para së gjithash, rrjedh nga përmbajtja e dispozitës së **nenit 73/2 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku në mënyrë të shprehur parashikohet se: “Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet”.**

Sipas kësaj dispozite kushtetutese, një person nuk mund të ndiqet penalisht nëse ai provon ekzistencën e dy kushteve. Së pari, që ai është i zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe, së dyti, që Kuvendi nuk ka lëshuar autorizim për ndjekjen penale të tij.

Në vështrim të nenit 73 të Kushtetutës, Kolegji Penal vlerëson se deputetët marrin një mandat politik dhe ushtrojnë funksionin e tyre brenda afatit ligjor. Me mandatin e deputetit ka lidhje edhe statusi i tij. Element i rëndësishëm i këtij statusi, ndër të tjera, është imuniteti parlamentar, **që përfshin papërgjegjshmërinë penale dhe paprekshmërinë penale të deputetit.** E para ka të bëjë me papërgjegjshmërinë parlamentare. Pra, lidhur me veprimtarinë e tij si anëtar i Kuvendit, në ushtrim të funksionit të tij, ndërsa paprekshmëria penale ka të bëjë me paprekshmërinë parlamentare.

Në rastin në shqyrtim kemi të bëjmë me institutin e imunitetit, përkitazi me paprekshmërinë parlamentare (papkrekshmërinë penale), që është një aspekt i institutit të imunitetit parlamentar. Imuniteti është një institucion i vendosur për të siguruar ushtrimin e lirë të mandatit parlamentar dhe synon të parandalojë ndjekjen penale kundër deputetit, apo arrestim pa autorizimin e Kuvendit të Shqipërisë.

Paprekshmëria, si tipar i qenësishëm i imunitetit parlamentar, është parashikuar në nenin 73/2 e 3 të Kushtetutës.

Gjithashtu, sipas neneve 65, 71 dhe 73 të Kushtetutës, autorizimi për ushtrimin e ndjekjes penale i dhënë nga Kuvendi ka efekte brenda mandatit të legjislaturës përkatëse të Kuvendit. Kjo për arsye se me mbarimin e mandatit të Kuvendit (Neni 65.3 i Kushtetutës), sipas germës “ç” të pikës 2, të nenit 71 të Kushtetutës,) mbaron edhe mandati i deputetit. Sipas kësaj, mandati i deputetit, Fatmir Mediu, ka mbaruar dhe, për rrjedhojë edhe autorizimit, të dhënë nga Legjislatura XVII-të e Kuvendit, i kanë shteruar efektet juridike.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga provat e administruara në seancën gjyqësore të datës 14.09.2009, konstaton se ndjekja penale ndaj të pandehurit, Fatmir Mediu, nuk mund të vazhdojë. Ai, prej datës 01.08.2009, është zgjedhur deputet dhe, pasi ka marrë këtë mandat kushtetues, Kuvendi i Shqipërisë nuk ka lëshuar autorizim për ndjekjen e tij penale.

Autorizimi që ndodhet në dosjen hetimore mban datën 16.06.2008 dhe është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Legjislaturën XVII të tij, ndërkohë që, i pandehuri, Fatmir Mediu është deputet i Legjislaturës XVIII të Kuvendit të Shqipërisë. Vazhdimi i procedimit penal ndaj të pandehurit F. M., do të ishte antikushtetues me pretendimin se autorizimi i datës 16.06.2008 vlen edhe pas datës 01.08.2009. Me këtë arsyetim do të pranohet faktin se ky i pandehur mandatin e deputetit e ka fituar pa imunitet parlamentar.

Natyrisht, ky mandat nuk mund të ishte i pjesshëm, sepse imuniteti i deputetit të sapo zgjedhur është element përbërës i statusit të tij dhe mund të hiqet vetëm në seancë plenare të Kuvendit dhe me një procedurë të caktuar, posaçërisht, në rregulloren e Kuvendit.

Përforcimi kushtetues i mandatit të deputetit me një imunitet kundër ndjekjes penale është një akt sovran, të cilin zgjedhësit e kanë parasysh kur e votojnë një kandidat për deputet. Në ushtrimin e kësaj prerogative politike zgjedhësit nuk mund të kufizohen nga

një akt i Kuvendit të mëparshëm, sepse imuniteti i hequr nuk ndalon as rikandidimin e as zgjedhjen e deputetit të personit, të cilit i është hequr më parë imuniteti. Kjo është një nga pasojat e rëndësishme të mbrojtjes politiko-kushtetuese të deputetit, që e dallon atë nga shtetasit e zakonshëm. Akti i zgjedhjes dhe konfirmimi i mandatit të deputetit të sapo zgjedhur në seancën e tij të konstituimit, nga Kuvendi është një akt i plotë dhe, as në teorinë e, as në praktikën kushtetuese, nuk njihen raste që ky akt të jetë i privuar nga elementet e tij thelbësore, siç është, ndër të tjera, imuniteti kundër ndjekjes dhe procedimit penal. E kundërta do ta bënte këtë akt të pavlefshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe do t'i hapte rrugën ndjekjes penale kundër deputetëve, në kundërshtim me dispozitat Kushtetuese (Neni 73/2) dhe ato të K. Pr. Penale (Neni 288) të R.SH, duke i zhvleftësuar këto në qëllimin për të cilin janë parashikuar të veprojnë.

Organi i akuzës nuk mund të mbështetet në kërkimin e vazhdimin të gjykimit kundër të pandehurit, mbi bazën e një autorizimi të miratuar nga Kuvendi i mëparshëm, sepse ky autorizim, për nga vetë natyra e tij, është i kufizuar në kohë. Ky autorizim bie dhe zhvishet nga efektet, jo vetëm për shkak panevojshmërie, kur gjykata jep vendim themeli, por edhe kur i pandehuri, gjatë gjykimit, rifiton një mandat të rregullt parlamentar. Për shkak se imuniteti është garanci e Kuvendit, si institucion dhe jo e deputetit të tij, vazhdimi i gjykimit kundër të pandehurit do të cënonte vetë integritetin e Kuvendit, i cili është ai që mund të vendosë për heqjen e këtij imuniteti mbi një kërkesë të posaçme, vetëm të organit të akuzës.

Mungesa e autorizimit për ndjekjen penale të pandehurit, Fatmir Mediu, e ndalon gjykatën të vazhdojë ndjekjen penale në ngarkim të tij, ndalim i cili është parashikuar, shprehimisht, në dispozitën e nenit 290 të K. Pr. Penale. Në piken “e” të tij përcaktohet se: *“Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftëse ka filluar duhet të pushojë në çdo gjëndje të procedimit ... në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji”*. Një prej

këtyre rasteve, pa dyshim, është ndalimi i ndjekjes penale të deputetit pa autorizimin e Kuvendit, ndalim që është parashikuar, shprehimisht, në ligjin themeltar të shtetit, në nenin 73/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 288/1 të K.Pr.Penale.

Të njëjtin qëndrim e ka mbajtur Gjykata e Lartë edhe me vendimin nr. 2, datë 30.04.2002, i cili bën fjalë për të pandehurin A. H., etj. Sipas këtij vendimi, ndër të tjera, Kolegji Penal arsyeton se: *“... edhe pse i pandehuri A, statusin e deputetit të Kuvendit e fitoi mbas nisjes së procedimit penal, kur çështja ndodhet në gjykatë, gjykimi i tij nuk mund të vazhdojë, pasi gjykata ndodhet përpara rasteve të parashikuara në nenin 290 të K. Pr. Penale”*.

Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se ai ndodhet në pamundësi procedurale për t’i kërkuar Kuvendit të Shqipërisë autorizimin për vazhdimin e ndjekjes penale të pandehurit, Fatmir Mediu. Nga përmbajtja e dispozitës së nenit 288/1 të K. Pr. Penale, sipas të cilit: *“Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesën në organin përkatës”*, rezulton se të drejtën për të kërkuar këtë autorizim e ka vetëm prokurori.

Përsa i përket deklaramit të mbrojtësve të pandehurit, Fatmir Mediu, se janë të interesuar për të vazhduar gjykimin, gjykata konstaton se imuniteti i deputetit nuk është një garanci personale e tij, por një mjet kushtetues për të siguruar funksionimin normal të Kuvendit si institucion. Për rrjedhojë, dorëheqja personale e deputetit nga imuniteti, të cilin ai e gëzon për shkak dhe për efekt të qenies së tij si anëtar i trupit legjislativ, është konstitucionalisht pa vlerë juridike dhe nuk mund të merret parasysh nga gjykata.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi Pushimin e procedimit penal në ngarkim të pandehurit Fatmir Mediu, për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk mund të vazhdojë.

Po t’i referohemi nenit 292 të K. Pr. P., i cili e përcakton mungesën e autorizimit për procedim, si rrethanë që nuk lejon fillimin e procedimit edhe nëse ka filluar vazhdimin e

tij. Mirëpo, afati 30-ditor nis nga momenti i regjistrimit të emrit, për të cilin është i nevojshëm autorizimi i procedimit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Ndërkaq, Kushtetuta përcakton qartë se kjo kategori personash nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimet përkatëse.

Në momentin që është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emri i personit për të cilin është i domosdoshëm autorizimi, Prokuroria nuk mund të vazhdojë ndjekjen penale, të filluar tashmë, pa marrë autorizim për të vazhduar ndjekjen e filluar. Për këtë arsye, dispozitat e n. 292 theksojnë se “Rifillimi i ndjekjes penale bëhet më vonë, kur jepet autorizimi, ose autorizimi nuk nevojitet më, pasi që personi nuk ka statusin e mëparshëm”.

Për këto arsye, neni 289 i KPP-së, duke përcaktuar ndalimin e disa veprimeve hetimore, por në një interpretim, në të kundërtën lejon kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Kjo dispozitë bie ndesh me ligjin themelor të shtetit shqiptar që përcakton se disa funksionarë shtetërorë ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit kompetent.

Nëse gjatë veprimeve hetimore arrihet në dyshimin e arsyeshëm se autori i veprës penale është një funksionar, për të cilin kërkohet një autorizim specifik, autorizim që, vetë shoqëria, nëpërmjet kushtetutës dhe ligjvënësit, ua ka dhënë funksionarëve të lartë shtetërorë, duhet ta shënosh në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e personit për të cilin kërkohet ky autorizim . Çasti regjistruar në regjistër nuk është moment kur personi po ndiqet penalisht, për arsye se, që të kemi ndjekje penale ndaj një personi duhet të kryhen veprime hetimore rreth tij. Në rastin tonë, shënimi në regjistër është një veprim procedural, por jo veprim procedural hetimor. Veprimi procedural hetimor, i mbështetur në KPP, ekziston vetëm atëherë kur organi shtetëror, prokuroria, jep autorizimin.

Nëse ndjekja penale e filluar është pezulluar, për arsye përcaktuese të ligjit, rifillimi i procedimit nuk mund të bëhet pa një autorizim paraprak të prokurorit.

Pra, jo më kot është vendosur titulli i dispozitës “ rifillimi i ndjekjes penale”, i cili i jep dritë jeshile konceptimit të ndjekjes penale, se, ajo fillon që nga momenti që kryhen veprime hetimore rreth faktit dhe pastaj kalohet në drejtim të personit. Koncepti i rifillimit të ndjekjes penale është ka filluar, siç është në rastin kur ke proceduar ndaj një fakti, por që, më pas, kjo ndjekje nuk mund të vazhdojë ndaj një personi, pasi që fillimi është ndërprerë pikërisht nga mungesa e autorizimit, apo kur autorizimi nuk nevojitet më. Kështu “fillimi” i procedimit rifillon aty ku është ndërprerë, për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, mjafton që të mos jetë parashkruar ndjekja penale.

6.4. Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal

Kodet Penale të mëhershme, të aplikuara në Kosovë dhe Shqipëri dhe tani, këto të periudhës aktuale në zbatim kanë normuar ligjësishtë, rrethanat, ekzistenca e të cilave poqe është e pranishme gjatë shqyrtimeve të kallëzimeve penale, pamundësimin e fillimit apo vazhdimin e tij. Këto rrethana shprehen: kur vepra nuk është e përcaktuar me ligje, ka arritur parashkrimi i saj, është e rëndësisë së vogël, është gjykuar njëherë, është dhënë amnestim për te, personi ka vdekur, nuk është provuar me prova fajësia e të dyshuarit se është kryes i veprës penale, si dhe rrethanat të tjera të parapara me ligje. Perkundër, rrethanava të përmendura të cilat ligjësishtë me ç’do kusht e ndalojnë fillimin e procedimit penal praktikant kanë treguar të kundërtën, duke vazhduar me dërgim të aktit akuzus apo kërkesen akuzuse tek organi shqyrtues gjykata. Ku kjo e fundit duke shqyrtuar rrethanat e përmendura ka sjellur nganjher vendim meritor ndaj të akuzuarit, e nganjher edhe vendime të disfavorshme ndaj të akuzuarit për shkakë të mosë respektimit të vlerësimit të aspektit formal të rrethanave, të lëshuara nga organi ndjekës, qenë i detyrueshëm për ti respektuar.

Mirëpo, nëse organet e ndjekjes vijnë në dijeni nga burime të ndryshme njoftimi se për një ose disa vepra penale të kryera, nga një person, me pasoja formale gjatë kryerjes së detyrës zyrtare sjellin pasoja për personin zyrtar nëse vërtetohen se kanë qenë të karakterit subjektiv, me rastin e fillimit të procedimit, përkundër ekzistencës së rrethanave të përmendura etj., sjellin dyshime të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Prandaj, me të drejtë, ligji ka përcaktuar një pengesë të tillë, për të mosfilluar procedimin penal ndaj tyre e, nëse ka filluar, pushimin e tij (veprat në vendngjarje, ose kur organi procedues nuk ka ditur moshën e të miturit), por ka përcaktuar marrjen e masave edukuese, pasi që vetëm në këtë mënyrë ai do të ketë premisë për t'u formuar si individ i dobishëm për shoqërinë. Në këtë drejtim, linjë rrjedhë se, ligji ka parashikuar si pengesë për të filluar procedimin penal ndaj atyre personave që janë të papërgjegjshëm. Siç e theksuam edhe më lart, kjo rrethanë lidhet me paefektshmërinë e qëllimit të dënimit, që lidhet në mënyrë të pashmangshme me qëllimin final të procedimit. I rëndësishëm për t'u evidentuar është fakti, nëse ndërmerren veprime procedurale hetimore në drejtim të konstatimit ose jo të faktit kriminal, apo nëse ndërmerren veprime procedurale në drejtim të përgjegjshmërisë ose jo të personit, të cilit i atribuohet vepra penale. Atëherë, rrjedhimisht ke ushtruar veprimtari procedurale, që do të thotë se ke ushtruar ndjekje penale e, rrjedhimisht do të thotë se ke ushtruar procedim penal. Kështu duhet të operohet me anë të regjistrimit të procedimit penal dhe me pushimin e tij, nëse rezulton se personi është i papërgjegjshëm. Mund të operohet me vendim mosfillimi të procedimit penal vetëm atëherë, kur merr të dhëna verifikuese nga familjarët dhe nga mjeku psikiatër, por pa caktuar ekspertim psikiatrik. Nga këto të dhëna rezulton se personi është i papërgjegjshëm. Procedimi, detyrimisht, duhet të fillojë pasi që, siç e dimë edhe vetë, sëmundjet psikike nuk janë absolute nga pikëpamja e kohëzgjatjes. Meqë shkenca mjekësore ka konkluduar se ka dhe faza qetësie, shkak ky që bën të detyrueshëm kryerjen e një ekspertimi psikiatrik të këtyre

të sëmureve, për të konkluduar se kanë qenë të përgjegjshëm ose jo në kohën kur kanë kryer vepra penale. Për këtë arsye, kryesisht, për këtë kategori subjektesh nuk mund të veproh me vendim mosfillimi të procedimit penal. Në vijim të asaj që thamë më lart, ekzistenca e një karteje mjekësore të mëparshme, për persona të tillë, nuk mund të përbejë shkak dhe, si rrjedhim, as edhe bazë dokumentare të mjaftueshme për të vendosur mosfillimin e procedimit penal, e, nëse ka filluar, mosvazhdimin e tij.

Në disa raste mjafton që të analizosh disa elemente të anës objektive të veprës penale, që ndërlidhen me mënyrën e kryerjes së veprës penale, vendin e kryerjes, mjetet kryerjes, si dhe kohën e kryerjes etj. Kjo me qëllim që të japin një mendim të qartë lidhur me aftësinë psikologjike të individit për të parashikuar dhe kontrolluar veprimet e tij. Vlen të theksohet se ka njerëz që kryejnë krime për kënaqësi dhe që e dinë se po i bëjnë dëm shoqërisë, madje, vrasin edhe me ndërgjegje të plotë. Prandaj, mendoj se ekspertimi psikiatrik lidhur me papërgjegjshmërinë e individit, është një rrethanë që duhet të merret edhe në analizë të elementeve objektive të veprës penale dhe jo vetëm në elementet subjektive. Kjo do të thotë se detyrimisht për këtë rrethanë duhet të aplikosh me anë të pushimit të procedimit dhe jo me mosfillim të procedimit penal.

Ndërkaq, natyrshëm lind pyetja se si dhe, më parë se mbi çfarë dokumentesh do të bazohet prokurori për të marrë një vendim për mosfillim të procedimit penal për rastet e papërgjegjshmërisë. Për sa u përket dokumenteve – anës dokumentare që lypset t'i bashkëngjitemi mendimit për mosfillimin e procedimit penal, apo pushimit të tij, në rastet kur personi është nën moshën për përgjegjësi penale, mendoj se duhet të jetë një certifikatë e zyrës së gjendjes civile, si dhe një ekstrakt nga regjistri përkatës i vetë lindjes veqë mbahen në arkivat e bashkime përkatëse, si dhe në arkivat e prefekturave, në rastin kur personi i mitur është banor i komunës. Por, edhe për ato vepra penale me pasoja formale, nëse mosha e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, është e diskutueshme, pra kur nuk

mund të verifikohet mosha me anë të dokumentacionit personal atëherë për saktësimin e moshës nevojitet që të kryhet një ekspertim, që do të thotë se detyrimisht, duhet ta regjistrohsh procedimin penal. Në këto raste kur personi nuk është regjistruar në regjistrat e gjendjes civile janë pyetur prindërit e tij, është administruar certifikata familjare, si dhe është administruar akti i lindjes. Kjo e ka bërë të vështirë mosfillimin, për shkak të mosarritjes së moshës për përgjegjësi penale, por, më pas është proceduar në pushim të çështjes. Mbi bazën e këtij dokumentacioni të mbledhur, është e nevojshme kryerja e një ekspertimi, për të verifikuar moshën e autorit të dyshuar, apo të kallëzuar për kryerjen e veprës penale.

Për vepra penale me pasoja materiale për të cilat është e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore, detyrimisht, duhet ta regjistrohsh procedimin penal, pavarësisht nga faktiqë atë e ka kryer dukshëm një i mitur dhe, më pas, nëse nga kryerja e veprimeve hetimore është i sigurt se atë e ka kryer i mituri, jo i nxitur nga ndonjë person tjetër, vendoset pushimi i procedimit të filluar, apo, thënë ndryshe, pushimi i çështjes. Pra, theksoj se vetëm nëse jemi para veprave penale me pasoja materiale, mund të veprojmë me vendim mosfillimi të procedimit penal, për shkak se personi që e ka kryer atë vepër është nën moshën e përgjegjësisë penale.

Në rastet kur personi është i papërgjegjshëm dhe familjarët e tij nuk e deklarojnë, si duhet vepruar?

Nga ana e prokurorit është e nevojshme vlerësueshmëria meritore e sjelljes së tij dhe, mbi bazën e provave të mbledhura, në këtë drejtim, i dyshuari duhet t'i nënshtrohet ekspertimit përkatës të procedimit, komfor dispozitave përkatëse. Në këtë rast, duhet të procedohet në fillim dhe më pas të pushohet çështja . Po në rastet kur prindërit pretendojnë se personi i mitur ose jo është i papërgjegjshëm dhe paraqesin dokumente mjekësore, në këtë drejtim, përmes të cilave dokumente dëshirohet të arrihet bindshmëria tek organi procedues, a është

e nevojshme që të verifikohet dokumentacioni? Atëherë, me të drejtë themi po dhe, më pas, nga ana e organit lind detyrimi për ekspertimin përkatës.

Në rastet kur personi është dukshëm i papërgjegjshëm a duhet vendosur mosfillimi apo çështja duhet filluar. Përgjigjeja pason çështja duhet filluar dhe personi duhet t'u nënshtrohet ekzaminimeve, ekspektimeve mjekoligjore.

6.4.1. Mungesa e vullnetit të të dëmtuarit për ankim?

Sipas nenit 284 të KPPSH-së, të parashikuara nga nenet 89, 102, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të KPK-së, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili e tërheq çdo fazë të procedimit. Ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në bazë të cilit **“ndjekjet për çdo krim, apo kundërvajtje komunale bëhen kryesisht nga prokuroria”** shpjegohet me shkallën e rrezikshmërisë se, pakot shoqërore të këtyre veprave penale, me pasoja që ka në vete procedimi penal me faktin se marrëdhëniet ndërmjet të dëmtuarit dhe autorit të veprës penale janë bërë miqësore dhe, si rrjedhim, nuk ka kuptim që të fillohet një procedim penal pasiqë, qëllimi i tij final, jo vetëm se nuk do të sjellë ndonjë dobi për shoqëri, por përkundrazi, do të shkaktonte rinisjen e një armiqësie të re. Thënë ndryshe, do të përbënte një burim konflikti të mundshëm në mes të autorit dhe të dëmtuarit.

Kjo e drejtë e të dëmtuarit justifikohet në raportin që ekziston në mes të interesit individual dhe atij shoqëror, në kuptimin që, edhe pse individi është pjesë përbërëse e shoqërisë, nëse ai nuk ka interes personal për të reaguar ndaj një veprimi që e ka cenuar apo dëmtuar atë, atëherë edhe shoqëria nuk ka interes për të reaguar ndaj veprimeve të tilla, pasiqë ato, për vetë karakteristikën që bartin, nuk përbëjnë rrezik për shoqërinë në tërësi. Ky përjashtim i jep të drejtë qytetarit që të e mos acarojë më tej gjendjen me autorin, mos të vazhdojë

grindjet dhe mosmarrëveshjet, të arrihet pajtimi social midis palëve, në mënyrë që të evitohen pasojat e procedimit penal. Sipas dispozitës së KPP-së rezulton se vetëm i dëmtuari nga vepra penale, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm, ka të drejtë të bëjë ankim. Mungesa e këtij ankimi bën të pamundur ushtrimin e procedurës penale, ose vazhdimin e saj nëse ka filluar. Se çfarë kuptojmë me person të dëmtuar nga vepra penale, sipas kodit aktual të procedurës penale do të japim sqarim në vijim:

Me person të dëmtuar nga vepra penale do të kuptojmë personin i cili ka pësuar cenime, shkelje të të drejtave dhe interesave të ndryshme pasurore, apo jo pasurore, të shkaktuara nga subjektet e veprave penale, si të mira juridike që i ka marrë shoqëria në mbrojtje përmes ligjit penal-material. Ashtuqë për të kërkuar fillimin e procedimit penal kundër atij që pretendohet se ka shkaktuar dëmin, e kanë edhe trashëgimtarët ligjorë të treguar në nenin 360 të KC-së, pavarësisht nga rradha e thirrjes së tyre në trashëgim. Duke iu referuar nenit 284/2 të KPP-së, del se ankimi bëhet personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm. Ndërsa, duke iu referuar nenit 58 të KPP-së, kjo e drejtë u njihet edhe përfaqësuesve ligjor. Si përfaqësues ligjor janë të dy prindërit, ose vetëm njëri prej tyre, ai prind që është kujdesur për rritjen dhe edukimin, si dhe kujdestarët.

Ndërsa, nëse ankimi është bërë nga përfaqësuesi ligjor i të miturit, 14–18 vjeç, po që gjatë zhvillimit të procedimit ai e ka mbushur moshën 18 vjeç, a ka të drejtë që të tërheqë ai vetë ankimin?

Në këto momente është e qartë se tërheqja e ankimit, pavarësisht se ankimi është bërë nga përfaqësuesit ligjorë, apo me pëlqimin e tij, zotësia procedurale penale për ta tërhequr ankimin, sigurisht, i përket të dëmtuarit madhor. Për të vendosur fillimin e procedimit penal është e mjaftueshme që i dëmtuari të vendosë vullnetin e tij edhe nëse nuk njihet personi, të cilit i atribuohet vepra penale (p.sh., marrëdhënia seksuale me dhunime etj.).

Një çështje tjetër, e cila nuk është e normuar nga procedura penale, ka të bëjë me faktin se çfarë do të bëhet me ato raste, kur personi i dëmtuar nga vepra penale vdes pasi të ketë bërë ankimin? Në këto raste është e nevojshme të dihet se a duhet të vazhdohet procedimi tashmë i nisur, apo duhet të pushohet apriori? A mund të aplikohet pushimi i çështjes nga prokurori nëse vullneti i trashëgimtarëve është i tillë që kërkojnë të tërheqin ankimin? Nëse pranohet që trashëgimtarët të tërheqin ankimin, trashëgimtarët e cilës radhë e kanë këtë të drejtë? Po nëse trashëgimtarët e të njëjtës radhë nuk janë unik për sa i përket vazhdimit ose jo të procedurës, si p.sh., bashkëshortja e të ndjerit është dakord për tërheqje, por, me këtë qëndrim nuk është dakord i biri madhor i trashëgimtarit, vullneti i kujt do të jetë përcaktues? Për këto, me rëndësi juridike dhe tepër sociale, Kodi ynë hesht. Megjithatë, mendoj se në lidhje me këto situata, duke pranuar mundësinë e aplikimit të tërheqjes së ankimit nga ana e trashëgimtarëve që thirren në trashëgim (të mos jenë të padenjë), me arsyetimin se procedurën e filluar tashmë nga i ndjeri, për të vënë në vend ose jo të drejtën e cenuar, do t'u kalojë trashëgimtarëve të radhës së parë, të cilët vijnë në trashëgim, duke përdorur edhe analogjinë në të drejtën e të dëmtuarit akuzues.

Po nëse është parashikuar, shprehimisht, në testament se, trashëgimtarit i kalon e drejta për të tërhequr ankimin, a është i vlefshëm ai? Për këtë situatë të fundit, mendoj se nuk ka vend për diskutim, pasi që kjo e drejtë i ka kaluar trashëgimtarit me anë të testamentit.

Si do të veprohet në rastet kur, nga materiali i ardhur, nga policia gjyqësore, rezulton të jetë marrë kallëzimi, por në të nuk shprehet se i dëmtuari kërkon ndjekje penale? Në këto raste personat janë thirrur përpara organit procedues dhe kanë shprehur vullnetin e tyre në këtë drejtim. Por, në rastet kur i dëmtuari, pas marrjes së kallëzimit, për arsye të ndryshme nuk gjendet, sepse është larguar jashtë shtetit, apo nuk dihet adresa e tij e banimit, si duhet vepruar? Në këto raste, mendoj se duhet vepruar me fillimin e procedimit penal, për sa kohë që është marrë një kallëzim penal. Mendoj se, vetë fakti i bërës së kallëzimit penal,

tregon se personi ka pasur ankim, andaj, në këto raste duhet proceduar në fillimin e procedimit penal dhe kur i dëmtuari të vihet në dijeni të këtij fakti, ai të shprehet në lidhje me këtë. Praktika e sotme ka ndjekur të dyja variantet, si atë të fillimit, ashtu edhe atë të mosfillimit të procedimit penal.

6.4.2. Fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ose kur del qartë se fakti nuk ekziston

Në rastin e parë ligji ka parasysh mungesën e elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale. Pikërisht, anën objektive të figurës së krimit, ose kundërvajtjes penale të pretenduar. Kështu, vërtetë, veprimet e personit mund të jenë të kundërligjshme, por ato nuk janë të dënueshme penalisht nga shoqëria e të parashikuara nga dispozitat.

Pra, kur jemi para fakteve që i përkasin të drejtës civile, zgjidhja e pasojave të cilave bëhet nëpërmes procedurës civile, apo kur jemi para fakteve, zgjidhja e pasojave të cilave bëhet nëpërmjet procedurës administrative, themi se jemi para rrethanës që fakti nuk parashikohet si vepër penale, rrethanë kjo që nuk lejon fillimin e procedimit penal.

Me fjalë të tjera, që të jemi para kësaj rrethane, e cila nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, duhet që, nga perceptimi i faktit të pretenduar të mos ekzistojë dyshimi se fakti i pretenduar i përgjigjet ekzistencës së një figure konkrete të parashikuar nga KP-ja.

Fakti – ekzistenca e tij nuk parashikohet si vepër penale nga ligji. Përndryshe, fakti i përket grupit të atyre rrethanave, të cilat, kryesisht, mund të përbëjnë shkak për mosfillimin e procedimit penal. Kjo për arsye se, të arrish në konkluzionin se fakti i pretenduar nuk parashikohet si vepër penale nga ligji, nuk ka nevojë për zbatimin e hetimeve. Pra, me ndërmarrjen e veprimeve procedurale-hetimore, e thënë në kontekstin e temës nuk ka nevojë të fillosh procedimin penal.

Për të qenë para kësaj rrethane, e cila përbën shkak për mosfillimin e procedimit penal, është evidente që, fakti i pretenduar nga kallëzuesi, apo ankuesi ekziston, por ai nuk është i dënueshëm penalisht sipas ligjit material penal, pasi që një fakt i tillë nuk i përgjigjet ekzistencës së asnjërës prej figurave konkrete të veprave penale. Kjo rrethanë nuk është një gjë tjetër, veçse një shprehje e parimit procedural-penal se askush nuk mund të dënohet për një vepër, e cila, në kohën e kryerjes së saj, nuk quhej e tillë nga ligji penal. Është, padyshim, një garanci që askush të mos dënohet arbitrarisht, pasi që është vetë shoqëria e cila nuk jep autorizim për të ushtruar ndjekje penale ndaj atyre fakteve, apo veprimeve që nuk janë të dënueshme në kuptimin penal. Të dalësh në konkluzion se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, kërkon jo vetëm një studim të mirë të materialit kallëzues, por edhe një perceptim të mirë të vetë ekzistencës së faktit. Jo rrallë herë ndodh që, për të dalë në një konkluzion të tillë, është e nevojshme të kryhen veprime verifikuese.

Në praktikën dhe në teorinë e të drejtës penale njihen raste kur veprimi apo mosveprimi kriminal është fshehur nën petkun e kontratave, në një kohë kur autori i krimit, që në fillim ka planifikuar gjithçka me kujdes dhe e ka fshehur veprimtarinë e tij kriminale, pikërisht në mbulesën e kontratave, duke dhënë kështu përshtypjen e parë se jemi përpara një konflikti civil, ku në fakt, ai është penal. Prandaj, në raste të tilla lind si domosdoshmëri kryerja e një sërë veprimesh hetimore, si: pyetja e palëve të kontratës, qëllimi i lidhjes së saj, mundësitë reale të palëve për të përmbushur detyrimin reciprok dhe sjellja e tyre në drejtim të përmbushjes së këtyre detyrimeve etj. Në praktikë ka pasur raste që kallëzimet penale, të cilat janë parashtruar e në mungesë të të dhënave të mjaftueshme, është kërkuar që të plotësohen dhe një plotësim i tillë është bërë me qëllim që të verifikohen të dhënat e treguara në të. Mirëpo nganjëherë palët kontraktuese kanë refuzuar të paraqiten, apo të japin shpjegime rreth tij. Atëherë, lind pyetja, si do të veprohet në raste të tilla? Mbi çfarë baze ligjore do të urdhërohet thirrja e tyre dhe si do të veprohet në rast refuzimi për

paraqitje, apo dhënie deklarimesh? Mendoj se, në raste të tilla, nuk ka zgjidhje tjetër, veçse ta regjistros proceduren penale dhe të kryesh veprime hetimore. Në një përfundim të tillë të shpie analiza e nenit 328, pika 1 (shkronja “b”), sipas KPP-së, e cila parashikon pushimin e çështjes për rrethanën e faktit (nuk parashikohet nga ligji si vepër penale).

Tjetër është fakti kur ai nuk ekziston si rrethanë që nuk lejon fillimin e procedimit penal e, nëse ka filluar, nuk e lejon vazhdimin e tij.

“Nëse fakti ekziston ose jo dhe nëse vepra është kryer nga personat e kallëzuar, thekson Kolegji Penal i Gjykatës së Lart, ky përfundim mund të nxirret vetëm pasi të jenë kryer hetimet lidhur me rrethanat. Pra, organi procedues, që të bëjë këto veprime hetimore, duhet detyrimsht, të fillojë çështjen penale që është ana materiale e procedimit penal. Pra, që do të thotë, detyrimsht, duhet të fillojë procedimin penal”. “Është situat tjetër nëse fakti nuk parashikohet nga ligji, si vepër penale e tjetër është kur fakti nuk ekziston”. Në rastin e parë, kur fakti nuk parashihet me ligj, organi procedues mund të vendosë me mosfillimin e çështjes, pasi që Prokuroria të bëjë verifikime përkatëse, të parapara me ligj. Ndërsa rasti i dytë, kur fakti nuk ekziston, atëherë duhet zhvilluar hetimet e plota dhe në raport me përfundimin e tyre vendoset nëse çështja duhet t’i referohet gjykatës për t’u gjykuar, apo duhet pushuar për njërën nga shkaqet që parashihen me nenet 290, 328 të KPP-së, RSH.

Nga ky arsyetim del se rrethana që fakti nuk ekziston nuk mund të shërbejë asnjëherë si shkak për mosfillim të procedimit penal. Pasi që të vërtetohet si rrethanë, detyrimsht, duhet të hetohet, e, që të hetohet, sipas Gjykatës së Lartë, patjetër, duhet të vendosësh fillimin e procedimit penal. Sipas arsyetimit, të cilën e jap Gjykata e Lartë, del qartë se hetimi është shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale. Pra nuk mund të hetosh pa filluar procedimin penal, apo, thënë ndryshe pa filluar ndjekjen penale.

Nga kjo analizë del qartë se, po kërke verime hetimore në drejtim të faktit, pavarësisht atribuimit të personit konkret, detyrimsht, ke filluar procedimin penal dhe nuk mund të

kryesh veprime hetimore e pastaj të procedosh me mosfillim procedimi, siç është vepruar në pjesën dërmuese të rasteve të praktikës.

Jo rrallë, nga praktika, nga ana e policisë gjyqësore, janë kryer një sërë veprimesh procedurale e, megjithatë, nga ana e organit procedues vendoset mosfillimi i procedimit penal. Një praktikë e tillë, mendoj se është e gabuar, se, me kryerjen e një sërë veprimesh hetimore nga ana e policisë gjyqësore, që nga momenti i marrjes së kallëzimit e gjerë në dërgimin e materialit kallëzues në organin procedues, janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si pyetja e deklaruesve, sekuestrimi i dokumenteve, kontrollimi i vendeve etj... Këto veprime janë bërë në pajtim dhe në mbështetje të dispozitave të KPP-së. Pra në këtë rast procedimi penal, faktikisht dhe ligjërisht ka filluar e, në këto kushte, marrja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, mendoj se është e gabuar “sipas vendimit nr. 706, të datës 18.12.2002. KPGJL-ja çmon se, për t’u arritur në një përfundim të tillë, si organi i akuzës, ashtu edhe gjykata duhet që paraprakisht të evidentohet dukshëm fakti se, ajo, për të cilën kërkohet fillimi i procedimit nuk parashikohet si vepër penale nga legjislacioni shqiptar. Pra, thënë në kontekstin e këtij procedimi, falsifikimi i dokumentit, sipas legjislacionit penal shqiptar, nuk parashihet si vepër penale. Elementi i dytë të cilin parashikon kjo dispozitë është që, fakti për të cilin kërkohet fillimi i procedimit nuk ekziston, apo, thënë ndryshe, nuk ka vepër penale në veprimet ose mosveprimet e personit që kallëzohet. Që të arrijë në këtë përfundim organi i akuzës, duhet të kryejë veprime procedurale dhe jo të marrë vendime apriori, pa kryer asnjë të tillë. Në këtë rast, si akuza edhe gjykatat kanë pranuar, pa kryer asnjë veprim procedural, të mos fillojnë procedimin penal dhe të mos pranojnë ankimin e shtetasit V.F.; duke iu referuar padrejtësisht nenit 290, pika 1, germa “C”, e KPP-së. Rasti që fakti nuk ekziston ka të bëjë me rastin kur jemi përpara një gënjeshtre, apo fantazie të kallëzuesit, të vërtetuar përgjatë procedimit penal meanë të hetimeve, se vepra e pretenduar nga kallëzuesi, është joreale. Kjo rrethanë,

kryesisht është e mjaftueshme për të filluar procedimin penal për veprë penale të kallëzimit të rremë.

6.5. Parashkrimi i veprës penale pengesë ligjore e fillimit të procedimit penal

Rrethanë tjetër që nuk lejon fillimin e procedimit penal është edhe rrethana e momentit të parashkrimit të ndjekjes penale, për shkak se ajo është vjetërsuar. Këtë rrethanë e përcakton neni 106 i KPK-së, përkatësisht neni 66 i KPSH-së, ku, përmes këtyre dy normave përcaktohen afatet e parashkrimit të ndjekjes penale. Ligji ka parashikuar afatet që e pamundësojnë organin e shtetit – prokurorinë, si organ përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale, që, të mos fillojë procedimin penal, apo, nëse e ka filluar atë, ta pushojë. Sipas nenit 66 të KP-së, i cili parashikon se nuk mund të bëhet ndjekja penale kur, nga kryerja e veprës e deri në momentin e marrjes së personit, si të pandehur, ka kaluar kohë, kohë kjo që ndërlikohet, varësisht nga sanksioni – masa e dënimit. Siç shihet, pamundësia e ushtrimit të ndjekjes penale lidhet me personin e jo me veprimin, apo mosveprimin kriminal, në një kohë kur është vepra ajo që ka humbur rrezikshmërinë shoqërore për shkak të parashkrimit. Kjo mënyrë e ndërtimit të kësaj dispozite nuk na duket e drejtë, pasi që, nga praktika nuk kanë munguar edhe rastet, kur hetimet, deri në marrjen e personit si të pandehur, janë zvarritur. Kështu ka ndodhur kur vepra është kallëzuar në dogana, në limitet e parashkrimit dhe, më tej, deri në marrjen e personit si të pandehur, ka qenë e nevojshme kryerja e disa veprimeve hetimore. Zvarritja e hetimeve deri në marrjen e personit si të pandehur është bërë me qëllim të mosushtrimit të ndjekjes penale. Duke e lidhur kohën e kryerjes së veprës penale e deri në momentin e marrjes së tij si të pandehur, krijohet mundësia për abuzime me detyrën. Marrja me vonesë nxjerr në pah se hetimet janë në përfundim e sipër drejtë parashkrimit të veprës penale.. Mendoj se kjo dispozitë ka lidhje me atë se kur kalohet një

kohë e gjatë e mosndërmarrjes së veprimeve për vepër, e cila ka karakter të rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe mos ndërmarrja e këtyre veprimeve, rezulton se më nuk është në atë rrezikun e duhur. Kjo do të thotë se mungon rrezikshmëria shoqërore e saj dhe në këto kushte, shoqëria e ka autorizuar prokurorin që të mos reagojë ndaj asaj vepre penale. Në këtë linjë arsyetimi qëndron rasti i procedimeve penale pa autor, dhe ato pasi që kryhen të gjitha veprimet e mundshme hetimore, procedimi pezullohet. Ky pezullim nuk është absolut, por zgjat deri sa të parashkruhet vepra penale. Kjo do të thotë se, me kalimin e afateve të parashikuara nga ligji, organi që zhvillon procedurë, në këto raste prokuroria, vendos pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Për rrethana parashkruese të mosfillimit të procedimit penal, detyrimi i organit procedues shtënë ta arsyetojë vendimin e procedimit penal fillimisht duke e bërë kualifikimin ligjor të veprës penale. Kjo vëmendje justifikohet nga fakti se duhet një përkushtim i plotë në drejtim të përcaktimit me saktësi të kualifikimit ligjor të veprave penale, pasi që siç e dimë, për vepra penale të ndryshme kodi parashikon afate të ndryshme parashkrimi.

Është kjo arsye, që për t'iu shmangur subjektivitetit të mundshëm, apo dhe atij paragjykues, në vendimin e tij prokurori duhet të arsyetojë se, vepra penale nuk është ajo, siç pretendohet në kallëzim penal, por, si e tillë, cilësohet ndryshe. Janë të shumta rastet e praktikës, që nuk përmbajnë fare arsyetim, për sa i përket kualifikimit të veprës penale, për ua bërë një analizë elementeve të figurës së veprës penale, apo kualifikimit të gabuar të saj. Mos arsyetimi i kualifikimit ligjor të kallëzimit të pretenduar, mendoj se përbëjnë parregullsi të veprimtarisë së Prokurorisë, si tërësi.

Në jetën e përditshme ndodhë që një person të ketë kryer dy, apo më shumë vepra penale, prej të cilave njëra, apo dyjat mund të jenë të parashkruara dhe ndaj tyre të mos lejohet fillimi i procedimit penal. Ndërsa të tjerat, për shkak të kalimit të kohës dhe mosndërmarrjes së veprimeve në kohën e duhur nga organi procedues, si të tilla të jenë të

parashkruara. Shtrohet pyetja se si të veprohet në këto raste. Mendoj se, për ato vepra penale, për të cilat është plotësuar afati i parashkrimit, duhet të procedohet me mosfillimin e vendimit të procedimit penal, ndërsa për të tjerat duhet të fillojë procedimi penal. Vendimi i mosfillimit të hetimeve nga ana e organit procedues, nga prokurori, duhet të jetë evident çdoherë, kur të ketë kaluar afati kohor i parashkrimit, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve. Në të kundërtën, nëse nuk konstatohet me saktësi koha e kryerjes së veprës penale, p.sh.:falsifikimi i dokumenteve, detyrimisht, duhet të fillojë procedimi për të kryer hetimin, e, nëse nga faktet e grumbulluara gjatë procedurës së hetimit vërtetohet se falsifikimi është nën kohën e jo parashkrimit kohor, atëherë duhet të vazhdohet me procedurë hetimi. Në të kundërtën, nëse nga faktet e grumbulluara rrjedh se falsifikimi i zbuluar gjendet i kryer në kohën kur ka kaluar afati për ndjekje penale, atëherë duhet që hetimi të mosfillojë së proceduari. Çfarëdo lloj vendimmarrjeje e dyshimtë përbën shkak për vendime të mosfillimeve të procedimeve penale të gabuara.

Një çështje tjetër që mund të lindë, mund të jetë rasti kur një ligj i ri e konsideron veprën kundërvajtje penale, ndërkohë që ligji i kohës, kur është kryer vepra penale, e cilësonte krim.

Në këto raste, sigurisht që do të aplikohet ligji më i favorshëm dhe, nëse janë plotësuar afatet e parashkrimit për kundërvajtjen penale, atëherë ndjekja penale nuk mund të fillojë e, në qoftë se ka filluar duhet të pushojë me arsyetimin se është parashkruar ndjekja penale.

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar studimit të materialit kallëzues. Ka ndodhur që, në pamje të parë, materiali kallëzues, pa u thelluar në përmbajtjen e tij dhe pa kryer veprime të tjera verifikuese nga organi, të bëjnë një kualifikim të gabuar të veprës penale të kryer e në këto kushte ajo rezulton e parashkruar, kur, në fakt nuk është e tillë. Në këto kushte, organi procedues me pa të drejtë do të vendosë pushimin, ose mosfillimin e ndjekjes penale për shkak të parashkrimit.

Në kuadrin e Konventës kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, në KP janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e duhura. Kështu, është shtuar dispozita e veprës penale e “pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287, pika 3, e këtij Kodi, ku thuhet se “dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në rastet kur personi që ka kryer vepër prej së cilës burojnë produktet e veprës penale nuk mund të merret i pandehur, nuk mund të dënohet, ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose mungon njëri nga kushtet e procedimit penal për një vepër të tillë”.

Vlerësimi i materialit kallëzues që lidhet me një moment të tillë meriton një kujdes të veçantë. Kjo, jo vetëm për rëndësinë që paraqet vepra e kryer, por edhe për faktin se vepra penale mund të jetë shuar dhe organi procedues, pa u thelluar, vendos mosfillimin e procedimit penal. Parashkrimi i ndjekjes penale konsiston në atë se, për shkak të kalimit të afatit, i cili është paraparë me ligj, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe nuk mund t’i shqiptohet dënimi personit për vepër penale që e ka kryer, andaj parashkrimi, apo vjetërsimi është institut juridik, me ç’rast shteti e humb të drejtën e zbatimit të ndjekjes penale pas kalimit të afatit. E drejta penale, përkatësisht Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i vitit 2012, njih dy lloje të parashkrimit: parashkrimin e ndjekjes penale dhe parashkrimin e ekzekutimit të sanksioneve penale. Njëjtësisht këtë e parasheh edhe Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995.

6.5.1. Parashkrimi i lëndëve penale në Gjykatat e Republikës së Kosovës, 2011-2012

Përkundër përpjekjeve që të evitohet mundësia e institutit të parashkrimit nga organet ndjekëse në R.Kosovës, dhe ato ndjekse të R.Shqipërisë që ti kushtojnë kujdes në mënyrë që ndjekjet penale të mos parashkruhen- vjetërsohen dhe kështu të pa mendohej fillimi i procedimit penal i ndjekjes së kryesit të veprës penale, prapëseprapë nuk është arritur

progres dhe preventivë dëshiruese e pritur në evitimin e lëndëve për të mos u parashkruar, fenomen ky mjaft shqetësues. Kjo dukuri është më se evidente te gjykatat, sidomos në periudhën e pas luftës ku, ende vazhdon të jetë për shkak të numrit të madhë të lëndëve dhe kuadrit jo të mjaftushëm në sistemin prokurial dhe atë gjyqësor edhe pas reformave formale të ndodhura në vitin 2010.

Kosova vazhdon të ketë një rritje enorme të numrit të parashkrimit edhe pas reformave edhe gjatë periudhës së vitit 2011-2012, ashtu si edhe në vitet paraprake, 2001-2010. Ky aspekt parashkrues është mjaft shqetësues në gjykatat komunale të Kosovës. Pa dashur të theksoj shifrën e parashkrimeve për periudhën 2001-2012, theksoj se, vetëm për vitet, 2011-2012, në 17 gjykatat komunale të Kosoves janë parashkruar 1845 lëndë penale. Po ta llogarisim në përqindje, del se rrethë 22.3% e totalit të lëndëve që janë të pranuar gjatë vitit 2011/2012 si të tilla janë parashkrua për shkak neglizhimit-kujdesit nga organet e gjyqësorit. Trendi i parashkrimit është shqetësues dhe marramendës. Vlenë të theksohet se, sipas raportit monitorues të Organizatës për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet „Çohu”, zyra e qeverisjes së mirë dhe për sundim të ligjit, shkurt 2013 fq.9, pas monitorimeve të 17 gjykatave të Kosovës në lidhje me parashkrimin –vjetërsimin e lëndëve, gjetjet konsistojnë në të cekurat e theksuara. Për më tepër, vlen të theksohet se në Gjykatën Komunale të Istogut kishte gjithsejtë 242 lëndë të parashkruara, ndërsa vetëm në vitet 2011-2012 kishte 307 lëndë të parashkruara. Kjo tregon se në këtë gjykatë janë parashkruar më shumë lëndë në dy vitet e fundit, se sa në dhjetë vitet paraprake. Poashtu, edhe në gjykatën komunale të Kaçanikut si dhe në atë të Suharekës kemi më shumë lëndë që janë parashkruar në dy vitet e fundit, se sa në dhjetë vitet paraprake. Numër më të madhë të parashkrimit të lëndëve penale, në vitet 2011-2012, kemi edhe në gjykatat komunale të Ferizajt, Gjakovës, Prishtinës dhe Klinës. Ndërsa më së paku

parashkrime kanë gjykata e Pejes, Prizerenit, Deçanit dhe e Malishevës. Është fjala për vitet 2011-2012. Sipas raportit monituros të organizatës rrjedhë se parashkrimi absolut dominon në raport me parashkrimin relativ, prej 5-10% më shumë. Nga përfundimet e këtij raporti rrjedhë se parashkrimi relativ u bie në supe gjyqëtarve, sepse nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim, ndërsa absoluti është afat që nganjëherë e diktojnë rrethanat e pamundësisë së ndjekjes penale.

Ne vijim përkitazi me lëndët e parashkrimeve nëpër gjykata do të gjeni të bashkangjitur tabelën, e cila është nxjerra nga raporti monitorues i Organizatës për Demokraci, Anit-Korrupsion dhe Dinjitet „Çohu”!, zyra e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, shkurt 2013 fq. 9.

Gjykatat Komunale	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategoriz uara/Ekzekutime Penale	Numri total i lëndëve të parashkruara
GJ. Komunale e Prizrenit	368	1183	-	1551
GJ. Komunale e Ferizajt	442	797	-	1239
GJ. Komunale e Rahovecit	385	515	149	1049
GJ. Komunale e Gjakovës	138	32	411	581
GJ. Komunale e Istogut	415	134	-	549
GJ. Komunale e Deçanit	508	6	27	541
GJ. Komunale e Klinës	-	-	523	523
GJ. Komunale e Prishtinës	91	322	105	518
GJ. Komunale e Pejës	374	61	13	448
GJ. Komunale e Malishevës	52	201	40	293
GJ. Komunale e Kaçanikut	3	256	-	259
GJ. Komunale e Kamenicës	75	58	84	217
GJ. Komunale e Suharekës	58	121	-	179

GJ. Komunale e Vushtrrisë		175		175
GJ. Komunale e Lipjanit	-	27	57	84
GJ. Komunale e Skenderaj	1	26	-	27
GJ. Komunale e Glogocit	1	3	-	4
TOTALI	2911	3917	1409	8237

Shpreh mendimin se duhet një mobilizim strategjik i KGJK-ës dhe KPK-ës, për t'i evituar parashkrimet e tilla e, në veçanti, relativin duke marr masa ndaj gjyqtarëve të çështjeve që lënë të parashkruhen lëndet me afat relativ, pa ndërmarë asnjë veprim. Një strategji dhe një kontroll i tillë duhet të jetë edhe e çështjet penale, me ç'rast parashkrimi është evident edhe në sistemin gjyqësor të Shqipërisë, i cili nuk ka afat relativ. Ka vetëm afate të përgjithshëm varsishtë sanksionimit me kanosje dënimesh por jo specifikisht për vepra të caktuar penale⁶⁹. Vlen të theksuar se K.Penal i shqipërisë i vitit 1980, ne nenin 40 të tij, kishte normuar afatin për vepra penale të kundërvajtjes i cili saktëson dy situata të parashkrimit dhe atë kur dihej autori i krimit dhe kishin kaluar 5 (pesë) vite pa u mare ne pyetje vepra parashkruhej. Situata kur pasoja ishte shkaktuar por autori i krimit nukë ishte zbuluar dhe për këtë kishin kaluar 10 dhjetë vite. Këto dy momente ekzistimi e privonin nga kjo e drejtë organin e prokurorisë për të filluar procedimin apo për të vazhduar nese si i tillë kishte filluar.

Gjykata e lartë në Tiranë, në një rast, lidhur me parashkrimin e procedimit penal për një vepër penale që kishte ndodhur në vitin 1999 dhe fillimi i procedimit të organit procedues ka nisur në vitin 2007. Me këtë rast ka vendosur rrëzimin e kërkeses së

⁶⁹ Sipas nenit 66 par.1 pika a,b,c d të KP, të R.Shqipërisë, përcaktohet : Nuk mund bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës e deri në çastin e marrjes se personit si të pandehur kanë kaluar:

- njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;
- dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënimënga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;
- pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;
- tri vjet për kundërvajtje penale që parashikojnë dënim gjerë ne dy vjetë burgim
- dy vjet për kundërvajtje penal që parashikojnë dënim me gjobë.

prokurorisë për gjykimin e çështjes, pasi që procedimi i nisur për kete veper është parashkruar. Gjykata arsyeton se procedimi për këtë vepër penale nuk mund të fillonte, pasi që nga koha e ndodhjes së faktit të parashikuar në kodin penal, si vepër penale, kane kaluar më shumë kohë sesa vetë dënimi, të cilin e parashikojnë kodet penale përkatëse në aplikim, në Shqipëri –Kosovë, për veprat penale te tyre të normuara ligjësisht. Këtë rast gjykata arsyeton se gjykata e shkallës së parë, si dhe ajo e apelit kanë vepruar drejt në zbatim të ligjit material dhe procedural penal, përkundër kërkesës se prokurorisë për gjykimin e çështjes.

Vendimi nr. 241 26.09.2012 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë për pushimin e procedimit penal për shkak të parashkrimit të veprës penale.

A. Rrethanat e çështjes -Prokuroria e Rrethit Tropojë ka nisur procedimin penal, nr.82, viti 2007, në ngarkim të pandehurve A. M., H. D. dhe M. S., të akuzuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr.84, datë 22.10.2008 vendosi:

Pushimin e gjykimit të çështjes penale nr.98 akti në ngarkim të pandehurve A. M., H. D. dhe M. S. pasi që ndjekja penale është parashkruar.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.103, datë 15.04.2009, vendosi:

Lënien në fuqi të vendimit nr.84, datë 22.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

B. Arsyetimi ligjor i vendimit të ankimuar-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr.84, datë 22.10.2008, ka arsyetuar në këtë mënyrë:

Ndjekja penale është **parashkruar, bazuar në nenin 66/c të K.Penal**, sepse regjistrimi fillestar nga ana e të pandehurve është bërë nga viti 1996-2000, ndërsa regjistrimi i tyre si të pandehur është bërë në 08.09.2007, pra, pas afro 7 vjetësh.

Sipas nenit 248, të K.Penal, ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.09.2004, maksimumi i dënimit është bërë 5 vjet, nga 7 vjet që ishte me ligjin e mëparshëm dhe parashkrimi i kësaj veprë, sipas nenit 66/c, është plotësuar në fund të vitit 2005 e për pasojë edhe ndjekja penale jashtë këtij afati nuk mund të vazhdojë.

Ndryshimet e bëra në vitin 2007, duke rritur maksimumin e dënimit për këtë veprë, nuk kanë fuqi prapavepruese për ato vepra penale, për të cilat është plotësuar afati i parashkrimit përpara ndryshimit të këtij ligji.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.103, datë 15.04.2009 ka arsyetuar në të njëjtën mënyrë.

Kundër vendimit nr.103, datë 15.04.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.84, datë 22.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ka ushtruar rekurs Prokuroria e Apelit Shkodër, e cila kërkon prishjen e këtyre vendimeve duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimet e gjykatave janë të gabuara, sepse vepra penale e shpërdorimit të detyrës nga ana e të pandehurve është kryer në vitin 1999 dhe ushtrimi i ndjekjes penale ka filluar në datë 30.08.2007. Në të dyja rastet, edhe në atë të kryerjes së veprës penale dhe të fillimit të ndjekjes penale, vepra penale e shpërdorimit të detyrës ka parashikuar si marzhë (lartësi) të dënimit gjobë deri 7 (shtatë) vjet burgim. Sipas nenit 66/c, nuk mund të kryhet ndjekja penale kur nga kryerja e veprës deri në marrjen e personit si të pandehur, kanë

kaluar 10 vjet, për krime që parashikojnë dënime nga 5 deri 10 vjet burgim. Pra, nuk kanë kaluar 10 vjet nga kryerja e veprës, nga viti 1999 deri më 30.08.2007 e as ditën e gjykimit.

Referenca në nenin 248 të K. Penal, i cili ka qenë në fuqi për periudhën prej 19.06.2004, deri 26.02.2007, ku kjo vepër parashikonte, si sanksion penal atë të dënimit me burgim deri në 5 vjet, është i gabuar.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

Duke pasur parasysh gjithë sa u tha më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, Gjykata e Apelit Shkodër, ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin material e procedural penal përkitazi me aplikimin e ligjit favorizues për të pandehurit, si një nga parimet bazë të së drejtës penale.

Pretendimi i organit të akuzës se, të dy gjykatat kanë gabuar përkitazi me referimin në ligjin nr.9275, datë 16.09.2004 i cili ka ulur maksimumin e dënimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës në 5 vjet nuk qëndron.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.14, datë 17.04.2007, në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit penal, ka përcaktuar se:

“Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lexo retro agit in mitius* ose *lex mitior retro agit*). Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përrjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal, i cili favorizon pozitën e të pandehurit, synon t’u përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë

shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen”.

Duke iu referuar qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese thekson se: “ parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta⁷⁰”.

Në rastin konkret, kjo vepër penale është parashkruar në vitin 2005, pasi që me ligjin nr.9275, datë 16.09.2004, maksimumi i dënimit është bërë 5 vjet nga 7 që ishte me ligjin e mëparshëm dhe, me të drejtë, të dy gjykatat kanë vendosur pushimin e gjyimit të çështjes.

Nisur nga sa u tha më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.103, datë 15.04.2009 i Gjykatës së Apelit, Shkodër, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr.84, datë 22.10.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tropojë, është rezultat i zbatimit të drejtë të ligjit penal, e si i tillë duhet lënë në fuqi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur : Lënien në fuqi të vendimit nr.103, datë 15.04.2009 i Gjykatës së Apelit Shkodër.Mendoj se ky vendim është unifikimi i një praktike të drejtë që lidhet me parashkrimin e procedimit penal, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Penale.

6.5.2. Fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale

Parashkrimi i ndjekjes penale fillon prej ditës kur është kryer vepra penale. Për përcaktimin e fillimit të afatit të parashkrimit është vendosur koha e kryerjes së veprës

⁷⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.35, datë 20.12.2005. Përmbledhje e vendimeve, viti 2005, fq. 308

penale. Shumë kode penale në botë e pranojnë teorinë e veprimit dhe jo të pasojës. Te veprat penale të vazhduara dhe veprat penale kolektive, parashkrimi fillon me ndërmarrjen e veprimit të fundit, p.sh., te vepra penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332, parashkrimi i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve fillon prej ditës së shfrytëzimit të dokumentit. Te veprat penale të gjendjes fillimi i parashkrimit fillon në momentin e paraqitjes së pasojës. Për veprimet në bashkëpjesëmarrje është koha e ndërmarrjes së veprimit për veprën kryesore dhe jo koha kur është ndërmarrë vetë veprimi bashkëpjesëmarrës. Te deliktet omisive garantuese me paramendim fillimi i parashkrimit përputhet me mosplotësimin e detyrimeve garantuese⁷¹.

Sipas Kodit Penal të Kosovës fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse shfaqët më vonë ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë, neni 107 (shih nenin 107,paragraf 1 të Kodit penal të Kosovës, të vitit 2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19, paragraf 1 të KPRK-së). Në rast se vepra penale është kryer kundër personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur viktimi të ketë mbushur tetëmbëdhjetë vjeç neni 107,paragraf 2, i KPRK-së (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082, fq. 46), (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, fq. 46).

6.5.3. Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale

Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale paraqitet atëherë kur, për shkak të disa rrethanave të parapara me ligj, ndjekja penale nuk mund të fillohet, apo, nëse është

⁷¹V. Kambovski, *E drejta penale*, Shkup, 2006, fq. 1068

filluar, nuk mund të vazhdohet sipas ligjit. Gjatë asaj kohe, derisa janë të pranishme ato rrethana, të cilat e pengojnë fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale, parashkrimi nuk rrjedh. Kjo ngecje e afatit të parashkrimit, për shkak të efektit të rrethanave të caktuara, quhet ndalja e parashkrimit. Kur pushojnë pengesat që kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit, afati i parashkrimit vazhdon të ecë. Në atë mënyrë që, për aq kohë sa ka zgjatur ndalja, për aq kohë vazhdohet edhe afati i parashkrimit.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të pengesave që mund të shkaktojnë ndaljen e afatit të parashkrimit: pengesat faktike dhe pengesat juridike.

6.5.3.1. Pengesat faktike

Janë ato rrethana dhe situata reale, të cilat e bëjnë të pamundshëm fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale. Të tilla janë, p.sh. arratisja e kryerësit të veprës penale, kur nuk dihet vendbanimi i kryerësit, okupimi i territorit nga ana e armikut, tërmeti, vërshimet, zjarri dhe rrethanat e tjera të ngjashme, të cilat e bëjnë të pamundur punën e gjykatës.

6.5.3.2. Pengesat juridike

Pengesat juridike ekzistojnë kur është fjala për ndonjë rrethanë apo situatë të natyrës juridike, për shkak të të cilave nuk mund të fillohet apo të vazhdohet ndjekja penale. Të tilla, p.sh janë: imuniteti i deputetit të parlamentit, sëmundja psikike e të pandehurit gjatë procedurës penale etj. Në raste kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, ndalja e parashkrimit mund të paraqitet vetëm ndaj atij bashkëpunëtori, tek i cili ekzistojnë rrethanat apo situatat e sipërpërmendura, kurse ndaj të tjerëve afati i përshkrimit vazhdon të ecë⁷²

⁷²I. Salihu, *E drejta penale*, Prishtinë, 2010, faqe. 561–562

6.6. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale

Ndërprerja e përshkrimit të ndjekjes penale, në kodin tonë penal, është paraparë në dy raste kur parashkrimi ndërpritet në çdo veprim të organit kompetent shtetëror, i cili ndërmerret me qëllimin të ndjekjes së kryerësit të veprës penale, dhe rasti i dytë, kur kryerësi gjatë afatit të parashkrimit kryen vepër të re penale. Vepra e re penale nga pesha duhet të jetë e njëjtë, apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë.

Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim procesor që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryerësit, për shkak të veprës së kryer. Veprimi procedural duhet të ndërmerret kundër personave konkretë, në cilësinë e kryerësit, për vepër konkrete penale. Me këtë rast janë të përjashtuara veprimet e ndërmarra kundër kryerësit të panjohur, ose kundër personit konkret, p.sh. kryerësi vërtetë është thirrur në bisedë informative në polici, por pa shkas që biseda të jetë konkretisht për veprën penale. Veprimi i ndërprerjes së parashkrimit, për dallim nga ndalja, përbëhet në atë që, për secilën ndërprerje, (secili veprim procedural, ose vepër e re penale), parashkrimi fillon të rrjedhë, kështuqë, në afat të parashkrimit nuk llogaritet koha e parashkrimit para paraqitjes së ndërprerjes.

Në bazë të KP të R.Kosovës, afati i parashkrimit ndërpritet sipas çdo veprimi që organi procedues e ndërmerrë për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer, (neni 107, par. 5). Afati i parashkrimit, poashtu ndërpritet kur kryerësi, para skadimit të afatit të parashkrimit, kryen një vepër tjetër penale, me peshë të njëjtë ose më të rëndë se vepra penale e mëparshme, (neni 107, par. 6). Pas çdo ndërprerjeje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

6.7. Parashkrimi absolut rrethanë e mosfillimit të procedimit penal

Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit mund të çojnë, praktikisht, që asnjëherë të mos shkaktohet parashkrimi. Për këtë arsye Kodi Penal e ka paraparë parashkrimin absolut të

ndjekjes penale, i cili lind kur kalon dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin, (neni 107, par. 8). Kështu, p.sh. nëse për ndonjë vepër penale është paraparë parashkrimi relative për 2 vite, parashkrimi absolute do të jetë 4 vite, apo, nëse për një vepër është paraparë afati i parashkrimit 3 vite, parashkrimi absolute do të jetë 6 vite. Parashkrimi relativ dhe absolut, sipas legjislacionit Kosovar, varet nga sanksioni i veprës penale. Ndryshe, ky parashkrim rregullohet sipas legjislacionit Penal të Shqipërisë, i cili ka vetëm parashkrim absolut të përgjithshëm e jo edhe atë relativ.

6.8. Lloji i caktuar i veprave penale jo pengesë e fillimit të procedimit penal në çdo kohë

Mosparashikimi i krimeve ndërkombëtare, ndjekja penale dhe ekzekutimi i dënimit nuk vjetërsohet për veprat penale, si: gjenocid, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, të parapara në KPRK-së dhe veprat, të cilat janë paraparë me Konventa ndërkombëtare, si ajo e Kombeve të Bashkuara për mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, nga viti 1968, si dhe Konventa Evropiane, e vitit 1974.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës moszbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë, neni 111, paragraf 1 dhe 2, asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit ose për vepra të tjera penale, të cilat sipas së drejtës ndërkombëtare, nuk parashkruhen. Edhe vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkruhet. Afatet e parashkrimit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 106, janë të ndryshme dhe këto afate rrjedhin varësisht nga sanksioni penal i veprës penale të posaçme dhe se mosrespektimi i tyre sjell vjetërsimin dhe nuk lë mundësi që kryerësit e veprave penale të ndiqen, apo të dënohen nga gjykatat.

6.8.1. Amnistia si rrethanë përjashtuese e ndjekjes penale

Si rrethanë e radhës për përjashtimin e ndjekjes penale është edhe amnistia. Është akti i amnistisë, akt ky që e ndërmerr organi kompetent, nga vuajtja e dënimit tërësisht, apo pjesërisht ose bën zëvendësimin e dënimit në çdo lloj dënimi më të butë⁷³. Siç dihet, amnistia është një akt ligjor, me fuqi prapavepruese të cilin e sjell parlamenti, në bazë të cilit nuk mund të fillohet procedimi penal. Nëse ai ka filluar gabimisht, duhet të pushohet për llojet e veprave të caktuara penale, të cilat, në ligjin e amnistisë, janë përcaktuar për një periudhë kohore.

Sigurisht edhe për këtë rrethanë të mosfillimit të procedimi penal, për t'iu shmangur çdo lloj subjektivizmi, themi se duhet të arsyetohet mirë e qartë mbi bazën e të dhënave konkrete. Kjo bëhet për të konkluduar me saktësi nëse veprimet ose mosveprimet e presonit bëjnë pjesë në ato lloje të veprave penale për të cilat zbatohet amnistia. Amnistia nuk zbatohet për veprat penale të qëndrueshme, në qoftëse gjendja e kundërligjshme vazhdon edhe pas daljes së aktit të amnistisë, si dhe për veprat penale vazhduese, në rast se akti i fundit i saj kryhet pas daljes së aktit të amnistisë.

Ky është rasti më i qartë kur duhet të procedosh me vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Kjo për faktin se, për të përcaktuar nëse vepra penale është e amnistuar apo jo, është një proces i thjeshtë ballafaqimi i faktit të pretenduar në kallëzim me ligjin e amnistisë. Por, edhe këtu, me të drejtë, ligjvënësi ka përcaktuar pushimin e procedimit penal, kur ai ka filluar gabimisht nga Prokuroria, ose kur ka filluar procedimi i rregullt. Por, nëse në përfundim të hetimeve rezulton se akuza fillestare nuk qëndron më, duke bërë një cilësim ligjor të veprës penale për të cilën zbatohet amnistia, atëherë, rrjedhimisht, duhet të vendosësh pushimin e ndjekjes penale.

⁷³Grup autorësh,*Komentari i Kodit Penal*, botimi i vitit 2004.

6.8.2. Rastet e tjera të parashikuara me ligj –rastet e gjykuara

Në kreun e dytë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë e njeriut janë të përcaktuara si të drejta themelore, të garantuara në këtë akt. Vlen të theksohet se në nenin 34 të saj përcaktohet se: “Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykim i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”⁷⁴. Një dispozitë e tillë kushtetuese gjen pasqyrimin e saj në nenin 7 të KPP-së, ku thuhet ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtën vepër. Rasti i gjykuar është shprehje e parimit të sigurisë juridike, sipas së cilës, një procedim penal i mbaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtit person nuk mund të rifillojë përsëri. Vendim gjyqësor të formës së prerë kemi në rastet kur kundër tij nuk lejohet ankim në një gjykatë më të lartë, pasi që kanë kaluar afatet e ankimit, ose, kur ankimi nuk është pranuar dhe është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës më të ulët nga gjykata më e lartë. Një gjë e tillë reflekton parimin e sigurisë juridike, sipas së cilës çdo procedim penal duhet të ketë një fund. Është ky parim që nuk lejon të fillohet një procedim i dytë kundër të njëjtit person dhe për të njëjtën vepër penale. Nëse rasti i gjykuar është më i qartë, problemi konsiston me faktin se, si do të veprohet në ato raste kur është vendosur mosfillimi apo pushimi i çështjes për një çështje konkrete në ngarkim të një personi konkret, por që nuk është ushtruar ankim as në gjykatë dhe as te prokurori i përgjithshëm, e që më pas paraqitet i njëjti kallëzim për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtit person:

A mund të operosh me mosfillim, apo mjafton që t’i përgjigjesh qytetarit me një shkresë se rasti është shqyrtuar një herë dhe ju keni humbur afatet e ankimit?

⁷⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998

Ndryshe nga KPP-ja e vitit 1980, në nenin 71, të tij, i cili parashikonte mosfillimin e hetimeve, me ç'rast më parë ishin kryer hetime dhe çështja ishte pushuar, dispozitat procedurale të Kodit në fuqi, me të drejtë nuk e parashikojnë një mundësi të tillë. Dispozitat aktuale parashikojnë se prokurori më i lartë ka të drejtë të urdhërojë shfuqizimin e akteve të prokurorit më të ulët. Kjo është edhe e vetmja mundësi e drejtë dhe e ligjshme.

Vënia në lëvizje e prokurorit të përgjithshëm, i cili është i vetmi autoritet që mund të shfuqizojë vendimet e prokurorëve më të ulët, me përjashtim të rastit kur kallëzuesi, apo, kryesisht Prokuroria ka zbuluar ndonjë rrethanë, fakt apo provë e cila tregon qartë se vendimi i mosfillimit të procedimit apo i pushimit ka qenë i gabuar, çdo zgjidhje tjetër do të përbënte një kërcënim të rendit juridik dhe një zbehje të autoritetit të Prokurorisë në drejtim të mbrojtjes së rendit juridik.

Si rast i gjykuar merret edhe atëherë kur shtetasi shqiptar, për vepër penale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, po që i nënshtrohet parimit të fajësimit të dyfishtë, është dënuar me vendim të formës së prerë dhe dënimi është ekzekutuar.

Parimi i eksteritorialitetit, si rast – rrethanë që nuk lejonë fillimin e procedimit e nëse ka filluar vazhdimin e tij.

Personat që gëzojnë të drejtën e eksteritorialitetit kanë imunitet konsideral penal absolut, që do të thotë se organi i Prokurorisë është në pamundësi objektive për të kryer veprime procedurale penale. Pra, për disa kategori që grup i veçantë personash për shkak të detyrave që i kryejnë, ligji parashikon garanci gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre për këta funksionar. Ndër këta mund të përmendim personat që gëzojnë të drejtën e eksteritorialitetit, si përfaqësuesit diplomatik të shtetit të huaj që akreditohen në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat që gëzojnë këtë status nga Konventa e Vjenës. Rrethanë tjetër që nuk lejon fillimin e procedimit penal, ose vazhdimin e tij nëse ka filluar,

ka të bëjë me efektet e ligjit penal shqiptar ndaj shtetasve shqiptarë, të cilët kryejnë krime në territorin e një shteti tjetër.

Për rastin e një krimi, p.sh. që ndërlidhet me paraqitjen e identitetit të rremë përpara autoriteteve kompetente të shtetit të huaj, duhet që veprimi të jetë i dënueshëm penalisht, si nga shteti i huaj, ashtu edhe nga shteti ynë. Pra, të ekzistojë kushti “i fajësimit të dyfishtë”⁷⁵. Për këto lloj veprash, të kryera jashtë territorit të Shqipërisë, nuk mund të procedohet në fillim procedimi penal, pa një informacion të plotë të kuptimit të dispozitës penale, nga autoritetet e huaja, që vepra është e dënueshme penalisht edhe në shtetin e huaj. Megjithatë, praktika ka treguar se, pavarësisht se personat që kanë paraqitur identitet të rremë në shtetin e huaj, nuk janë proceduar nga shteti i huaj, por, pasi janë kthyer në Shqipëri janë proceduar penalisht për këtë fakt. Për këto lloj veprash, të kryera jashtë territorit të Shqipërisë, nuk mund të procedohet me fillim procedimi penal pa një informacion të plotë të kuptimit të dispozitës penale nga autoritetet e huaja se vepra është e dënueshme penalisht edhe në shtetin e huaj. Një informacion i pamjaftueshëm do të përbente shkas për fillim të paligjshëm të ndjekjes penale. Se si do të veprohet rastet kur veprat penale, të kryera nga shtetasit shqiptarë, janë të parashikuara nga të dyja shtetet si të dënueshme penalisht, por që në shtetin e huaj këto vepra penale janë amnistuar?

Mendoj se, përderisa vepra është amnistuar, atëherë kjo vepër do të cilësohet e pa dënueshme në kuptimin e njëkohshëm që parashikon neni 7, i KP-së. Do të thotë se s’mund të procedohen as në Shqipëri.

Një rrethanë tjetër që nuk lejon fillimin e procedimit penale është edhe rasti i veprave penale, të përcaktuara në nenin 59, të KPP-së (i dëmtuari akuzues).

Në punën e përditshme të organit procedues, jo rrallë, paraqiten kallëzime penale të veprave të përcaktuara me nenin 59, të KPP-së, të cilat vepra ndiqen me kërkesën e të

⁷⁵ A. Hoxha, *Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BR-së*

dëmtuarit të akuzës e që, për këto raste është bërë praktikë që të mos vendoset mosfillimi i procedimit penal, duke iu referuar, për këtë, nenit 290, shkronja “e” e KPP-së, që bën fjalë për rrethanën “në të gjitha rastet e tjera të përcaktuara nga ligji”.

Ndonëse ligji procedural penal nuk e parashikon mosfillimin e procedimit penal për një rrethanë të tillë, në praktikën e punës së këtij organi është ndjekur, pikërisht, kjo praktikë. Praktika e tillë është bërë me “arsyetimin” e dhënies rrugë të kallëzimit, për shkak të mungesës së njoftimeve të të dëmtuarit akuzues, kur disponohej me moskompetencë lëndore sipas neneve 83 e 84 të KPP-së. Në momentet e vendosjes së moskompetencës i dëmtuari akuzues, i cili kishte bërë kallëzimin tek organi procedues nuk njoftohej me këtë vendim e, në këto kushte, këto kallëzime depozitoheshin pranë gjykatës. Gjykata nuk i jep rrugë për një kohë të gjatë, apo i arkivonte ato pa i gjykuar. Pikërisht për t’i dhënë fund kësaj praktike të gjykatës, në kompromis edhe me këtë të fundit, u vendos që në këto raste të procedohej në mosfillim. Duke u njohur me një vendim të tillë i dëmtuari akuzues, i lind e drejta për t’u ankuar në gjykatë dhe, me këtë rast, ishte kjo e fundit që, kur i dëmtuari i akuzës nuk tërhiqej nga ankimi, vijonte ta ndiqte çështjen, vazhduar në nenin 59 të KPP-së. Duke vepruar në një mënyrë të tillë, mendoj se vendimi i mosfillimit i organit procedues, jo vetëm nuk gjenë mbështetje në LPP, por asnjë justifikim apo “kompromis” nuk mund të shërbejë për të përligjur mosrespektimin e ligjit. Ashtu siç vihet në lëvizje organi procedues duke njoftuar të dëmtuarin akuzues me vendimin e mosfillimit, poashtu duhet të vihet në lëvizje Gjykata për të njoftuar të dëmtuarin akuzues, i cili ka vënë në lëvizje procesin dhe, në rast se ai merr njoftim e nuk paraqitet në seancë për shkaqe të arsyeshme, siç parashikon edhe paragrafi 3 i nenit 59, të KPP-së, gjykata vendos pushimin e gjykimit. Pa dyshim që, i dëmtuari i akuzës, në këto raste ka të drejtën të kërkojë rifillimin e çështjes, kur tregon se nuk është njoftuar rregullisht për ditën e gjykimit, siç ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për gjykimin e çështjes

6.9. Mosfillimi i procedimit penal si fazë paraprake e procedimit penal

Mosfillimi i procedimit penal në esencë qëndron në faktin se ekziston një hapësirë boshe, për sa u përket veprimeve që mund të kryhen nga prokurori e policia gjyqësore, për të arritur në një nga shkaqet që parashikon KPP-në (shih nenin 290 të KPPSH-së). Pra, problemi qëndron në raportin që duhet të ekzistojë në mes të marrjes së këtij vendimi të rëndësishëm dhe natyrës së veprimeve që mund të kryhen. Përcaktimi i këtij raporti, duke qenë se Kodi nuk përcakton asgjë për veprimet që kryhen nga prokurori, në këtë fazë, duhet të dërgojë në njërën nga mundësitë e mëposhtme:

- Për të arritur në vendimin e mosfillimit duhet të kryhen vetëm veprime verifikuese konstatuese, por pa kryer veprime hetimore, si ato të parashikuara nga KPP-ja (shqyrtimet e kallëzimeve penale dhe raporteve të tjera të pranuar, pa pasur nevojë të ndërmerren hetime të përcaktuara sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe atij të Shqipërisë).
- Për të arritur në vendimin e mosfillimit duhet të kryhen veprime hetimore, duke respektuar kërkesat e KPP-së.
- Për të arritur në vendimin e mosfillimit të procedimit duhet të kryhen veprime të tilla hetimore, siç mund të jenë marrja e të dhënave nga personat që ndodhen në vendin e ngjarjes, sekuestrimi i sendeve apo pronave që mund të shërbejnë si provë, të bëjë këqyrje të vendeve, sendeve të të dëmtuarit, apo të caktojë një ekspert, të bëjë fotografimin e gjurmimeve të tjera për të përcaktuar nëse ka vend ose jo për fillimin ose mosfillimin e procedimit penal (veprimtaria me iniciativë të policisë gjyqësore).

Zgjidhja e drejtë e këtij raporti ka rëndësi të jashtëzakonshme, pasi që ajo lidhet me zbatimin e drejtë të ligjit. Nga ana tjetër, kjo ka rëndësi të madhe për sa u përket kushteve aktuale të praktikave kontradiktore dhe debateve që ndeshen sot në organin procedues.

Mungesën e një qëndrimi të njëjtë, në cilindo variant, që të konkludohet, e paguan si shoqëria, e cila kërkon medoemos, luftën ndaj krimit, ashtu edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të themi se e paguan edhe prokuroria, për shkak të qëndrimeve të politikës. Vështirësi për zgjidhjen e këtij problemi gjejmë në shumë aspekte, qoftë në atë strukturor të kodit, ashtu dhe në terminologjinë e përdorur, si dhe në hendeqet e tjera.

Kështu me nenin 24.1 të KPP-së të R.SH. dhe me ligjin mbi organizimin e Prokurorisë, thuhet shprehimisht: “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime... ngre akuzë në gjykatë... “kjo do të thotë se termi *ndjekje penale*, si term dallohet nga hetimi dhe akuza”. Në të kundërtën, do të kuptonim se për të njëjtin moment procedural, KP-ja përdor terma të ndryshëm që kanë edhe të njëjtin kuptim, gjë që mendoj se është e padrejtë.

Pra, për përcaktimin e funksioneve, KPP-ja përdor ndjekje penale, procedim penal, hetime, përfaqësim akuze etj. Por, këtë problem e zgjidh KRSH-ja, e cila, në nenin 148, pika 1, të saj përcakton se “prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq..”. Në një interpretim logjik të dispozitës, duke u nisur nga fakti se Kushtetuta është një akt themelor që në përmbajtjen e saj karakterizohet nga parimet themelore dhe sinteza, arrijmë në përfundimin se ndjekja penale përfshinë dhe hetimin. Arsyetimi i mësipërm del qartë nga neni 277, i KPP-së, i cili thotë: “Prokurori dhe Policia Gjyqësore zhvillojnë brenda kompetencave të caktuara hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Kjo do të thotë se hetimet kryhen pikërisht nga funksioni themeltar (kushtetues), ushtrim i ndjekjes penale. Ndërkaq, siç e dimë, kemi termin e përgjithshëm të cilin e përdor Kushtetuta, që është termi „ndjekje penale”, ndërsa Kodi dhe ligjet e tjera përdorin koncepte të veçanta (hetime). Gjithashtu, dimë se ndërmjet konceptit të përgjithshëm dhe koncepteve të veçanta nuk ka kontradikta, pasi që rrjedhin, pikërisht, nga koncepti i përgjithshëm, duke konkretizuar atë. Ndërkaq, po t’i referohemi analizës strukturore të

kodit, hetimet paraprake, si një ndër kategoritë kryesore të ndjekjes penale trajtohen me një titull, e, pikërisht titulli VI.

Kapitulli i parë përmban dispozita të përgjithshme; Kapitulli i dytë përmban dijeni për veprën penale; kapitulli i tretë përfshin kushtet e procedimit. Por, që të mosfillosh procedimin penal do të thotë të kryesh veprime paraprake, për të arritur në ndonjërin nga ato rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

Po t'i kthehemi analizës strukturore të Kodit, vëmë re se nuk paraqitet asnjë dispozitë që të përcaktojë se për çfarë veprimesh paraprake konkrete është i autorizuar prokurori dhe policia gjyqësore për të kryer përpara se të vendosë mosfillimin e procedimit penal. Është e domosdoshme, në këto raste, që të ndërmerren veprime konkrete e hetimore, që të vërtetosh ndonjërin nga ato rrethana.

Ndërkaq, është e vërtetë se, të drejta të ndryshme pozitive kanë autorizuar prokurorinë dhe policinë gjyqësore që të kryejnë veprime konkrete procedurale, të përcaktuara në mënyrë taksative në të drejtat e tyre dhe, mbi bazë të tyre, të vendosin fillimin e procedimit penal-ndjekjes penale. Në këtë mënyrë edhe ligjvënësi ynë ka parashtruar disa kushte, në mënyrë që të fillohet ose të mosfillohet procedimi penal. Por, nga ana tjetër, ka hartuar të përcaktojë konkretisht se çfarë veprimesh procedurale mund të kryejnë prokuroria dhe policia gjyqësore, mbi bazë të cilave të vendosë fillimin e procedimit penal apo mosfillimin e tij. Ndërkaq, duke u nisur nga mungesa e kufizimeve të termeve të përdorura në Kod kemi siç vijon:

-Duke u nisur nga kuptimi gjyqësor i fjalës procedim,

-Duke u nisur nga kuptimi gjuhësor i mbiemrit penal që lidhet me një veprim ose mosveprim të dënueshëm nga ligji,

-Duke u nisur nga teknika legjislative, në të cilin veprim vërejmë se veprimtaria me iniciativë të policisë gjyqësore bën pjesë në kapitullin e hetimeve paraprake, por është i

renditur së bashku me veprimtarinë e prokurorit në krye, si pasardhës i Institutit të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal.

-Duke u nisur nga fakti se rrethanat e mosfillimit të procedimit penal lidhen, si me faktin, ashtu edhe me personin, arrin në konkluzionin e vetëm e të pakundërshtueshëm që, veprimtaria, me iniciativë të policisë gjyqësore, është pjesë përbërëse e procedimit penal, që do të thotë se kjo veprimtari shënon praktikisht fillimin e procedimit penal. Të drejtat e ndryshme pozitive e kanë zgjedhur problemin që po e evidentojmë, duke parashikuar shprehimisht veprimet që mund të kryhen para nisjes së procedimit penal. Këto veprime janë të parashikuara, shprehimisht, në këto kode dhe, si të tilla, kryhen nga subjektet e caktuara, prokuroria dhe policia hetimore në Kosovë, ndërsa nga ajo gjyqësore në Shqipëri. Këto subjekte veshën, në formën e caktuar, nga KPP-ja dhe, për pasojë, kanë një vlerë të caktuar procedurale, si për nisjen e procedimit ashtu edhe për vlerën provuese.

Në këtë këndvështrim, këto të drejta e kanë zgjidhur mjaftë mirë këtë institut, atë të mosfillimit, pasi që disjplinohet me rregulla të qarta për kryerjen e veprimeve procedurale të ndryshme e të shumëllojshme, nga policia e prokuroria. Kjo bëhet duke qenë në uniformitet me vetë arsyen e ekzistencës së këtyre organeve publike, që është ndjekja penale apo bërja e hetimeve. Kodi i Procedurës Italiane, me nenin 326 të tij, thekson se: “Prokuroria e policia gjyqësore ushtrojnë aktivitete për të bërë të mundur verifikimin e për të vendosur të ushtrojë ndjekjen penale ose të bëjë mosfillimin”. Pra, në këtë kod parashikohet se këto organe kanë të drejtë për të verifikuar nëse ka akt kriminal apo jo dhe mund të hartojnë akte jotipike, akte këto të paparashikuara me KPP-në, por të nevojshme për të përcaktuar ushtrimin e ndjekjes penale.

Duke qenë në kushtet kur Kodi Penal shqiptar nuk e kishte një normim të tillë, është shfaqur nevoja që prokurori i përgjithshëm të sjellë një udhëzim, përmes të cilit ka normuar mosfillimin nga pikëpamja e afatit kohor, ashtu edhe nga pikëpamja rregulluese, pasi që nga

praktikat e deriatëhershme kallëzimet qëndronin për një kohë relativisht të gjatë (edhe nga disa muaj) pa u vendosur as fillim procedimi dhe as mosfillim i procedimit penal. Përmes tyre është synuar të arrihet deri te një disiplinim në këtë drejtim për bartësit e çështjeve në drejtim të asaj që në mungesë provash, kallëzimin penal ta hedhin poshtë, ta kthejnë në plotësim etj., e të mos fillojnë procedimin e panevojshëm, në mungesë provash apo fakteve.

KAPITULLI VII: DINAMIKA E FILLIMIT APO MOSFILLIMIT TË PROCEDIMEVE PENALE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI 2010-2015

Periudha para riorganizimit të sistemit të ri gjyqësor, vitet 2010-2012

Në kuadër të këtij kapitulli është synuar të pasqyrohet vëllimi i kallëzimeve penale të paraqitura dhe trajtuara nga organet ndjekëse, para organizimit të sistemit gjyqësor, për vitet 2010, 2011–2012, dhe pas riorganizimit të sistemit të ri gjyqësor në R.Kosovës, për vitet 2013, 2014 dhe 2015, si dhe paraqitjet e kallëzimeve të ndodhura për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 të organet ndjekëse në Republikën e Shqipërisë. Krejt kjo, me qëllime që përmes të dhënave të siguruara nga organet ndjekëse prokurorive qendrore të dyja vendeve të paraqitet dinamika e fillimeve dhe mosfillimeve në përgjithësi vitesh dhe në veçanti vitesh duke shprehur për vite numrin e kallëzimeve penale të regjistruara pranë organeve ndjekëse, fillime, mosfillimet, pezullimet, pushimet, dërgimet në gjykata përkatëse, përfaqësimet gjyqësore nga organi akuzës në shkallë nivel të gjykatave, si dhe epilogun e vendimeve gjyqësore. Të gjitha këto të dhëna duke i shtjelluar teoritikisht me formalizim grafikë përmes figurave të cilat do jenë pjesë e këtij kapitulli përmes të secilit do të pasqyrohet efektiviteti i organeve ndjekëse në zgjedhjen e çështjeve fillu nga organet ndjekëse e deri në epilogun për dhënje të verdiktit- vendosjes meritorë të çështjeve penale. Në vijim do të shprehen grafikonet e fillimit dhe mos-

-fillimit, të cilat janë ndërmarrë në nivel vendi, për periudhën para 1 janarit 2013, për vitet 2010-2012 dhe, më vonë, pas riorganizimit, për vitet 2013-2015, në Kosovë dhe në shtetin Shqiptar, referuar të dhënave të siguruara raportet vjetore statistikore, nga shërbimet - dikasteret përkatëse të Prokuroria e Shtetit në Kosovë dhe Prokuroria e Përgjithshme –Tiranë. Të gjitha këto janë të tërhequra fizikisht dhe në mënyre elektronike, për vitet 2010–2015 dhe atij gjyqësor⁷⁶. Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli përveç aspektit teorik që do të jetë në vëmendje elaborimi dhe studimi, s’do të anashkalohet se shtjelluari efikasiteti i prokurorive të Kosovës dhe të Shqipërisë, sipas instancave të organizimit dhe funksionimit ligjor si dhe epilogu i vendimmarrjeve gjyqësore të këtyre dy shteteve rreth vendosjes në lidhje me procedimet penale të fillimit apo mosfillimit. Në këtë kapitull jemi përpjekur që, përmes të dhënave të siguruara dhe të grumbulluara në rrugët ligjore dhe, pas analizimit të tyre veç e veç, të të dy vendeve, paraqesim shtrirjen e kriminalitetit, në nivel, të dy vendeve, si dhe azhuritetin e organeve ndjekëse drejt luftimit të tij, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, duke pasqyruar ardhjet kallëzuese –denoncuese të veprave nga institucionet me të drejtë paraqitjeje të denoncimeve. Përkushtimin e organeve për zgjidhjen e tyre, përmes vendimmarrjeve konkrete, rreth fillimit apo mosfillimit të hetimeve nga prokuroritë, dërgimin e akuzave dhe përfaqësimin e tyre në gjykatat përkatëse dhe, së fundi, vendimmarrjet e gjykatave. Përmes të dhënave të siguruara dhe të vlerësuara ndër vite, rrjedhin rritjet kallëzuese prej vitit në vit, të cilat rritje reflektohet edhe tek organet e prokurorisë me marrje vendimesh, me fillim apo mosfillim procedimi, pasuar sipas viteve 2010-2015, në Kosovë dhe në Shqipëri 2010-2015. Duke pasur parasysh këtë numër të rritur, i cili ishte edhe indikator shtytës për mua për tu marrë me këtë temë disertacioni.

⁷⁶ Raportet e punës së Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, referuar në Kuvend nga Kryeprokurorja Ina Rama, viti 2012

Tregusi rritës nga 13-26%, i shprehur ndër vite, në vijim do të pasqyrohet nëpër vite duke shprehur përmes grafikoneve në vijim.

7.1. Dinamika pranuese e kallëzimeve penale para riorganizimit të sistemit prokurorial 2010, 2011–2012, në prokuroritë e Kosovës⁷⁷

Analiza e fig.1

Përmes grafikonit të parë në vijim shihet se numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të të gjitha llojeve, të pranuar në prokuroritë e Kosovës në nivele të ndryshme për tri vite është gjithsejt 72602 kallëzime penale. Specifikuar sipas viteve rrjedh se, vitet 2010 dhe 2011 pasqyrojnë një rritje nga viti në vit, duke pasuar me një rritje prapë në vitin 2012. Shprehur në numra dhe përqindje, rrjedhë se në vitin 2010 ka shënuar shifër pranuse të kallëzimeve penale prej 20952, apo, shprehur në përqindje, 19,05%. Viti 2011 shënon pranim rastesh të k.p në 25663, apo, shprehur në përqindje, 22,48% më shumë se në vitin 2010, duke u përcjell akoma me një rritje të k.p. në numër 25987 viti 2012 apo shprehur në përq. për +1.26% .



Fig.1

⁷⁷ Të dhënat i kam siguruar drejtpërdrejt nga Zyra e Statistikave, Zyra e Prokurorit të Shtetit. Të dhënat me janë printuar me lejen e Drejtorit të Statistikave dhe me janë dhënë. Kopjet kopjet i kam pranuar fizikisht, në datë 15 shkurt 2015.

7.1.1. Paraqitje garfike/tabelare e zgjidhjes së kallëzimeve penale në periudhën raportues –sipas personave nga viti 2010–2012⁷⁸.

Më poshtë shihet pasqyrimet e të dhënave ne fig.2 përmes të secilit rrjedh mënyra e zgjedhjes se kallëzimeve penale për periudhën raportuese sipas viteve, 2010, 2011 dhe 2012, nga ana e Prokurorive të R. Kosovës, më saktësisht si në figurë (*Prokuroria e shtetit, Prishtinë, 2013*).



Fig.2

Nga fig.2, shifet se organet e Prokurorisë së Kosovës, nga numri i përgjithshëm i kp, në shifër 72602 për periudhën 2010-2012, gjithsejt në punë, pa lëndë të trashëguara, ka trajtuar gjithsejtë 89.387, raste sipas personave, ku pas procedimeve të ndërmarrura është vendosur si ne vijimë:

-Dërgim në kompetencë: Nga numri i përgjithshëm i k.penale, në kompetencë ka dërguar 3879 raste sipas personave, që do të thotë se nga numri shqyrtues i bie të jenë dërguar 4.32% te rasteve.

⁷⁸ Të dhënat më jan mundësuar nga Departamenti i statistikav, ne kuadër të Këshillit Prokorial i Kosoves, në muain dhietor 2015, fizikisht nga zyrtari i statistikave, sipas kërkesës sime gojore paraqitur tekë drejtori i statistikave.

-Hedhje e kallëzimeve penale: Nga numri i përgjithshëm i k.p, numri i hedhjeve të kallëzimeve penale ka arritur në shifren e 9822 të rasteve sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm sipas personave, i bie 10.98%.

-Pezullimi i hetimeve: Nga numri i përgjithshëm i k.p, numri i pezullimeve të hetimeve kishte mbrëritur në shifren 273 të rasteve sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm sipas personave, i bie të jetë në përqindje të jetë 0.30%.

-Pezullimi ose pushimi i ndjekjes penale: Nga numri i përgjithshëm i k.p gjegjësisht sipas personave numri i pezullimeve ose pushimi i ndjekjes penale është 149 raste sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm i bie të jetë, 0.16%.

-Propozim akuza: Nga numri i përgjithshëm i k.p, gjegjësisht sipas personave numri i propozimakuzeve, dërguar gjykatave kishte arritur në 26786 raste, çka do të thotë se nga numri trajtues i përgjithshëm të k.p. që i bie të jenë ngritur akte akuzuse sipas personave për 29.96%.

-Propozim akuza me dhënie të urdhrit ndëshkimor: Nga numri i përgjithshëm i k.p. propozimakuzeve me propozim për dhënie të urdhrit ndëshkimor, dërguar gjykatave, është 25786 raste sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm të k.p, i bie të jetë ngritur propozimakuza me urdhër ndëshkimor sipas personave për 28.84%.

-Aktakuza të drejtpërdrejta: Nga numri i përgjithshëm i k.p, sipas personave, numri i aktakuzave të drejtpërdrejta, dërguar gjykatave kishte mbrëritur shifrën 13542 raste sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm të k.p, i bie të jenë ngritur aktakuza të drejtpërdrejta 15.15% të rasteve.

-Aktakuza pas hetimit: Nga numri i përgjithshëm i k.p, numri i aktakuzave pas hetimeve, dërguar gjykatave ishte arritur në shifren 7181, që do të thotë se, pas hetimeve, nga numri shqyrtues i përgjithshëm të k.p, i bie të jenë ngritur aktakuza, sipas personave, 8.03%, nga rastet e përgjithshme, të trajtuara për periudhën 2010, 2011-2012.

-Kallëzimi penal është zgjidhur në mënyra të ndryshme: Nga numri i përgjithshëm i k.p, shprehur sipas personave, për periudhën 2010,2011-2012, nga numri i përgjithshme shqyrtues i kallëzimeve penale të trajtuara nga ana e Prokurorive të RK-ës, vendosja në mënyra të ndryshme e kallëzimeve penale është bërë për 1434 raste që, në përqindje i bie të jetë 1.60%.

Nga sa u tha më lartë, rezulton se numri i rasteve të vendosura për kallëzimet e pranuar për shqyrtim nga ana e organeve ndjekëse të prokurorive të shtetit të Kosovës, për periudhën 2010,2011-2012, vendimmarrja ndjekëse më e lartë ka rezultuar me ngritje të propozimkuzave, 26786, apo 29.96% të rasteve. Ndërsa më e ulta, me pezullim ose pushim ndjekjeje, për 149 raste, shprehur në përqindje 0.16% më saktësisht, si në fig. 2 dhe përshkrimin tekstual si më lartë.

7.1.2. Rastet e personave që kanë mbetur të pazgjidhura në fund të çdo viti.

Analiza e fig. 3

Sipas figurës në vijim shihet pasqyrimi i rasteve të personave, kallëzimet që kanë mbetur të pazgjidhura në fund të çdo viti, kallëzime të të gjitha llojeve sipas viteve. Shihet se kemi një trend në rritje dhe atë, nga viti 2010, në vitin 2011. Ndërsa viti 2012 paraqet një rënie në raport me vitin paraprak, 2011. Shikuar sipas viteve shihet se trendi ka shkuar në rritje, prej vitit në vit, gjë që e tregon edhe vetë grafiku. Për sqarim, në fillim të vitit 2010, 2011 dhe 2012 më lëndë të bartura kishin mbetur për t'u poceduar në vitin 2010 gjithësejtë 17389 raste, në vitin 2011 gjithësejtë, 21957 raste dhe në vitin 2012, 19360 raste. Shprehur në përqindje shihet se numri trashëgues ka shkuar në rritje prej vitit në vit, ndërsa në vitin e fundit ka rezultuar një rënie në raport me vitin paraprak, gjë që lë për të kuptuar se kemi një angazhim më të lartë të organit ndjekës për një qasje paksa më serioze në drejtim të zgjidhjes së rasteve që i kishin para vetes organet për procedim. Për të qenë më praktik,

del se, raportet mes viteve, shprehur në përqindjen e trashëgimit të lëndëve, i bie se për vitin 2010 kemi rritje trashëguese të kallëzimeve të pazgjidhura, prej 2.035 më shumë se ishin në vitin 2008. Në vitin 2010 ishin pranuar 9468 më shumë në relacion vitin paraprak 2009. Më pas vazhdon relacioni ngritës trashëgues i vitit 2011, në raport me vitin 2010, e që i bie se në vitin 2011 të jenë pranuar si lëndë të trashëguara 4.568 më shumë në vitin paraprak, 2010. Së fundi, del se viti 2012 rezulton me një rënie trashëguese, në raport me vitin paraprak, për 2.597 lëndë që lë për t'u kuptuar një ngritje efikasiteti në zgjidhje procedimesh.

Rastet e personave të cilat kanë mbetur të paggjidhura në fund të çdo viti (2010, 2011 dhe 2012)




Fig.3 Analizë tabelare/grafike (të dhënat janë marrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës)

7.1.3.Vendimet gjyqësore nga Gjykatat e R.Kosovës për periudhën 2010-2012

Analiza e fig.4

Nga gjykatat e Republikës së Kosovës në nivele lokale dhe qendrore, nga numri i përgjithshëm i lëndëve të shqyrtuara sipas viteve dhe, në tërësi, rrjedhë se vendimet e gjykatave kanë rezultuar me këtë status zgjidhjeje:

-Aktgjykime me urdhër ndëshkimor

Për tri vite, gjithsej janë vendosur 22741 lëndë, specifikisht, sipas viteve: për vitin 2010 (3646 aktgjykime pa shqyrtimë gjyqësor), 2011 (6014 aktgjykime pa shqyrtim gjyqësor), 2012 (13063 aktgjykime pa shqyrtimë gjyqësor). Rrjedh se, nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, sipas numrit 22741 për vitet 2010, 2011, 2012, më të paktat vendimet gjyqësore të kësaj natyre kanë qenë në vitin 2010, ndërsa më të shumtat në vitin 2012.

-Aktgjykimet Refuzuse, Si të tilla, për periudhën raportuse, janë të tretat më radhë, shikuar nga vendimmarrjet e përgjithshme gjyqësore, apo të tretat nga vendimmarrjet e ulëta gjyqësore, për periudhën 2010, 2011, 2012. Shprehur në tërësi, të natyrës së tillë, e Aktgjykimet refuzuse, gjykatat kanë sjellur gjithsej 2056 aktgjykime. Prijnë gjykatat me këtë vendimmarrje aktgjykimesh të kësaj natyre, për vitin 2012 me 963, me rënie në vitin 2011 me 462 aktgjykime dhe me 631 raste për vitin 2010.

-Aktgjykime liruese

Emërtimin e aktgjykimit lirues, ligjëvënësi e ka normuar me normim të veçantë, duke shpjeguar se kur mirret si i tillë nga ana e gjyqëtarve të gjykatave. Më saktësisht, norma përcakton mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me subjekte procedurale, me nxjerrjen dhe administrimin e provave dhe me dhënien e vendimit gjyqësor meritator për çështjen e caktuar. Sipas periudhës së cekur, vendimet gjyqësore për vitet 2010-2012, përfaqësohen me 901 aktgjykime liruese. Vendime të tilla të marra, nga gjykatat, janë të njejta në vitin 2010 dhe atë, 2012, me nga 318 aktgjykime liruese. Ndërsa viti 2011 rrjedh me një numër më të lartë, 225 raste aktgjykimesh.

-Aktgjykimet denuese

Periudha raportuse pasqyron një rritje nga vitit në vit, si në grafikun, ashtu që numri i përgjithshëm i tyre, në periudhën 2010-2012, është 15289, specifikisht si në (fig.4)

-Masat e trajtimit të detyrueshëm

Vlenë të theksohet se numri i vendimeve gjyqësore me emërtimë të tillë është me numër më i ulët, në raport me të gjitha llojet e vendimmarrjeve tjera të specifikuara si më lartë.

Ky lloj vendimi përfaqëson 66 raste për periudhën e cekur, 2010-2012.

Në vijim, pas mbarështimit teorik shih. Fig. 4 , si më poshtë ku janë bërë edhe zbërthimet në përqindje, ku, aktgjykime me urdhër ndëshkues janë sjellur 22741, apo 55.39%, aktgjykime refuzues, 2056 apo 5.01%, Aktgjykime liruse 901 apo 2.19%, aktgjykime dënuse 15289; vendime me masa të trajtimit të detyrueshëm ka sjellur gjithsejt 0.16%.




Fig.4

7.2. Dinamika pranuese e kallëzimeve penale pas riorganizimit të sistemit prokuroria të Kosovës, 2013, 2014, 2015

Përmes fig.5, shihet se numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të të gjitha llojeve, të pranuar në prokuroritë e Kosovës, për tri vite në nivele të ndryshme është gjithsej 104093 kallëzime penale, të të gjitha llojeve nga institucionet e ndryshme të paraqitura. Specifikuar sipas viteve, rrjedh se, në vitin 2013 kemi rritje, pasuar, në vitin 2014 dhe rënie të serishme, në vitin 2015.

Shprehur veç e veç sipas viteve dhe, në total, zbërthyer në numra dhe përqindje, rrjedh me sa vijon: viti 2013 shënon pranim rastesh të kallëzimeve me numër 35798 (29.08% nga totali i tri viteve) , viti 2014 pason me numër më të ulët pranues të k.p. 35441 (29.37%) dhe

viti 2015, me një rënie akoma më të madhe të shifrës pranuese dhe atë në numër 32854 k.p (31.68%).




Fig.5

Vlenë për tu cekur se numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të gjitha llojeve, të pranuar për tri vitet 2013, 2014, 2015 në prokuroritë e Kosovës në nivele të ndryshme është gjithsejtë 104,093 kallëzime penale, specifiku sipas viteve rrjedhë se sipas numrit dhe përqindjes në vitin 2013, janë pranuar 35798 apo 34,39% nga totali i tri viteve. Ne vitin 2014 janë pranuar gjithsejtë, 35441 kallzime penale të të gjitha llojeve apo shprehur në përqindje 34.05%, dhe se fundi ne vitin 2015 jan pranuar gjithsejt 32854 apo shprehur ne përqindje 31.56% . Theksoj se prinë viti 2013, viti 2014 me pak ramje dhe viti 2015 me akoma ramje me saktësishtë si ne fig. 5. reflektonin me rritje nga viti në vit, duke pasuar me një rritje prapë në vitin 2012. Shprehur në numra dhe përqindje rrjedhë me sa vijon: viti 2010 shënon pranim rasteve të kallëzimeve me numër 20952 apo shprehur në përqindje (19,05%), 2011 shënon pranim rasteve të kallëzimeve me numër 25663 apo shprehur në përqindje (23,19%) dhe së fundi viti 2012 shënon pranim të rasteve të kallëzimeve me numër 25987 apo shprehur në përqindje (23,48%). Nga viti 2009–2010 kemi ngritje për +14.10%, 2010—2011 ngritje për +22.48% dhe së fundi ngritje për +1.26 % nga viti 2011 në vitin 2012.

7.2.1. Pasqyra grafike mbi zgjedhjen e kallëzimeve penale sipas personave nga viti 2013 deri 2015

Më poshtë, në fig.6, shihet pasqyrimi, përmes të secilit rrjedh mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale, për periudhën raportuese, për vitet 2013, 2014 dhe 2015, nga ana e Prokurorive të R. Kosovës, më saktësisht si në figurë (*Prokuroria e shtetit, Prishtinë, 2016*).




Fig.6

Nga fig.6 shihet se organet e Prokurorisë së Kosovës, nga numri i përgjithshëm prej 104093, kallëzimeve penale të pranuar, për periudhën 2013-2015, gjithsej në punë, pa lëndë të trashëguar nga vitet paraprake, nga prokuroritë e Republikës së Kosovës, janë trajtuar gjithsej 122,340 raste sipas personave.

Epilogu i vendimmarrjeve në procedurë penale paraprake, në shtrirje vendi, nga prokuroritë e Kosovës, ka rezultuar me vendosje si në vijim:

-Hedhje e kallëzimeve penale: Nga numri i përgjithshëm i K. Penale, shprehur në numër personash të dyshuar, si kryers të veprave penale, pas analizimit dhe vlerësimit të kallëzimeve penale e në mungesë provash dhe faktesh, ka rrjedhë se organet e akuzës Prokuroritë e Kosovës në nivel vendi, kanë bërë hedhjen e kallëzimeve penale sipas personave, sipas shifrës së përgjithshme, për vitet: 2013, 2014, 2015 dhe atë, përcaktuar si

në fig.6, për 10396 raste sipas personave. Kjo do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm, prej 122,340 personave, i bie të jetë në 17.68%.

-Aktakuza të drejtpërdrejta: Nga numri i përgjithshëm i k. Penale, gjegjësisht sipas personave, numri i aktakuzave të drejtpërdrejta, dërguar gjykatave, është 31685 raste sipas personave, që do të thotë se nga numri shqyrtues i përgjithshëm të K. Penale i bie të jenë ngritur aktakuza të drejtpërdrejta sipas personave 38.61%.

- Aktakuza me kërkesa...: Drejtuar dhe dërguar gjykatave të RK-ës, për periudhën e viteve 2013-2015, në total ishtin 18688 raste sipas personave, apo, shprehur në përqindje, i bie të jetë 15.27%, nga numri shqyrtues i kallëzimeve penale.

-Hetimet e para...., Me hetime të para, shqyrtuara nga organet e akuzës për vitet 2013-2015, janë vendosur, gjithsej 9236 raste të k.p, sipas personave nga totali shqyrtues, apo, shprehur në përqindje, i bie të jetë 13.24%.

-Aktvendim mbi fillimin e hetimeve, Organet e ndjekjes penale, gjatë viteve 2013-2015 gjithsej kanë marrë aktvendime mbi fillimin e hetimeve për 23515 raste sipas personave. Shprehur në raporte me totalin e kp të rasteve sipas personave, i bie te jetë 19.22%.

-Pezullimi i hetimeve: Nga numri i përgjithshëm i K. Penale, gjegjësisht sipas personave, numri i pezullimeve të hetimeve penale është 666 raste, sipas personave, që do të thotë se nga numri shqyrtues i përgjithshëm sipas personave, i bie 0.50%.

-Rifillimi i hetimeve të pushuara, Gjatë viteve 2013-2015, organet e prokurorisë së shtetit të R Kosovës, në zgjidhjen e rasteve, rifillimin e hetimeve të pezulluara-pushuara, e ka aplikuar për gjithsejt 59 raste, sipas personave, apo shprehur në përqindje, 0.05%.

-Pushimi i hetimeve: Nga numri i përgjithshëm i K. Penale sipas personave, pushimi i hetimeve, për periudhën 2013-2015, është bërë për 3436 raste të personave. Shprehur në përqindje, numri shqyrtues i përgjithshëm sipas personave, i bie të jetë, 3.56%.

-Propozim akuza: Nga numri i përgjithshëm i Kallëzimeve Penale, gjegjësisht, sipas personave, numri i propozim akuzave dërguar gjykatave është 26786 raste sipas personave, që do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm i K. Penale, i bie të jenë ngritur akte të akuzës sipas personave, për 29.96%.

-Për shkak te Ligjit mbi falje, gjatë periudhës së ripërsëritur disa herë, janë vendosur 649 raste sipas personave, në raport me totalin, shprehur në përqëndje 5.30%

-Aktakuza pas hetimit: Nga numri i përgjithshëm i K. Penale, gjegjësisht sipas personave, numri i aktakuzave pas hetimeve, dërguar gjykatave, është 16492, që do të thotë se, pas hetimeve, nga numri shqyrtues i përgjithshëm i K. Penale, i bie të jenë ngritur aktakuza, sipas personave, 13.48%, nga rastet e përgjithshme, të trajtuara për periudhën kohore 2013, 2014-2015.

-Pushim i procedurës, është bërë për 238 raste sipas personave, në raport me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale sipas personave, për periudhën 2013-2015. Shprehur në përq. 1.94%.

-Propozime për shqiptimin e dënimit: Nga numri i përgjithshëm i K. Penale, gjegjësisht, sipas personave, numri i akuzave me propozim për shqiptimin e dënimit, dërguar gjykatave, është 143 raste, sipas personave. Kjo do të thotë se, nga numri shqyrtues i përgjithshëm i K. Penal i bie të jenë ngritur propozime me urdhër ndëshkimor (gjobë), për 143 raste sipas personave, apo 1.16%. nga totali i rasteve, sipas personave për vitet 2013-2015.

-Cedimi në kompetencë: Nga numri i përgjithshëm i K.Penale, gjegjësisht, sipas personave, gjithsej në kompetencë janë dërguar 6009 raste, sipas personave, që do të thotë se nga numri shqyrtues –cedues, i bie 0.04%.

7.2.2. Kallëzime penale të pazgjidhura sipas viteve 2013-2015

Gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015 , kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 70365 K. Penale. Shprehur në numra dhe përqindje rrjedh kjo gjendje në: vitin 2013, me 18006 raste të K. Penale, që shprehur në përq. i bie 25.59%, viti 2014 me 26065, (37.04%) dhe viti 2015 me 26294(37.37%).

Siq shihet, viti 2013 ka pasur më pak raste të pazgjidhura të kallëzimeve penal, e në raport me vitet 2014 dhe 2015. Nga figura ku shihet se numri rasteve ka shkuar duke u ngritur për mos zgjedhjen e tyre.

Analizimi i fig.7.




Fig.7

7.2.3. Rastet e zgjedhura sipas personave.

Gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, janë zgjidhur gjithsej 87087 raste, sipas personave, që përbejnë numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale të gjitha llojeve, për tri vitet e cekura. Veçmas, rrjedh se, në vitin 2013 janë zgjidhur 28737(33.99%), viti 2014 me 24856 raste apo 28.54 % dhe viti 2015 me 33493 raste apo 38.45%. Siq shihet nga fig. 8 e përshkruar

si në përmbajtje, rezulton se në vitin 2014 ka ulje për -13.50% në raport me vitin 2013, ndërsa nga viti 2014 në drejtim të vitit 2015 kemi ngritje për 34.75% ⁷⁹

Analiza e fig. 8




Fig.8

7.2.4. Vendimet Gjyqësore 2013-2015

Analiza e fig. 9

Nga fig. 9, gjejmë të paraqitura të dhënat e vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Kosovës, për periudhën 2013-2015 dhe epilogun e vendimmarrjeve të Gjykatave të Kosovës për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Nga të dhënat numerike, të pasqyruara si në fig. 9, rezulton se numri më i ulët i vendimmarrjeve gjyqësore për periudhën e theksuar del të jenë ato të llojit të masave të trajtimit të detyrueshëm, ndërsa më i lart numri i vendimmarrjed me aktgjykime fajësuese më saktësisht, si në fig.9

⁷⁹ Më saktësisht, shih figurën nr. 8, të punimit, që i referohet pasqyrimit numerik të të dhënave për vitet 2013, e gjerë në vitin 2015, të zgjidhjes së kallëzimeve penale sipas personave në R. Kosovës, nga të gjitha nivelet.




Fig.9

7.3. Çështjet e regjistruara pranë organeve të prokurorisë në pesë vitet e fundit në Republikën e Shqipërisë

Analizë e fig.10

Nga të dhënat statistikore rezulton se, në vitin 2011 janë regjistruar 19726 procedime penale. Në vitin 2012 janë regjistruar 22079 procedime penale, që do të thotë rritje prej 10,6 % në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2013 janë regjistruar 27677 procedime penale, që do të thotë rritje prej 20,20 % në krahasim me vitin 2012. Në vitin 2014 janë regjistruar 33894 procedime penale, që do të thotë rritje prej 18,34 % në krahasim me vitin 2013 dhe, në vitin 2015 janë regjistruar 32497 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4,3 % në krahasim me vitin 2014.

Më poshtë paraqiten grafikikisht procedimet penale të regjistruara nga organi i prokurorisë në pesë vitet e fundit shprehur në numra dhe përqindje.




Fig.10

7.3.1. Numri i rasteve në ndjekje penale, për vitet 2011 deri 2015 në R. SH.

Analizë e fig.11

Në vitin 2011 rezultojnë 24975 procedime në ndjekje penale. Në vitin 2012 rezultojnë 27626 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 10,6 % në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2013 rezultojnë 33761 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 22 % në krahasim me vitin 2012. Në vitin 2014 rezultojnë 43827 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 30 % në krahasim me vitin 2013 dhe, në vitin 2015 rezultojnë 44077 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 0,6 % në krahasim me vitin 2014.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike, pasqyrohen procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë në pesë vitet e fundit:



Fig.11

7.3.2. Analizë statistikore e pezullimeve të procedimeve penale për vitet 2011 deri 2015 në R. Shqipërisë

Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokurori publik i shtetit tani mund të pezullojë hetimin me vendim, nëse i pandehuri pas kryerjes së veprës penale, vuan nga një çrregullim, ose paaftësi e përkohshme mendore, apo nga ndonjë sëmundje tjetër të rëndë, nëse është arratisur ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat, përkohësisht, e pengojnë ndjekjen e sukseseshme të pandehurit. Është organi kompetent

ai që vendos për pezullimin e hetimeve, atëherë kur nuk njihet autori i veprës penale, ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve, pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe hetimi të jetë pezulluar, mund të rifillojë me vendimin e prokurorit. Ky tregues i vitit 2011–2015, rezulton nga të dhënat statistikore, si më poshtë.⁸⁰




Fig.12

Përkitazi me procedimet e pezulluara, për periudhën e viteve 2011 deri në vitin 2015, nga të dhënat statistikore zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme të Tiranës, rezulton se, numri total i pezullimeve për pesë vite është 52526 raste pezullimesh sipas totalit. Shprehur sipas viteve në numra dhe përqindje dhe rritjeve nga viti në vitë rezulton se në vitin 2011 ka pasur 7906 pezullime apo shprehur në përqindje 15.05% nga totali i përgjithshëm i pezullimeve. Në vitin 2012 ka pasur me një ngritje pezullimesh dhe atë në 8747 rastesh apo shprehur në përqindje 16.65% nga totali. Pastaj viti 2013 akoma me një rritje me 10632 rastesh apo shprehur në përqindje 20.24%. Viti 2014, me 23.53% dhe viti 2015 me 12883 rastesh apo shprehur në përqindje 24.53%. Nga grafikoni në fig. në vitin 2011 ka rritje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,63% të vendimeve të prokurorit për pezullimin e hetimeve. Për vitin 2012, procedimet

⁸⁰ Më saktësisht, shih figurën nr. 12, të këtij punimi, ku, ana teorike e analizimit është zbërthe numerikishtë.

penale të pezulluara për mos zbulim të autorit sipas veprave penale nuk janë përfshirë në grafik të procedimeve penale të pezulluara, për vepra të ndryshme penale, numri i të cilave është nën shifrën 15.

7.3.3. Dinamika e mosfillimeve të procedimeve penale në Shqipëri 2011-2015

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale, të cilat mund të vijnë nga subjekte të ndryshme e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara me nenet 281 dhe ato vijuese të Kodit të Procedurës Penale, ekzistojnë elementet e veprave penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi, në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që, në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme për kallëzimet, të cilave u mungon baza ligjore, ka pësuar një rritje nga viti në vit. Përderisa, në vitin 2011 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 7793 kallëzime, duke vazhduar me një ngritje të mosfillimeve me një ngritje të rasteve në 8866, në vitin 2012, me një rënie rastesh në 8414 raste mosfillimi në vitin 2013, duke vazhduar me ngritje të numrit të rasteve në 13416 mosfillime në vitin 2014 dhe, më tutje, ngritje të shifrës në 14452, për vitin 2015.

pavarësisht se janë kryer, i japin të drejtë prokurorit që të vendosë mosfillimin e procedimit fig.13⁸¹.

⁸¹ Sigurimin, e të dhënave, për periudhën 2011–2015, për vëllimin dhe dinamikën e procedimeve penale në Shqipëri, e kamë realizuar, në dy forma, me paraqitjen time drejtpërdrejt në Prokurorinë e Përgjithshme në Tiranë, dhe përmes kontaktit shoqëror dhe miqësor përmes kërkesës gojore me prokurorin Arben




Fig.13

Përmes figurës së mësipërme, (fig.13), në të cilën pasqyrohet periudha e viteve 2011–2015, përkundër asaj që koha e studimit ndërlidhet me vitet e regjistrimit në studimet e doktoratës, e që ishin vitet 2011/2012, për arsye lidhëse janë përfshirë edhe të dhënat paraprake, të vitit 2010, duke vazhduar, më pas, me periudhën studimore 2011, 2012...e deri në vitin 2015.

Përkitazi me procedimet, për të cilat është vendosur mosfillimi, rezulton se, nga të dhënat statistikore, të siguruar dhe të analizuar, del se viti 2011 ka rritje prej 11,07% në krahasim me vitin 2010. Viti 2012 ka rritje prej 12,10% në krahasim me vitin 2011. Viti 2013, pasqyrohet me një rënie në raport me vitin 2012, e atë -5.37% , e më pas me ngritje, në vitin 2014 ne raport me vitin 2013 dhe atë për 37.28% dhe sërish me ngritje në vitin 2015 për 7.17% ne raport me vitin 2014. Më saktë si në fig.13 shih treguesit e shprehur në numra, dhe përqindje.

7.3.4. Volumi i punës në hetim nga viti 2011 deri 2015

Nga figura e mëposhtme që ndërlidhet me vitet 2011 deri 2015, pasqyrohen të dhënat mbi hetimet e kryera nga organet e ndjekjes, të prokurorive, në nivel shteti, të RSH, përmes të secilit aktivitet hetimor, mënyrat e vendosjeve rreth mosfillimeve, rifillimeve,

⁸¹ Dollapajn dhe shokë të tij, të dhënat mi kanë siguruar në CD, për nevojat e studimit. Respekt dhe falënderim ndaj tyre! Mënyrën tjetër e kam realizuar përmes internetit, duke u qasur në *website*-in e Prokurorisë së Përgjithshme, aty kam nxjerrë raportet vjetore të procedimeve penale si në figurat e pasqyruara me numrat, 10,11,12,13,14,15,16,17 të këtij punimi.

procedimeve të regjistruara dhe atyre të bartura prej vitit në vit. Kjo e qe më së miri pasqyrohet përmes fig.14, ku shihen aktivitetet e organeve ndjekëse përmes të dhënave numerike për secilin vite.

Në vijim veçmas përmes viteve dhe figurave do të gjeni të bashkangjitur volumin procedues për hetimet si vijon:




Fig.14

7.3.4.1 Volumi i punës i organit të prokurorisë për çështje të përfaqësuar në gjykata për vitet 2011 deri 2015

Në vijim, do të pasqyrojmë volumin e veçantë, sipas viteve 2011 deri 2015, ku organet e akuzës kanë përfaqësuar, pranë, gjykatave, të niveleve të ndryshme të shkallshmërisë varësisht kompetencës lëndore dhe territoriale të çështjes së procedimit penal. Në vijim, do të mbarështrijmë këtë volum pune, sipas viteve në mënyrë me specifike. Numri më i madhe i përfaqësime nga organi i akuzës është bërë në nivel shkalle të parë⁸², me pastaj në nivele të shkallës së dytë⁸³ dhe më i ulëti në Gjykata e Lartë.⁸⁴ Nga figura 15 rrjedhë se 87.04% të përfaqësimeve kanë qenë në nivel, të shkallës së parë të rasteve të prokurisë e

⁸² Gjykatat të shkallës së parë janë gjykatat e nivelit të parë apo gjykata e faktit e qe zyrtarishtë quhen si gjykata të rrethëve gjyqësore.

⁸³ Gjykatat e shkallës së dytë janë Gjykatat e Apelit në R.SH.

⁸⁴ Gjykata e lartë është instanca e fundit më e lartë në kuader të gjykatave të rregullta.

shkalles se parë. Ndërsa 12.30% nga Prokurorit e Apeleve, dhe, 0.66% te rasteve nga Prokuroret e pergjithëshem. E tërë ky përfaqësim është llogaritur ne përqindje të pergjithëshem për pesë vitesh. Shiqu sipas viteve numerikisht ne nivel të shk. Se parë përfaqësimi me i lartë ka qenë ne vitin 2015 dhe atë ne numër 58529 rastesh, kurse me i ulti ne vitin 2011. Poashtu ne nivel te prokuroris se apelit ne gjykatë apeli përfaqësimi ne vitin 2015 është pasqyru me 9212 raste dhe me i ulti ka qenë ne vitin 2011 me 4821 raste dhe se fundi përfaqësimet nga Prokuroret e Prokurorive të pergjithëshme më të lartat kan qenë ne vitin 2012 me 433 raste nërsa më i ulti ne vitin 2015 me 249 raste.




Fig.15

7.3.4.2. Të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake për vitet 2011 deri 2015

Analizë e fig.16

me **çështjet e pushuara**, në vitin 2011 ka ulje prej 12,6%, në krahasim me vitin 2010 dhe, në vitin 2012 ka rritje prej 29,63% në krahasim me vitin 2011.

Përkritazi me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2010 ka rritje prej 15,11% në krahasim me vitin 2009; Në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 15,87% në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,63% në krahasim me vitin 2011.

Përkitazi me çështjet e **dërguara në gjyq**, në vitin 2010 ka rritje prej 10,78% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka rritje prej 11.9% në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka ulje prej 1,69% në krahasim me vitin 2011. Sa u tha më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Siç vihet re nga tabela, rezulton se numri i të **pandehurve të dërguar në gjykatë** në vitin 2010 rezulton me dërgime të 9261 të të pandehurve. Në vitin 2011 ka rënie të vogël, ashtu që numri i të pandehurve dërguar në gjyqe është 9256. Ndërsa, viti 2012 pason me një ngritje dërgimesh të numrit të pandehurve në gjykatë dhe atë, me 9354 personash. Shprehur në përqindje, viti 2010 ka rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009; Në vitin 2011 ka rënie për -0.05% në raport me vitin 2010. Ndërsa, në vitin 2012 ka rritje prej +1,05% të numrit të pandehurve të dërguar në gjyqe, në krahasim me vitin 2011. Rol të rëndësishëm kanë edhe vendimet e gjykatave për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq. Kjo rezulton si më poshtë: Në vitin 2010 vendimet e gjykatës për pushimin e çështjes janë 3,42% në vitin 2011 është 3,11% dhe në vitin 2012 ky tregues është 14,49%

Sa i përketë rasteve të **pushimit të akuzës** për të pandehurit, dinamika në tri vitet e fundit është e tillë që, në vitin 2010 ka rritje prej 36,73% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka ulje të lehtë, prej 1,37% në krahasim me vitin 2010 dhe, në vitin 2012 ka rritje prej 10,89% në krahasim me vitin 2011.




Fig.16

7.3.4.3. Të dhënat statistikore për pafajësinë e të pandehurve për vitet 2011-2015

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në fig.17, rrjedhë se pas zhvillimit të hetimeve organi i prokurorisë –akuzes për vitet 2011,2012,...2015, gjithsejtë ka dërguar në gjykatë 61.289, të pandehur. Nga ky numër i të pandehurve, rrjedhë se, vendimet e gjykatës për pafajsi, nga numri i përgjithshëm për, pesë vitet specifiku sipas numrit dhe përqindjes është me sa vijon: viti 2011 pason me 234, raste pafajësie apo 16.86 %, nga numri total i pafajsisë për pes vitet. Viti 2012, pason me 221, vendime apo shprehur në përqindje 15.92%. Viti 2013 me 238, raste vendimesh gjyqësore apo, shprehur në përqindje 17.15%. Viti 2014 me 277 vendime pafajësie apo shprehur në përqindje 19.96% dhe se fundi pason viti 2015 me numër rastesh pafajësie të 418 rastesh apo shprehur në përqindje 30.11%, gje që viti 2015 prinë me rritje, kuse viti 2015 pason me numër të ultë v.pafajësie.




fig.1

KAPITULLI VIII: KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

KONKLuzionET

Në këtë punim janë vënë në pahë çështjet e aspektit krahasor të fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal në Kosovë dhe Shqipëri, përmes rrugëtimit zhvillimor, politiko-shoqëror, sipas ndryshimeve të kuadrit ligjor të Kodeve Procedurale Penale, përmes të sëcilave është bërë normime, ndryshime dhe plotësime të kompetencave të subjekteve autorizuese të procedimit penal e në veçanti për fazën e procedimit penal paraprak. Poashtu në këtë punim janë përfshirë disa ngjarje të rasteve praktike penale, të cilat ishin më se interesante për punimin para periudhës së studimit, dhe kuptohet periudhën kohore të studimit, duke aplikuar dispozitat normuese të dyfishta të KPPPK-ës, të vitit 2004 dhe KPPRK-ës, të vitit 2012, që filloj të zbatuar, që nga 1 janari 2013, me rastin riorganizimit të sistemit gjyqësor në Kosovë. Poashtu, ky punim bartë në vete aplikimin e dispozitave normuese që i referohen kuadrit ligjor penal dhe procedural të KPPSH-ës, për vitet 1953, 1980, dhe 1995, referuar fillimit dhe mosfillimit të procedimit penal dhe evoluimin e këtij instituti në periudha para reforme dhe reforme. **Në këtë kontekst vihet në pah si vijon:**

1. Janë bërë vlerësime të efektshmërisë së zbatimit fillestar të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2004, dhe të kodeve aktuale në zbatim nga 1 janari i vitit 2013 si dhe të KPr.PSh, të viteve 1953, 1980, 1995 e në vijim.
2. Janë bërë studime fillestare të nevojave për harmonizim në mes të dy sistemeve në disa fusha të ngushta të së drejtës penale (Shqipëri dhe Kosovë),
3. Janë organizuar disa tryeza të rëndësishme, ku janë shqyrtuar mangësitë në zbatim të këtyre dy kodeve dhe është vënë në pah nevoja e pasurimit gjuhësor të teksteve,

4. Miratimi i Kodit Penal dhe Procedural, i përkohshëm në Kosovë, dhe aplikimi i tij nga 6 prilli i vitit 2004, shënon një datë të rëndësishme, sepse për herë të parë Kosova, pasë qllirimit paiset me legjislacion Penal dhe Procedural. E rëndësishmja më e madhe është se nga ky moment kemi kalim nga sistemi inkvizitor në akuzator. Ky reformim legjislacioni përcillet me bartjen e kompetencave nga gjyqëtar hetues në Prokurorë sa i përket zhvillimit të hetimeve. Reformimi i tillë në R.SH. me bartje dhe kalim të kompetencave ishte bërë më heret.

5. Avansimi i reformimeve sa përketë stadi të procedimit penal paraprakë me tej ishte avansuar si në Kosovë ashtu edhe në R.SH., me nxjerrjen e mëvonëshme të K.Penal dhe K.Pr.P.K-ës, pasë shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ndërsa në Shqipëri me nxjerrjen e K.Pr.Penale të vitit 1995, i cili disa herë është përcjellur me ndryshime dhe amadamentime të neneve përshtatëshmerishtë me rrethanat dhe nevojat e funksionimit më të mirë të procedimit.

6. Sipas KPrPK-ës, është ndryshuar edhe vetë sistemi i gjykatave, dhe prokurorive, sipas ligjeve të reja⁸⁵, kështu që, sistemi i gjykatave dhe i prokurorive ka pësuar ndryshime, ashtu që: gjykatat komunale/prokuroritë komunale me ligjet e reja njihen si Gjykata Themelore/Prokurori Themelore. Pastaj, gjykata e qarkut/prokuroria e qarkut janë shndërruar në Gjykatë të Apelit/Prokurori të Apelit dhe kështu me radhë. Kurse Gjykata Supreme, pavarësisht ndryshimeve, në emërtim ka mbetur e njëjtë. Në kuadër të organizimit të mbrendëshëm ndarja është bërë në departamente.

7. Kodit Jugosllav të procedurës penale i mungonin kapacitetet për të filluar dhe zbatuar hetimet proaktive të krimeve të ndërlikuara. Për dallim KPrPK, së vitit 2004, shenoi një progres sepse i lejoi prokurorit publikë të ndërmerre 4 masa të fshehta të hetimit me të

⁸⁵ Ligji mbi Gjykatat e R.Kosovës, Nr.03/L-199, i dt.24.08.2010, i cili ligj ka hyr në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse për nenet e tjera fillon të zbatohet nga 1 janari 2013, dhe Ligjit për Prokurorin e Shtetit në R. Kosovës, nr.03/L-225, i dt. 30.06.2015.

pranuar kallëzimin penal nga policia apo kallëzimet nga të tjerët. Sipas KPr.PK, të vitit 2004, rrjedhë se Prokuroret Publikë të Kosovës, përderisa zbatonin kodin e theksuar, kanë luajtur rol proaktivë në mbledhjen e provave.

8. Sipas Kodit të ri të Pr.PK-es, në zbatime, prokuroritë shprehimishtë i lejohet që të zbatojë hetime proaktive të cilat në veçanti përqendrohen në hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe në rastet, kur nuk dihen emrat e të pandehurve.

9. Sipas K.Pr.PK-es, është bërë avansime të dukëshme sa i përket heqjes se disa instituteve atë të konfirmimit të aktakuzës dhe heqjes se paditësit privat, institute këto që sipas ligjëbërsit janë treguar të pa efektëshme në praktiken e përditëshme.

10. Heqja e paditësit privat – të dëmtuarit, si paditës subsidiar për ndërmarrjen e ndjekjes penale pasi që prokurori ka hedhë kallëzimin penal ndaj të dyshuarit-të pandehurit me pushim hetimesh nga ana e Prokurorit, dhe njoftimi për të ndërmarrë ndjekjen drejtë në gjykatë nuk ka dhënë rezultate.

11. Stadi i procedimit penal është tërësia e veprimeve procedurale të përcaktuara me ligjin procedural-penal që kryhen nga organet e caktuara shtetërore, Prokuroria dhe Policia gjyqësore. Këto veprime kryhen mbi bazën e të dhënave se, a është kryer vepra penale, e nëse nga këto veprime ekziston dyshimi i arsyeshëm apo të bazuar (d.m.th. Perceptimi intelektual i prokurorit se ka vepër penale), atëherë procedohet me zbulimin e autorit, gjykimin e tij nga gjykata dhe zbatimin e masës së dënimit ndaj tij. Numri i madh i veprave penale – të karakterit të rrezikshmërisë së ulët, për të cilat duhet të vendoset regjistrimi i procedimit mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit, në kushtet edhe të mbingarkesës së punës së organit të hetimit është një domosdoshmëri e trajtimit nga organet përkatëse.

Një kategori veprash penale të lehta, për të cilat nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve, apo të ashtuquajturat “Vepra –fakti”, si dhe të atyre, kur midis palëve, të dyshuarit dhe të

dëmtuarit arrihet pajtimi, është e domosdoshme mos të vendoset mosfillimi i procedimit penal. Padyshim që, një gjë e tillë do të shoqërohej me rregullimet e duhura ligjore.

12. Si objekt i procedimit penal është çështja penale e që na paraqitet në kuadër të perceptimit subjektiv, në formën e dyshimit të arsyeshëm ose të bazuar, se jemi para një fakti kriminal pa person konkret ose në formën e një fakti të dënueshëm penalisht, i cili i atribuohet një personi konkret.

13. Mendoj se KPrPK dhe KPrPSH, duhet të shprehin se cili është akti që duhet të merret në lidhje me fillimin e procedimit penal dhe bazën e të dhënave mbi të cilat duhet marrë vendimin.

13.1 Sa i takon aktit që duhet të merret në lidhje me fillimin e procedimit penal aktualisht është zgjidhur dhe pranuar nga praktika hetimore dhe gjyqësore që është vendim mbi regjistrimin e njoftimit të veprës penale, bazuar në nenin 287 të Kodit Pr.Penale, ndërsa mbi bazën e të dhënave gjykojë se është një rekomandim me vlerë, megjithatë një parashikim të tillë nuk e gjejmë të shkruar as në Kodin e Procedurës Penale italiane dhe ky mund të jetë vetëm si një lloj nderhyrjeje në parimet e përgjithshme.

14. Gjithashtu, me Kodin e ri të Kosovës është edhe një risi e cila është paraparë me nenin 153 dhe ka të bëjë me njëfarë kontrolli të hetimeve, të punës efektive të prokurorit të shtetit, sipas të cilit, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngrihet aktakuza.

14.1 Sipas KPr.PSH, funksione të tilla janë baze e punës së prokurorit bazuar në (nenet 227/2, 291 dhe 326, 327/2, 328, 331 të K.Pr.Penale.)

15. Arsyeja e parashikimit të policisë gjyqësore në procedurën paraprake ka qenë e bazuar në domosdoshmërinë për të siguruar

kualitetin e nevojshëm në fillimin e procedimit penal dhe në zhvillimin e hetimeve paraprake.

15.1 Mendoj dhe gjykoj se policia gjyqësore është përfshirë në hetime për efekt kualiteti, por jo për efektë domosdoshmerie dhe nevojë, për shkakë se është ajo që e para bie në kontakt me veprat penale dhe provat apo indiciet e para).

16. Praktika hetimore ka dëshmuar dhe dëshmon se faza më e dobët e procedimit penal është procedimi penal paraprak kur në veprimet e para kryhen nga agjentët e policisë së shtetit dhe jo nga policia gjyqësore, deri diku është një vërejtje që qendron, pasi momenti i parë i ruajtjes së provave dhe mungesa e profesionalizmit në ruajtjen e tyre është e vërtetë se sjell probleme të mëdha më pas në hetimet e veprës penale dhe autoresisë mbi të.

17. Ligjvënësi ka autorizuar vetë të dëmtuarin që të vendos të ushtrojë kompetencat e tij për të drejtat e veta që i janë cenuar nga të tjerët, ashtu që, këtë mundësi ia ka garantuar ligji i KPK-së, që, në sajë të vullnetit të tij, t'i drejtohet gjykatës për ta vënë në vend të drejtën e tij të cenuar⁸⁶. E drejta e tij është garantuar përmes nenit 59 të Kodit Penal. Në gjykimin tim i dëmtuari akuzues është parashikuar si subjekt procedural, dhe i detyruar për të paraqitur prova dhe për të mbrojtur akuzën në gjyqë për një kategori veprash penale, nisur nga fakti se këto vepra për nga rrezikshmëria e ulët dhe nga cenimi i drejtpërdrejtë i interesave personale të të dëmtuarit akuzues, nuk kishte pse shteti të ushtronte nëpërmjetë prokurorit ndjekjen penale.

17.1 Konsideroj, se i dëmtuari, më shumë se të drejta do të thojë se ka detyrime, pasi ndryshe nga i dëmtuari nga vepra penale i dëmtuari akuzues ka detyrimin ta iniciojë

⁸⁶Ejup Sahiti. *E drejta procedurës penale*.

ndjekjen penale ne gjykatë, të mbledhë prova, të mbrojë akuzen që ai ngre kundër personit tjetër në tere fazat dhe shkallet e gjykimit.

18. Vendimi për dhënien apo mosdhënien e autorizimit për procedim duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar. Për këtë grup – kategori personash, të cilët ushtrojnë funksione publike shtetërore, përcaktuar sipas nenit 59 të KPP-së, nuk mund të ushtrohet ndjekja penale, pa vullnetin e një organi shtetëror të përcaktuar me ligj. **Shih vendimin nr. 39/2000 te Gjykares Kushtetuese të Shqiperisë.**

19. Sa i përketë paraqitjes se vetëkallëzimeve si mënyrë e paraqitjes, ku kallëzusi e inkriminon vetëveten si kallëzus i v.p. të caktuar, duhet të merren me **rezervë** nga ana e organit procedues. Kallëzimet e tilla janë pakësa të rralla.

19.1 Në çfarë kuptimi konsiderohet “**rezerve**”. Pasi për këto lloj kallëzimesh prokurori e Shtetit sin ë Kosovë ashtu edhe në Shqipëri janë tee detyruar te vendosin mosfillimin e procedimit penal dhe njoftimin e kallëzuesit mbi vendimmarrjen e tij, që duhet edhe arsyetuar.

20. Bazu ne nenin 293 te K.Pr.P të Shqipërisë pasi policia ka detyrimin me ligjë të referoje veprat penale të prokurori. Ky i fundit delë me një vendimmarrje mbi faktin nëse duhet ushtruar ndjekja penale prej tij, apo prej të demtuarit akuzues, dhe, ka ky detyrimin për njoftimin e menjehershem të çeshtjes tek i dëmtuari akuzues. Policia gjyqësore në asnjë rast nuk mund të vendosi me iniciativen e vet a do të referoje apo jo të prokurori, edhe nese vepra është një ndër ato të parashikuara në nenin 59 të K.Pr.P. Gjithmonë fjalen e fundit e thotë prokurori.

20.1 Pa marrë ankimin e të dëmtuarit mos të ngaterrohen rastet e parashikuara nga neni 59 i K.Pr.Penale me ato te parashikuara nga neni 284 I K.Pr.Penale.

A duhet të vazhdojë procedimi i filluar, apo duhet të pushojë menjëherë?

Në këto raste prokurori vendos mbi mosfillimin e procedimit penal nese nuk e ka filluar, neni 290 i K.Pr.penale, dhe nese e ka filluar vendos pushimin e hetimeve te metejshme.

21. Nese personi ka vdekur, çështja nuk mund të vijohet me tej pasi edhe në gjykim është **një çështje tashme pa objekt**, ushtrimi i së drejtes së parashikuar ne nenin 59 të K.Pr.PSh, bëhet personalisht nga i dëmtuari dhe nuk mund të trashegohet. Flasim për të drejten e ushtrimit të ndjekjes penale dhe jo për padine civile për shperblim demi, e cila trashegohet.

22. Një kategori veprash penale të lehta, për të cilat nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve, apo të ashtuquajturat “Vepra –fakti”, si dhe të atyre, kur midis palëve, të dyshuarit dhe të dëmtuarit arrihet pajtimi, është e domosdoshme të vendoset mosfillimi i procedimit penal. Padyshim që, një gjë e tillë do të shoqërohej me rregullimet e duhura ligjore.

22.1 Nuk e gjykoj të drejtë këtë konstatim , kjo pasi pajtimi mund të zgjidhet me format e tjera te parashikuara në ligje të tjera. Gjithashtu duhet te mbajme parasysh se seanca e pare qe zhvillohet ne gjykatën e shkalles se parë, mbi kerkesen e të dëmtuarit akuzues është seanca e pajtimit, më të cilën gjyqtaret marrin përsiper të pajtojnë palet. Kjo nuk është e parashikuar në ligjin procedural penal dhe është huazuar nga ligji procedural civil, por nuk gjykoj se ka gjë të keqe qe këto rregullime të elaborohen me tej në ligjin procedural penal.

23. Në lidhje me vetëkallëzimet, praktika e deritanishme ka treguar se kallëzimet e tilla bëhen nga personat më gjendje mendore të dyshimtë. Prandaj,

verifikimi i këtyre kallëzimeve është i domosdoshëm dhe duhet bërë duke treguar kujdesin maksimal.

Çështje me interes e pa hasur në doktrinen e së drejtës penale shqiptare.

24. Ndërkaq, procedimi penal është një dhe i vetëm, por, nga pikëpamja e fillimit të tij, themi se kemi fillim të procedimit penal, atëherë kur procedojmë rreth një fakti të caktuar, i cili paramendohet kriminal dhe, më pas vazhdohet në atributivin ndaj një personi konkret, ose, në të kundërtën vendoset të pezullohet procedimi për moszbulim të autorit, deri në plotësimin e afatit të vjetërsimit të krimit.

25. Prokuroria, së bashku me policinë gjyqësore, janë organe që kanë si mision të posaçëm luftën kundër kriminalitetit.

26. Për mosfillimin e procedimit penal kërkohet një perceptim i tillë intelektual dhe profesional i vlerësuar nga ana e organit procedues, se nuk ekzistojnë kushtet ligjore të elementeve të veprës penale për të filluar procedimi penal.

27. Relacionet midis fillimit ose mos fillimit të procedimit penal duhet të jenë të tilla që, për rastin e fillimit të procedimit penal mjafton standardi minimal, dyshimi i arsyeshëm se jemi para një veprë penale, e cila është e paraparë me ligj dhe e sanksionueshme dhe, kështu, organit procedues i imponohet detyrimi ligjor për të ushtruar ndjekjen penale. Ndërsa në rastin e mosfillimit të procedimit përjashtohet ekzistenca e çdo lloji dyshimi se mund të jemi para një veprë penale, sepse nuk ka elemente të saj, se “x” apo “z” personi të ketë kryer veprë penale.

28. Policia gjyqësore është subjekt përcaktues i fillimit të procedimit penal në kuptimin se, *de facto*, është ajo që realizon ndjekjen penale, duke kryer një sërë veprimesh me vetë

iniciativë, në përputhje me KP-në, duke shënuar në këtë mënyrë edhe fillimin e procedimit penal.

29. Nëse do ta pranonim faktin, se koncepti, ndjekje penale, dhe, procedim penal, janë të ndryshëm, nuk do të bënim gjë tjetër, veçse do të pranonim cenimin e ligjshmërisë së sistemit të drejtësisë.

30. Më këtë rast gjykatat e shkallëve të ndryshme marrin të njëjtin vendim gjyqësor, atë të pushimit të çështjes, duke iu referuar rasteve të ndryshme. Ndërsa, po të pranonim faktin se këto koncepte janë të ndryshme, atëherë do të përqaфонim idenë e një sistemi të pasigurisë juridike. Duke qenë se sistemi i drejtësisë bazohet me ligjshmëri dhe siguri juridike, atëherë, **termi ndjekje penale dhe procedim penale, të cilat i përdor KP-ja, SHQIPTARE, janë i njëjti koncept.** Si rrjedhim, rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal apo vazhdimin e tij nëse ka filluar janë të njëjta me rrethanat që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale, apo vazhdimin e saj, kur ai ka filluar (neni 387, 428, 442 të KPP-së). Me ndjekje penale – procedim penal kuptojmë aktivitetin shtetëror që zhvillohet nga Prokuroria dhe policia gjyqësore, me anë të të cilit synohet të vërtetohet nëse kemi një vepër penale apo jo, cili është autori i saj, më çfarë formash faji është kryer, dhe, së fundi, të përcaktohet masa e cënimit nga gjykata dhe ekzekutimi nga ana e organit të Prokurorisë.

31. KPrPSh, në nenin 277 përcakton se, hetimet janë në lidhje me vetë ndjekjen penale, që do të thotë se, hetimet janë të pandara me ndjekjen penale. Kështu arrijmë përfundimin se vetë ushtrimi i ndjekjes penale – procedimit penal, shprehet me kryerjen e veprimeve hetimore për sqarimin e rrethanave të faktit, nëse fakti i pretenduar është kriminal apo jo.

32. Ndërkaq, nëse rasti i gjykuar është më se i qartë, problemi konsiston në faktin se si do të veprohet në ato raste kur është vendosur mosfillimi apo pushimi i çështjes për një çështje konkrete, në ngarkim të një personi konkret, ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim në gjykatë dhe te prokurori i përgjithshëm, dhe se më pas paraqitet i njëjti kallëzim, për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtit person, si të veprohet më tutje?

33. Në këtë rast mendohet se e vetmja mundësi e drejtë dhe e ligjshme është, pikërisht, vënia në lëvizje e prokurorit të përgjithshëm, pasi që ky është i vetmi autoritet që mund të shfuqizojë vendimin e prokurorit më të ulët. Përjashtim paraqet rasti kur, kallëzuesi ka paraqitur fakte apo prova që tregojnë se vendimi i mosfillimit të procedimit, apo i pushimit të çështjes kanë qenë të gabuara. Çdo zgjidhje tjetër do të përbënte një kërcënim për rendin juridik, zbehje të autoritetit të prokurorisë.

-Për veprat penale që u dihet vendngjarja, mendohet se nuk mund të procedohet në mos fillim të procedimit penal, ndonëse nga praktika e përditshme, jo në pak raste, është vendosur mos fillimi i procedimit penal, sidomos në rastet e vetëvrasjeve, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, të vdekjeve të papritura, të dëmtimit të pronës së tij. Por, me regjistrim të procedimit penal, i cili tashmë ka filluar nga organi procedues penal, duke kryer hetime dhe, në mungesë të provave dhe shkaqeve të parashikuara me ligj, procedimi duhet të pushojë.

34. Poqese Prokuroria apo Policia gjyqësore kryejnë veprime procedurale – hetimore, konform rregullave procedurale penale, si në drejtim të faktit të supozuar kriminal, ashtu edhe në drejtim të personit, atëherë, detyrimisht, ka filluar një procedim penal, që do të thotë, ka filluar një ndjekje penale.

35. Me mosfillim të procedimit penal kuptojmë pamundësinë ligjore të shtetit që, nëpërmjet të organit të tij, prokurorisë, të zhvillojë veprimtari procedurale hetimore për një çështje të

caktuar. Përpara se të vendosë mosfillimin e procedimit penal, e drejta e prokurorit është të kryejë veprime joprocedurale – veprime verifikuese.

36. Nisur nga fakti se rrethanat e mosfillimit të procedimit penal lidhen, jo vetëm me personin, por edhe me faktin, arrijmë në konkluzionin e vetëm e të pakundërshtueshëm se, veprimtaria me iniciativën e policisë gjyqësore, është pjesë e procedimit penal, që do të thotë se kjo veprimtari shënon praktikisht fillimin e procedimit penal.

37. Në kuptimin e veprimeve joprocedurale do të kuptojmë çdo lloj veprimi, i cili kryhet nga prokurori e policia gjyqësore që i përkasin karakterit administrativ, civil etj. Pra, ato veprime kryhen duke respektuar rregullat ligjore të fushave përkatëse, por jo edhe rregullat procedurale penale. Si të tilla mund të jenë: marrja e ekstrakteve të ndryshme (jo sekuestime), procesverbale të caktuara, të kryera jo mbi bazën e dispozitave të KPP-së, konfirmime nga institucionet e tjera, kërkesa për paraqitje dokumentesh drejtuar institucioneve të ndryshme etj.

38. Në nenin 289 të KPP-së duke ndaluar disa verime hetimore, si: ndalimi, caktimi i masave të sigurimit, kontrollimit, këqyrja e personit etj., por, duke lejuar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, do të thotë se ke filluar edhe ndjekje penale në rast se ke shënuar emrin personit, të cilit i atribuohet vepra penale që është regjistruar në regjistrin përkatës të njoftimeve të veprave penale. Mendoj se kjo është një dispozitë që bie ndesh me ligjin themelor të shtetit, i cili që përcakton se disa funksionarë shtetërorë nuk mund të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit kompetent⁸⁷.

39. Heqja dorë për ndjekje të procedimit penalë, vie si rezultat kur i dëmtuari paraqet kërkesë tekë organi procedus, duke u deklaruar se nuk ndien intersim ndjekjeje penale⁸⁸. Kërkesa i lejohet të dëmtuarit në çdo moment dhe në çdo stad të rrjedhës së procedurës

⁸⁷ Te zgjedhurit nga vota e popullit, psh. deputetet e parlamentit nuk mund të ndiqen penalisht përderisa organi më i lartë ku përfaqësojnë nuk japin autorizim procedimi.

penale, përderisa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë, bazu në (Kodin e Procedurës Penale të Shqipërisë, vitit 1995 dhe Kodeve të mëhershme).

40. Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës, formalisht në esencë ndryshon nga ligji procedural paraprak i mëhershëm Jugosllavë, sa i përket pjesës së procedimit hetimor që ishte nënë autoritetin e gjykatës dhe, këtë funksion ia beson Prokurorit kompetent, duke e autorizuar atë që, gjatë udhëheqjes së procesit hetues, ta drejtojë dhe mbikëqyrë edhe punën e policisë gjyqësore, (neni 200, paragrafi 3 i KPPPK-së, 2004).

41. Dobësitë imanente në sferën e zhvillimit të procedurës hetimore, pa u mbështetur në parimet e caktuara penale dhe procedurale, sigurimin e provave, të cilat në këtë fazë janë detyrim për prokurorinë; dhe Jo shumë rrallë, hamendjet e prokurorisë lidhur me ekzistimin ose mosekzistimin e veprës penale, ose me cilësimin juridik të saj, duhet t'i zgjidhë gjykata, me aktgjykim. Dominon logjika që çështjet e caktuara t'i vlerësojë gjykata!

42. Jo rrallë vërehet se prokurorët kanë tendencën e hedhjes së fajit në gjykata. Ata, lëndët e caktuara nuk i përpunojnë mirë dhe, provat, kërkesat e procedurës së hetimeve, veprimet e ndryshme nuk i kanë të zhvilluara siç kërkohet. Kështu, aktakuza e përpiluar nga ta nuk është e kompletuar dhe, gjyqtarët, jo rrallë i hedhin poshtë aktakuzat e tilla. Në këto situata prokurorët shfajësohen se në gjykata ka oportunitet, duke krijuar kështu mundësitë e kundërpërgjigjes së gjykatave se, janë prokurorët ata që nuk kanë sjellë prova të mjaftueshme për zhvillim të duhur të gjykimit. Në të dyja rastet palët e dëmtuara janë humbës, kurse prokurorët dhe gjykatësit vetëkënaqen duke raportuar vetëm me numra të lëndëve të zgjidhura.

43. Objektivat e parapara me ligjet e aprovuara në Republikën e Kosovës në fushën e të drejtës penale, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale nuk kanë arritur në pritshmëri të duhur dhe shkaqet janë të nduarduarshme. Nga këtu nxjerrim se objektivat nuk arrihen në një kohë kaq të shkurtër. Kemi mungesë të përgatitjes në harmoni me kërkesat e këtyre

ligjeve, të cilat janë inkorporuar në sistemin e drejtësisë, por, pa u bërë përgatitjet e duhura kadrovike dhe pa u pajisur me dijeni të mjaftueshme lidhur me këto ligje, i tërë personeli – bartës i veprimeve të procedimeve penale. Ligjet vetvetiu kanë ndikuar në rritjen e numrit të kallëzimeve penale. Por, kjo nuk do të thotë se është ngritur efektshmëria në ndjekje dhe në procedime penale përgjithësisht.

44. Heqja e paditësit subsidiar mund të ketë shkaktuar mundësi për arbitraritet dhe ndikim në prokurorë. Pala e dëmtuar, me zgjidhjet e reja ligjore përcaktuara në KPr.PK-es, në zbatim nga viti 2013, nuk paraqitet më si paditës subsidiar dhe, si palë e dëmtuar, fatin e vet e ka të lidhur ngusht me vendimin dhe me veprimet e prokurorit, rrugëtim ky që me projekte propozimi e draftimit të vitit 2014 në Shqipëri, sa i përket ndryshimeve të shumta do jetë edhe qështja e të drejtave të dëmtuarit, të cilat do barasvlersohen si në KPr.PK-ës.

45. Gjithashtu, me KPrPK-es, parashihet edhe një risi sipas nenit 153 dhe ka të bëjë me njëfarë kontrolli të hetimeve, të punës efikase të prokurorit të shtetit. Sipas këtij neni prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij, shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet, apo të ngrihet aktakuza (neni 156 i KPPRK-së, viti 2012,fq.70).

46. Praktika hetimore, ka dëshmuar dhe dëshmon se faza më e dobët e procedimit penal është procedimi penal paraprak, në faktin se në këtë fazë është marrë policia e, më vonë përmirësimet e tilla i ka bërë organi i policisë gjyqësore, si organ më adekuat, i profesionalizuar.

47. Roli i prokurorit ka karakter formal të debatit gjyqësor, gjë që e obligon prokurorinë që, në përputhmëni me zhvillimin e debatit gjyqësor, të krijuar ndërmjet vetë të të dëmtuarit akuzues dhe të personit të cilit i atribuohet vepra penale, të kërkojë dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Po të jetë subjekt themelor i ndjekjes penale në këto

gjykime, atëherë lind pyetja se a mund të kërkojë pafajësi prokurori gjatë gjykimit të këtyre çështjeve?

48. Kompozimi i funksionit hetues me funksionin e mbikëqyrësit të të drejtave dhe lirive individuale është logjika e ligjvënësit, e cila, që në fazën fillestare të zbatimit të KPPPK-së, po has në vështirësi.

49. Vlenë theksuar se sipas projektligjit të Kodit të procedurës Penale të dt. 27.01.2014 i finalizuar janë bërë ndryshime të shumta për subjektet procedural si dhe aplikimi i institutit të pranimit të fajësisë i cili është shtuar pas KREUT VIII Neni 123 pas KREUT VIII “PËRFUNDIMI I HETIMEVE”, shtohet Kreu IX “MARRËVESHJET MES PROKURORIT DHE TË PANDEHURIT”, me përmbajtje si vijon: “KREU IX MARRËVESHJET MES PROKURORIT DHE TË PANDEHURIT SEKSIONI I MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË, i cili i referohet edhe procedurës penale paraprake që ka të bëjë me fillimin dhe mosfillimin e procedimeve penal.

Neni 332/1 i referohet arritjes se marrëveshjes ku thuhet:

1. Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të arrihet mes prokurorit dhe të pandehurit që nga momenti i regjistrimit të procedimit deri në momentin kur të pandehurit i kërkohej të deklarohet për akuzën në gjykim. 2. Në momentin e arritjes së marrëveshjes, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës. 3. Marrëveshja e bërë më shkrim paraqitet nga prokurori dhe shqyrtohet nga gjyqtari i caktuar sipas nenit 278, nëse bëhet gjatë hetimit paraprak, ose nga kryetari i trupit gjykues, nëse bëhet gjatë gjykimit. 4. Nëse marrëveshja arrihet para se të dërgohet çështja në gjyq, prokurori do t’i bashkangjisë asaj edhe kërkesën për gjykim, e cila përbën një pjesë thelbësore të marrëveshtjes. Gjithashtu me këtë projektligje të finalizuar është bërë edhe decentralizimi i Kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm në Shqipëri të cilat ishin mase absolute në raporte me

Prokuroret tjerë. Andaj qëllimi i Khipotezes nr.II, të këtij punimi është përmbushur ngase në periudhën kur janë nxjerrur Hipotezat e punimit nuk ishte në finalizim dhe as në lexim draftimi i këtij projektligji të theksuar për reformat e pritura dhe të mirëqena për sistemin e drejtësisë në R. E Shqipërisë. Këto dhe shumë ndryshime të tjera më gjersishtë do i gjeni të shtjelluara në Projekt PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.03.1995, ‘KODI I PROCEDURËS PENALE’, I NDRYSHUAR” dt.27.01.2014.

REKOMANDIME

Duam të besojmë se përveç dobësive imanente, të cilat janë aktuale në praktikën gjyqësore në implementim, KPPK-ja dhe KPPSH-ja, që në këtë fazë edhe mund të jenë të arsyeshme, ende ekzistojnë mundësi që duhet shfrytëzuar. Kompozimi i funksionit hetues me funksionin e mbikëqyrësit të drejtave dhe lirive individuale është logjika e ligjvënësit, e cila që në fazën fillestare të zbatimit të KPPPK-së, po has në vështirësi.

Jo shumë rrallë, hamendjet e prokurorisë lidhur me ekzistencën ose mos ekzistencën e veprës penale ose me cilësimin juridik të saj, duhet t’i zgjidhë gjykata me aktgjykim. Dominon logjika që çështjet e caktuara t’i vlerësojë gjykata! *Dobësitë imanente në sferën e zhvillimit të procedurës hetimore pa u mbështetur në parimet e caktuara penale dhe proceduralë, sigurimin e provave të cilat tani në këtë fazë janë detyrim për prokurorinë; dhe në pikëpamje cilësore do të kontribuonin në zbatimin më cilësor të dispozitave ligjore. Për arritjen e këtyre synimeve propozojmë që duhet ndërmarrë këto masa: të cilat kanë të bëjnë me strukturën ekzistuese pas hetimeve dhe ndjekje në Kosova; që kanë të bëjnë me bashkëpunimin më konkret në fushë në mes të institucioneve të fushës nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës dhe ndryshimet në legjislacionin*

ekzistues dhe harmonizimin e tyre me legjislacionet e vendeve te bashkimit evropian ku synon Kosova të shkoj.

- Të vazhdohet edhe me tutje me organizimin e punëtorive profesionale lidhur me trajnimin profesional të prokurorëve dhe gjyqtarëve, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, me qëllim të shkëmbimit të përvojave më cilësorë të procedurës hetimore, me logjikën e re të veprimit dhe atë, në profilizim fushash e jo për çështje ndjekjesh të përgjithshme.
- Pavarësisht ndryshimeve, institucionet përkatëse të të dyja shteteve, përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit, të kenë qasje të njëjta në aspekt të **fillimit/mosfillimit** të ushtrimit hetimit-ndjekjes. Në disa çështje bashkëpunimi duhet të jetë edhe duke krijuar trupa të përbashkëta, p.sh, për çështjet e krimit ndërkufitar.
- Të mundësohet puna profesionale sipas asaj që njihet si internship-prokuror, nga Republika e Shqipërisë të kalojnë koha në Kosova nëpër të gjitha institucionet e drejtësisë me fokus Prokurorit dhe anasjelltas.
- Angazhimi konkret në drejtim të përmirësimit dhe efikasitetit të organeve gjyqësore, të policisë dhe prokurorisë, me qëllim të rritjes së luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë tema të rëndësishme, të cilat trajtohen gjatë zbatimit në praktikë të MSA.
- Meqe në Kosovë është sjellur ligji për akademin e drejtësisë në Kosovë i cili shumë shpejtë pritët të implementohet, bartësve të ardhëshëm që do të përzgjedhen si përgjegjës të këtij institucioni të rëndësishëm ju sugjerohet që të vazhdojnë me shkëmbimin e përvojave me përfaqësuesit e kësaj akademie në Shqipëri, pasi këta të fundit kanë këtë akademi vite me heret dhe meqë jemi në afërsi në baza të rregullta të jenë të

pranishme për të bartur përvojën e tyre tek ndjekësit e mësimave. Njësoj të veprohet edhe me ekspertët nga bota akademike.

- Me qëllim të ndërgjeshmërisë së mëtejme të prokurorëve, pavarësisht detyrave që u janë ngarkuar sipas ligjit, është e domosdoshme njohja e tyre me rekomandimet e Këshillit të Evropës “Për prokurorinë”. Kjo do të bëjë të mundur që ata të njohin më mirë standardet dhe detyrimet e tyre në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e tjera të Këshillit të Evropës. Një nga rekomandimet që vlen të përmendet në këtë drejtim është edhe ai nr. R (87) 18, i Komitetit të Ministrave “mbi lehtësimin e drejtësisë penale”. Sipas këtij rekomandimi, duke pasur parasysh numrin e shumtë të çështjeve penale që dërgohen për gjykim e, veçanërisht për ato që parashihen dënime të lehta, rekomandon, midis të tjerash, parimin e procedimit jo të detyrueshëm. Sipas këtij rekomandimi, heqja dorë nga procedimi, ose vendimi i mosfillimit të procedimit, për veprat penale të lehta dhe, në rastet kur përmbushen disa kushte nga ana e të dyshuarit si, kompensimi i dëmit ndaj të dëmtuarit, sjellja e tij me të dëmtuarin, si dhe ndonjë detyrim tjetër i përcaktuar, apo edhe lirimi me kusht.

- Fillimi i hetimeve, apo edhe mosfillimi është bërë praktikë e shabllonizmave gjatë nxjerrjes së vendimeve gjyqësore dhe atyre procedurale tek pjesa dërmuese e prokurorëve dhe gjyqtarëve për çka mendoj se veprimet e tilla duhet shmangur - larguar sepse jo çdoherë jo gjithherë një çështje e vendosur, qoftë në procedurë paraprake penale apo me vonë në procedim shqyrtues gjyqësor, të jetë meritore, përkundër faktit? që nuk është aplikuar e drejta e rekursit. Kjo jep të kuptosh se prokurorët edhe gjyqtarët në fazën e mëvonshme akoma nuk janë të gatshëm të jenë vetë të pavarur. Kur vendosin në mënyrë të shabllonizuar, ata, sikur vetëcenzurohen, duke mos i lënë vetes mundësi që hetimet ta bëjnë në bazë të dijes, ekspertizës, kreativitetit në mbledhje të provave.

- Maksimalisht t'i shfrytëzojnë mundësitë për vërtetimin e provave me angazhimin e ekspertëve nga të gjitha fushat dhe, në asnjë mënyrë çështjet, që kanë nevojë për ekspertizë, të mos i kalohen gjykatës, pa u zbatuar nga organi ndjekës, dhe, akti akuzues gjykatës, mos i përcillet për, shqyrtim gjyqësor pa prova të duhura mbështetëse.
- Të jenë më aktivë në fazën parapenale, respektivisht të jenë më operativë dhe më bashkëpunues me policinë hetimore të njësive përkatëse gjyqësore, lidhur me sigurimin e provave, e sigurimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes;
- Ndryshimet në KPP pasi për të njëjtin kuptim përdoren terme procedurale të ndryshme, çka ndonjëherë sjellë edhe keqkuptime të ndryshme të veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të procedimit penal (Procedimi penal, ndjekja penale, pezullim të hetimeve, pezullim të procedimeve). ?
- Heqja dorë nga KPP i disa rrethanave që përcaktojnë mosfillimin e procedimit penal konkretisht, kur fakti nuk ekziston, personi ka vdekur, personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale, fakti nuk përbën vepër penale, si dhe shprehja në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligje. Pasë parasyshë se vendimet e Gjykatës se lartë janë ligje dhe se për situatën e theksuar ka sjellë vendim unifikues për këtë çështje , duke përcaktuar se fakti nuk do kishte për të egzistuar vetëm dhe vetëm atëherë kur organi procedues të ketë përfunduar hetimet. Vendimet e tilla për sqarim situatash dhe dilemash është e kuptueshme që i nxjerrë Gjykata e Lartë e Shqipërisë si autoritet me kompetenca kushtetuese. Për këtë rekomandojmë që të gjitha këto të fusen në nja afat sa më të shkurtër për kodifikim në KPrPSH, më qëllim që punonjësit e sistemit prokorial dhe gjyqësor të praktikës dhe te teorisë dhe fushës akademike të jenë në përmasa më të mëdha njoftuese me ndryshimet që ndodhin.

- Në rastet e moshës për përgjegjësi penale nuk janë të pakta rastet kur personat e ndryshëm nuk janë regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, apo janë regjistruar me emra të ndryshëm, apo ndryshojnë qëllimisht gjeneralitet, kështu që është e domosdoshme heqja e një klauzole të tillë nga rastet e mosfillimit të procedimit penal, por të merret një vendim vetëm pas kryerjes së hetimeve paraprake.
- Për rastet e papërgjegjshmërisë kërkojnë kryerjen e ekspertimeve si domosdoshmeri, të cilat mund të kryhen vetëm në rastet e një procedimi penal të filluar, ndërsa të mosfillimet nganjher duke e parë vetëm moshën në një dokument të caktuar që e ka në dispozicion kryesi e i cili mund të jetë si i tillë i falsifikuar dhe se data e tij e saktë sipas regjistrit të gjendjes civile nuk do na dërgonte të një vendimmarrje mosfillimi për shkak të moshës ashtu siq ka vlersu organi procedues, por në vendimmarrje fillimi. Mu për këtë organi procedues duhet të ketë parasyshë një verifikim të tillë duke kërkuar ndihmë akteriale përmes parashtresës për moshën e të dyshuarit ashtu që pas verifikimit të sjellë vendimin meritore të fillimit apo mosfillimit varsishtë nga të dhënat e siguruar.
- Për rastet kur fakti nuk përbën vepër penale, në të shumtën e rasteve ndihet nevoja për hetime, pa folur këtu qartazi për raste të dukshme. Personi që ka bërë një kallëzim penal, kundër përgjegjësisë për kallëzim të rremë, është përgjegjës për sa kallëzon. Nuk janë të pakta rastet kur ai është i bindur se fakti që kallëzon është vepër penale, por që rezulton se nuk duhet filluar procedimi penal. Në këto raste të shihet mundësia jo vetëm e ngarkimit të tij në shpenzimet procedurale, por edhe vjedhja e këtyre shpenzimeve. Rekomandoj që për situata të tilla të shtohet një normë e veçantë përveq përgjegjësis penale që paraqitësit i bije me automatizëm të arkatoj shpenzimet e krijuara për kallëzim të rremë. Kjo normë të veçohet nga shpenzimet procedurale por dukshëm të jetë më e lartë dhe të jetë në kuadër të normimit të veprës penale në KPK dhe KPSH, në zbatim.

- Në lidhje me vetëkallëzimet, praktika e deritanishme ka treguar se kallëzimet e tilla bëhen nga personat më gjendje mendore të dyshimtë. Prandaj, verifikimi i këtyre kallëzimeve është i domosdoshëm dhe duhet bërë duke treguar kujdesin maksimal. Te tyre para se te merret vendimi konkret i fillimit apo mosfillimit. Çështje me interes e pa hasur në doktrinen e drejtes penale shqiptare.
- **Krjimi i policisë Gjyqësore-** Policia gjyqësore e cila aktualisht i mungon shtetit të Kosovës është mase e domosdoshme të formohet sepse ajo e luan rolin primar në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Kriminalitetit. Arsyeja e parashikimit të policisë gjyqësore, si në Shqipëri, për procedurën tonë penale në Kosovë, paraqet nevojë dhe domosdoshmërinë për të siguruar kualitetin e nevojshëm në fillimin e procedimit penal dhe në zhvillimin e hetimeve paraprake. Në këtë drejtim, Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria duhet në bashkërendim me Policinë e Shtetit të krijohet sa më parë policia gjyqësore me theks të veçantë në të gjitha fushat që në Kodi Penal i Kosovës, i ka normu veprat penale nëpër kapituj të veçantë. Policia gjyqësore e specializuar në bashkëveprim me organin e ndjekjes duhet të kenë rolin kryesor në parandalimin dhe zbulimin e autorëve të veprave penale në fushën e ekonomisë. Policia e shtetit duhet të veprojë që në këtë strukturë të përfshijë persona me përgatitje të lartë shkollore dhe me eksperiencë që do të ndikonin në rritjen e efikasitetit në fillimin dhe mosfillimin e procedimit penal paraprak.
- Domosdoshmëria, për, shtimin e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, duke mos përfshirë edhe shtimin e numrit të bashkëpunëtorëve profesional dhe atë së paku dy gjyqtarë ta kenë në dispozicion një bashkëpunëtor. Kujtoj se Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor në Kosovë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë në Shqipërisë, duhet të rrisin numrin e prokurorëve gjyqtarëve, dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, duke krahasuar numrin ardhës të kallëzimeve penale mbi bazat vjetore dhe mundësin dhe kapacitetet e numrit të zgjedhjeve të tyre e që nga studimi imë është vërejtur

nji rritje nga 12-26 % e tyre në vitë si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, për periudhën e studimit. Kjo rritje e shprehur e kallzimeve penale të pranuar në vitë për Shqipëri dhe në shtetin e Kosovës paraqet një disbalancë të madhë në raport me numrin e Prokurorve që aktualisht janë në ushtrim funksioni. Shtimi i tyre do t'i shërbente rritjes së efikasitetit në zbulimin e veprave penale dhe zvoglimit të numrit të çështjeve penale për të cilët shoqëria pretë derjtësi meritore në kohë dhe afat të duhur siq parashohin edhe nenet e KEDNJ dhe ligjet organike të të dyja vendeve.

- Përcaktimi i saktë i termave egzistues në KPrPSH, përmes një dispozite të veçantë është domosdoshmëri sepse egzistojnë terma shprehimor me emërtime të ndryshme, bile edhe në vetë Komentarin e Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, i sjellur nga Ilir Pando, Artan Hoxha..., në këtë kontekst gjykoj se është nevojë një normim i veçantë pasi që diku e përmendin ushtrim ndjekje, ndjekje penale, procedim penale, hetim etj.

Vendosja normues e afateve të parashkrimeve relative rreth veprave penale në Shqipëri siq është në Kosovë, është domosdoshmëri, afat ky që kishë me shprehë disiplinim për organin ndjekës, ku për fajin e tij, parashkruhet vepra penale për shkak të neglizhencës së tij pa marrë asnjë veprim nga pranimi i kallëzimit penal.

Në këtë kontekst, gjykoj se është edhe e domosdoshme të përcaktohen afatet e posaçme të parashkrimit për ato lloje veprash penale që ndiqen edhe sipas iniciativës së të dëmtuarit të akuzës.

- Të bëhet përcaktimi i saktë i veprimeve që mund të kryhen para se të vendosësh mosfillimin e procedimit penal, pra, të shtohet një dispozitë me përmbajtje që të theksojë se prokurori ka të drejtë të vendosë mosfillimin e procedimit penal edhe në rastet kur janë kryer veprimet hetimore, duke përcaktuar taksativisht një dispozitë të mirëfilltë lidhur me autorizimin që ka prokurori dhe policia gjyqësore për të kryer veprime hetimore konkrete.

- Mendoj se KPP-ja duhet të pësojë ndryshime nga të cilat rezultojnë se mosfillimi i procedimit penal të kushtëzohet vetëm me ato raste kur nuk nevojitet kryerja e veprimeve procedurale penale e, si të tilla, mund të përmendim, se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, vepra penale është shuar, është amnistuar, personat që gëzojnë imunitet diplomatik, ose të ekzistojë si institut i plotë, siç është aktualisht, por të parashikojë në mënyrë taksative se çfarë veprimesh procedurale-penale mund të kryhen nga prokuroria dhe policia gjyqësore të cilat, penal duke iu referuar njërit nga kushtet që nuk lejojnë fillimin e hetimeve, pavarësisht se janë kryer, i japin të drejtë prokurorit që të vendosë mosfillimin e procedimit.
- Ndryshimet e nenit 277 të KPP-së duke e lidhur kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim që të ushtrohet ose jo ndjekja penale, pra, hetimi të mos jetë i lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale, të mos jetë shprehje e ushtrimit të ndjekjes penale, siç është aktualisht por të saktësohet si fillim i hetimeve..apo fillim i procedurës paraprake, më qëllim që të kemi nja normim më të përshtatëshem.
- Ndryshimet që duhet bërë në kodet e procedurës penale si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri duhet të ashpërsohet sanksionimi me ligje i vlerave të rëndësisë së vogël. Mbizotron arsyeja e nja propozimi për amadamentim me nene plotësuse që egzistojnë sepse konsideroj se është preventivë në vetëdijsimin e kryersve te këtyre veprave. Aktualishtë si në Kosovë ashtu edhe në shqipëri janë evidente kryesit e këtyre veprave penale.
- Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në Kosovë të ndodhura në vitin 2012, lidhur me pushtetin diskrecional të prokurorit duhet të parashohin mundësinë, që palët e dëmtuara ta ankimojnë këtë pushtet në rastet kur prokurori konsiderohet se nuk vepron konformë dispozitave për fillim procedimi penal, apo kur qëllimisht, duke e përdorur pushtetin diskrecional, nuk e zbaton ligjin. Aktualisht këtë të drejtë nuk e gëzon me KPrPK, në zbatim

e qe më heret e kishte sipas vitit 2004. Rekomandojm nxjerrjen e një dispozite të veçantë për ta ankimuar pala e dëmtuar pushtetin e organit ndjekës Prokuroret me rastin e hudhjes së kallëzimit penal.

- Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar studimit të materialit kallëzues. Ka ndodhur që, në shikim të parë, materiali kallëzues, pa u thelluar në përmbajtjen e tij dhe pa kryer veprime të tjera verifikuese nga organi, të bëjmë një kualifikim të gabuar të veprës penale të kryer e, në këto kushte, ajo rezulton e parashkruar, kur, në fakt nuk është e tillë. Në këto kushte, organi procedues, me pa të drejtë, do të vendosë pushimin ose mosfillimin e ndjekjes penale, për shkak të parashkrimit. Këtu organi procedues do duhej ulur përformanca me automatizem por paraprakisht do duhej rregulluar me mekanizëm përkatës normues kur situata e tilla përsëriten mbi tri raste parashkrimesh për shkaqe cilësimesh juridike të gabuara, nga organi procedues për shkak të jo profesionalitetit të tij.
- Të normohet –amamentohet një dispozitë në KP të Kosovës, përshtatshmërisht sikurse e ka të normuar KPSH, në nenin 313 që i referohet Prokurorit kur ndërmerre fillim të paligjshëm të ndjekjes penale, me faktin se praktika ka evidentu situata të tilla fillimesh.
- Rekomandojmë, aprovimin e dispozitës së nenit 35 të projekt KPrPSH, përmes të secilit është mëndur ndryshimi i nenit 58 i kodit aktual, më arsye se po bëhet një barazim njëjtësisht i të drejtave që i ka i dëmtuari sipas nenit 62 të KPrPK-es.
- I dëmtuari në një proces penal ka një rol të rëndësishëm, jo vetëm për interesat e tij, por edhe për procesin në tërësi, pasi ky proces nuk ka si qëllim vetëm ndëshkimin e kryerësit të veprës penale, por për atë që është e mundur, edhe kompensimin e dëmit që i është shkaktuar të dëmtuarit nga vepra penale. KPrPSH nuk ka nën të veçantë që të përkufizojë shprehjen “i dëmtuar”, por në kreun e VI të tij, që ka të bëjë më të dëmtuarin, paditësin dhe të paditurincivil, kur flitet për të drejtat e të dëmtuarit mund të vimë në përfundimin se i

dëmtuari është personi i cili është dëmtuar nga kryerja e veprës penale. Kur flitet për dëmin, kjo nënkupton çdo dëm që mund t'i jetë shkaktuar të dëmtuarit nga vepra penale e kryer.

- Në Republikën e Shqipërisë e sidomos në Rrethin Gjyqësor të Tiranës kamë. vrejtur se masat e sigurisë në procedur paraprake, ekskluzivishtë lëshohen nga dega civile e gjykatës, gjë që për mua personalishtë ka zgjuar shqetësim dhe intersim. Arsyeja e këti shqetësimi është se është e pa imagjinueshme se sa janë në gjendje gjyqëtarët civilistë ti analizoin kërkesat e prokurorit për të nxjerrë vendime të ligjëshme penale për caktim masashë. Sa janë të familjarizuar me procedur penale neqoftë se asnjher nuk kanë punuar si gjyqtarë penalista? Sa janë në gjendje ti kuptojn kushtet e secilës masë se kur duhet aplikuar etj. E kuptoj se ka munges gjyqetaresh por shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut është e pakompenzueshme me privim lirie të gabuar.

LITERATURA DHE BIBLIOGRAFIA

Burimet parësore

1. Bashkimit Evropian, datës 30 mars 2010.
2. DUDNJ – Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948.
3. GJEDNJ – Gjykatat Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
4. KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, viti 1950.
5. Kodi i Drejtësisë për të Miturin. 03-L93, i vitit 2010.
6. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004.
7. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës i vitit 2012.
8. Kodi Penal i Republikës së Kosovës i vitit 2012(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
9. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë i vitit 2006 (Gazeta zyrtare nr.37/96).

10. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 2001(ligji me nr.8733, Fletorja Zyrtare).
11. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1995(ligji me nr.7895, i datës 27.1.1995).
12. Konventa e të drejtave të fëmijëve nr.4 shkurt 2001).
13. Korniza Kushtetuese e Kosovës, e vitit 2001 Kosovës.
14. Kushtetuta e Republikës se Kosovës, e vitit 2008.
15. Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë e vitit 1998.
16. Kushtetuta e RSFJ-së, e vitit 1974.
17. Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
18. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar).
19. Ligji nr. 8677, datë 2.11.2000, për Policinë Gjyqësore, Tiranë.
20. Ligji nr. 9090, datë 26.6.2003, për ndërmjetësimin në zgjedhjen e22.7.2010.
21. Ligji i Procedurës Penale i RSFJ-së i vitit 1977(Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.4/77).
22. Ligji mbi policinë me nr. 04/ L-076,i datës 2 mars 2012.
23. Ligji nr. 03./L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e KPPK-së.
24. Ligji nr. 04/L-140, i datës 11 shkurt 2013.
25. Ligji Penal i KSAK-së,1977.Kuvendi i Kosovës nr.011-25/77.
26. Ligji Penal i RSFJ-së i vitit 1977.
27. Ligji për gjykatat e rregullta, Gazeta Zyrtare KSAK, 21/1978, datë 28 prill 1978.
28. Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës, nr./L-199, miratuar në Kuvend .
29. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës nr.03/L-224 miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
30. Ligji për prokurorinë e Kosovës, Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 32/1976, datë 28 korrik 1976.

31. Ligji për prokurorinë e shtetit me nr.03/L-225, i datës 30 shtator 2010.
32. Ligji për prokurorinë, i Republikës së Shqipërisë, nr. 8737, datë12.2.2001.
33. Ligji nr.1650,datë 30.3.1953, Kodi i Procedurës Penale(hyrë në fuqi më 1 qershor 1953),Gazeta Zyrtare nr.7,30 maj 1953, 362 nene.
34. Dekretnr.1776,datë 3.12.1953,“Mbi shtesat dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale”, Gazeta Zyrtare nr.17, 14nëntor 1953,f.367,35 nene.
35. Kodi Penal, Dekretinr.615,datë 13.5.1948, shpallur me ligjin nr.599, datë 13.5.1948:Kodi Penal shqiptar-Gazeta Zyrtare nr.63,e premte,4 qershor 1948,f. 1–15,106 nene.
35. Dekretnr.1142, datë 11.9.1950,Mbi disa korrigjime në Kodin Penal, pjesa e përgjithshme shpallur me numër të ligjit nr. 599, datë 13.5.1948, Gazeta Zyrtare nr.65, 5 tetor 1950, f.2–3,2 nene.
36. Dekret nr. 941, datë 08.10.1949. mbi interpretimin autentik të nenit 104 të Kodit Penal të ri, Gazeta Zyrtare nr.81, 25 tetor 1949, f.14.
37. Ligji, KPP i vitit 1959.
38. Ligji, KPP i vitit 1980.
39. Ligjin kundër Korrupsionit të Kosovës nr. 2004/34 i miratuar më 22 prill 2005.
40. Ligjin mbi amnistinë, Republika eKosovësnr.04/L-209, shtator 2013 me nr.13/19).
41. PNDKP – Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.
42. Rregullore e Këshillit Evropian e aprovuar më 6.2.1962.
43. Rregullorja e Këshillit Evropian e datës18.12.1995.
44. Traktatet e Romës, të datës25 mars të vitit 1957, të cilat krijuan Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (EUROATOM).

45. Traktatet për Bashkimin Evropian, e posaçërisht atë të Romës, Romë 25 mars 1957, themelimi gradual i tregut të përgjithshëm të përbashkët (EEC) dhe Bashkësia Evropiane e Energjisë Atomike (EAEC ose Euro atom).
46. Traktati i Komunitetit Evropian dhe protokollin e Statutit të ESCB-së.
47. Vendimi nr. 65, datë 30.1.2002, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
48. Udhëzimi A nr. 2/13 i datës 4.1.2013, e që ka të bëjë me arrestimin, ndalimin dhe kërkesën përcaktimin e masës së sigurisë-paraburgimit.
49. General Comment no. 13 (artikulli 14), në UN Compilation of General Comments, f. 124

Burimet dytësore

Libra dhe punime:

1. Altin Shegani: E drejta Penale e krahasuar, botim i vitit 2008
2. Artan Hoxha: Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE-së. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumente të KE-së, botim i vitit 2010
3. Dimitrijevič, Dragolub, E Drejta e procedurës penale, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste, autonome të Kosovës – Prishtinë, 1976
4. E drejta penale. Prof. Vllado Kambovski, Shkup, 2006, f. 1068
5. Ejup Sahiti: E drejta e Procedura Penale Prishtinë, botimi i vitit 2005
6. Gashi, Rexhep, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë 2001;
7. Gashi, Rexhep, Krimi i Jakës së Bardhë – Prishtinë, 2012;
8. Gashi, Rexhep, Krimi i Organizuar, Prishtinë, 2010;
9. Grigor Gjika: Procedura penale e RPSH, PJESA E POSAÇME (dispense), Tirana, 1970
10. Grup autorësh: Komentari i KPP të RSH, botim i vitit 2003
11. Grup autorësh: Manual i Prokurorit dhe Policisë Gjyqësore, botim i vitit 2003

- 12.Hajdari, Azem, *Disa Aspekte të mënyrës së organizimit dhe veprimtarisë së prokurorit të shtetit në vështrim të zgjidhjeve që adreson L.P.SH.*, Avokatura, Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës, nr. 13, Prishtinë;
13. Hajdari, Azem, *E Drejta e Procedurës Penale* (pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2013;
14. Hajdari, Azem, *E Drejta e Procedurës Penale* (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2013;
- 15.Hajdari, Azem, *E Drejta e Procedurës Penale e të Miturve*, Prishtinë, 2005;
- 16.Hajdari, Azem, *Procedura penale, Komente*, Prishtinë, 2010;
17. Hasni, Čukalović, op. cit., f. 538
18. Ademaj, Xhemajl, *Hetimet në Vendin e Ngjarjes Kriminale*, shtypshkronja “ TINS”, Prishtinë, 2003
- 19.Ina Rama, *instrumentet ligjore dhe teknike të luftës kundër krimit të organizuar transnacional*. Botim i vitit 2007.
20. Islami, Hoxha, Panda, op. cit., f. 53.
22. Ismet Elezi: *E drejta Penale (Komentuar)*botimi i vitit 2009
- 23.Kurmehaj, Agim, *Autorizimet e Policisë në procedurën penale – Punim i magjistraturës*, Universiteti i Prishtinës- 2006, f. 5
- 24.Murati, Rexhep, *Disa aspekte të mbrojtjes të drejtave dhe lirive të njeriut në procedurën penale*;
- 25.Murati, Rexhep, *E drejta, Disa çështje mbi paditësin e autorizuar në procedurën penale të Jugosllavisë*, Fakultetit juridik nr.4,1983,Prishtinë;
- 26.Murati, Rexhep, *E drejta Penale dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të pandehurit në procedurë penale*, *E Drejta Fakultetit juridik* nr.3, 1996,Prishtinë;
- 27.Murati, Rexhep, *Prokurori Publik në Procedurën para penale*.
- 28.Murati, Rexhep, *Rishikimi i Procedurës Penale për shkak të fakteve dhe provave të reja*, Prishtinë 2006;

29. Murati, Rexhep, Sistemi Gjyqësor Penal në Kosovë dhe mbrojtja e të drejtave dhe Lirive të Njeriut; procedurës penale, E drejta, Fakulteti juridik, nr.1–2, Prishtinë, 1988;
30. Përmbledhje me rekomandime të KE për Prokurorinë, botim i vitit 2005.
31. Sahiti, Ejup & Rexhep Murati, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (shqyrtim teorik), E Drejta, nr. 3/2003, Prishtinë;
32. Sahiti, Ejup, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 2006;
33. Sahiti, Ejup, Dëshmia e Dëshmitarit si provë në procedurën penale, Prishtinë 1993;
34. Sahiti, Ejup, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005;
35. Sahiti, Ejup, Murati Rexhep, E Drejta nr. 3/2003, Prishtinë;
36. Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013;
37. Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Kunshtek, Eduard, Sistemi i Procedurës Penale i Kosovës;
38. Sahiti, Ejup, Procesi i të provuarit në procedurë penale, mundësit dhe vështirësitë, E Drejtat nr. 3/1996, Prishtinë;
39. Sahiti, Ejup, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë 2007;
40. Salihu, Ismet, E drejta penale (pjesa e përgjithshme) Prishtinë, 2008;
41. Salihu, Ismet, E drejta Penale për të mitur, Prishtinë, 2005;
42. Salihu, Ismet, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme Prishtinë, Kolegji Fama, 2006;
43. Skënder Begeja: Kriminalistika, botimi i vitit 2004
44. Vasilika Hysi: Kriminologjia, botin i viti 2010
45. Hulaj Murat, “Vepra Penale e Vjedhjes dhe Shkretimit të Pyllit në Gjykatën e Qarkut në Pejë në periudhën 2004–2007, shtypshkronja “Dukagjini”, 2010 Pejë.
46. Ali L. Bajgora, Veprat penale kundër lirisë së personit në planin krahasues, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike Prishtinë, 1999.

47.Afrim Shala, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, me raste nga praktika gjyqësore, Kolegji Gjilani, Gjilan,2010.

48.Bajram Yzeiri, Ligji dhe Policia (përmbledhje shkrimesh), shtëpia botuese “Ilar”,Tiranë, qershor 2002.

49.Vendim mbi pushimin e hetimeve, Rasti PP/I nr. 313/13, i datës 21.2.2014, Prokuroria Themelor Pejë- Departamenti për Krime të Rënda.

50.Aktakuza PPnr.403/14,datë 9.12.2014)për veprën penale armëmbajtje pa leje nga neni 374,paragraf 2 të KPK-së.

51.Kallëzimi penal nr.(2014-DA-3183 i datës5.12.2014),i NJHR-Pejë.

52.Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve PP nr.403/14, dt. 8.12.2014, nga P.Th.Pejë, Departament për Krime të Rënda.

53.Aktakuza PP.nr.403/14, datë 9.12.2014 e ngritur nga DKR- i PTHP, pas zhvillimit të hetimeve (sipas kallëzimit anonim), ndaj të pandehurit, R.D, fsh.K. Komuna e Pejës, për veprën penale armëmbajtje pa leje, nga neni 374, par. 2 të KPK-së.

54. Sipas aktgjykimit P.nr.312/15 të dt.26.5.2015, i akuzuari R.D. është shpallur fajtor sipas pranimi të fajësisë, që në shqyrtimin fillestar, me teje si në aktgjykimin me numër dhe datë të cekur.

55. Kallzimi penal nr.2015-DA-0846, i dt. 25.5.2015, nga NJHN, në PTH-Pejë- DKP, me dyshimin se i dyshuari R.D nga K.Pejës, ka kryer v. p.

56. Aktakuza PP nr. 261/12, datë 24.12.2012, dhe PPnr.2135/12, datë 28.12.2012

Burimet terciare

1. gjykata supreme –[ks.org/repository/doscs/Ligji për _amnistin](http://ks.org/repository/doscs/Ligji_për_amnistin) (Qasja në datën 29.9.2015)

2. http://bankofalbania.org/eb/Traktati_i_Romes_2088_1.php<http://consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/st06655-re01.en08.pdf>(aksesuar me dt. 5.4.2016.

3. http://.ipo.int/ipolex/en/text.jsp?file_id=331030 (Qasja në datën 27.9.2015)
4. http://.gjykatasupreme-ks.org/repository/docs/Kodi-i-procedurës_penale__454278.pdf
(Qasja në datën 9.08.2015)
5. <http://.infocip.org/al/?p=4134> (Qasja në datën 2.10.2015)
6. <http://.infocip.org/al/?p=4137> (Qasja në datën 9.4.2015)
7. [http://.kgjk-ks.org/repository/docs/Ligji-per-keshillin-prokuroral-\(shqip\)_60677.pdf](http://.kgjk-ks.org/repository/docs/Ligji-per-keshillin-prokuroral-(shqip)_60677.pdf) (Qasja në datën 2.10.2015)
8. http://.klsh.org.al/web/pub/20071109103905_kushtetuta_e_republikes_se_shqiperise_28_1.pdf (qasur në datën 27.9.2015)
9. http://.kosovopolic.com/repository/docs/Ligji_i_Policise1.pdf (Qasja më datën 3.7.2015)
10. http://.kryeministriks.net/repository/docs/PROJEKTLIGJI_PER_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTESIMIN_E_LIGJIT_NR.03L-199_PER_GJYKATAT.pdf (Qasja ne datën 1.6.2015)
11. Qasja ne datën 19.7.2015)
12. http://.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf
(Qasja në datën 14.5.2015)
13. http://.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_34_al.pdf (Qasja në datën 8.7.2015)
14. [http://.md-ks.net/repository/docs/Kodi_Penal_i_R.Kosoves_\(shqip\)1.pdf](http://.md-ks.net/repository/docs/Kodi_Penal_i_R.Kosoves_(shqip)1.pdf) (Qasja në datën 5.9.2015)
15. http://.md-ks.net/repository/docs/LIGJI_NR.03-L-003_PER_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTESIMIN_E_KODIT_TE_PERKOHSHEM_TE_PROCEDURËS_PENALE.pdf (Qasja në datën 1.9.2015)

16. [http://.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_Kompetencat_e_zgjeruara_\(shqip\).pdf](http://.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_Kompetencat_e_zgjeruara_(shqip).pdf)
(Qasja në datën 16.7.2015)
17. http://.pp.gov.al/ëeb/kushtetuta_perditesuar_822.pdf (Qasja në datën 13.8.2015)
18. Qasja ne datën 2.6.2015)
19. <http://.pravda.gov.mk/documents/73%20Krivicen%20zakonik%20%28izm%20i%20dopl%29.pdf> (Qasja në datën 4.4.2015)
20. Qasja ne datën 5.6.2015)
21. <http://.slideshare.net/diskovera/traktati-i-komunitetit-evropian-dhe-statuti-i-escb> (Qasja në datën 7.6.2015)
22. <http://.shish.gov.al/files/Ligjet/KUSHTETUTA%20E%20RSH.pdf> (Qasja në datën 23.7.2015)
23. http://.unicef.org/magic/media/documents/CRC_albanian_language_version.pdf (qasja në datën 2.10.2015).
24. <http://.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf> (Qasja në datën 2.10.2015).
25. http://gazetajnk.com/repository/docs/RA2003_25_CCintranet_295748.pdf (Qasja në datën 15.9.2015).
26. https://ikisource.org/ëiki/Deklarata_Universale
27. Online Education Centar <http://.dadalos-europe.org/alb> (qasja në datën 27.9.2015)
28. Dekretin nr.1188, datë 10.8.1995 “Për Policinë Gjyqësore”, qasja fizike.
29. Hulaj, Murat, Gjeneral Taks an Authorizations of Poice Inpreliminary Procedure in Kosova, Overvied by Material Target European Journal of Social Sciences Education and Research Vol.2 No.1 septembar-Dec.2014.EJSER, Rumani, 2014.
30. Hulaj Murat, The Development of Criminal and Procedural Legislation After the

Independence of Kosovo, Overvied by Material Target, International Journal of Academic Research and Reflection Vol.3, No.5.2015 ISSN 2309-0405, Angli 2015.

31. Revista “Trajtime juridike” (dhjetor 2002 – korrik 2002), seminarët e organizuara me gjyqtarët dhe prokurorët e Matit, Bulqizës dhe Dibrës, Tiranë 2002.

32. Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, përgatitur nga Jon Smibert, Këshilltar Juridik ne Departamentin e Drejtësisë, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 20

TREGUES I SHKURTIMEVE:

KPPPK-Kodi Përkohshëm Procedural i Kosovës;

KPP -Kodi Përkohshëm Penal i Kosovës;

KPPRSH-Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

KPRSH- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KPPRK - Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës;

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

KPPP – Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës;

KPP – Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës;

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur;

KRK – Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

KRSH- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

LKP – Ligji për Këshillin Prokurorial;

LKGJ- Ligji për Këshillin Gjyqësor;

LPPJ – Ligji i Procedurës Penale të Jugosllavisë;

LPSH – Ligji për Prokurorinë e shtetit;

NJHRP- Njësi i Hetimeve Regjionale Policore Pejë.

Par.-Paragraf

Fq-Faqe

PP-Procedim Penal;

KP-Kallëzim Penal.

V.P-Vepra Penale